

PASQYRA E KOMUNËS NJË VIT PAS ZGJEDHJEVE LOKALE

A ËSHTË BËRË GJITHÇKA E MUNDUR?

Organizatrat Partnere:



Kaçanik



Mitrovicë



Deçan



Klinë



Skenderaj



Graçanicë



Shtime



Fushë-Kosovë



Viti



Gjakovë



Kamenicë



Me mbështetjen e:




2014

VLERËSIMI VJETOR I 18 KOMUNAVE TË KOSOVËS
2014

PASQYRA E KOMUNËS NJË VIT PAS ZGJEDHJEVE LOKALE

A ËSHTË BËRË GJITHÇKA E MUNDUR?



VLERËSIMI VJETOR I 18 KOMUNAVE TËKOSOVËS
2014

Copyright ©2014. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)

Ky raport është bërë në kuadër të Projektit “Angazhimi Qytetarë për Transparencë dhe Llogaridhënie në Nivel Lokal.” Ky punim u mundësua me përkrahjen e Fondit për Demokraci të Kombeve të Bashkuara (UNDEF) i cili ka mbështetur KDI-në gjatë kësaj iniciative për monitorim dhe avokim për qeverisje lokale dhe ngritjen e kapaciteteve lokale për të angazhim qytetar në qeverisje lokale.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	7
Rreth Kësaj Initiative	8
1. Komuna DEÇAN.....	11
Vlerësimi i Përgjithshëm	11
<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	<i>13</i>
Transparenca në Komunë	13
Llogaridhënia në Komunë.....	14
<i>Menaxhimi i Ambientit dhe Pyjeve</i>	<i>15</i>
Rekomandimet për Deçan.....	17
<i>Rregulloret dhe Vendimet.....</i>	<i>18</i>
2. Komuna GJAKOVË	21
Vlerësimi i Përgjithshëm	21
<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	<i>22</i>
Transparenca në Komunë	23
Llogaridhënia në Komunë.....	25
<i>Arsimi dhe Shëndetësia.....</i>	<i>26</i>
<i>Ankesat në Punësime.....</i>	<i>26</i>
Rekomandimet për Komunë	27
<i>Rregulloret dhe Vendimet.....</i>	<i>28</i>
3. Komuna KAÇANIK	31
Vlerësimi i Përgjithshëm	31
<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	<i>33</i>
Transparenca në Komunë	33
Llogaridhënia në Komunë.....	34
<i>Parregullsitë në konkurse</i>	<i>35</i>
<i>Emërtimi i rrugëve</i>	<i>36</i>
Rekomandimet për Komunën.....	38
<i>Rregulloret dhe Vendimet.....</i>	<i>40</i>
<i>Struktura e Kuvendit Komunal</i>	<i>44</i>
4. Komuna KLINË	45
Vlerësimi i Përgjithshëm	45
<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	<i>47</i>
Transparenca në Komunë	48
Llogaridhënia në Komunë.....	49
<i>Fabrika e ujit të pijes</i>	<i>49</i>
<i>Trajtimi i pronës publike</i>	<i>50</i>
Rekomandimet për Komunë	51

	<i>Rregulloret dhe Vendimet</i>	53
5.	Komuna FUSHË KOSOVË	57
	Vlerësimi i Përgjithshëm	57
	<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	58
	Transparenca në Komunë	58
	Llogaridhënia në Komunë.....	59
	<i>Mungesa e klasave për parashkollorët</i>	60
	<i>Menaxhimi i Ndërtimeve të larta</i>	60
	Rekomandimet për Komunë	62
	<i>Rregulloret dhe Vendimet</i>	64
6.	Komuna KAMENICË	67
	Vlerësimi i Përgjithshëm	67
	<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	68
	Transparenca në Komunë	69
	Llogaridhënia në Komunë.....	70
	<i>Tejzgjatja e Projekteve Ndërtimore Komunale</i>	70
	<i>Mosfunksionimi i Tregut</i>	70
	Rekomandimet për Komunë	71
	<i>Rregulloret dhe Vendimet</i>	72
7.	Komuna MITROVICË	75
	Vlerësimi i Përgjithshëm	75
	<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	76
	Transparenca në Komunë	77
	Llogaridhënia në Komunë.....	78
	<i>Prolongimet e Palestrave Sportive</i>	79
	<i>Përballja me Borxhin Komunal</i>	80
	Rekomandimet për Komunë	81
	<i>Rregulloret dhe Vendimet</i>	83
8.	Komuna SKENDERAJ	87
	Vlerësimi i Përgjithshëm	87
	<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	88
	Transparenca në Komunë	89
	Llogaridhënia në Komunë.....	90
	<i>Formimi i Këshillave të Fshatrave</i>	91
	<i>Zbatimi i Rregullores për Transport Publik</i>	91
	Rekomandimet për Komunë	92
	<i>Rregulloret dhe Vendimet</i>	94

9.	Komuna SHTIME.....	97
	Vlerësimi i Përgjithshëm	97
	<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	99
	Transparenca në Komunë	99
	Llogaridhënia në Komunë.....	101
	<i>Përmbytjet nga lumi dhe Fondi i Emergjencave</i>	102
	<i>Dhënia në shfrytëzim e pronës komunale për 99 vite</i>	103
	Rekomandimet për Komunë	104
	<i>Rregulloret dhe Vendimet.....</i>	106
10.	Komuna VITI.....	111
	Vlerësimi i Përgjithshëm	111
	<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	113
	Transparenca në Komunë	114
	Llogaridhënia në Komunë.....	115
	<i>Borxhet e trashëguara</i>	116
	<i>Rreziqet nga vërshimet</i>	116
	Rekomandimet për Komunë	117
	<i>Rregulloret dhe Vendimet.....</i>	119
11.	Komuna MALISHEVË.....	123
	Vlerësimi i Përgjithshëm	123
	<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	124
	Transparenca në Komunë	125
	Llogaridhënia në Komunë.....	126
	<i>Pakënaqësitë me konkurse për arsim</i>	127
	<i>Humbja e Dosjes së Tenderit</i>	127
	Rekomandimet për Komunë	128
	<i>Rregulloret dhe Vendimet.....</i>	130
12.	Komuna JUNIK	133
	Vlerësimi i Përgjithshëm	133
	<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	134
	Transparenca në Komunë	135
	Llogaridhënia në Komunë.....	135
	<i>Menaxhimi i Mbeturinave dhe Pyjeve</i>	136
	Rekomandimet për Komunë	136
	<i>Rregulloret dhe Vendimet.....</i>	137
13.	Komuna MAMUSHË	141
	Vlerësimi i Përgjithshëm	141

<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	142
Transparenca në Komunë	142
Llogaridhënia në Komunë	143
<i>Kyçja në Autostradë</i>	144
<i>Buxhet për aktivitete rinore</i>	144
Rekomandimet për Komunë	145
<i>Rregulloret dhe Vendimet</i>	147
14. Komuna GRAÇANICË	151
Vlerësimi i Përgjithshëm	151
<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	153
Transparenca në Komunë	153
Llogaridhënia në komunë	154
Rekomandimet për Komunë	156
<i>Rregulloret dhe Vendimet</i>	157
15. Komuna PRIZREN	161
Parregullsitë	161
<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	162
Transparenca e Komunës	162
Rekomandimet për Komunë	163
16. Komuna SUHAREKË	167
Parregullsitë	167
Transparenca në Komunës	167
<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	168
Rekomandimet për Komunë	169
17. Komuna RAHOVEC	173
Parregullsitë	173
<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	173
Transparenca në Komunë	174
Rekomandimet për Komunë	175
18. Komuna DRAGASH	179
Parregullsitë	179
<i>Statusi i Premtimeve Zgjedhore</i>	180
Transparenca në Komunë	180
Rekomandimet për Komunë	181
PËRFUNDIMET	183
Aneks: Premtimet e Gjitha Komunave	184

PËRMBLEDHJE

Viti 2014 solli mjaft risi në qeverisjen lokale. Ky vit nisi vitin e parë të mandatit të pestë të qeverisjes lokale që nga paslufta dhe shumë kryetarë të komunave erdhën për herë të parë në krye të udhëheqjes komunale. Pa dyshim që këta kryetarë të rinj sollën energji të re në komunat e tyre dhe në qeverisjen lokale. Për herë të parë, tri subjekte politike morën udhëheqjen e komunave të Kosovës, gjegjësisht AKR, LVV dhe Lista Serbe.

Përderisa viti 2014 karakterizohet si një vit kryesisht si joefektiv për nivelin qendror të qeverisjes, ai ka qenë mjaft dinamik për vetë-qeverisjen lokale, përjashtuar këtu katër komunat në veri të vendit me shumicë serbe që ishin jofunksionale.

Megjithatë, banorëve të Kosovës ende nuk u ofrohen shërbime publike nga më baziket si menaxhimi i mbeturinave, uji i pijshëm, kanalizimi, qasja e afërt tek mjeku, transporti publik për fëmijët që kanë shkollën larg, ndriçimi publik dhe mbrojtja nga vërshimet për tokat e tyre prej së cilës mbajnë familjet. Të gjitha këto shërbime publike kanë paraqitur problem në më shumë se dy nga komunat e monitoruara dhe shumica janë përgjegjësi ekskluzive e vetëqeverisjes lokale.

Me shkurtimin e investimeve kapitale në shumicën e komunave për vitin 2015, si shkak i rritjes së pagave në mënyrë lineare, si dhe borxhet e lëna më herët në disa komuna, qeveritë lokale kanë nevojë shumë për planifikim më të mirë të buxhetit, konsultime më të afërta dhe më kualitative me banorët, por dhe bashkëpunim më të ngushtë me shoqërinë civile që t'iu dalin ballë sfidave të ofrimit të shërbimeve publike.

Qytetarët presin edhe realizmin e premtimeve zgjedhore, apo 'mbajtjen e fjalës' siç shpesh njihet në publik, që kanë dhënë udhëheqësit e tyre sa kanë qenë kandidatë në zgjedhje. Përkundër që pothuajse asnjëri kandidatë për kryetarë të komunave nuk u ka ofruar votuesve ofertën zgjedhore dhe premtimet në të shkruar, grupi i organizatave monitoruese në vitin 2013 kishte monitoruar premtimet e dhëna në tubime zgjedhore. Nga 126 premtimet zgjedhore të dhëna nga kryetarët e 18 komunave, sa kanë qenë kandidatë për kryetarë, ky raport tregon se vetëm 27 prej tyre janë realizuar plotësisht në vitin e parë, kurse për 41 premtime ka filluar realizimi në gjysmën e dytë të vitit. Disa nga premtimet e dhëna dhe që ende presim të realizohen nuk kanë kosto financiare, siç është bërja më transparente e komunës, ndalimi i nepotizmit në punësim dhe konsultimi më i ngushtë i qytetarëve, kurse disa tjera madje edhe do ti kursenin fonde komunës siç është reduktimi i drejtorive komunale.

Ky raport, tregon se në shumë komuna udhëheqësit ende nuk ofrojnë llogari sa pritët për punën e bërë. Edhe këtë vit janë vërejtur kryetarë të komunave që nuk japin llogari të mirëfilltë para publikut në takime publike dhe para anëtarëve të Kuvendit Komunal, janë vërejtur kryetarë që nuk kanë konsultuar banorët e komunave të tyre për planifikimet buxhetor të vitit të ardhshëm dhe janë vërejtur kryetarë që nuk ofrojnë në mënyrë të qasshme dhe online buxhetet, shpenzimet, vendimet, planet dhe investimet e komunave. Grupi i organizatave tona edhe këtë vit ka vërejtur një menaxhim jo të mirë të ueb-faqeve zyrtare të komunave, të cilat do duhet të ishin një burim i mirë për banorët e këtyre komunave.

Puna në kuvendet komunale, në përgjithësi, kanë qenë të zbehtë për ndikim në politikat lokale, ofrimin e alternativave dhe mbajtjen në llogari të degës ekzekutive. Përkundër faktit se kryesuesit e komunave në të shumtën e komunave kanë qenë korrekt me anëtarët e kuvendit të tyre, anëtarët e Kuvendit nuk kanë shfrytëzuar sa kanë patur mundësi kuvendet komunale për të shtyer politika në të mirë të komunës dhe përfaqësim të qytetarëve. Në katër komuna kemi vërejtur ashpërsim të gjuhës në mes të Kryetarëve dhe anëtarëve të Kuvendit, kryesisht të opozitës, dhe disa kanë quar edhe në bojkotim të punës së Kuvendit.

Rreth Kësaj Iniciative

Të gjeturat e këtij raporti janë të bazuara në monitorimin e rregullt dhe të vazhdueshëm të komunave gjatë tërë vitit 2014. Me këtë iniciativë monitorohen gjithsej 18 kuvende komunale duke përfshirë të gjitha rajonet e Kosovës. Organet që janë monitoruar më direkt kanë qenë Kuvendi komunal dhe Zyra e Kryetarit. Këto të dhëna bëjnë përpjekje të ofrojnë një pasqyrë të qeverisjes një vjeçare duke potencuar mangësitë por edhe arritjet gjatë këtij viti.

Njëjtë si në vitin 2013, edhe këtë vit monitorimi i komunave është bërë nga organizata jo-qeveritare që operojnë në këto komuna, ndërsa KDI ka monitoruar drejtpërdrejtë vetëm komunat e rajonit të Prizrenit.

KDI ka dizajnuar metodologjinë e monitorimit duke përfshirë këtu edhe mjetet e monitorimit dhe ka trajnuar organizatat partnere në monitorim dhe raportim. Metodologjia e monitorimit ka pasur për qëllim matjene transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit të punës së organeve komunale. Qëllimi ka qenë që të bëhet monitorimi i gjitha komunave me një metodologji të njëjtë që qytetarët si dhe zyrtarët të mund të bëjnë edhe krahasime me qeverisje lokale të komunave tjera të Kosovës.

Raporti po ashtu ofron rekomandime për institucione lokale si Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Anëtarët e Kuvendit. Edhe pse tashmë shumë nga kryetarët e mandatit të kaluar nuk janë më në zyre të Kryetarit, besojmë se këto rekomandime duhet të merren parasysh nga qeverisja e re sepse besojmë që kjo qeverisje të jetë më e avancuar se e kaluara.

Më tutje, KDI dhe organizatat partnere kanë monitoruar premtimet e kandidatëve për kryetarë të komunave për zgjedhje lokale 2013 dhe për secilën komunë ka vënë një tabelë me premtimet e kryetarëve ku në njërin anë listohet premtimi kryesor që është monitoruar dhe në anën tjetër statusi i premtimit. Kjo synon tu ofrojë qytetarëve një mekanizëm për të mbajtur përgjegjës të zgjedhurit e tyre ndaj këtyre premtimeve dhe tu mundësojë organizatave jo-qeveritare të monitorojë këto premtime se a do të bëhen realitet apo të mbesin fjalë boshe. Për komunat e rajonit të Prizrenit, KDI ka bërë raporte më të detajuara prandaj dhe në këtë raport përfshihen vetëm disa të gjetura kryesore të këtyre komunave.

OJQ-të partnere për këtë nismë janë: Bashkohu Edhe Ti – Gjakovë, Elita – Viti, Fortesa – Kamenicë, Iniciativa Për Zhvillim Lokal - Fushë Kosovë, Instituti Demokratik i Kosovës – 6 komuna të rajonit të Prizrenit, Klubi i Gazetarëve - Kaçanik, KOHA – Klinë, Mundësia – Mitrovicë, POLIS- Shtime, Prehja – Skenderaj, Shoqata Intelktualëve të Pavarur - Deçan dhe Junik, Srpska Demokratska Omladina – Gračanica.



Komuna Deçanit


SHOQATA E INTELKTUALËVE TË PAVARUR




ASSOCIATION OF INDEPENDENT INTELLECTUALS

Struktura e Komunës

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



1. Komuna DEÇAN

Vlerësimi i Përgjithshëm

Cfarë e karakterizojë komunën këtë vit

Pas përfundimit të Zgjedhjeve Lokale 2013, Komuna e Deçanit kishte vonesë të pazakonshme në konsolidimin e institucioneve, përkatësisht në emërimin e drejtorëve të drejtorive komunale. Kryetari i rizgjedhur z. Rasim Selmanaj, (mandati i tij i dytë) ka bërë vetëm një ndryshim në kabinetin e tij (vetëm një drejtor është zëvendësuar, nga mandati i kaluar). Pra, kryetari i komunës, nuk ishte në gjendje të bën ndryshime në ekzekutivin komunal, përkundër premtimeve të dhëna, gjatë fushatës zgjedhore. Ai, vazhdon të qeverisë me 11 drejtori, edhe pse është në kundërshtim me Statutin e Komunës.

Legjislativi komunal, edhe nga zgjedhjet e fundit, ka nxjerr fituese subjektin politik të AAK-së, duke marrë numrin më të madh të ulëseve. Mirëpo, për dallim nga përbërjet e kaluara, kësaj radhe, për herë të parë ulëse në Kuvendin Komunal të Deçanit, ka siguruar edhe Lëvizja Vetëvendosje. Legjislatura e tashme e Kuvendit përbëhet nga: 13 këshilltar nga AAK-ja, 9 nga LDK-ja, 3 nga PDK-ja dhe 2 nga LVV-ja.

Puna e Kuvendit Komunal është karakterizuar me vonesat e shumta në fillim të seancave, daljeve të shpeshta nga seancat, gjë që është bërë edhe dukuri e vazhdueshme. Po ashtu, mos përgatitja e duhur e anëtarëve të Kuvendit (Asamblesë), ka bërë që, disa nga anëtarët e legjislativit, asnjëherë të mos diskutojnë për çështjet e prezantuara në agjendën e punës. Kuvendit Komunal, nuk ka arritur të bën ndryshime në Statutin Komunal, përkundër asaj që është në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Akti më i lartë juridik të Komunës, parasheh se, buxhetit i komunës, duhet ti marr 2/3 e votave, çka do thotë se, 18 këshilltar duhet ngritur dorën në përkrahje të buxhetit të planifikuar.

Problemet kryesore të komunës

Përkundër asaj që ka resurse të shumta zhvillimore, qofshin mbi tokësore apo nën tokësore, Deçani mbetet njëra ndër komunat më të pa zhvilluara të Kosovës. Qytetarët e Deçanit përballën me probleme të shumta:

- Mungesë të kanalizimit të ujërave të zeza, sidomos në zonat rurale. Projekti për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në zonën urbane është duke vazhduar, por çështja e ujërave të zeza mbetet problem, për gjitha lokalitetet e zonave rurale.
- Furnizimi me ujë të pijes, është problem për disa lokalitete, sidomos për fshatrat në regjionin e Vokshit. Mirëpo, përkundër vështirësive të dala gjatë kryerjes së punimeve dhe mungesës së mjaftueshme të ujit, është realizuar projekti për furnizim me ujë për 10 fshatra (Prejlep, Prekolluk, Irzniq, Rastavicë, Baballoq, Glllogjan, Shaptej, Dubravë, Gramaqel dhe Jasiq i Ri).
- Ndotja e mjedisit, është ndër problemet më të mëdha të kësaj komune që pretendon të bëhet komunë turistike, pasi që posedon natyrë dhe resurse të mira për të zhvilluar këtë veprimtari. Në mbrojtje të bukurive natyre të kësaj komune, pos vullnetit qytetar, mungon përkushtimi institucional, sidomos i Shërbimit të Inspeksionit. Ky shërbim është në thumb të kritikave nga qytetarët edhe për mos efikasitet, edhe në fusha tjera të rëndësishme për qeverisje të mirë.

- Shkatërrimi i pyjeve dhe pa mundësia e shfrytëzimit të resurseve turistike, janë ndër problemet tjera të kësaj komune. Pyjet e Deçanit (Bjeshkët e Nemuna), po iu nënshtrohen shkatërrimit masiv nga prerjet legale dhe ilegale. Resurset hoteliere-turistike janë të pa shfrytëzuara nga ndikimet politike që vijnë nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, pasi që konsiderohen si objekte që janë brenda zonës së mbrojtur me Ligj (manastiri e Deçanit).
- Borxhi publik që përcillet vit pas viti, shpenzimet e mëdha për karburante, riparime i makinave zyrtare, shpenzimet për subvencione ishin bazë e akuzave të ngritura nga subjektet opozitare, drejtuar kundër kreut komunal dhe stafit të tij.

Të arriturat në vitin 2014

Komuna e Deçanit ka shënuar rritje të investimeve dhe zhvillimit. Ndër investimet më të mëdha mund të konsiderohen investimet që bëhen në ndërtimin e tri hidrocentraleve në “Grykën e Deçanit”, si dhe ndërtimi i fabrikës për grumbullim dhe përpunim të produkteve të mjaltit. Mirëpo, për të dyja këto investime ka pasur reagime dhe mospajtime nga qytetarët dhe subjekteve opozitare, sepse konsiderojnë se këto investime janë të dështuara, sidomos për fabrikën e mjaltit pasi që dyshohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe investim politik (nga ndikimi i Manastirit të Deçanit).

Ndër sukseset apo të arriturat më të rëndësishme në këtë periudhë qeverisëse, konsiderohet edhe nisja e punimeve në ndërtimin e rrugës që lidh Deçanin me Plavën, gjë që krijon mundësi për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, sidomos të turizmit. Po ashtu, sukses dhe e arritur e çmueshme, mund të konsiderohet përfundimi i ujësjellësit për 10 fshatra (Prejlep, Prekolluk, Irzniq, Glllogjan, Shaptej, Gramaqel, Dubravë, Baballoq, Rastavicë dhe Jasiqi i Ri), që ishte ndër shqetësimet dhe kërkesat më të mëdha të qytetarëve.

Në Deçan për herë të parë është organizuar edhe panairi tre ditor veror turistik, ku ishin prezantuar produkte nga prodhues të ndryshëm nga Kosova dhe jashtë saj. Ky panair është përcjell edhe me koncerte të zhanreve të ndryshme të muzikës shqiptare.

Kuvendi Komunal pas diskutimit publik ka aprovuar Rregulloren Komunale për Bashkëpunim me fshatra, e cila pritet të zbatohet gjatë vitit vijues, që kërkohet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Këshilltarët komunal ishin pjesë aktive e debateve të organizuara me qytetar, si nga organizimet e bëra nga shoqëria civile apo edhe nga vet ky institucion. Këtu më duhet përmend takimet e organizuara nga SHIP dhe KDI me qytetar të rajonit të Vokshit dhe të fshatit Shaptej. Anëtarët e Kuvendit ishin pjesëmarrës i shumë tryezave në të cilat janë trajtuar shqetësime të ngritura nga qytetarët apo diskutime publike, për trajtim të rregulloreve dhe vendimeve të ndryshme komunale. Në çdo takim të shoqërisë civile, pos kryesuesit të Kuvendit, merrnin pjesë edhe përfaqësuesit e subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend.

Vlerësimi për performancë në transparencë

a. Kryetari i komunës ka raportuar një herë në fund të vitit para anëtarëve të Kuvendit por prapë nuk ka respektuar obligimin ligjor, (Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin), që e obligojnë të raporton, së paku dy herë, para anëtarëve të Kuvendit Komunal. Kryetari i komunës, Rasim Selmanaj, disa herë është akuzuar nga opozita deçanase, kryesisht nga LDK-ja, për keqqeverisje, keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe shpërdorim të buxhetit komunal, sidomos në linjat buxhetore që kanë të bëjnë me subvencione dhe mallra e shërbime. Akuzat e këshilltarëve opozitar dhe shoqërisë civile, janë të drejtuara kryesisht në shpenzime të shumta për karburante dhe mirëmbajtje të makinave zyrtare, sikurse edhe

për shpenzime që ndërlidhen me dreka zyrtare, mëditje dhe subvencionim të individëve dhe organizatave të shoqërisë civile (Grupi Lokal i veprimit dhe Shoqata Jeta).

b. Drejtorët e Drejtorive Komunale. Prania e drejtorëve të drejtorive komunale në seancat e Kuvendit dhe takimet e KPF-së, ka qenë e vogël dhe shpesh ka ndodhur që në takime, të mos jetë prezent, as kryetari i komunës, as drejtorët e tij.

c. Anëtarët e Kuvendit si përfaqësues të qytetarëve, duhet të jenë të përgjegjshëm ndaj tyre. Ata, në bazë të përgjegjësisë së marrë nga qytetarët, janë të obliguar që të ballafaqohen me shqetësimet dhe kërkesat e qytetarëve, duke marrë vendime të duhura për interes të përgjithshëm, pa dallime partiake. Mirëpo, një pjesë e këshilltarëve, më shumë ishin të interesuar për pagat e tyre, se të përfaqësojnë interesat e qytetarëve. Gjatë mandatit të kaluar, kishte këshilltar që asnjëherë nuk ka diskutuar në seancat plenare. Anëtarët e Kuvendit (kryesisht opozita), ishin të injoruar për kërkesat e tyre në adresë të ekzekutivit komunal. Kërkesat e tyre për raportim, prezantim të raporteve financiare, transparencë në shpenzime buxhetore, nuk ishin përfill, ndaj kishte reagime të ndryshme, edhe lëshim të seancës.

d. Kryesuesi i Kuvendit është në mandatin e tij të tretë, duke qenë me një përvojë të gjatë në këtë pozitë. Ai nuk ka reflektuar ndonjë preferencë të veçantë për asnjërin grupim politik, duke gëzuar edhe respekt nga të gjithë anëtarët e Kuvendit sikurse edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Ky respekt që gëzon kryesuesi i takimeve ka bërë që seancat të kalojnë pa ndonjë problem të theksuar ndaj edhe nuk ka ndodhur që të ndërmerren masa ligjore ndaj këshilltarëve, qoftë me ndërprerje të diskutimeve, marrjes së fjalës apo largimit nga seanca.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Penda në Hulaj dhe “Grykë të Deçanit	Pa-realizuar
2	Shëtitoren përgjatë lumit “Lumëbardhi”	Pa-realizuar
3	Rruga Deçan-Plavë	Kanë filluar punimet
4.	Asfaltimin e gjitha rrugëve lokale	Pjesërisht
5.	Bursa për studentët	Planifikuar
6.	Uji të pijes për gjitha fshatrat	Pjesërisht
7.	Investime të shumta në bujqësi	Planifikuar me buxhet pamjaftueshëm
8.	Transparencë më të madhe	Pjesërisht

Transparenca në Komunë

Transparenca komunale, si te legjislativi ashtu edhe te ekzekutivi, ka shënuar ngritje duke bërë që qytetarët, sidomos shoqëria civile, të kenë më shumë informacione rreth aktiviteteve komunale. Gjatë mandatit të shkuar, është arritur progres në lajmërimin e seancave të Kuvendit, duke shfrytëzuar edhe faqen zyrtare të internetit, rrjetin social Facebook, monitorin e vendosur në hyrje të komunës, si dhe tabelën informative të vendosur në qytet.

Edhe pse, si ekzekutivi ashtu edhe legjislativi janë të obliguar të konsultojnë qytetarët në planifikimin buxhetor afatmesëm dhe vjetor, kjo gjë është bërë pjesërisht. Që të diskutohet,

Korniza Afatmesme Buxhetore, legjislativi ka mbajtur një dëgjim publik, por jo edhe ekzekutivi i kësaj komune. Si planifikimi, ashtu edhe shpenzimi i buxhetit, nuk bëhet publik, as përmes faqes zyrtare apo formave tjera të publikimeve. Edhe pse është obligative të raportohet për shpenzimet buxhetore në çdo tre muaj, kjo gjë nuk ndodh, sikurse që nuk është raportuar, as në periudhën gjashtë mujore.

Nga OJQ-të vendore, monitorimin e punës së komiteteve dhe seancave plenare, e bën vetëm SHIP-KDI. Ndërsa nga ato ndërkombëtare OSBE-ja dhe KFOR-i (Njësit për ndërlidhje dhe monitorim-LMT).



Përgjithësisht, legjislativi i komunës ka qasje pozitive ndaj shoqërisë civile dhe mediave, duke ofruar hapësira të duhura për të qenë pjesë e proceseve të vendimmarrjes. Mirëpo, kjo komunë, vazhdon të mos ketë asnjë komitet konsultativ, përkundër kërkesave të vazhdueshme të shoqërisë civile për krijimin e këtyre komiteteve, që do mundësonin qasje më të madhe të shoqërisë civile, në proceset e vendimmarrjes.

Mungesa e interesimit të qytetarëve dhe subjekteve të ndryshme për qasje në dokumente zyrtare, ka bërë që një numër i vogël i kërkesave të adresohen në zyrën për qasje në dokumente zyrtare, pranë kuvendit komunal. Sipas zyrtarit për qasje në dokumente zyrtare, janë adresuar vetëm 11 kërkesa për qasje në dokumente, kryesisht nga persona juridike.

Faqja zyrtare e komunës së Deçanit, kryesisht freskohet me aktivitetet e zhvilluara nga kreu komunal si dhe njoftime të ndryshme komunale. Po ashtu, në faqen zyrtare janë të vendosura edhe disa nga dokumentet bazë, siç është: Statuti i komunës, Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban, etj. Komuna e Deçanit ka të hapur edhe faqen në rrjetin social të Facebook. Mirëpo, kjo komunë nuk prezanton dokumente të rëndësishme për qytetarët si: projektet kapitale, buxhetin komunal, ankande publike, procesverbale të takimeve apo dokumente të natyrave të ngjashme.

Llogaridhënia në Komunë

Bazuar në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale dhe Statutin Komunal, kryetari i komunës është i obliguar, së paku dy herë në vit, të raportojë para qytetarëve, për angazhimet e tij dhe të stafit, raport i cili duhet të jetë i prezantuar edhe me shkrim. Raportimi para Kuvendit, gojarisht dhe me shkrim, është bërë vetëm një herë me 29 dhjetor. Gjatë këtij viti, kryetari i komunës ka raportuar gojarisht, para qytetarëve. Kryetari i komunës, sipas njoftimit të vendosura në tabelën informuese dhe faqen zyrtare, ka caktuar ditën e premtë, (nga ora 14-15), për takime me qytetar, me qëllim të informimit të tyre, me punën që bën ekzekutivi i komunës, sikurse edhe njohja me hallet dhe kërkesat e tyre. Mirëpo, një gjë e tillë, nuk është realizuar në mënyrë të kënaqshme.

Komuna e Deçanit, është e hendikepuar për nga mbulimi medial. Kjo komunë, përkundër përpjekjeve të disa medimeve, që të mbulojnë ngjarjet, mediat e shkruara nuk kanë korrespondent të angazhuar në Deçan. Trajtimi i mediave nga ana e legjislativit dhe ekzekutivit komunal, ishte në nivel të mirë.

Bazuar në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale dhe Statutin Komunal, kryetari i komunës është i obliguar, së paku dy herë në vit, të raportojë para këshilltarëve komunal, për angazhimet e tij

dhe të stafit, raport i cili duhet të jetë i prezantuar edhe me shkrim. Mirëpo, kryetari i komunës, sikurse edhe në mandatin e kaluar, nuk ka raportuar para legjislativit komunal.

Legjislativi komunal ka mbajtur dëgjim publik dhe takime konsultative me sektorin e shëndetësisë dhe arsimit, për planifikimin afatmesëm buxhetor, 2015-2017. Në dëgjimin publik me qytetar ishin të pranishëm mbi 30 qytetar të cilët kishin kërkesa kryesisht infrastrukturore për rajonin nga vinin. Mirëpo, në planifikimin final të buxhetit dhe aprovimin e tij, pak ishin marrë parasysh, kërkesat dhe propozimet e qytetarëve. Këtu mund të përmendet si shembull i mirë, planifikimi i projektit kapital për rregullimin e ujësjellësit për regionin e Vokshi, projekt i kërkuar nga SHIP-KDI, si kërkesë e dal nga takimi me qytetar.

Këshilltarët komunal nuk kanë organizuar ndonjë takim me qytetar, pos atyre zgjedhore, mirëpo gatishmëria e tyre për të marrë pjesë në takime të organizuara nga shoqëria civile, ishte e një niveli të mirë.

Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i takimeve	Numri	Në rend dite	Pjesëmarrja	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare	10	42	97.04	96.67
Komiteti për Politikë dhe Financa	12	67	100%	100%
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli Komunal Sigurisë në Bashkësi	4		Po	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	2		35 persona	

Menaxhimi i Ambientit dhe Pyjeve

Deçani krenohet me bukuritë natyrore që posedon, por këto bukuri shkatërrohen vazhdimisht, si në zonat malore, ashtu edhe ato fushore. Mbeturinat e shumta dhe hedhja e tyre nëpër rrugë, lumenj,... po shëmtojnë bukuritë e kësaj komune që pretendon të bëhet turistike. Stoque të shumta, deponitë ilegale, niveli jo i mirë i vetëdijes qytetare për mjedis të pastër, mungesa e shërbimeve të mira publike nga institucionet gjegjëse, po krijojnë imazh të keq për investitorët e interesuar.



Bjeshkët e Nemuna paraqesin resurs të madh të zhvillimit, jo vetëm për Deçanin, por edhe më gjerë. Këto resurse natyrore, janë duke u shkatërruar nga prerjet ilegale dhe legale, duke bërë që Deçani të humb shumë në aspektin material. Deçanasit e kritikojnë qeverinë lokale dhe qendrore, për gjendje e mjerë në pyje. Deçanasit, po ashtu kanë reaguar edhe ndaj investimeve që bëhen në grykën e Deçanit për ndërtimin e tri hidrocentraleve, që sipas tyre, punimet që po bëhen, janë duke dëmtuar natyrën dhe ujësjellësin, çka kanë detyruar inspeksionin komunal të ndërmer masa të përkohshme në ndalimin e punimeve.

Legjislativi i kësaj komune, ka kundërshtuar memorandumën e ofruar nga Ambasada gjermane me të cilin, Komuna e Deçanit dhe manastiri ortodoks, do arrinin marrëveshje për rehabilitimin e një pjese të hapësirës brenda zonës së mbrojtur (zonës rreth manastirit), por e njëjta të kalohet në pronësi të manastirit të Deçanit. Sipas këshilltarëve, ky vendim me premisa politike dhe të dëmshme për Deçanin, nuk do pranohet, ndaj edhe do shfrytëzohet çdo rrugë ligjore dhe politike, që ky vendim, të mos realizohet.



Në Deçan, është shqetësuese dukuria e vjedhjeve të shtëpive nëpër çdo lokalitet, duke bërë që siguria publike të jetë, temë diskutimi, si nëpër institucione, ashtu edhe lokale dhe ndëja të ndryshme. Qytetarët duke mos u pajtuar me neglizhencën institucionale për kapjen e kryesve të veprave të tilla, janë detyruar të vet organizohen në ruajtje të pronave të tyre.

Rekomandimet për Deçan

Zyrës së Kryetarit të Komunës:

- Kryetari i komunës duhet të përfill ligjin dhe në mënyrë të rregullt të raporton para këshilltarëve komunal, ashtu siç parashihet edhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës.
- Kryetari dhe stafi i tij, duhet të jenë prezent në takimet e Kuvendit komunal dhe tu përgjigjet këshilltarëve në çështjet e ngritura nga ata.
- Të fillohen konsultimet, në momentin kur hartohet buxheti, si dhe të merren parasysh sugjerimet e tyre. Po ashtu, para se të realizohen projektet kapitale apo vendime të rëndësishme, të bëhet konsultimi i qytetarëve dhe shoqërisë civile.

Kryesuesit të Kuvendit:


- Kryesuesi të gjen mënyra që obligon këshilltarët komunal për respektim të orarit të takimeve, qoftë në ardhje apo mos lëshim të seancave
- Kryesuesi të inkurajon organizatat e shoqërisë civile që të jenë më aktive në monitorimin e punës së kuvendit dhe KPF-së, si dhe të marrin pjesë aktive në proceset e vendimmarrjes.
- Të bëhen publike raportet, vendimet, rregulloret dhe dokumentacionet tjera përcjellëse, të parapara edhe me ligj në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Asamblistëve të Kuvendit:

- Këshilltarët të jenë më aktivë në debate dhe marrjen e vendimeve, duke arsyetuar besimin e marrë.
- Seancat e Kuvendit të fillojnë në kohën e paraparë dhe sipas agjendës së planifikuar, jo të vonohen siç është bërë praktikë e deritanishme.
- Këshilltarët komunal, mos të lëshojnë seancat para mbylljes së punimeve;
- Këshilltarët komunal, të kenë kontroll rigoroz mbi shpenzimet buxhetore, duke kërkuar edhe arsyeshmërinë e këtyre shpenzimeve.

Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
<i>Rregullorja e punës së Kuvendit</i>	Miratuar	Pro: 26; Kundër: 0; Abs: ____
<i>Vendimi për themelimin e çmimit “krenaria e Deçanit”</i>	Miratuar	Pro: 25; Kundër: 2; Abs: ____
<i>Rregullorja për punë e Komisionit për emërtime e shesheve, rrugëve,...</i>	Miratuar	Pro: 25; Kundër: 0; Abs: ____
<i>Shqyrtimi i Raporti të Auditorit të Përgjithshëm</i>	Miratuar	Pro: ____ Kundër: ____ Abs: ____
<i>Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2015-2017</i>	Miratuar	Pro: 25; Kundër: 0; Abs: 1
<i>Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi</i>	Miratuar	Pro: 26; Kundër: 0; Abs: 0
<i>Themelimi i Komitetit për Arsim</i>	Miratuar	Pro: 26; Kundër: 0; Abs: 0
<i>Rregullorja për transportin publik dhe urban</i>	Miratuar	Pro-27 Kundër-0, Abs-0
<i>Shqyrtimi dhe miratimi i propozim buxhetit për vitin 2015</i>	Miratuar	Pro-18 Kundër-8, Abs-1
<i>Themelimi i Komitetit për Shëndetësi</i>	Miratuar	Pro: 26; Kundër: 0; Abs: 0
<i>Rregullorja komunale për bashkëpunim me fshatra, lagje....</i>	Miratuar	Pro: 26; Kundër: 0; Abs: 0
<i>Rregullorja e punës së Kuvendit</i>	Miratuar	Pro: 26; Kundër: 26; Abs: ____




Komuna
Gjakovë




Struktura e Komunës

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



2. Komuna GJAKOVË

Vlerësimi i Përgjithshëm

Çfarë e karakterizojë komunën këtë vit

Punën e Komunës së Gjakovës këtë vit e ka karakterizuar zhvillimi i seancave maratonike ku në shumicën e rasteve është ashpërsuar gjuha politike në mes opozitës, kryesisht anëtarëve të AAK-së dhe Kryetares Znj. Mimoza Kusari Lila për temat e shëndetësisë, arsimit, punësimit dhe borxheve të trashëguara nga qeverisja e kaluar. Përderisa vullneti për zgjidhje të problemeve lokale dhe transparenca është rritur në komunë, këtë vit komunën e kanë karakterizuar edhe konflikte në mes të Kryetares dhe ndërmarrjes komunale Çabrati, kryesisht për pastrimin e dëborës dhe mbeturinave në qytet, që mbetin sfida në komunë.

Kuvendi Komunal i Gjakovës për vitin 2014 ka mbajtur 10 seanca të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme ku janë diskutuar dhe aprovuar mbi 65 vendime. Kuvendi Komunal nuk ka staf të mjaftueshëm për përpunimin e informatave brenda organeve komunale dhe si rrjedhojë ka edhe mungesa të informatave bazike siç janë të dhënat kontaktuese dhe biografike për anëtarët e Kuvendit Komunal.

Gjatë kësaj periudhe nga Kuvendi Komunal ka munguar bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me bashkitësitë lokale, nuk ka arritur të aprovohet Rregullorja e Punës; ka munguar raportimi i mirëfilltë nga drejtoritë komunale para anëtarëve të Kuvendit. Ndërsa anëtarët e Kuvendit Komunal nuk kanë shfrytëzuar seancat për të propozuar në rend të ditës çështje për shqyrtim që do të ngritnin hallet e qytetarëve dhe komuniteteve të ndryshme të komunës.

Problemet kryesore të komunës

Pastrimi i rrugëve dhe trotuareve nga dëbora – Në sezonin e dimrit ka dështuar pastrimi i rrugëve dhe trotuareve, gjë që ka vështirësuar tejmasë qarkullimin e këmbësorëve dhe automjeteve në qytet dhe fshatra. Madje ka patur edhe një rritje të numrit të lënduarve si shkak i mos pastrimit të rrugëve dhe trotuareve nga dëbora dhe akulli;

Mbledhja e mbeturinave – Mbetet problem pastrimi i qytetit dhe mbledhja e mbeturinave. Komuna ka bërë përpjekje duke miratuar një Rregullore për Menaxhimin e Mbeturinave dhe ka pastruar në disa raste lumin Krena por mbledhja e mbeturinave dhe mos-disiplimi i qytetarëve dhe disa bizneseve mbetet problem. Fërkimet në mes të Komunës dhe kompanisë së ndërmarrjes publike për këtë punë nuk kanë ndihmuar për të zgjidhur këtë problem;

Qenët endacak – ky problem që po i përcjell shumë komuna të Kosovës nuk ka arritur të zgjidhet as në Komunën e Gjakovës dhe ka përbërë rrezik serioz për publikun e Gjakovës.

Borxhet e trashëguara – Janë trashëguar mjaft borxhe financiare nga mandati i kaluar gjë që ka rënduar buxhetin e komunës për këtë vit dhe kanë ngelur së filluar realizimi për disa projekte kapitale;

Shëndetësia – Mosfunksionalizmi për një periudhë të mirë të vitit të Qendrës të Mjekësisë Familjare në qytet, mungesa e barnave esenciale, transporti për stafin në zonat rurale dhe mungesa e ngrohjes së institucioneve shëndetësore për sezonin dimërorë;

Shqetësimet për politizim të punësimeve- Ka patur mjaft shqetësime nga opozita dhe qytetarë për tendencë në politizim të punësimeve si në arsim dhe sport, ashtu edhe në borde të ndërmarrjeve komunale;

Të arriturat në vitin 2014

Disa nga të arriturat e Komunës së Gjakovës për këtë vit mund të përmenden: përpjekjet për zhvillim ekonomik lokal, përfundimi i disa projekteve infrastrukturore në qytet, vazhdimi i përmirësimit të infrastrukturës rrugore në zonat rurale, menaxhimi i ndriçimit publik në zona rurale dhe urban, ngritja e nivelit të transparencës në komunë si dhe themelimi i zyrave të vendit. Këtë vit komuna ka arritur të filloj zgjerimin e hapësirave gjelbëruese në qytet dhe ka qenë arritje e mirë fillimi shëndrrimit të ish-kazermës ushtarake në park multi-funksional. Mbetet të shihet realizimi i plotë i këtij projektit komunal.

Komuna ka arritur që këtë vit të shtojë cilësinë dhe numrin e aktiviteteve kulturore dhe ka arritur të sjell mjaft muzikant dhe artisët nga Kosova dhe jashtë Kosova për të performuar për publikun e Gjakovës.

Është për tu vlerësuar si arritje edhe Konferenca e Donatorëve në fillim të vitit si përpjekje për të tërhequr vëmendjen e donatorëve dhe Qeverisë së Kosovës tek nevojat e Gjakovës. Megjithatë këto përpjekje duhet të vazhdoen dhe të përcjellën për realizim të projekteve për qytetarët e komunës.

Vlerësimi për performancë në transparencë

Ekzekutivi i ri i komunës ka arritur të ngrit nivelin e transparencës në buxhet, shpenzime dhe të dhëna për politika e projekte komunale. Funksionalizimi i *Qendrës për Informim* e themeluar nga KDI në bashkëpunim me Komunën ka rezultuar si një përpjekje e mirë për të informuar më lehtë qytetarët rreth shërbimeve publike, konkurseve për punësime dhe evidentim e kërkesave dhe të shqetësimeve të qytetarët. Megjithatë, Kryetarja e komunës nuk ka ndarë një kohë të caktuar për takime me qytetarë siç është praktikë e shumë kryetarëve të komunave.

Edhe pse mbetet mjaft për tu bërë në rritjen e konsultimit me publik dhe bashkësi lokale, ekzekutivi ka qenë prezentë në takimet e Kuvendit Komunal dhe kryesisht ka dhënë sqarime të mjaftueshme për anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët, kryesisht përmes medieve lokale.

Sidoqoftë, kanë mungesë të raportit të punës nga drejtoritë komunale për anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët. Nuk është raportuar asnjëherë në Komunë nga drejtorët dhe nuk ka raporte të publikuara në ueb-faqe. Për shkak të mungesës së stafit në sekretarinë e Kuvendit, Kryesuesi përballet me vështirësi për të informuar qytetarët për punën e këtij institucioni dhe për konsultime publike pa u varur në Zyrën e Kryetares.

Gjithashtu, në pjesën e parë të vitit Drejtori Komunal për Shërbime Publike kishte dhënë dorëheqje si shkak i shpërdorimit të postit zyrtar.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Projekte Kapitale: “Zgjerimi i rrugës në dalje të Prizrenit dhe Pejës”.	Pa-realizuar
2	Përfshirje të qytetarit në të gjitha proceset e planifikimit dhe marrjes së vendimeve në lidhje me të	Realizuar

	ardhmen e Komunës”.	
3	“Ndërtimi i Gjakovës së Re dhe Qendra e Kongreseve”	Pa-realizuar
4.	Ndërtimi i Pikave Grumbulluese të qumështit me brend “Gjakova Quality”.	Pa-realizuar
5.	Zhvillimi i programeve për ndërmarrësi dhe inovacion në Universitetin e Gjakovës	Planifikuar me buxhet pamjaftueshëm
6.	Sigurimi i pjesëmarrjes së klubeve sportive nëpër ligat elite të vendit dhe liga ndërkombëtare	Planifikuar me buxhet pamjaftueshëm
7.	Reduktimi i 12 Drejtorive në 9 Drejtori	Pa-realizuar
8.	Fondi për Ndërmarrje Publike të Vogla dhe Mesme	Pa-realizuar
9.	Fondi për Bujqësi	Pa-realizuar

Transparenca në Komunë

Transparenca në Komunën e Gjakovës është ngritur megjithatë Kuvendit Komunal i mungojnë draft-rregulloret, detajet biografike dhe kontaktuese të anëtarëve. Ndërsa, në ueb-faqe janë të publikuara detajet biografike të Kryetares, drejtorëve, email-at dhe janë të publikuara edhe planet zhvillimore. Në këtë komunë mungon Rregullorja për Transparencë me udhëzimet e reja të MAPL-së. Ueb-faqja e komunës është kryesisht mirë e pasuar dhe organizuar me dokumente strategjike të komunës dhe financiare. Ka mangësi në informatat për Kuvendin Komunal. Kryetarja e Komunës ka qenë mjaft aktive në ndarjen e informatave dhe vendimeve edhe përmes rrjeteve sociale, gjë që ka ngritur interesim për punët e komunës.

Megjithatë, vlen të theksohet emërtimi jo adekuat i faqes së Facebook-ut zyrtarë “*Kuvendi Komunal i Gjakovës*” pasi që paraqet vetëm aktivitetet e Kryetares dhe shpesh transmeton replika nganjëherë të ashpra për partitë opozitare që janë pjesë e Kuvendit Komunal. Informimi për mbledhjet e Kuvendit në ueb-faqe duhet të respektohet me afatin kohorë prej 7 ditësh, një gjë e tillë në shumicën e rasteve nuk ka ndodhur.

Gatishmëria e Komunës për të qenë bashkëpunuese me disa organizata jo-qeveritare duke përfshirë këtu KDI-në në lidhje me Qendrën për Informim ka kontribuar në hapjen e komunës për qytetarë dhe lehtësimin e ofrimit të informatave në komunë. Komuna ka ofruar gjatë gjithë vitit edhe 2 numra falas për thirrje të qytetarëve për të shprehur shqetësimet, dhënë kërkesa dhe ide. Njëkohësisht ka instaluar një sistem të menaxhimit dhe adresimit të këtyre thirrjeve.

Kryetarja ka bërë raportimin në Kuvend si dhe çdo të premte u përgjigjet pyetjeve të qytetarëve në Radio Gjakova. Informimi i rregullt në mediat lokale ka qenë në TV Syri dhe Radio Gjakova, pasi që këto janë mjaft të shikuara dhe dëgjuara lokalist. Ndërsa ka patur disa ankesa nga gazetarë që Kryetarja dhe sidomos drejtorët komunal nuk kanë qenë të gatshëm të i përgjigjen pyetjeve të gazetarëve pas takimeve të Bordit të Drejtorëve.

Transparenca financiare në Komunën e Gjakovës këtë vit ka qenë në nivel të mirë. Janë organizuar katër (4) dëgjime buxhetore dhe ka menaxhim më të mirë të shpenzimeve dhe borxheve ndaj operatorëve ekonomik. Megjithatë, Komuna duhet t'i marrë parasysh kërkesat e qytetarëve në dëgjimet buxhetore, të jetë më afër këshillave lokal për akomodim të nevojave të lokaliteteve në buxhet, përshkrimi i mëditjeve të brendshme të jetë me specifik, ndërsa buxheti të jetë i gatshëm dhe i qasshëm për publik në fazën e draftimit.

Korniza Afatmesme Buxhetore është kundërshtuar kategorikisht nga opozita për shkak të lëvizjeve të brendshme buxhetore dhe Komuna nuk ka marrë kohë të jetë akomoduese e këtyre kërkesave dhe një uniteti për miratim të buxhetit.

Zhvillimi i seancave plenare në Kuvend Komunal të kësaj komune kryesisht është bërë me gjuhë konstruktive dhe menaxhim të mirë nga ana e kryesuesit, mirëpo transparenca informative nuk është në nivel të kënaqshëm këtu duke përfshirë: hapësirën mediale që e mbulon shumë pak punën e Kuvendit, mungesën e stafit të sekretarisë për përpunimin dhe informimin e qytetarëve me informata këtu duke e përfshirë edhe punën konstruktive që bënë opozita, “Detajet biografike të anëtarëve të Kuvendit” dhe informatat bazike të tyre duke përfshirë email adresën e tyre dhe numrat e telefonit.

Themelimi i tri (3) komiteteve konsultative në Kuvendin Komunal ka kontribuar përpjekjet për transparencë, mirëpo përzgjedhja e anëtarëve të saj është politizuar duke angazhuar njerëz që thirren në emër të shoqërisë civile por që në fakt më herët kanë qenë kandidat në listat zgjedhore të subjekteve politike. Gjithashtu, gjatë periudhës 1 vjeçare ishin të parapara katër (4) takime, mirëpo kjo gjë nuk ka ndodhur në asnjërën prej komiteteve.

Qasja në dokumentet zyrtare Komuna ka të shqyrtuara të gjitha kërkesat për qasje në dokumente zyrtare dhe ka kthyer përgjigje në përputhje me afatin ligjor.

Llogaridhënia në Komunë

Në të gjitha seancat plenare të mbajtura nga Kuvendi Komunal për këtë periudhë të vitit, Kryetarja ka qenë prezent në pjesën më të madhe të kohës së bashku me të gjithë drejtorët komunal. Një praktikë të cilën gjithmonë e kemi kërkuar edhe në raportin e 2013-ës ka qenë që drejtoritë të raportojnë më shpesh tek Kuvendi Komunal së paku çdo tre (3) muaj gjë të cilën nuk e kanë bërë edhe pse kanë qene prezent vazhdimisht.

Një mangësi në këtë drejtim nga ana e Zyrës së Kryetarë për Kuvendin dhe qytetarët është mos raportimi për “Task Forcën” e cila është themeluar për arsye të ndihmës ndaj Inspektoratit me një numër prej 9 inspektorëve dhe 2 zyrtarë ligjor, me kontrata mbi vepër me periudhë 6 mujore, vlera mesatare e shpenzimit të buxhetit është 16.500€ për 6 muaj.

Komisioni për Banim Social ka filluar punën e tij shumë vonë dhe për më tepër tani mezi arrin kuorumin. Madje mbledhja e fundit ka dështuar plotësisht dhe si arsye kryesore për këtë është mungesa e vullnetit të anëtarëve të tij për t’u marrë me çështje të tilla të ndjeshme. Një segment tjetër me shumë rëndësi është paraqitë edhe mungesa e vullnetit për ta iniciuar “Rregulloren e Punës” për këshillat lokal në Kuvendin Komunal për aprovim, e cila do ta definojë qartë rolin e tyre në komunitet.

Qeverisja Komunale në këtë aspekt ka qenë mjaft e angazhuar duke organizuar katër (4) dëgjime buxhetore, një debat publik dhe shume takime me qytetarët, mirëpo “Qendra Informative” ka proceduar afro 5,700 raste gjatë kësaj periudhe në përpilim të ankesave, kërkesa dhe vërejteve. Në bazë të anketimeve që janë bërë ndaj qytetarëve nga ana e organizatës *Bashkohu Edhe Ti* rezultojnë që shërbimin dhe komunikimin më të mirë në Komunë e kanë marrë nga stafi i “Qendrës Informative”. Vërejtjet më të mëdha që kanë ardhur nga qytetarët si në zyrën për Informim ashtu edhe në debatet publike janë për shërbimet publike, infrastrukturën rrugore, ndriçimin publik, menaxhimin e mbeturinave, qenët endacak, banimin social, etj.

Aktivitetet nga ana e Asambleistëve me qytetarin është bërë praktikë e keqe e cila po rezultojnë vazhdimisht me mungesën e plotësisht dhe diskutimit në Kuvend në hapësirën e pikave të ndryshme të rendit të ditës. Kjo buron edhe nga mungesa e vullnetit të Komunes për të siguruar një hapësirë të cilën do ta shfrytëzonin Asambleistët për takime me qytetarët dhe diskutime në mes tyre për çështje të caktuara që janë në interes të qytetarit.

Përfaqësimi i grupit opozitarë AAK me 3 anëtarë dhe i AKR-së me 4 anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa (KPF) është treguar si i padrejtë pasi që në zgjedhjet për Kuvend Komunal, AAK ka dalë me 500 vota më shumë se AKR. Edhe në bazë të Nenit 52 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale thuhet që KPF “reflekton përfaqësimin e etnitateve politike në Kuvend” andaj kjo do të shërbente edhe llogaridhënies më të madhe të Zyrës së Kryetares ndaj Kuvendit Komunal.

Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i takimeve	Numri	Në rend dite	Pjesëmarrja	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare	12	65	95%	92%
Komiteti për Politikë dhe Financa	09	57	95%	95%
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli Komunal i Sigurisë	2		Po	

në Bashkësi		
	Gjithsej	Pjesëmarrja Mesatare
Takimet me publikun	2	Mbi 100

Arsimi dhe Shëndetësia

Një shqetësim kryesorë i opozitës që ka karakterizuar këtë vit qeverisjen komunale të Gjakovës ka qenë puna e Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë.

Drejtorja e Arsimit ka treguar neglizhencë për ta raportuar në KPF dhe seancë plenare dhe kjo ka zgjatur një periudhë shumë të gjatë duke krijuar huti për qytetarët dhe grupet opozitare. Një dukuri tjetër e neglizhencës ju është bërë anëtarit të Kuvendit Komunal, Z. Agon Batusha, i cili ka kërkuar zyrtarisht qasje në dokumentet e “testeve të kandidatëve” për mësimdhënës por ju është zgjatur 77 ditë pa marrë përgjigje.

Madje kishte pakënaqësi edhe me ngrohje të shkollave si dhe themelimin e Këshillave Drejtues të Shkollave.

Ndërsa në shëndetësinë lokale, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ka qenë tema e diskutimit të nxehtë ndërmjet AAK-së dhe qeverisë komunale ku është kritikuar ashpër mbyllja e objektit të QKMF-së me justifikimin e renovimit të objektit për standarde më të mira. Mungesa e furnizimit me barna esenciale në Qendrat e Mjekësisë Familjare, mungesa e shëndetit stomatologjik në shkollat fillore, mungesa e transportit për stafin mjekësorë në zonat rurale të gjitha këto dukuri po reflektohen dhe po barten çdo vit si pasojë e justifikimit të mungesës së buxhetit për ti mbuluar financiarisht.

Ankesat në Punësim

Gjatë kësaj periudhe kohore shqetësimi kryesorë i qytetarëve të Gjakovës ka qenë tendenca e qeverisjes për shkelje të kriterëve të punësimit dhe mungesa respektimit të rregullores për procedurat e rekrutimit.

Shkelja e kriterëve është raportuar në Shkollën “ Nexhmedin Nixha “ – Gjakovë për pozitën mësimdhënës dhe është rishpallur menjëherë pas reagimit të organizatës “*Bashkohu Edhe Ti*” me vendim Zyrt. 04/396/dt.07/10/2014. Pozita udhëheqëse e Muzeut Etnografik është rishpallur menjëherë pas ankesës së kandidatit i cili ka plotësuar kriteret e profesionit të kërkuar të cilat janë shkelur duke përzgjedhur kandidatin me profesion Arkitekturë.

Në disa raste është shkelur rregullorja nr 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit, e cila sipas Nenit 26 për përgatitjen e listës së kandidatëve përcaktohen edhe afatet kohore për thirrje në intervistim të kandidatëve potencial dhe pranim në pozitën zyrtare.

Rekomandimet për Komunë

Zyrës së Kryetares së Komunës:

- Të ketë monitorim dhe llogaridhënie më të madhe sa i përket procesit të rekrutimit të stafit civil, sidomos në arsim dhe shëndetësi;
- Një praktikë e raportimit të drejtorëve në seancat e Kuvendit do të kishte qenë shumë më llogaridhënese dhe transparente për anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët;
- Qendrat e Mjekësisë Familjare në Komunën e Gjakovës të furnizohen me barna esenciale, të sigurohet transporti për stafin punonjës, të sigurohet ngrohja para sezonit dimërorë.
- Të zbatohet Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave nga Drejtoria e Inspektoratit e cila ligjërisht parasheh gjobat dhe ndëshkimet për qytetarët e pa ndërgjegjshëm të cilët hedhin mbeturina në rrugë, lumenj dhe zona tjera urbane – rurale.
- Të adresohen kërkesat e qytetarëve nga dëgjimet publike për buxhet dhe Zyra të jetë më fleksibile në përfshirjen e nevojave të qytetarëve në buxhet; pra këto konsultime të marrin formën konsultative dhe jo vetëm informative;
- Të aprovohet sa më shpejtë rregullorja e punës për Bashkësitë lokale, sepse është e vetmja mundësi dhe formë e cila do të definojë statusin dhe përkrahimin e detyrave të punës për Këshillat Lokal;
- Të jenë më të gatshëm për tu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve dhe mediave tjera dhe jo vetëm të ndajnë informata të një trajtshme të komunës;
- Të ndajë një ditë të javë për të takuar qytetarët me nevoja dhe kërkesa të tyre dhe komuniteteve të tyre dhe të mundësoj që të njejtën gjë të bëjnë edhe drejtorët e komunës për të shkarkuar barrën që mund të bjerë mbi Kryetaren.

Kryesuesit të Kuvendit:

- Të shqyrtojë më me seriozisht akomodimin e kërkesave të anëtarëve të Kuvendit për përfaqësim në Komitete dhe për marrje të dokumenteve dhe informatave nga Zyra e Kryetares;
- Të kërkoj menaxhim të pjesës së ueb-faqes zyrtarë për të dhëna nga zhvillimet në Kuvend;
- Të kërkoj nga Sekretaria që bëjë të qasshme të dhënat kontaktuese dhe biografike të anëtarëve të Kuvendit si dhe të organizojë konsultime me publikun për rregullore dhe buxhet;
- Të shërbej si një urë lidhëse më e fort në mes të ankesave dhe kërkesave të anëtarëve të Kuvendit dhe Kryetares së Komunës.

Anëtarët e Kuvendit:

- Duhet ti kontaktojnë më shpesh qytetarët dhe të ngritin shqetësimet dhe kërkesat e tyre në Kuvend;
- Të jenë më aktiv në konsultime publike të komunës dhe të kërkojnë nga Sekretaria e Kuvendit dhe ndihmën e Kryesuesit që tu mundësohen më shumë konsultime me publikun në mënyrë institucionale;
- Të jenë më të kujdesshëm në gjuhën zyrtare dhe mos të ashpërsojnë tonet dhe fyerjet gjë që do të sillte agjitimin e banorëve të komunës.

Rregulloret dhe Vendimet


Dokumenti	Statusi	Votimi
<i>Shqyrtimi i draft rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave ne territorin e Komunës së Gjakovës</i>	Miraturar	Pro: 35 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Shqyrtimi i planit rregullues Urban për zonën nga rruga “Nëna Terezë” “Fehmi Agani” “Sadik Stavileci” deri tek rruga “Tivari”</i>	Shqyrtuar	Pro: 35 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Rishikimi i buxhetit për vitin 2014</i>	Miraturar	Pro: 16 Kundër: 14 Abs: 1
<i>Draft Plani i punës për Kuvendit Komunal të Gjakovës</i>	Miraturar	Pro: 34 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Vendimi për shkarkimin e bordeve të ndërmarrjeve publike dhe “Stacioni i Autobusëve Gjakovë KRM “Çabrati”</i>	Miraturar	Pro: 34 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Propozimi i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, për rregullimin e brendshëm dhe transferët e ndarjeve Buxhetore të Komunës së Gjakovës për vitin 2014.</i>	Miraturar	Pro: 33 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Rregullorja Komunale për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme në Komunën e Gjakovës për vitin 2015</i>	Miraturar	Pro: 34 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Buxheti i Komunës së Gjakovës për vitet 2015 - 2017</i>	Miraturar	Pro: 20 Kundër: 12 Abs: 1
<i>Plani Komunal për Efijencë të Energjisë në Komunën e Gjakovës</i>	Miraturar	Pro: 35 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Plani Rregullues Urban për zonën Pej sazhi i Mbrojtur “Shkugëza” i propozuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit</i>	Miraturar	Pro: 35 Kundër: 0 Abs: 0




Komuna
Kaçanik

Struktura e Komunës

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



3. Komuna KAÇANIK

Vlerësimi i Përgjithshëm

Çfarë e karakterizoi komunën këtë vit

Kuvendi Komunal i Kaçanikut gjatë vitit 2014 i ka mbajtur seancat e rregullta dhe një seancë të jashtëzakonshme. Seancat janë udhëhequr kryesisht në përputhje me rregulloren e KK-së, duke përjashtuar këtu disa raste por të cilat nuk kanë penguar në përmbajtjen e punës. KK i Kaçanikut ka nisur punën me përbërjen e re, e dalë nga zgjedhjet lokale 2013, por e cila është treguar tejet pasive dhe joefikase në përfaqësimin e interesave të qytetarëve. Përveç partive në pushtet (PDK-së dhe LDK-së), të cilat rëndom pajtohen me punën e ekzekutivit, pavarësisht se jo çdoherë sjellë përmbajtje të mirë në agjendat e seancave të KK-së, opozita e këtushme është duke qëndruar jashtëzakonisht indiferente ndaj lëshimeve të (pa)qëllimshme të qeverisjes lokale. Kuvendit të Kaçanikut i mungon debati parlamentar dhe nuk i trajton as për së afërmi çështjet me interes për qytetarët. Në të shumtën e rasteve seancat zgjasin shkurt, duke mos u dhënë vend të merituar trajtimit pikave të agjendës. Legjislativi komunal ka zhvlehtësuar disa vendime të mëhershme të kundërligjshme, por ka marrë edhe vendime në kundërshtim me ligjin. Në disa raste nuk janë përfillur kërkesa të delegatëve për të futur në agjendë të seancës pika të tjera për çështje të veçanta, por edhe këshilltarët në disa raste nuk kanë marrë përgjigje në pyetjet dhe kërkesat e parashtruara gjatë seancave. Mbledhjet e organit më të lartë komunal vazhdon t'i shoqërojnë edhe mangësi teknike. Përveç sallës e cila nuk i plotëson kushtet, seancat gjatë tërë vitit janë zhvilluar pa teknike zërimi, e cila është instaluar në muajin dhjetor.

Problemet kryesore të Komunës

Komuna e Kaçanikut vazhdon të përballët me problemet elementare, të cilat edhe më tej mbeten preokupim dhe shqetësim i qytetarëve. Ndonëse ka kaluar një kohë relativisht e gjatë pasluftës dhe përkundër mbështetjes së donatorëve, administrata komunale nuk ka prezantuar ndonjë strategji, vendosmëri dhe as shenja për të dalë nga situatat e vështira. Territori i komunës së Kaçanikut vazhdon të pasqyrojë imazh të ambientit të degraduar, si pasojë e mbeturinave të hedhura kudo dhe të pa menaxhuara si duhet, ndotjes së ajrit afër vendbanimeve nga veprimtaritë prodhuese, ndotjen e ujit për shkak të hedhjes në lumenj të mbetjeve industriale, përkatësisht derdhjes në shkallë ekstreme të kanalizimeve fekale. Si njëri ndër faktorët dominues për moszgjidhjen e këtyre problemeve nuk mund të përjashtohet as mundësia e ndërhyrjes së politikës.

Qytetarët të cilët banojnë në zonën urbane dhe në periferi të qytetit, përveç se uji përshkon gypat e asbest-betonit me përmbajtje të substancave kancerogjene, këtë vit janë përballur me furnizim me ujë jashtëzakonisht të turbullt. Administrata komunale vazhdon të funksionojë me kompetenca dhe llogaridhënie të padefinuar. Ajo poashtu po e mban në trend avazin e vjetër të punësimeve të parregullta, familjare dhe partiake, të zyrtarëve faktikisht pa vende pune, por edhe në disa pozita me numër të tepërt, e të cilat bashkë me funksionime jotransparente dhe shkelje ligjore po e dëmtojnë buxhetin dhe diskriminojnë qytetarët. Është vërejtur tolerancë e tepruar e ndaj një pjese të stafit të administratës lokale, mungesë e disiplinës, rregullit, mos respektimit të orarit të punës.

Qytetarët janë ankuar edhe për shërbime zvarritëse e joefikase, sjellje arrogante të disa zyrtarëve dhe vonesa maratonike në përmbushjen e kërkesave të tyre nga disa dikastere komunale, ndërsa është vlerësuar “Qendra e Shërbimeve për Qytetarët” si sektor i cili u ka shërbyer me efikasitet qytetarëve. Orientimi i buxhetit komunal për investime kapitale

vazhdon të diktohet nga “të fortit” dhe ndikimet politike e elektorale, sikurse edhe planifikimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të projekteve.

Të arriturat në vitin 2014

Ekzekutivi dhe legjislativi i Kaçanikut kanë kthyer në rishqyrtim dhe kanë shfuqizuar disa vendime të paligjshme, të sponsoruar dhe të vendosur me vetëdije të plotë nga ekzekutivi dhe legjislativi në mandatin e kaluar, siç janë: rikthimi i statusit ligjor të ndërmarrjes së ujësjellësit dhe kanalizimit. Po ashtu, KK-ja ka rishqyrtuar dhe ndryshuar vendimin për ndërtimin e lokacionit të Palestrës Sportive.

Qeveria lokale ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm dhe është konsultuar me qytetarët deri në marrjen e pëlqimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e fushës së futbollit të KF Lepenci dhe caktimin e lokacionit të ri të Varrezave të Qytetit. Këto konsultime janë shndërruar më vendime të KK-së.

Vlerësimi për performancë në transparencë

Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, është treguar modest në sjellje dhe komunikim me qytetarët, ndërkohë që jo rrallë dhe taktikisht ua ka “atribuar” vartësve të tij kompetencat e autoritetit kryesor të Komunës, duke iu shmangur përgjegjësi të llogaridhënies së kreut komunal. Ai është shprehur i hapur për transparencën e punës së tij, por nuk i ka ftuar mediat në asnjë konferencë shtypi, sikurse nuk e ka trajtuar as shoqërinë civile si faktor të rëndësishëm dhe urë-lidhës ndërmjet qytetarit dhe pushtetit.

Drejtoritë komunale: I kanë hartuar planet e punës për vitin 2014 kryesisht në stilin “copy paste” të planeve nga vitete pararendëse. Të ndodhur për herë të parë me të nominuar të ri në poste politike dhe udhëheqëse, dikasteret komunale pjesërisht e kanë ndryshuar qasjen dhe shtuar vëllimin e efikasitetit të punës. Brenda disa prej syresh ka probleme me sistematizimin të punësuarve, etj. Qytetarët janë ankuar shpeshherë se nuk kanë mund të kryejnë punë, për shkak të ndodhjes në pushime vjetore apo në takime e trajnime jashtë Kaçanikut të zyrtarëve të drejtorive komunale.

Këshilltarët e Kuvendit Komunal: Përderisa nuk pritet që subjektet politike në koalicionin qeverisës (PDK-LDK) të adresojnë kritika për punën e pushtetit, është e evidentë serviliteti i tepruar i disa subjekteve politike opozitare. Është shqetësues fakti se AAK-ja e cila ka 5 anëtarë në Kuvend, e ka lavdëruar pothuaj në secilin rast punën e pushtetit, madje duke i dalë në mbrojtje atij edhe në tendencat për shkelje të ligjit, por edhe duke injoruar kërkesat legjitime të shoqërisë civile. Kjo sjellje rezultoi me daljen në PDK të tre këshilltarëve të AAK-së, duke e bërë PDK-në me 14 këshilltarë, nga 11 sa kishte në fillim të mandatit. Vlen të përmendet se opozitë të vërtetë dhe në linjë me interesat dhe mandatin e dhënë nga qytetarët është duke bërë këshilltari Shukri Luta (Iniciativa Qytetare “Bashkimi Demokratik për Kaçanikun”) dhe pjesërisht Basri Kodra (LVV).

Kryesuesi i Kuvendit Komunal: Xhelal Gashi, seancat e KK-së i ka udhëhequr pothuajse në përputhje të plotë me Rregulloren e KK-së, duke e mbajtur nën kontroll debatin dhe duke u lënë mundësi maksimale të interesuarve për diskutime. Ai u ka bërë trajtim të barabartë të gjithë këshilltarëve të të gjitha subjekteve politike të përfaqësuara në KK.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Pajisja e shkollave me mjete konkretizuese	E perealizuar
2	Themelimi edhe i dy drejtorive komunal	E perealizuar
3	Asfaltimi i rrugës së fshatit Sllatinë	I realizuar
4.	Instalimi i sistemit të kamerave në shkolla	Pjesërisht i realizuar
5.	Ndërprerja e ndotësve të mëdhenj të ambientit	E perealizuar
6.	Ndërtimi i shkollës në Kaçanik të Vjetër	Planifikuar, por me buxhet të pamjaftueshëm
7.	Ndërtimi dhe revitalizimi i monumenteve historike	Pjesërisht i realizuar dhe i planifikuar me buxhet

Transparenca në Komunë

Buxheti komunal është prezantuar në raportet e drejtorisë përkatëse dhe është diskutuar me publikun në shtatë takime të organizuara nga Komuna. Megjithatë, orientimi i tij nuk është bërë në bazë të kërkesave të artikuluar nga qytetarët, por ashtu siç e ka planifikuar ekzekutivi, në katër raste të destinuara për projekte të lokaliteteve të favorizuara, në shumën nga 80 mijë deri në 140 mijë euro. Nga 36 kërkesa të qytetarëve për projekte konkrete, Ekzekutivi i ka përfshirë 3 projekte për t'i realizuar në vitin 2015. Ndërkaq, në dy kërkesa të qytetarëve Komuna i ka paraparë vetëm nga 5 mijë euro, mjete me të cilat nuk mund të realizohen ato, ndërkohë që një projekt e ka planifikuar për vitin 2017.

Komuna ka përfillur kërkesën e shoqërisë civile, për t'i përkrahur materialisht aktivitetet e personave me aftësi të kufizuara të shoqatës "Handikos" në Kaçanik, për të cilët ka paraparë buxhet prej pesë mijë eurosh. Buxheti për vitin 2015 është aprovuar në KK me 20 vota, tri vota kundër dhe tre abstenime. Buxheti është transparent dhe është publikuar në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut.

Seancat e KK të Kaçanikut janë ftuar me kohë dhe materialet në përgjithësi u janë dërguar në afatin ligjor anëtarëve të legjislativit, me ndonjë përjashtim kur në ndërkohë është futur ndonjë pikë e rendit të punës dhe materiali u është shpërndarë me vonesë. Ato u janë shpërndarë edhe mjeteve të informimit dhe organizatave të interesuara për të pasur qasje në përmbajtjen e materialit të seancave. Seancat rregullisht janë përcjellë vetëm nga gazeta "Koha Ditore", ndërsa përveç Klubit të Gazetarëve të Kaçanikut, i cili ka qenë prezentë në të gjitha seancat, nga OJQ-të kanë marrë pjesë në pak seanca vetëm përfaqësues të HANDIKOS-it. Ndonëse seancat kanë qenë të hapura për publikun, përveç komuniteteve të organizuara për çështje të caktuara dhe atë në raste simbolike, qytetarët nuk kanë marrë pjesë.

Kuvendi Komunal i Kaçanikut nuk ka marrë vendim për themelimin e Komiteteve Konsultative. Ekzekutivi komunal nuk i ka adresuar asnjë propozim për t'i formuar komitetet konsultative, madje strukturat komunale nuk kanë treguar asnjë interesim për t'i përfshirë ekspertët profesionalë të fushave të ndryshme në proceset e planifikimeve.

Qasja në dokumente zyrtare është e pjesshme dhe me vonesa. Në disa kërkesa për të pasur qasje në dokumentet publike, nuk ka pasur asnjë përgjigje. Në këtë aspekt tendencat janë

kryesisht për të mohuar mundësinë e informimit për punën, përgjegjësinë, llogaridhënien e institucioneve, pavarësisht se kjo përbën shkelje të Ligjit për qasje në dokumente publike.

Ueb-faqja e Komunës i përmban pothuaj të gjitha pikëpamjet e parapara në transparencën publike, por nuk ka ndonjë ndryshim apo freskim me detaje të reja. Ajo ka ndryshuar përmbajtjen vetëm në kuptimin e ndryshimeve në institucionet komunale, të imponuara nga ardhjet e reja pas zgjedhjeve lokale 2013. Ueb-faqja zyrtare vazhdon t'i publikojë të gjitha aktivitetet e organizuara nga Komuna dhe punën e saj në terren. Kësaj faqeje një kohë i kanë munguar publikimet e disa tenderëve, të cilat janë shfaqur pas rekomandimeve të KGK-së.

Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i takimeve	Numri	Në rend dite	Pjesëmarrja	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare	11	45	97.7 %	100%
Komiteti për Politikë dhe Financa	10	38	93.6 %	98,5 %
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli Komunal Sigurisë në Bashkësi	6		Po	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	7		260 persona	

Llogaridhënia në Komunë

Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, punën e ekzekutivit e ka shpalosur nëpërmjet raporteve me shkrim. Në të njëjtën mënyrë kanë vepruar edhe drejtorët e drejtorive komunale. Punën e qeverisë lokale ai, përkatësisht nënkryetari i Komunës, Remzi Elezi, e kanë prezantuar në takim me qytetarët, sidomos gjatë dëgjimeve publike për buxhetin. Jo të gjitha dikasteret e Komunës kanë shpalosur para publikut aktivitetet përkatëse, por vetëm në takimet e rregullta me kryetarin, të cilat janë publikuar në ueb-faqen zyrtare, përmes të cilës kanë pasur mundësi të informohet publiku. Kryetari dhe drejtorët nuk kanë organizuar asnjë konferencë shtypi, për prezantimin e punës së tyre. Të njëjtët nuk kanë organizuar takime të veçanta as me përfaqësues të shoqërisë civile, për t'u njohur me peripecitë e funksionimit, preokupimeve dhe kërkesat e tyre, por as për t'u konsultuar për rregullore, propozim-vendime dhe hartimin e politikave sociale e zhvillimore në nivel lokal. Megjithatë, disa organizata të shoqërisë civile i kanë artikulluar kërkesat dhe preokupimet tyre dhe të qytetarëve në forma të ndryshme.

Edhe në seancat e Kuvendit Komunalë, prezantimi i punës së kryetarit të Komunës bëhet nëpërmjet raporteve me shkrim. Kryetari u është përgjigjur të gjitha pyetjeve, kërkesave dhe komenteve të cilat i kanë artikulluar gjatë seancave këshilltarët e legjislativit komunal.

Komuna e Kaçanikut i ka mbajtur shtatë dëgjime publike për planifikimin buxhetor dhe planifikimin e projekteve për tri vitet e ardhshme, në të cilat janë përfshirë 17 fshatra dhe dy zonat e qytetit.

Janë mbajtur edhe takime të tjera për shqyrtimin e rregulloreve dhe propozim-vendimeve të qeverisë lokale. Takimet kanë qenë të hapura, por kanë marrë pjesë një numër relativisht i vogël i qytetarëve. Arsye për mospjesëmarrje, përveç njoftimit mangët, konsiderohet edhe

mos interesim i qytetarëve. Kjo me motivacion se artikulli i kërkesave dhe shqetësimeve të tyre nuk merren parasysh nga drejtuesit e institucioneve komunale. Kjo përshtypje është konstatuar me rastin e dëgjimeve publike në të cilat morën pjesë rreth 260 qytetarë dhe se nga 30 propozime e tyre të cilat nuk figuronin në planin e qeverisë lokale për vitet 2015-2017, nuk është përfshirë asnjë prej syresh në listën e prioriteteve.

Prioritetet kryesisht caktohen në rrethe të ngushta të individëve, brenda politikës dhe institucioneve, e të cilat marrin miratimin e shumicës në KK. Përfaqësuesit e Komunës së Kaçanikut u kanë dhënë hapësirë maksimale qytetarëve për t'i shprehur brengat dhe kërkesat e tyre, por nuk i kanë marrë parasysh ato, ndërkohë që Kryetari i Komunës, në disa raste, me arsyetim të agjendës zyrtare, nuk ka marrë pjesë në takimet me publikun.

Qytetarët në takimet publike kanë shfaqur preokupimet dhe problemet me të cilat përballen në zonat në të cilat jetojnë, duke shprehur pakënaqësi në adresë të institucioneve për trajtim jo të barabartë të tyre, mungesës së perspektivës për zbutjen e papunësisë, zhvillimit dhe problemeve sociale.

Kërkesat dhe propozimet e qytetarëve kanë të bëjnë kryesisht me investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore, rrugëve, kanalizimeve fekalë e atmosferike, ujësjellësve, shtretërit e përroskave, trotuareve, menaxhimit më të mirë të mbeturinave, investimet në mbrojtjen e ambientit, anashkalim dhe lënie në gjysmë të projekteve, mbikëqyrja e cilësisë së projekteve, etj.

Ndonëse i paraparë me udhëzim administrativ, Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi ishte temë e diskutimeve, reagimeve dhe rekomandimeve për një kohë të gjatë. Ekzekutivi dhe Legjislativi e kanë refuzuar formimin e KKS-së vetëm për t'iu shmangur kompensimit të anëtarëve të këtij këshilli konsultues. KKS ka funksionuar jashtëligjshëm që nga janari i vitit 2013 e deri më 31 mars 2014, kur edhe është themeluar nga KK-ja, pas kërkesës me insistim të shoqërisë civile dhe presionit të Qeverisë së Kosovës. Përkundër kësaj institucionet nuk janë duke e parë KKS-në si këshill të rëndësishëm. Kreu i Komunës, Besim Ilazi, vazhdon ta trajtojë me injorancë atë, për faktin se që nga (ri) zgjedhja e tij në këtë post (qershor 2012), në 12 takime të KKS-së ka marrë pjesë vetëm dy herë. Në takimet e KKS-së debatohet gjatë për preokupimet dhe problemet e qytetarëve, por nuk mbahet procesverbal, nuk raportohet në KK, nuk ka koordinator të organizimit të takimeve dhe, përveç shumë mangësive të tjera, Komuna nuk është duke e zbatuar vendimin e KK-së, i cili e parasheh kompensimin e anëtarëve të KKS.

Parregullsitë në konkurse

Vitin 2014 e kanë karakterizuar parregullsi dhe probleme të konkurseve për punësimin e kuadrove të kualifikuara nëpër institucione publike. Bazuar në ankesat e kandidatëve, përshtypjet e qytetarëve dhe deklaratat jo publike të zyrtarëve, përzgjedhja e atyre që do të punësohen në institucione ndodh shumë më herët se sa shpallen konkurset publike, madje vendet u rezervohen kryesisht familjarëve, të preferuarve të individëve, anëtarëve dhe militantëve partiakë, etj. Përveç kësaj, pranimet janë bërë me shkelje të kushteve të konkursit. Konkursi më maratonik dhe ende i pazgjidhur ka qenë ai për drejtor të Qendrës së Edukimit dhe Arsimit Parashkollor “Agimi”.

Gjatë dy viteve të fundit, për të njëjtin post janë shpallur e rishpallur nëntë konkurse publike, është anuluar dy herë dhe është bërë një pranim, më 23.01.2014. Por, në muajin shtator 2014 është shpallur sërish konkursi për drejtor të kësaj çerdheje, i cili është anuluar tri javë më vonë dhe sërish është rishpallur.

Edhe punësimi me konkurs i mësimdhënësve të shkollave është shoqëruar me shmangie ligjore dhe parregullsi të tjera. Drejtorja e Arsimit dhe Kulturës nuk i ka përfshirë në konkurs disa vende të lira të punës në të cilat vazhdojnë të punojnë mësimdhënës të

pakualifikuar, sikurse edhe për lëndët mësimore në të cilat punojnë mësimdhënës me kualifikim joadekuat. Në disa shkolla janë pranuar më shumë mësimdhënës, e në disa më pak se që janë kërkuar me konkurs.

Ndërkaq, me rastin e selektimit të përfituesve nga konkursi për ndarjen e bursave për studentë, komisioni i themeluar nga KK i Kaçanikut ka bërë përzgjedhje të gabuar në 13 raste. Pas ankesave të disa kandidatëve dhe reagimeve të shoqërisë civile, një komision tjetër e ka përmirësuar këtë gjendje plotësisht në përputhje me kriteret e caktuara, por që ky komision vet përbënte shkelje, sepse nuk ishte zgjedhur nga KK-ja, sipas vendimit për ndarjen e bursave.

Zyra për regjistrimin e mërgimtarëve

Komuna e Kaçanikut nuk e ka hapur Zyrën për regjistrimin e mërgatës, pavarësisht se ajo ishte e obliguar me Rregulloren e Ministrisë së Diasporës (QRK), nr. 32/2013, për hartimin e regjistrit të mërgimtarëve, përkatësisht nenit 18 “Roli i komunave”, nen sipas të cilit komunat obligohen të sigurojnë hapësirat e nevojshme për zyrtarin e regjistrimit të mërgatës, i cili do të caktohet nga Ministria e Diasporës. Është thënë se mos hapja e kësaj zyre kishte motive revanshi, për shkak të mos punësimit nga MD-ja të një personi të propozuar nga autoritetet e larta komunale të Kaçanikut. Në mungesë të zyrës, regjistrimi i bashkatdhetarëve është duke u bërë në rrugë, shtëpi private dhe lokale të qytetit.

Emërtimi i rrugëve

Komuna e Kaçanikut e ka përmbyllur procesin e emërtimit të rrugëve, por ky projekt nuk është zbatuar si duhet. Përderisa në rrethin e parë të emërtimeve ka pasur vetëm një kriter dhe pothuaj tërësisht është respektuar, kjo nuk ka ndodhur edhe në rrethin e dytë. Komuna nuk ka miratuar kriteret e tjera për emërtimin e rrugëve, ndërkohë që rrugët janë emërtuar pa asnjë kriter dhe kjo si rezultat papërgjegjësisë së të zgjedhurve dhe dëshirave të disa zyrtarëve për t'i vënë në emra rrugësh familjarët dhe të afërmit e tyre. Procesi i fazës së dytë ka rrjedhur mbrapsht që nga fillimi i propozimit, por që vendimmarrësit shpeshherë kontradiktorë nuk e kanë analizuar peshën dhe rëndësinë e emërtimeve, ndërkohë që kanë ndërhyrë vetëm parciaisht. Ekzekutivi dhe legjislativi nuk i kanë përfillur thirrjet dhe propozimet e shoqërisë civile për t'ia dhënë emrin e merituar secilës rrugë.

Rregullorja për subvencionet

Kuvendi Komunal i Kaçanikut ka miratuar Rregulloren 01- nr.16-27192/12, për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve, në nenin 2 e të cilit parashihet edhe mbulimi i shpenzimeve të krijuara gjatë ceremonive të varrimit në territorin e komunës së Kaçanikut. Neni 4.2. i kësaj rregulloreje specifikon se: “Alokimi i mjeteve (150 euro për secilin rast mortor, v.j.) do të bëhet në fondin (xhirollogari) e Bashkësisë Komunale Islame”. Fakti që KBI-ja nuk është e regjistruar dhe certifikuar si entitet juridik, Komuna e Kaçanikut nuk ka të drejtë ligjore për nënshkrimin e marrëveshjeve dhe kontratave me subjektet “de jure” inekzistente.

Dhe, ndonëse është marrë ky vendim, është duke u zbatuar në mënyrë selektive. Banorët e fshatit Biçec (me rreth 300 familje) janë ankuar se asnjë rasti mortor të këtij fshati nuk u janë mbuluar shpenzimet e varrimit. Këtë vendim KBI-ja është duke shfrytëzuar si mjet kushtëzimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të brendshme. Pavarësisht se subvencionimi për rastet mortore është i qëlluar dhe nuk e përjashton asnjë rast, KBI-ja menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes me Komunën (gusht 2013), nëpërmjet një njoftimi publik kishte “kërcënuar” qytetarët se ata të cilët nuk e kanë paguar anëtarësinë ndaj KBI-së nuk do të përfitojnë nga kjo ndihmë.

Ndonëse kanë qenë në dijeni për tendencat e kësaj të fundit, e cila duke i shfrytëzuar taksapaguesit kaçanikas dhe të vdekurit, t'i realizojë politikat strategjike të brendshme, institucionet vendimmarrëse dhe zbatuese të vendimeve në Kaçanik nuk e kanë rishikuar rregulloren dhe vendimin për subvencionet në rastin konkret.

Rekomandimet për Komunën

Zyrës së Kryetarit të Komunës

- Të themelohen Këshillat drejtues të shkollave dhe të jenë funksionalë në përputhje me Ligjin për Arsim Parauniversitar të Republikës së Kosovës 04/L-032, përkatësisht nenet 17 dhe 18 të këtij ligji.
- Të hapet Zyra për regjistrimin e mërgimtarëve, në përputhje me Rregulloren e Ministrisë së Diasporës (QRK), nr. 32/2013, e cila e obligon Komunën për hapjen e kësaj zyreje dhe ofrimin e asistencës logjistike.
- Buxheti i kompensimit të kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe zonave të qytetit, për t'u mundësuar atyre mbulimin e disa shpenzimeve dhe krijimin e kushteve për punë dhe aktivitet më efikas në interes të qytetarëve.
- Të caktohen zëvendësues të zyrtarëve për kohën që ata mungojnë në punë apo shkojnë në pushime, për të mos mbetur qytetarët pa shërbimet e nevojshme dhe realizim të kërkesave.
- Të zbatohet vendimi për Këshillin Komunal të Sigurisë në Bashkësi, 01Nr.16-8831/14, i cili është i bazuar në udhëzimet administrative të MAPL-së, nr. 03/2012 dhe MPB-së, nr. 27/2012, konkretisht nenin 9 i cili parasheh caktimin e një koordinatori komunal të KKSB-së, për përgatitjen e materialeve dhe mbajtjen e procesverbalit, pastaj prezantimin e planit vjetor të punës në Kuvendin Komunal, informimin e Kuvendit Komunal dy (2) herë brenda vitit për aktivitetet e KKSB-së, kompensimin e anëtarëve të KKSB-së, etj.
- Të funksionalizohet kutia e ankesave dhe komisioni për shqyrtimin e tyre, për t'i dhënë mundësi qytetarëve që t'i adresojnë ankesat e tyre dhe të shqyrtohen ato.
- Të merren masa ligjore ndaj të gjithë zyrtarëve ndaj të cilëve vërtetohet se në forma të ndryshme kanë shkelur ligjin dhe kanë qenë apo janë pjesë e aferave të ndryshme antiligjore.
- Të zgjidhet problemi i ndotjes së ajrit dhe ujërave të lumenjve nga prodhuesit industrialë dhe shkarkimet e ujërave të zeza, duke i ndaluar ndotësit industrialë dhe duke krijuar kushte adekuate për trajtimin e ujërave të zeza.
- Të aplikohet orientim racional i buxhetit për realizimin e projekteve kapitale, duke i marrë për bazë nevojat reale të qytetarëve, si dhe të ketë menaxhim të kujdesshëm të kualitetit të punimeve në terren
- Të mos ketë punësime pa konkurse, por vetëm në përputhje me ligjin, për të mos bërë diskriminimin e kuadrove profesionale dhe të aplikuesve në përgjithësi. Të drejtë punësimi kanë të gjithë qytetarët të cilët i plotësojnë kushtet e punësimit.
- Të aplikohet transparencë e plotë e institucioneve komunale dhe të ketë konsultime me shoqërinë civile dhe qytetarët për buxhetin, projektet kapitale dhe rregulloret, për t'u mundësuar atyre qasje dhe të drejtë në proceset vendimmarrëse.
- Të veprohet me inspeksione komunale për përmirësimin e gjendjes higjienike-sanitare të hapësirave biznesore, për faktin se mungesa e kushteve në disa nga lokalet afariste rrezikon drejtpërdrejt shëndetin e qytetarëve.
- Të ketë përgjigje në të gjitha qasjet e mundshme në dokumente zyrtare dhe të respektohen afatet kohore për përgjigje dhe zbatohen procedurave ligjore të prokurimit dhe të konkurseve për punësim, duke i lënë anash shkeljet, kurdisjet, favorizimet dhe diskriminimet.

Kryesuesit të Kuvendit:

- Të investojë në rregullimin e sallës së mbledhjeve të KK-së, duke e planifikuar në buxhet vjetor të komunës ose rishikim të buxhetit.
- Të themelohen komitetet konsultative, për t'i dhënë mundësi shoqërisë civile dhe ekspertëve në planifikimet dhe strategjitë, hartimin e politikave dhe implementimin e projekteve në fusha të ndryshme.
- Të vazhdohet me trajtimin e barabartë e të gjithë anëtarëve të KK-së, pavarësisht përkatësisë partiake dhe t'u jepet hapësirë e mjaftueshme për shprehjen e mendimeve dhe qëndrimeve të tyre.
- T'i sjellë në seancë të gjitha përgjigjet për të cilat janë shtruar pyetje dhe t'i marrë parasysh propozimet e këshilltarëve për pika shtesë në rendin e punës.
- Të kërkojë nga ekzekutivi që ta zbatojë në tërësi nenin 2.2 të rregullores 01-Nr.16-27192/12, të miratuar nga KK të Kaçanikut, më 22.07.2013, për mbulimin e shpenzimeve të ceremonisë së varrimit të anëtarit të familjes për të gjitha rastet e paraqitura në territorin e komunës së Kaçanikut, përkatësisht të kërkojë shpjegime pse kjo e drejtë është duke iu mohuar banorëve të fshatit Biçec.

Asamblistëve të Kuvendit:


- Të sjellin kërkesa të qytetarëve dhe t'i prezantojnë në mënyrë autonome shqetësimet e tyre në Kuvendin Komunal.
- Të shqyrtojnë dhe analizojnë materialin e seancave dhe të diskutojnë në mbledhje.
- Këshilltarët femra, sidomos ato të subjekteve politike në pushtet, ta përdorin në mënyrë të barabartë foltoren për çështjet që diskutohen në Kuvendin Komunal.

Rregulloret dhe Vendimet

Vendimi	Statusi	Votimi
<i>Rregullorja komunale për shërbime publike</i>	Miraturar	Pro: 24, Kundër: 0, Abs: 3
<i>Rregullorja për vendosjen e tatimit në pronë për territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2015</i>	Miraturar	Pro: 21, Kundër: 0, Abs: 4
<i>Raporti financiar për vitin 2013</i>	Shqyrtuar	
<i>Raportin i punës së ekzekutivit për vitin 2013</i>	Shqyrtuar	
<i>Raporti financiar për periudhën Janar-Mars 2014</i>	Shqyrtuar	
<i>Plani i Punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2014</i>	Miraturar	Pro: 24, Kundër: 0, Abs: 3
<i>Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa</i>	Miraturar	Pro: 26, Kundër: 0, Abs: 1
<i>Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete</i>	Miraturar	Pro: 27, Kundër: 0, Abs: 0
<i>Vendimi për zgjerimin-ndërtimin e fushës sportive të stadiumi i qytetit “Besnik Begunca”</i>	Miraturar	Pro: 21, Kundër: 0, Abs: 6
<i>Vendimi për lejimin e mjeteve financiare, për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës</i>	Miraturar	Pro: 16, Kundër: 0, Abs: 8
<i>Vendimi për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga viti 2012 dhe 2013, në vitin 2014</i>	Miraturar	Pro: 15, Kundër: 9, Abs: 2
<i>Vendimi për ndarjen e bursave të studentëve të Komunës së Kaçanikut për vitin akademik 2013/2014</i>	Miraturar	Pro: 24, Kundër: 0, Abs: 3
<i>Vendimi për financimin e shpenzimeve të varrimit për rastet mortore të paraqitura nga qytetarët e komunës së Kaçanikut</i>	Miraturar	Pro: 27, Kundër: 0, Abs: 0
<i>Vendimi për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Kaçanikut, për vitin akademik 2013/2014</i>	Miraturar	Pro: 23, Kundër: 0, Abs: 4
<i>Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive</i>	Miraturar	Pro: 24, Kundër: 0, Abs: 3
<i>Vendimi për ndryshim plotësimin e nenit 9 të Rregullores për pagesën e tarifave dhe ngarkesave administrative dhe shërbimeve të tjera komunale 01Nr. 05-4236/10</i>	Miraturar	Pro: 24, Kundër: 0, Abs: 3
<i>Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e një Rregullorja për caktimin e vijës rregullative, vijës së ndërtimit si dhe kushteve tjera ndërtimore, në pjesët ku ekziston plani rregullativ urban , deri me miratimin e Planeve Rregulluese Urbane</i>	Miraturar	Pro: 27, Kundër: 0, Abs: 0
<i>Vendimi për zgjidhjen përfundimtare të statusit të NKP “Lybeteni”</i>	Miraturar	Pro: 15, Kundër: 5, Abs: 6
<i>Vendimi për themelimin e një komisioni për gjetjen e alternativave të lokacionit për varrezat</i>	Miraturar	Pro: 27, Kundër: 0, Abs: 0

<i>e qytetit në komunën e Kaçanikut</i>		
<i>Vendimi për themelimin e komisionit të aksionarëve për KRM "Pastërtia", sh.a- Njësia në Kaçanik</i>	Miratuar	Pro: 22, Kundër: 0, Abs: 5
<i>Vendimi për destinimin e mjeteve financiare për realizimin e projekteve të drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, me Buxhetin e vitit 2014</i>	Miratuar	Pro: 20, Kundër: 0, Abs: 7
<i>Vendimi për ndryshimin e destinimit të parcelës kadastrale 664 të Zonës Kadastrale Kaçanik, nga PZHU i Kaçanikut nga destinimi, shërbime dhe banim individual në zonën për banim kolektiv dhe afarizëm</i>	Miratuar	Pro: 23, Kundër: 0, Abs: 4
<i>Vendimi mbi vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për ndërtimin e Stadiumit të Qytetit</i>	Miratuar	Pro: 27, Kundër: 0, Abs: 0
<i>Vendimi mbi Vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për ndërtimin e Varrezave të Dëshmorëve dhe Varrezat e Qytetit</i>	Miratuar	Pro: 27, Kundër: 0, Abs: 0
<i>Vendimi mbi bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme nga prona shoqërore Shoqëria Sportive "Lepenci", në Pronë Komunale</i>	Miratuar	Pro: 24, Kundër: 0, Abs: 3
<i>Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi</i>	Miratuar	Pro: 21, Kundër: 1, Abs: 0
<i>Vendimi për emërtimin e rrugëve të paemërtuara në komunën e Kaçanikut</i>	Miratuar	Pro: 19, Kundër: 2, Abs: 3
<i>Vendimi për formimin e Komisionit të aksionarëve për ndërmarrjen "Bifurkacioni"</i>	Miratuar	Pro: 27, Kundër: 0, Abs: 0
<i>Korniza afatmesme buxhetore e Komunës së Kaçanikut për vitet 2015-2017</i>	Miratuar	Pro: 17, Kundër: 4, Abs: 5
<i>Raporti Final i Auditimit të Përgjithshëm dhe Plani i Veprimit lidhur me Pasqyrat vjetore financiare, për vitin e përfunduar me 31.12.2013</i>	Miratuar	Pro: 17, Kundër: 0, Abs: 9
<i>Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar shkollave</i>	Miratuar	Pro: 22, Kundër: 0, Abs: 4
<i>Rishikimi Gjashtëmujorë i Buxhetit për Komunë, për vitin 2014</i>	Miratuar	Pro: 22, Kundër: 0, Abs: 4
<i>Raporti i Buxhetit për periudhën janar-qershor, 2014</i>	Miratuar	Pro: 20, Kundër: 4, Abs: 2
<i>Rregullorja për vendosjen e tatimit në pronë në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2015</i>	Miratuar	Pro: 21, Kundër: 0, Abs: 4
<i>Vendimi për rialokimin dhe transferin e projekteve kapitale sipas buxhetit të vitit 2014</i>	Miratuar	Pro: 25, Kundër: 0, Abs: 1
<i>Vendimi për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NKP "Stac. i Autobus." SH. A-Kaçanik</i>	Miratuar	Pro: 22, Kundër: 0, Abs: 4
<i>Buxheti për vitin fiskal 2015, vlerësimet për 2016-2017</i>	Miratuar	Pro: 20, Kundër: 3, Abs: 3
<i>Vendimi për formimin e Komitetit për Shërbime Publike</i>	Miratuar	Pro: 24, Kundër: 0, Abs: 1


<i>Rregullorja për transportin rrugor në territ. e Kaçanikut</i>	Miraturar	Pro: 25, Kundër: 0, Abs: 0
<i>Vendimi për ndryshimin-plotësimin e Rregullores 01Nr.05-4236/10, për pagesën e tarifave, ngarkesave administrative dhe shërbimeve tjera komunale.</i>	Miraturar	Pro: 24, Kundër: 0, Abs: 3
<i>Plani i Punës së Kuvendit të Komunës 2015</i>	Miraturar	Pro: 25, Kundër: 2, Abs: 0
<i>Plani i vlerësimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore për Komunën e Kaçanikut</i>	Miraturar	Pro: 20, Kundër: 5, Abs: 1




Komuna Klinë

Struktura e Kuvendit Komunal

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



4. Komuna KLINË

Vlerësimi i Përgjithshëm

Cfarë e karakterizoj komunën këtë vit

Puna e Kuvendit edhe në këtë vit, si pasoj e koalicionit të madh është shëndruar në vend ku votohet secili vendim i prezantuar nga Ekzekutivi duke i besuar shumë Ekzekutivit komunal, edhe atëherë kur Kryetari i Komunës paraqet propozim vendim vetëm në mënyrë verbale. Mos përcjellje e vendimeve të marra në Kuvend Komunal, votim pa trajtim të duhur të lëndëve dhe pa pasur dokumente bindëse për të votuar, këshilltarë lokalistë duke prezantuar vetëm gjendjen e fshatit apo zonës prej nga vijnë, po ashtu duke futur edhe projekte në planifikim buxhetor janë karakteristika të zhvillimeve në Kuvend.

Seancat e Kuvendit vazhdojnë të jenë të trazura përmes telefonatave dhe lëvizjeve të anëtarëve, ka mungesë drejtorësh në seancë, devijim nga rregullorja e punës duke kaluar minutazhën e lejuar. Kuvendi i Komunës së Klinës ka mbajtur deri në periudhën e raportimit (Nëntor 2014) gjithsej nëntë (9) seanca të rregullta dhe tri (3) solemne. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 9 takime. Ka një zhvillim në bashkëpunimin e më Organizatat e Shoqërisë Civile. Kuvendi dhe pse nga më herët ka të evidentuara shumë rregullore të pa-harmonizuara me ligjet në fuqi nuk ka proceduar ndryshime të rregulloreve e as miratimin e ndonjë rregulloreje të re, përveç asaj për taksa dhe tarifa komunale dhe iniciimin e asaj për transparencë në mbledhjen e KPF-së dhe Kuvendit, në muajin Nëntor.

Problemet kryesore të komunës

Komuna e Klinës edhe në vitin 2014 ka mjaft probleme, sidomos problemet me shpenzimin e parasë publike mbeten çështje për tu adresuar. Mos-transparenca e mjaftueshme, mos përfundimi i projekteve me kohë, cilësia e dobët e punimeve dhe zvarritja e punëve në terren nga reagimi qytetarë mbeten sfida.

Në raportin 9 mujor të shpenzimeve komunale ka shpenzime të mëdha për një komunë të vogël siç është Klina. Vetëm për vetura (karburant, regjistrim dhe mirëmbajtje), Klina ka shpenzuar 104,208 euro (vetëm derivate 78,188 euro, mirëmbajtje të veturave janë 16,951 euro). Edhe 10,247 euro të tjera kanë shpenzuar në linjën buxhetore “shpenzime udhëtimi brenda”. Për dreka zyrtare janë shpenzuar 27,991 euro. 9,214 euro të tjera për furnizim me ushqim-pije. Shpenzimet nga telefonja IPKO nuk ceken edhe pse tashmë të gjithë zyrtarët komunal kanë telefona nga kjo Kompani. Kompanisë Vala Komuna i ka paguar 14,220 euro, kurse shpenzime telefonike tjera (fiks) 9,591 euro. Në këtë periudhë vërehet një rënie në shpenzimet kapitale.

Në anën tjetër ka vonesa në mbylljen e projekteve në kohë. Vazhdon problematika për ujin e pijes në Klinë, ku fabrika është dashur të jetë funksionale qysh në Qershor të vitit të kaluar. Ajo është premtuar nga ana e Kryetarit z. Sokol Bashota gjatë një debati televiziv zgjedhor (Jeta në Kosovë) në nëntorin e vitit të kaluar. Por as atëherë e as sot qytetarët e Klinës nuk kanë ujin e pijes dhe tashmë kanë dalur punë shtesë nga Komuna për tu kryer. Probleme tjera për tu adresuar nga Komuna e Klinës mbeten:

- Zhvillimi ekonomik lokal,
- papunësia, uji i pijes,
- ujërat e zeza,

- mbeturinat dhe futja e gjithë territorit të Klinës në sistemin e grumbullimit të mbeturinave,
- arsimi,
- infrastruktura,
- stacioni i autobusëve,
- ruajtja e lumenjve,
- mundësitë për të rinjtë.

Të arriturat në vitin 2014

Komuna e Klinës hyn në mesin e komunave që arrijnë të marrin fonde shtesë nga Qeveria dhe organizma të tjerë lokalë apo ndërkombëtarë, krahas fondeve vetanake dhe granteve qeveritare. Investimet e Komunës së Klinës kanë qenë të fokusuara në infrastrukturë rrugore dhe kanalizime, arsim e po ashtu edhe në bujqësi me investime në penda të ujitjes. Vërehet një trajtim edhe i sektorit të shëndetësisë primare edhe pse kushtet janë të rënda në QKMF, QMF dhe ambulanca të tjera.

Për herë të parë janë marrë në konsideratë hulumtimet dhe prezantimet e bëra nga OJQ KOHA në takimet me publikun si edhe kërkesat që kanë dalë nga takime apo debate me qytetarë në fshatra dhe kanë hyrë në listën për investime, si: riparimi i shkollës, kanalizimi dhe ndërtimi i pendës së ujitjes në fshatin Grabanicë, dhe shkolla e fshatit Këpuz. Po ashtu analiza publike e prezantuar nga OJQ KOHA për ndriçim publik dhe ambulanca në Leskoc është realizuar.

Vlerësimi për performancë në transparencë

Kryetari i Komunës së Klinës z. Sokol Bashota pas diskutimeve dhe kritikave për vite me radhë që ka marrë banesë nga Komuna dhe nuk banon në të e ka kthyer banesën. Ai njihet për tërheqje të fondeve nga dikasterë të ndryshëm qeveritarë, ndërsa edhe në këtë vit pjesën e komunikimit me publikun e ka tejet të mangët. Zyra për Informim është jo shumë aktive, e shpesh edhe pa informimin e duhur të brendshëm, madje zyrtarja për informim e Komunës ka paditur Komunën sikur edhe një pjesë tjetër e stafit për mos pagesë të pagës sipas koeficientit të definuar në kontratë të punës edhe pse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyes Civil ka gjetur që Komuna ka bërë shkelje dhe duhet kompensuar.

Ditën e enjte të caktuar nga Kryetari për takime me qytetarë, nuk mbahet rregullisht. Formë të vetme komunikimi, Kryetari i ka takimet me publikun në të cilat ka mungesë të madhe të qytetarëve dhe salla plotësohet më zyrtarë të administratës komunale. Në këtë vit ka qenë pothuajse i rregullt në seancat e Kuvendit. Megjithatë, Kryetari nuk ka mbajtur asnjë konferencë për media, ndërsa nuk ka kontribuar që zyra për informim të jetë me aktive.

Drejtorët Komunal Drejtorët Komunal për dallim nga vitet tjera kanë definuar mënyrën e komunikimit me qytetarë. 7 prej 10 drejtorëve kanë caktuar një ditë të vetme në javë për komunikim me qytetarë prej orës 9.00-12.00. Kjo ka bërë të pamundur komunikimin e mirëfillt, po ashtu ka rrit pakënaqësitë qytetare sepse pas kësaj kohe më nuk gjinden drejtorët në zyrat e tyre.

Drejtorit janë të ndara ndërmjet PDK-së, AAK-së, IQK-së (të shkrirë në PDK) dhe IPK-së gjë që ka krijuar një ndërrim pozitash të drejtorëve të kaluar, e po ashtu sjelljen e disave për herë të parë në këtë pozitë, andaj edhe vërehet mos-përvoja e tyre sidomos në komunikim me publikun. Disa drejtori po përballen me disa probleme dhe si pasojë krijimin e mosbesimit. Drejtoria e Arsimit sipas Inspektoratit të Arsimit ka bërë shkelje në pranimin e

stafit arsimor, Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik nuk ka prezantuar Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal, po ashtu nuk ka publikim të shpenzimeve, raporteve periodike financiare, e buxhetit komunal. Urbanizmi nuk komunikon më qytetarë për projektet infrastrukturore dhe has në pengesa e kundërshti. Asnjëra drejtori nuk ka të dhënat mbi stafin e saj e as planin e as raporte të punës. Ndërsa, vetëm Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport udhëhiqet nga një femër.

Anëtarët e Kuvendit Komunal: Anëtarët e Kuvendit Komunal të Klinës gjatë zhvillimit të seancave të Kuvendit janë shumë pasiv, thuajse i gjithë zhvillimi bëhet nga shefat e grupeve kuvendare, ndërsa opozita është më aktive. Anëtarët e Kuvendit nuk marrin pjesë në takimet publike, po ashtu nuk kanë asnjë lloj komunikimi me qytetarë. Në ftesat për takime me qytetarë që OJQ KOHA iu ka dërguar në email adresat zyrtare asnjëherë nuk kanë kthyer përgjigje për (mos)pjesëmarrje. Gjatë seancave anëtarët janë kryesisht pasiv, kurse telefonatat dhe lëvizjet e shpeshta në janë ato çka i karakterizon ata edhe këtë vit.

Anëtarët e Kuvendit nuk përfaqësojnë interesin e përgjithshëm të qytetarëve, por gjatë zhvillimeve në Kuvend paraqesin vetëm çështje nga fshatrat apo zonat prej nga vijnë dhe votojnë sipas udhëzimeve të Kryetarit, edhe atëherë kur s'ka dokumente mbështetëse për tu bindur në votim pro. Fatkeqësisht, anëtarët femra të Kuvendit janë më pasive në Kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit. Kryesuesi i Kuvendit, z. Haxhi Ibishi më të marrë detyrën ka ftuar të gjitha OJQ-të lokale për takim dhe shqyrtim të mundësive për bashkëpunim dhe këtë vazhdon ta bëjë. Si pasoj e kësaj nisjeje OJQ KOHA është përfaqësuar në disa komitete komunale dhe komisione. Ndërsa, ftesave të OJQ KOHA për takime apo debate me qytetarë në këtë periudhë raportimi nuk i është përgjigjur pozitivisht.

Edhe në vitin 2014 Kryesuesi nuk ka bërë ndonjë takim me qytetarë jashtë zyrave të Kuvendit dhe takimet e rëndësishme për dëgjime buxhetore janë bërë pothuajse pa qytetarë.

Kryesuesi njihet për menaxhim të mirë të seancave, por në raste toleron tejkalime në diskutime, po ashtu vërehet një ndikim i Ekzekutivit, sidomos Kryetarit në takimet e Kuvendit. Kryesuesi dhe anëtarët e Kuvendit kanë bërë një shkëlqim ligjor që është vërtetuar dhe kthyer vendimi për një pronë publike nga ana e MAPL-së.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Ndërtimi i tri shkollave në fshatrat, Këpuz, Perqevë dhe Jashanicë	Pjesërisht (Në Këpuz nuk ka filluar)
2	Ndërtimin e Çerdhes për fëmijë	Planifikuar
3	Vazhdimi i ndërtimit të objektit për kategoritë e luftës	Realizuar (Duke u punuar)
4.	Rregullimi i Sheshit “Ndue Përlleshi”	Planifikuar (vendimi për rrenim ndërtesash është marrë në Kuvend)
5.	Staza këmbësore deri tek Ujëvarat e Mirushës	Pa-realizuar
6.	Ndihmë në projektin e Mozaikut të Dresnikut	Planifikuar me buxhet (10,000 euro)
7.	Kanalizime dhe ujësjellës në të gjitha fshatrat	Pjesërisht (mbetet numër i madh fshatrash pa kanalizim dhe ujësjellës)

8	Salla e Sporteve	Pjesërisht (nisur në 2005, ende duke u punuar)
9	Ngritje e serave, makina për mjelje lopësh	Planifikuar me buxhet
10	Penda për ujtitje në Kryshëvë të madhe	Duke u realizuar
11	Funksionalizimin e të gjitha sporteve në Klinë	Pa-realizuar
12	Administratë efikase, qeverisje transparente, komunikim me qytetarë	Pjesërisht

Transparenca në Komunë

Buxheti mbetet larg të qenit transparent, shpenzimi i tij që prezantohet përmes raporteve 3, 6 dhe 9 mujor, si edhe ai një (1) vjeçar, deri në periudhën e raportimit në ueb-faqe s'ka asnjë raport të publikuar. Edhe kur bëhet publikimi nuk bëhet tek raportet, por e gjen të grumbulluar me shpallje të tjera, rregullore dhe vendime të tjera mungojnë të Kuvendit apo Ekzekutivit. Tek secili vit buxhetor ka një ndarje buxheti të atillë, që zyra e Kryetarit ndal një shumë të madhe për bashkëfinancim me donatorë (prapë për 2015 ka 345.681 euro, kjo shumë nuk ka formë të rregulluar shpenzimi). Shpesh herë qytetarit i kërkohet të ndajë 30% e secilit projekt, mandej edhe donatorë të ndryshëm. Kjo ka bërë qytetarët të jenë taksapagues të dyfishtë. Raportet e auditimit nuk janë diskutuar në Kuvend.

Seancat, ashtu siç janë paraparë me rregullore të punës janë mbajtur, janë gjithsej 9 seanca të rregullta dhe 3 solemne. Takimet kanë qenë të hapura dhe me njoftime të rregullta paraprake. Edhe nga dinamika e punës, shihet që seancat plenare janë përqendruar në shumicën e rasteve vetëm në çështjet e domosdoshme, duke sjellë zhvillime, vendime dhe rregullore që i obligon Ligji. Nuk vërehet një dinamikë pune që sjellë diskutime, vendime apo rregullore që i përgjigjen nevojave të kohës. Vetëm opozita ngrit disa çështje jashtë planit të punës së Ekzekutivit dhe ato çdo herë mbivotohen. Në këtë mënyrë seancat zakonisht janë të shkurta dhe shumica në Kuvend voton secilin propozim të Kryetarit.

Komitetet konsultative janë pasive, mbesin pa kushte për punë edhe pse këtë e obligon Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimi Administrativ. Nuk janë ftuar për ndonjë angazhim dhe anëtarët e këtyre Komiteteve shprehen se nuk janë marrë parasysh edhe ato punë që i kanë bërë në mënyrë vullnetare. Për këtë arsye, Kuvendi has në probleme edhe me konkurset për anëtarë të rinj komitetesh, meqë s'ka aplikues dhe të interesuar. Sidoqoftë, është arritur të funksionalizohen të dy komitetet e formuara me rekrutimin e anëtarësisë së re, dhe me faktin se prej ri-funksionalizimit këto komitete kane mbajtur nga dy takime. Për më tepër njëri komiteti i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Mbrojtjes së Ambientit udhëhiqet nga një femër.

Më gjithë së jo e kënaqshme dhe e plotë kërkesat për Qasje në Dokumente në vitin 2014 kanë marrë përgjigje. Ky është një zhvillim pozitiv. Një problem i madh është se ka vetëm një zyrtar për qasje në dokumente dhe në rast të pushimeve ose mungesave askush tjetër nuk merr punën përsipër.

Ueb-faqja e Komunës së Klinës është larg plotësimit të të qenit në funksion të informimit publik për vendimet, projektet, dhe shpenzimet e parasë publike. Madje aty mungojnë edhe të dhënat bazike për zyrtarët përgjegjës, drejtorët dhe planet e punës, po ashtu mungojnë edhe kontaktet. Ende figurojnë si anëtarë të kuvendit ata që tashmë janë duke udhëhequr në Ekzekutiv. Procesverbalet nuk janë vënë në dispozicion të publikut, përveç formës elektronike që MAPL ka bërë të mundur, por që hapet më vështirësi. Zhvillim pozitiv mbetet vendosja në ueb-faqe e inqizimeve zanore të seancave të kuvendit.

Llogaridhënia në Komunë

Kryetari i Komunës së Klinës z. Sokol Bashota mënyrën e vetme të komunikimit me qytetarë e ka në takimet obligative ligjore, siç është raporti i punës dhe diskutimi i tij apo planifikimi buxhetor për vitet vijuese. Takimet e tilla thuajse mbahen pa qytetarë, për shkak të pasivitetit qytetarë në Komunën e Klinës.

Edhe komunikimi me Shoqërinë Civile është bërë nëpërmjet këtyre linjave, takimeve të hapura ku mund të merr pjesë secili qytetarë. Kuvendi ka bërë të mundur një bashkëpunim më të mirë me shoqërinë civile, OJQ-të në Klinë, si edhe një pjesë e drejtorëve. Asnjë konferencë për media nga ana e Kryetarit nuk është mbajtur në vitin 2014.

Kryetari i Komunës është aktiv dhe pothuajse është pjesëmarrës në secilën seancë të Kuvendit duke i japur edhe përgjigje çështjeve të ngritura, e po ashtu duke shtyrë propozimet e Ekzekutivit për të marrë votime pozitive, po ashtu edhe duke arsyetuar (mos)punën e bërë.

Në vitin 2014, deri në periudhën e raportimit janë mbajtur 4 takime me publikun nga ana e Komunës së Klinës, ai për të arriturat e Komunës për vitin paraprak dhe synimet për vitin vijues, raporti 6 mujor i punës, si edhe dy dëgjime për buxhetin, njëri për Kornizën afatmesme buxhetore 2015-2017, si edhe diskutimi publik për buxhetin e vitit vijues (2015). Takimet publike vazhdojnë të kenë numër të vogël të pjesëmarrësve në secilin takim, ndërsa Komuna e Klinës nuk ndryshon strategji, mjaftohet me organizimet në sallën e Kuvendit (një të tille), që, fatkeqësisht, vazhdon të plotësohet më zyrtarë komunal administrativ.

Nga këto takime, qytetarët kanë pasur shumë pak mundësi për ndryshime meqë buxheti veç ka qenë i planifikuar nga dikasteret brenda Komunës, por sikur në vitin e kaluar kanë dëgjuar ftesën e Kryetarit të Komunës për participim në vlerën e 30% të projektit, ndërsa pjesën tjetër e siguron Komuna.

OJQ KOHA ka organizuar debate publike të tjera në Klinë dhe zona në zona rurale dhe asnjëherë s'e ka pasur problem pjesëmarrjen qytetare. Vlen të theksohet se nga takime për herë të parë ka një konsideratë nga ana e Komunës dhe disa projekte kanë hyrë si prioritet për vitet në vazhdim. Anëtarët e Kuvendit nuk marrin pjesë në asnjë takim me qytetarë kushdo që e organizon.

Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i takimeve	Numri	Në rend dite	Pjesëmarrja	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare	10	64	87.28%	100%
Komiteti për Politikë dhe Financa	9	51	78%	S'ka
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli Komunal Sigurisë në Bashkësi	2 + 2 trajnime		OJQ "Elena Gjika" - si anëtare e KKSB-së	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	3		15 persona	

Fabrika e ujit të pijes

Qytetarët e Klinës edhe me tej përballen me mungesën e ujit të pijes. Investimi më i madh dhe më i rëndësishëm i Komunës së Klinës që do t'iu siguronte ujin e pijes mbi 10.000

qytetarëve të Klinës dhe më gjërë, ai i fabrikës së ujit ende nuk është funksionalizuar edhe pse ka kaluar afati i paraparë në kontratë. Premtimi i Kryetarit të Komunës vitin e kaluar, në fushatën e zgjedhjeve lokale nuk është realizuar dhe edhe në vitin 2014 nuk është uji i pijes në çeshmet e qytetarëve, edhe pse padrejtësisht paguajnë çmimin e njëjtë sikur qytetarët e Istogut apo Pejës që kanë ujin e pijes në shtëpitë e tyre. Në anën tjetër më vendim të Kuvendit shumica e paraparë për të paguar (afër 1.7 milion euro) është aprovuar e po ashtu ky projekt ka marrë mbështetje financiare edhe nga Qeveria.

Zyrtarët e Kompanisë akuzonin Komunën për mospagesë të shumës së mbetur, anëtarët e Ekzekutivit në fushatën e kaluar kanë pasur edhe konflikte të rënda verbale më zyrtarët e Kompanisë. Zhvillimet e reja thonë që duhen edhe punë shtesë të kryhen nga ana e Komunës. Komuna është në tenderim të punëve shtesë që nuk janë konsideruar me herët dhe e kap vlerën prej rreth 100.000 eurosh, ngritja e nivelit të ujit, pastrimin e shtratit të Lumit dhe largimin e një kanali të ujërave të zeza, madje tashmë thuhet që Fabrika nuk ka kapacitetin e paraparë.

Në këtë mënyrë Komuna e Klinës vazhdon me vonesat në përfundimin e projekteve kapitale dhe është temë e ngritur shpesh në Kuvend, sidomos nga opozita që kërkojnë sqarime për vonesat.

Trajtimi i pronës publike

Përkundër rekomandimeve në vazhdimësi që Kuvendi i Komunës të bëjë kujdes me vendimet që merr, sidomos për pronën publike, Komuna e Klinës vazhdon të veprojë njëjtë dhe të miratoj vendime edhe kur nuk ka material të shtypur dhe bazë ligjore, por vetëm propozim verbal nga ana e Kryetarit të Komunës. I tillë ishte edhe rasti me ndarjen e një parcele në seancën e 25 Prillit 2014. Kryetari përveç kërkesës për votim pro nuk ishte i saktë as për madhësinë e kësaj parcele që jepej nga ana e Kuvendit si bashkëpunim me një organizatë italiane. Ndërsa, anëtarët e Kuvendit pa hezitim votuan *Pro*. MAPL ka kthyer këtë vendim për shkelje procedure dhe të Ligjit nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, neni 5, neni 81, pika 4. Kuvendi ka anuluar këtë vendim, për të zbatuar procedurat dhe Ligjin.

Edhe në këtë vit Komuna e Klinës po është e ngutshme me marrjen e vendimeve kur ka të bëjë me pronën publike. Njëjtë ishte edhe vendimi për rrënimin e disa ndërtesave dhe nisjen e 3 të tjerave në qendër të Klinës në partneritet publiko/privat. Ngutia, mospasja e dokumentacionit përkatës, pastaj mos pasja e marrëveshjeve me shkrim me banorët, dhe mos komunikimi i mirëfilltë me publikun e gjërë ka sjellë reagime në Kuvend dhe jashtë. Po ashtu ngutia ka sjellë edhe në diskutim nëse ka qenë në konflikt interesi anëtar i Kuvendit, z. Ndue Shabanaj, i cili ishte në listë që kërkuar/pranuar rrënimin dhe në të njëjtën kohë ka votuar në Kuvend pro rrënimit.

Rekomandimet për Komunë

Zyrës së Kryetarit të Komunës:

- Trajtim serioz, të menjëhershëm dhe angazhim ekspertësh nga ana e Komunës për pranim të punimeve, të përfundoj punimet e nevojshme dhe funksionalizoj Fabrikën e ujit të pijes për qytetarët e Klinës;
- Ekzekutivi Komunal të pajis me material të mjaftueshëm Kuvendin duke mënjeluar votimet e ngutshme dhe pa material (faktues) të shtypur dhe si pasojë mënjanimin e shkeljeve ligjore përmes komunikimeve paraprake me zyrën ligjore;
- Të funksionalizohen Qendrat e Mjekësisë Familjare në Sferkë, Zllakuqan dhe Ujmirë dhe të jenë në shërbim të qytetarëve 24 orë, staf të mjaftueshëm dhe të ofrojë secilin shërbim ashtu siç e përcakton Ligji për Shëndetësi dhe QMF (Shërbime të laboratorit, EKG, ato stomatologjike, gjinekologjike dhe të pediatriisë);
- Komuna e Klinës në bashkëpunim të ngushtë me Kompaninë Regjionale “Ambienti” të nis komunikimet direkte me banorët e fshatrave dhe të bëhet një plan veprimi lokal i mjedisit dhe në mënyrë graduale të përfshihet i gjithë territori i Komunës së Klinës në sistemin e grumbullimit të mbeturinave;
- Të ndikoj në ulje të shpenzimeve, sidomos derivate, dreka e telefoni dhe kujdes në kategorinë e subvencioneve e transfereve dhe inicimi i një rregullore për këtë kategori. Transparencë me e madhe e shpenzimit të parasë publike, duke publikuar raportet e punës dhe shpenzimeve komunale për periudhat raportuese dhe të kërkojë me shumë përgjegjësi nga zyrtarët e tij që dokumentet publike të jenë të qasshme me kohë në ueb-faqe të Komunës apo përgjigje ndaj kërkesave për qasje në dokumente publike, edhe të bëhet zgjidhje në mungesë të zyrtarës të caktuar për Qasje në Dokumente Publike;
- Qytetarët të informohen me punën dhe angazhimin e organeve të Komunës së Klinës, stafi të përgatisë dhe dërgoj ftesa në adresë të përfaqësuesve të vendbanimeve në kohë e mënyrë të rregullt dhe të ketë konsultim të gjërë qytetar para miratimit të buxhetit, planifikimeve afatgjate, strategjive të ndryshme, investimet kapitale apo çështje më interes për publikun. Takimet të realizohen në fshatra apo Bashkësi Lokale, varësisht tematikës dhe zonës;
- Zyra për informim të jetë më aktive duke publikuar lajmet nga funksionimi i organeve komunale, njoftimet, vendimet e Kuvendit, po ashtu edhe ato të Kryetarit apo të Drejtorëve dhe çdo gjë tjetër ti komunikohet qytetarit në kohë;
- Themelimin dhe organizimin me rregullore përfaqësimitin e fshatrave dhe zonave urbane. Planifikim buxhetor dhe proces të drejtë dhe gjithëpërfshirës (jo politik), angazhim serioz në planifikimin e zonës për stacion të autobusëve, ruajtjen e hapësirave të gjelbërta dhe lumenjve nga ndërtimi dhe krijimi i shëtitoreve, planifikim për park qyteti dhe të respektohet vendimi i MAPL-së që ka shpallur të paligjshëm kushtëzimin e Komunës karshi qytetarëve me pagesën e mbeturinave.

Kryesuesit të Kuvendit:

- Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me Kryetarin të përgatisin kujdesshëm pikat e rëndit të ditës për secilën seancë të Kuvendit dhe respektim të pikave të rëndit të ditës;
- Kryesuesi i Kuvendit të jetë tejet i kujdesshëm në vënien në votim të propozimeve të Ekzekutivit duke pasur dokumentacion të bollshëm dhe paraprak për shqyrtim nga ana e këshilltarëve;
- Të ruaj neutralitetin gjatë udhëheqjes së seancave duke trajtuar barabartë të gjitha grupet kuvendare, pa anime politike dhe ndikime të tjera nga Ekzekutivi;

- Së bashku më Kryetarin e Komunës të nisin hapat e menjëhershëm për harmonizimin e rregulloreve komunale të cilat ka vite që nuk janë në harmoni më Ligjet në fuqi në Republikës së Kosovës, rregulloret për subvencionet dhe rregullore të tjera;
- Thelimin e bashkëpunimit më Organizatat e Shoqërisë Civile dhe pjesëmarrje në takimet që Organizatat e Shoqërisë Civile organizojnë;

Anëtarëve të Kuvendit:

- Marrjen e materialit të seancës me kohë dhe shqyrtimin e dokumenteve më me shumë kujdes para votimeve pro apo kundër;
- Këshilltarët e Kuvendit të jenë më aktiv në diskutimet në Kuvend, kërkimin e dokumentacionit shtesë nga ana e Ekzekutivit dhe jo votim dhe besim të tepruar propozimeve verbale të Ekzekutivit, sidomos kur ka të bëjë me pronën publike që prodhon efekt të menjëhershëm publik e ligjor;
- Të bashkëpunojnë dhe konsultohen rregullisht me qytetarët, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe të marrin pjesë në takimet me qytetarë. Sjelljen e propozimeve të ndryshme për rregullore, ngritje e zërit të qytetarëve në Kuvend;
- Përfaqësim të përgjithshëm të interesave të Komunës së Klinës, e jo vetëm të zonës apo fshatit që i takon;
- Këshilltarët të jenë më të kujdesshëm gjatë zhvillimit të seancave, duke lënë anash obligimet tjera, çfarë do qofshin ato, lëvizjet të minimizohen dhe lihen anash telefonatat;
- Femrat këshilltare të jenë më aktive duke ngritur zërin në mbrojtjen e interesit të femrës, të përfaqësimit të saj po edhe të këtë rolin e saj në proceset e ndryshme në Komunë.

Rregulloret dhe Vendimet


Vendimi	Statusi	Votimi
Zgjidhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës	Miratuar	Pro: 19 Kundër: 00 Abs:
Themelimi i Komiteteve Obligative	Miratuar	Pro: 19 Kundër:00 Abs:00
Shqyrtimi i çështjes së dhënies së tokës komunale në shfrytëzim dhe ndërmarrja e veprimeve përkatëse ligjore	Miratuar	Pro: 19 Kundër:00 Abs:00
Propozimi i vendimit për formimin e komisionit për ankesa lidhur me shqyrtimin e ankesave në procedurë të dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim	Miratuar	Pro: 26 Kundër:00 Abs:00
Plani i punës së Kuvendit të Komunës dhe caktimi i kalendarit vjetor të punës së KK-së dhe komiteteve	Miratuar	Pro: 24 Kundër:00 Abs:00
Raporti Financiar 2013	Miratuar	Pro: 18 Kund: 8 Abs:00
Plani i Punës së Zyrës së Prokurimit 2014	Miratuar	Pro: 18 Kund: 8 Abs:00
Themelimi i KKS-së	Miratuar	Pro: 26 Kund: 00, Abs: 0
Ndarja e trojeve për komunitetin RAE	Miratuar	Për: 22, Kund:2, abs: 0
Raporti ekzekutivitet dhe prokurimit 2013	Miratuar	Për: 15, Kund: 8, abs: 00
Raporti financiar janar-mars 2014	Miratuar	Për: 22, Kund: 1, abs: 2
Ndryshimi i rregullores për ngarkesa, taksa dhe gjopa komunale dhe formimi i komisionit për hartimin e ndryshimeve	Miratuar	Për: 23, Kund:00, abs:00
Vendimi për ndarjen e pronës komunale 40 metra katrore në fshatin Videjë për ndërtimin e një thetore	Miratuar	Për:23, Kund: 00, abs:01
Vënia në diskutim publik të ndryshimeve dhe plotësimeve të rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale	Miratuar	Për:27, Kund: 00, abs:00
Rishikimi i vendimit për ndarjen 42 metra katrore prone komunale në Videjë për thetore	Miratuar	Për:27, Kund:00, abs: 00
Strategjia e Plan-Veprimit të Grupit të Grave Asamblistë	Miratuar	Për: 25, Kund: 00, abs:00
Korniza Afatmesme buxhetore KAB-2015-2017	Miratuar	Për 25, Kund: 00, abs:00
Plani i Punës së KKS-së	Miratuar	Për: 26, Kund:00, abs:00
Formimi i Komisionit Komunal për implementimin e programit të KE-së për emërtimin e rrugëve,	Miratuar	Për: 26, Kund: 00, abs:00
Vendimi për vënie në diskutim publik të draft programit tre vjeçar të banimit social	Miratuar	Për: 27, Kund: 00, abs:00
Raporti ekzekutivitet janar-qershor 2014	Shqyrtuar	
Shlyerja e obligimeve financiare për obliguesit tatimor të ngarkuar për vitin 2013 e me parë	Miratuar	Për: 26, Kund:00, abs: 00
Vendimi për lejimin e ndërtimeve të larta afarist-banesore në afërsi të rreth rrotullimit në kuadër të sheshit “ Ndue Përlleshi” në Klinë	Miratuar	Për:18, Kund: 8, abs:01
Vendimi për vënie në diskutim i projekt rregullores për Transparencë	Miratuar	Për: 26, Kund: 0, abs: 0




Komuna Fushë Kosovë



Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



5. Komuna FUSHË KOSOVË

Vlerësimi i Përgjithshëm

Çfarë e karakterizoj komunën këtë vit

Gjatë këtij viti në kuvendin komunal në Fushë-Kosovë kishte disa ndryshime në aspektin substancial duke e ditur se ishte vit zgjedhor. Struktura e kuvendit komunal është plotësuar me disa subjekte të reja, të cilat me vet prezencën e tyre në kuvend kërkonin më shumë përgjegjësi dhe sqarime nga ekzekutivi për punët ditore që ata bënin. Për dallim nga legjislatura e kaluar, në këtë legjislaturë debatet janë më të ashpra dhe ka vendime që merren vetëm nga pozita pa përkrahjen e opozitës, dukuri e re nga e kaluara kur shumica e vendimeve janë marrë në mënyrë unanime. Prezenca e një numri të anëtarëve të rinj të Kuvendit që kanë ardhur si rezultat i zgjedhjeve të fundit ka shtuar debatin parlamentar duke ia rritur paska “vlerën” kuvendi karshi ekzekutivit të komunës.

Problemet kryesore të komunës

Komuna e Fushë Kosovës edhe gjatë këtij viti mund të themi se është përballur thuajse me problemet e njëjta sikurse nga vitet paraprake. Duke u bazuar në këtë mund të themi se problemet vazhdojnë të jenë të njëjtat që kanë qenë. Problemet kryesore të komunës janë:

1. Problemi i ujit të pijshëm
2. Ndërtimet e shumta dhe të larta
3. Hapësirat e pakta të gjelbëruara;
4. Ndotja e ajrit që vjen nga KEK-u
5. Derdhja e ujërave të zeza në lumenjtë etj.

Të arriturat në vitin 2014

Komuna e Fushë Kosovës gjatë këtij viti ka arritur të marrë më seriozisht punët dhe rekomandimet që i kemi dërguar, por edhe vet komuna ka bërë nja pasqyrim më të saktë të prioriteteve të saj duke u bazuar në rekomandimet e shoqërisë civile dhe kërkesave të qytetarëve, pasi që ne kemi listuar disa nga problemet kryesore që janë evidente në komunën e Fushë Kosovës, dhe këto probleme gjatë këtij viti kanë filluar të shqyrtohen më shtruar dhe nga kjo kemi edhe të arriturat e këtij viti nga komuna, pasi që në këtë vit komuna ka filluar të punojnë rreth projekteve siç janë:

1. Pastrimi dhe zgjerimi i lumit Drenica, Prishtevka dhe Sitnica.
2. Rregullimi i hapësirave të gjelbëruara në fshatin Sllatinë tek pishat dhe rregullimi i parkut në oborrin e shkollës fillore “Selman Riza”
3. Projekti për ndërrimin e gypave të ujësjellësit.

Vlerësimi për performancë në transparencë

Kryetari i komunës ka munguar në disa prej mbledhjeve kryesore të Kuvendit të komunës gjatë vitit 2014. Po ashtu, mënyra e raportimit të tij para kuvendit nuk është bërë në mënyrë të detajuar duke lënë të pasqaruar disa prej vendimeve të marra prej tij.

Ekzekutivi i komunës respektivisht drejtoritë në ekzekutivin e komunës sa i përket transparencës ka hapësirë shumë për t'u përmirësuar. Ata duhet të jenë më të përgjegjshëm në kërkesat e qytetareve dhe t'u përgjigjen kërkesave të tyre në afatet të përcaktuara me ligj.

Këshilltarët komunal janë transparentë por jo shumë aktiv në takime me qytetarët që do ta rriste performancën e transparencës sa i përket punës së tyre në kuvend në raport me qytetarin.

Kryesuesi është treguar transparent dhe bashkëpunues me ne në lidhje me punën e Kuvendit. Kryesuesi gjatë këtyre muajve të punës së tij ka dëshmuar që mund të kërkoj llogari nga ekzekutivi komunal gjë që është në përputhje të plotë me nevojat e qytetarëve dhe të demokracisë komunale.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Ndërtimi i shkollës në Nakarda	Pa-realizuar
2	Ndërtimi i parkut te pishat në Sllatinë të madhe	Realizuar
3	Asfaltimi i rrugëve në komunë	Pjesërisht/ Planifikuar me buxhet edhe për vitin e ardhshëm
4.	Rregullimi i sistemit të ujitjes nga lumi Drenica, në Pomozotin-Sllatinë e Vogël	Realizuar
5.	Furnizimi i shkollave me mjete kabinetike-didaktike	Realizuar
6.	Blerja e pajisjeve për shëndetësi	Planifikuar me buxhet pamjaftueshëm
7.	Pastrimi sanitar i pyjeve	Planifikuar me buxhet

Transparenca në Komunë

Buxheti si shtyllë kryesore e funksionimit të komunës kërkon përpikëri dhe profesionalizëm në hartimin e tij. Hartimi i buxheti është bërë në pajtueshmëri me dispozitat ligjore që janë paraparë me ligjin për vetëqeverisje lokale dhe ligjin për financat publike. Para miratimit të buxhetit komuna ka organizuar dhe ka mbajtur tri takime me qytetarët, që qytetarit i është mundësuar të jetë pjesë e vendimmarrjes dhe ti caktoj prioritet për vitin 2015 për lokacionet ku ata jetojnë. Për shkak të rritjes të madhe të numrit të banorëve edhe të hyrat të mëdha vetanake, komuna duhet të ketë shumë kujdes gjatë përpilimit të buxhetit duke u mbështetur në kërkesat e banorëve.

Sipas ligjit për vetëqeverisje komunat janë të obliguar të mbajnë së paku 10 seanca gjatë një viti, komuna e Fushë-Kosovës i ka mbajtur 11 seanca të kuvendit, seancat kanë qenë të hapura për publikun dhe mediat edhe pse prezencat e qytetarëve ka qenë e mangët kurse mediat kanë qenë të pranishëm vetëm në disa seanca. Gjatë seanca plenare kryesuesi është munduar të jetë mjaft konstruktiv dhe i paanshëm politikisht duke i dhënë mundësin që të gjithë asamblistët ta marrin të drejtën e diskutimit duke i respektuar rregulloren e punës

për asamblistë 5 minuta kurse për shëf të grupit parlamentar 10 minuta. Gjatë këtij viti në komunën e Fushë-Kosovës seancat janë zhvilluar në një klimë të mirë demokratike duke treguar pjekuri parlamentare, por ka patur raste kur kjo klimë është ndryshuar dhe është shndërruar në një arenë të nxehtë debati në mes të asamblistëve dhe ekzekutivit me arsyetimin që asamblistët po kërkojnë llogaridhënie më shumë nga ekzekutivi ndërsa ekzekutivi nuk po arrin me qenë transparentë ndaj kërkesave të legjislativit.

Komuna e Fushë-Kosovës në mandatin e ri e deri tani mund të themi se nuk i ka kushtuar rëndësi të madhe krijimit të komitetit konsultativ, përveç komiteteve të obligueshme me ligj atë të komitetit për politike dhe financa dhe atij komiteti për komunitete, komuna ka themeluar edhe komitetit për ndërmjetësim si pjesë e komiteti konsultativ. Pavarësisht mos funksionimit të tyre mbesim me shpresë që komuna e Fushë-Kosovës ti kushtoj rëndësi më të madhe themelimit dhe funksionimit të këtyre komiteteve.

Komuna e Fushë-Kosovës nuk qëndron keq sa i përket qasjen në dokumentet zyrtare, mirëpo për të ardhmen lenë shumë për të dëshiruar që përgjigjet e kërkesave ti kthejë në afat kohor të paraparë me ligj. Ne si IZHL gjatë këtij viti kemi bërë disa kërkesa për qasje në dokumente zyrtare ku në disa prej tyre kemi marrur përgjigje ndërsa në disa prej tyre ende nuk kemi marr përgjigje. Dy nga drejtorit që nuk kemi marrë përgjigje janë drejtoria e financave dhe drejtoria e urbanizmit.

Ueb-faqja e komunës është një problem kyç të cilin tash e sa kohë ne si IZHL jemi duke adresuar ankesë dhe vërejte për mos freskimin mbi ndodhitë në komunë, mos publikim e buxhetit, procesverbalet e kuvendit, statutin e komunës, shpalljen e konkursit për ndihmë financiare për studentët. Te gjitha këto dokumente janë të obliguar me ligj ti bëjnë publike ne ueb-faqen e komunës.

Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i takimeve	Numri	Në rend dite	Pjesëmarrja	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare	12	64	%	%
Komiteti për Politikë dhe Financa	11	59		
	Gjithsej takime		Pjesëmarrja e shoqërisë civile	
Këshilli Komunal Sigurisë në Bashkësi	6		Po	
	Gjithsej		Pjesëmarrja mesatare	
Takimet me publikun	2		150 persona	

Llogaridhënia në Komunë

Kryetari nuk ka mbajtur asnjë takim me qytetarët dhe shoqërinë civile ku do ta prezantonte një raport të punës së tij dhe drejtorive të komunës. Një arsyetim nga zyrtarët komunal për mos raportimin e kryetarit para qytetarëve dhe shoqërisë civile është se kryetari çdo ditë pranon qytetarët në zyrën e tij dhe ashtu e bënë njoftimin e qytetarëve mbi punën e tij dhe drejtorëve të tij.

Kryetari dhe drejtorët kanë qenë të pranishëm në disa emisione të ndryshme për të treguar punën e tyre, ata janë në gjendje gatishmëri të jenë të pranishëm në media por pak vëmendje i është kushtuar qeverisjes lokale këtë vit nga mediat.

Kryetari i komunës ka sjellë raportin mbi punën e tij në asamble, ku edhe ka mbajtur një fjalim ku ka shpalosur aktivitet e punës së tij prej fillimit të mandatit të ri. Duke e ditur se raporti i kryetarit nuk votohet por vetëm shqyrtohet atëherë edhe diskutimet rreth këtij raporti nuk kanë munguar, diskutimi është koncentruar në një debat mes pozitës dhe opozitës. Diskutimi i pozitës ka qenë mbështetës për punën e kryetarit dhe raportin financiar kurse opozita ka qenë kritik ndaj punës dhe raportit financiar të kryetarit duke i kritikuar shpenzimet në mallra dhe shërbime dhe në zyrën e kryetarit.

Komuna e Fushë-Kosovës ka organizuar 3 dëgjime publike rreth buxhetit, por këto dëgjime janë organizuar në objektin komunal, ka munguar informim rreth këtyre dëgjimeve informimi për këto dëgjime publike është bërë në ueb-faqen dhe në disa gazeta. Disa nga arsyet e mungesës së qytetarëve në këto dëgjime publike janë: mosinformimi për mbajtjen e këtyre dëgjimeve, humbja e besimit ndaj komunës, lokacioni dhe koha e papërshtatshme e mbajtjes së këtyre dëgjimeve.

Edhe pse ka pas shumë pak qytetarët në këto dëgjime, disa nga sugjerimet e tyre janë përfshirë në kornizën afatmesme buxhetore, disa nga kërkesat e qytetarëve ishin të rritet shuma e ndarë për bujqësi dhe shëndetësi. Niveli i konsultimit me qytetarët nuk është i kënaqshëm dhe komuna duhet të shkoj ti takoj qytetarët në lokacionet e tyre ashtu siç ka shkuar gjatë fushatës zgjedhore. Nuk ka pas ndonjë aktivitet të organizuar ku asamblistët janë takuar me qytetarët, zakonisht kur asamblistët thirrën në emër të qytetarëve për çështje të caktuar e bëjnë këtë vetëm për lagjen apo fshatin nga i cili vijnë.

Mungesa e klasave për parashkollorët

Një ndër problemet e komunës është mungesa e paraleleve për parashkollorë, komuna e Fushë-Kosovës është ndër të vetmet komuna në Republikën e Kosovës që në qytet nuk ka asnjë paralele për parashkollorët kurse në fshatra ekzistojnë disa paralele. Në kuvendin komunal është marr një vendim për themelimin e këtyre paraleleve dhe pagesa e mësimdhënësve që do të angazhohen të bëhet nga buxheti komunal por jo nga linja pagat dhe mëditjet, kjo për arsye se ministria e arsimit nuk e lejon rritjen e numrit të punëtorëve. Ky propozim ka ardhur nga kryetari i komunës dhe drejtori i arsimit, ka pas përkrahjen e asamblistëve nga pozita kurse opozita ka abstenuar. Tani është bërë 1 vit prej marrjes së këtij vendimi dhe ende nuk kanë filluar hapjen e këtyre paraleleve.

Menaxhimi i Ndërtimeve të larta

Problem thelbësor për komunën e Fushë-Kosovës vazhdon të mbetet menaxhimi i drejtë i ndërtimeve në komunë. Komuna ka pasur një plan urbanistik të miratuar në vitin 2005 ndërsa nga ai vit bumi i ndërtimeve ka qenë shumë i lartë. Fushë-Kosova karakterizohet me ndërtime të shumta të cilat e kanë bërë atë vendbanim të shumë qytetarëve të Kosovës, të cilën kryesisht janë joshin nga çmimet e ulëta të banesave (krahasuar me vendet tjera) por edhe shkak i pozitës së mirë që ka Fushë-Kosova (terren i rrafshët dhe shume afër me Prishtinën.

Në përgjithësi, është dështuar menaxhimi i drejtë i ndërtimeve dhe shumë prej tyre kanë tejkaluar standardet e lejuara për ndërtim dhe për hapësirë të gjelbërt dhe parkingje. Duket që trinomi (kryetar i komunës, drejtoria e Urbanizmit dhe ajo e Inspektionit) nuk kanë funksionuar si të koordinuar në parandalimin e tyre. Në shumicën prej tyre banorët veçse

janë duke banuar dhe intervenimet radikale (si rrënimet) janë të pamundura. Por, procesi i legalizimeve të objekteve pa leje duhet të ketë një kosto ndëshkuese për të gjithë ndërtuesit.

Përfshirja e kuvendit komunal në këtë proces duket të jetë e domosdoshme ndërsa formimi i komisioneve vlerësuese nga kuvendi dhe ekzekutivi mund të ishte një zgjidhje eventuale për këtë problem. Tarifat e larta që duhen vënë ndërtuesve të pa-përgjegjshëm duhet të përdoret në ndërtimin e parqeve si dhe parkingjeve të ndryshme afër lokacioneve kryesore ku është ndërtuar. Deri më tash nuk shihet ndonjë veprim nga asnjë nga akterët kyç në këtë fushë. Asamblastët komunal duhet të ngrisin zërin për të provuar që të hapin një debat më të gjerë në lidhje me ndërtimet e larta dhe kostot që duhen vendosur për procesin e legalizimit. Vetëm kjo, do të ishte një formë shpagimi për qytetarët e Fushë-Kosovës të cilët do të duhen të përballojnë çdo ditë jetesën në një ambient të tillë.

Rekomandimet për Komunë

Zyrës së Kryetarit të Komunës:

- Sa i përket zgjidhjes së problemit për themelimin e paraleleve për parashkollorët duhet të jenë të përfshirë edhe niveli qendror respektivisht ministria e arsimit dhe e financave, pasi që me ligj komunat mësimi për parashkollorët është i obligueshëm dhe komuna nuk ka të drejtë të rrisë numrin e mësimdhënësve. Për zgjidhjen e këtij problemi duhet të arrihet një marrëveshje në mes të nivelit lokal dhe atij qendror.
- Të investohet më shumë në blerjen e pajisjeve mjekësore dhe në renovimin e QKMF në Fushë-Kosovë, gjithashtu ti kushtohet një rëndësi e veçantë çështjes së higjienës sanitare.
- Komuna duhet ti kushtoj më shumë vëmendje uzurpimit të hapësirave publike nga kafiteritë dhe shëndrrimin e këtyre hapësirave në veprimtari afariste, këto hapësira duhet të gjelbërohen ashtu siç ishin më herët.
- Ligjin për vetëqeverisjen Lokale kryetarit të komunës i jep kompetenca të mëdha ekzekutive që nënkupton se ka të drejtë të marr vendime për mbrojtjen e qytetit nga degradimet dhe uzurpimet duke u bazuar në ligj dhe duke i zbatuar afatet kohore që parash ky ligj për çështje të ndryshme.
- Kryetari në raport me asamblistë duhet të tregohet më i matur dhe më i përgjegjshëm si një figurë përfaqësuese e qytetarëve të komunës.
- Kryetari i komunës përveç takimeve ditore me qytetar duhet të respektoj ligjin për vetëqeverisje lokale për mbajtjen e dëgjimeve publike rreth çështjes së buxhetit, projekte kapitale si dhe për tema të rëndësishme për qytetarët e komunës.
- Puna e kryetarit të komunës dhe e ekzekutivit duhet të bazohet në përfshirjen e projekteve dhe shërbimeve ndaj qytetarëve të gjithë komunës së Fushë-Kosovë. Dhe për ta arritur këtë komuna duhet ti kushtoj një rëndësi të veçantë krijimit të këshillave të fshatrave pasi ky këshill do t'ia lehtësonte punën ekzekutivit por njëherësh edhe do të ofronte më afër ekzekutivin me qytetarin, sepse ky këshill do ti paraqiste prioritet e fshatit të cilin e përfaqëson dhe këto prioritet do të duhet të përfshiheshin në buxhetin komunal. Ne rekomandojmë se anëtarët e këtij këshilli duhet të mos t'i përkasin asnjë subjekti politik, gjithashtu mos të jenë pjesë e administratës komunale sepse besojmë që këta do ta kishin të vështirë t'i përfaqësonin dhe mbronin interesat e qytetarëve.

Kryesuesit të Kuvendit:

- Kryesuesi duhet të bëjë presion më të madh që ekzekutivi të përgjigjet në kërkesat e anëtarëve të Kuvendit brenda afate kohore të përcaktuara me ligjin për qasje në dokumente publike.
- Kryesuesi i kuvendi të marr iniciativën për themelimin e disa komiteteve konsultative që të ketë hapësirë edhe shoqëria civile pjesë e vendimmarrjes.


Asamblistëve të Kuvendit:

- Duhet të vijnë të përgatitur në seanca, ka pasur të atillë që janë deklaruar që nuk e kanë lexuar fare dokumentet për të cilat do të duhet që ai të votoj.

- Gjatë diskutimeve asamblastët duhet të jenë sa ma të qartë dhe konkret në kërkesa e tyre. Asambleistët gjatë këtij viti që ne e kemi mbikëqyrë punën e kuvendit asnjëherë nuk kanë sjell propozime për ndonjë çështje.
- Asambleistët duhet të jenë me aktiv gjatë shqyrtimit të rregullore dhe vendimeve të ndryshme që merren në kuvend e jo vetëm ta ngritin dorën siç bëjnë shumica e tyre. Asamblastët duhet të kenë kontaktet me qytetarët përmes debateve të ndryshme.


Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
Vendim për bartjen dhe shpërndarjen e të hyrave vetanake të vitit 2013- në 2014.	Miratuar	Pro: 17, Kundër: 1 Abs :2
Vendim për ndarjen e subvencioneve në bujqësi dhe zhvillim rural.	Miratuar	Pro: 16 Kundër: 3 Abs: 3
Vendim për fillimin e procedurës për dhënien në shfrytëzim të Ngastrës Kadastrale 1342 në ZK Fushë-Kosovë.	Miratuar	Pro: 20 Kundër:0 Abs: 2
\$Raporti i kryetarit për vitin 2013.	Shqyrtuar	
Raporti financiar i shpenzimeve për vitin 2013.	Miratuar	Pro: 19, Kundër: 3 Abs :4
Vendim për ndihmë financiare në shërim.	Miratuar	Pro: 25, Kundër: 0 Abs :0
Raporti financiar për buxhetin e shpenzuar në tremujorin e parë.	Miratuar	Pro: 18, Kundër:9 Abs :0
Vendim për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e arsimitarëve që zhvillojnë mësim joformal	Miratuar	Pro: 24, Kundër: 0 Abs :3
Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për zbatimin e planit të veprimit për parandalimin e braktisjes së arsimit.	Miratuar	Pro: 25, Kundër: 0 Abs :0
Vendim për lejimin e mjeteve financiare për ansamblin Zëri i Kosovës.	Miratuar	Pro: 12, Kundër: 5 Abs :5
Raporti i punës së kryetarit të komunës për gjashtëmujorin e parë.	Shqyrtuar	
Raporti financiar për buxhetin e shpenzuar në gjashtëmujorin e parë 2014.	Miratuar	Pro: 16, Kundër: 6 Abs :2
Vendim për transfer dhe ridestinimin e mjeteve për projekte.	Miratuar	Pro: 20, Kundër: 0 Abs :3
Raporti i Auditorit të jashtëm 2013.	Shqyrtuar	
Rregullorja për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale.	Miratuar	Pro: 15, Kundër: 7 Abs :0
Vendimi për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës	Miratuar	Pro: 19, Kundër: 3 Abs :0
Vendimi për lejimin e zbatimit të taksave administrative për leje të ndërtimit për vitin 2015.	Miratuar	Pro: 25, Kundër: 0 Abs :0
Vendimi për miratimin se planit zhvillimor komunal për vitin 2013-2023/	Miratuar	Pro: 18, Kundër: 0 Abs :7
Raporti financiar për buxhetin e shpenzuar në nëntëmujorin e vitin 2014.	Miratuar	Pro: 15, Kundër: 8 Abs :2




Komuna
Kamenicë

Kuvendi Komunal



Dega Egzekutive



6. Komuna KAMENICË

Vlerësimi i Përgjithshëm

Çfarë e karakterizoj komunën këtë vit

Kuvendi i Kamenicës nuk ka ndikim të dukshëm në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kamenicës. Njëjtë sikurse vitin e kaluar, shqetësues mbetet niveli i ulët i diskutimeve në asamble dhe mospërgatitja adekuate e asamblistëve para mbledhjeve. Opozita nuk ka qenë e organizuar dhe e bashkuar, dhe nuk ka dhënë ide e alternativa për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve. Gjatë monitorimit të seancave të Kuvendit, është vërejtur shkelje ligjesh, rregulloresh e dokumentesh. Vetëm gjatë një mbledhjeje, asamblistët tri here e kanë shkelur Planin Zhvillimor Komunal, ku i kemi bërë thirrje Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal t'i evidentoj dhe të reagoj për këto veprime.

Kryesuesi i Kuvendit nuk ka dëshmuar aftësi për udhëheqjen e legjislativit të Kamenicës dhe tjetër shqetësim, i shprehur edhe përmes paraqitjeve në media, është niveli i disa asamblistëve, të cilët në vend që ta përfaqësojnë interesin qytetar, gjatë mbledhjeve luajnë rolin e makinave të votimit. Në disa mbledhje me kohëzgjatje maratonike, kemi vërejtur tendencën e disa këshilltarëve opozitarë që t'i tejkalojnë kompetencat e tyre dhe ta ndryshojnë agjendën e Kuvendit, për çka nuk kanë marrë vërejtje nga kryesuesi. Po ashtu një numër i madh i seancave nuk janë drejtuar në përputhje me rregulloren e punës së Kuvendit. Është tejkaluar koha për diskutim dhe është shkelur rregullorja në rastin e replikave. Është bërë tashmë praktikë që mbledhjet të mos nisin në orarin e paraparë, por 20 apo 30 minuta me vonesë dhe përdorimi i telefonave gjatë mbledhjeve dhe dalja e shpeshtë gjatë kohës së votimeve nuk mungon as këtë vit. Pjesëmarrja e femrave në diskutimet e Kuvendit ka qenë shumë e ulët dhe zëri i tyre pothuaj nuk është dëgjuar fare.

Problemet e Komunës

Në këtë vit Komunës së Kamenicës ju kanë shtuar më shumë probleme. Në fushën e arsimit problem serioz mbetet mungesa e sigurisë në shkollë, e veçanërisht në shkollat e mesme ku ka pasur raste kur nxënësi është rrahur në klasë si dhe rasti tjetër rrahja dhe therja e nxënësve mes tyre në oborrin e shkollës.

Prania e madhe e qenve endacak në rrugët e qytetit, vazhdon t'i shqetësoj banorët të cilët rrezikohen çdo ditë nga kafshimi, e që mund të bartë sëmundje. Komuna ka paraparë një buxhet për vitin 2015, por të pamjaftueshëm për zgjidhjen e këtij problemi.

Edhe përkundër premtimeve, qeveria komunale ka dështuar me Administratën. Nga 222 punonjës sa kishte në fillim të muajit janar, administratës i janë shtuar dhjetëra punëtorë, kryesisht për akomodime partiake e familjare dhe të panevojshëm për punën dhe efikasitetin e administratës. Edhe pse janë investuar dhe vazhdojnë të investohen qindra mijëra euro për ujësjellës, furnizimi me ujë të pijshëm po del problem i pazgjidhshëm në Kamenicë.

Problemet kryesore të Komunës së Kamenicës mbesin:

1. Mungesa e ujit të pijes
2. Papunësia
3. Mbingarkesa e të punësuarve në Administratë
4. Qentë endacakë
5. Mungesa e sigurisë në shkollë

Të arriturat në vitin 2014

Në fillim të muajit nëntor, është vënë gurë themeli për ndërtimin e shkollës së mesme në fshatin Roganë. Është një projekt milionësh dhe objekti shkollor do t'i ketë 2 mijë e 400 metra katrorë, përfshirë sallën e sporteve dhe shumë kabinete. Procesi mësimor në këtë fshat është mbajtur me vështirësi, në tri turne dhe funksionalizimi i shkollës që pritet të bëhet pas një viti, do të krijoj kushte normale për zhvillim efikas dhe kualitativ të procesit mësimor.

Brenda këtij viti, janë shtruar disa rrugë nëpër lokalitete të ndryshme të Kamenicës, të cilat kanë ndikuar në ngritjen e cilësisë së jetës dhe mirëqenies sociale. Vlen të përmendet rruga 5.5 kilometërshe Hogosht-Poliqke dhe rrugë e rrugica në fshatrat: Hodonoc, Koretin, Kopërnice e Strezoc.

Komuna ka sanuar në tërësi defektet e ndriçimit publik në rrugën kryesore të qytetit dhe në rrugën “Nënë Tereza”, të cilat kanë pasur probleme në vitet e kaluara. Është rregulluar ndriçimi në fshatin Ruboc dhe gjatë vitit 2015 është paraparë shtrirja e rrjetit edhe në disa fshatra të pandriçuara.

A. Vlerësimi për performancë në transparencë

Kryetari i Komunës, Begzad Sinani, shquhet për mënyrën e komunikimit dhe afërsinë me qytetarët. Ai një ditë gjatë javës pret qytetarët dhe grupet e ndryshme dhe dëgjon hallet e problemet e tyre. Në agjendë të çdo seance të Kuvendit është futur pika “Pyetje ekzekutivit”, ku kryetari i Komunës përgjigjet në kërkesat dhe pyetjet e asamblistëve.

Drejtorët komunalë kanë treguar një performancë relativisht të mirë në punën e tyre njëvjeçare, në veçanti drejtori i Administratës Komunale dhe ai i Shërbimeve Publike. Ata kanë qenë prezentë në komunikim me publikun dhe asamblistët sa herë që u është kërkuar.

Për **këshilltarët komunalë** nuk mund të jepen vlerësime pozitive. Është vërejtur shkëputje e kontakteve me votuesit. Dhe pos pjesëmarrjes në seanca, këshilltarët nuk kanë organizuar takime për të dëgjuar hallet e qytetarëve apo për tu konsultuar me ta për ndonjë problematikë të caktuar.

Transparenca dhe toleranca e **kryesuesit të Kuvendit**, në disa raste ka qenë në nivel aq të lartë sa që ka dalë qesharak dhe seanca është shndërruar në cirk. Kryesuesi është munduar të jetë i paanshëm dhe të punojë për të mirën e qytetarëve.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Ndërtimi i shkollës së mesme në fshatin Roganë	Realizuar
2	Projekte infrastrukturore për qytetin	Pjesërisht
3	Ujësjiellës në Muciverc	Parealizuar
4.	Kujdes institucional për vlerat kulturore dhe mbështetje klubeve sportive	Pjesërisht
5.	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Kopërnice	Realizuar
6.	Funksionalizimi i palestrës sportive në vitin e parë të qeverisjes	Parealizuar
7.	Zgjidhja e problemit të qenve endacak	Planifikuar me buxhet pamjaftueshëm

Transparenca në Komunë

Seancat Plenare janë mbajtur në pajtueshmëri me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe rregulloren e punës së Kuvendit. Ndërsa, sa i përket procedurave të bërjes publike apo shpalljes së njoftimeve për kohën dhe agjendën e seancave, ato nuk janë bërë në bazë të rregullores për Transparencë. Pos në ueb-faqen e Komunës, njoftimet për seanca nuk janë bërë edhe hapësirat e frekuentuara nga qytetarët. Pjesëmarrja e qytetarëve edhe gjatë këtij viti nuk ka qenë e kënaqshme, kjo për faktin e mosgatishmërisë së tyre për pjesëmarrje në të tilla ngjarje, por edhe mos marrjes së informacioneve për kohën e mbajtjes së seancave.

Komuna e Kamenicës, këtë vit ka themeluar Komitetet Konsultative, si një mekanizëm shumë efikas për paraqitjen e brengave dhe interesave të qytetarëve. Komuna ka shënuar një hap progresiv në forcimin e mekanizmave të demokracisë. Janë themeluar: Komiteti për Shërbime Publike, ai për Shëndetësi, Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Komiteti për Arsim dhe janë zgjedhur drejtuesit dhe anëtarët e këtyre komiteve. Po ashtu në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile ka filluar trajnimi i tyre dhe hartimi i planeve të punës.

“Fortesa” ka hasur në vështirësi në qasjen në dokumente zyrtare, ku shumë dokumente që do të duhej të ishin të hapura për publikun, na është pamundësuar qasja në to. Fortesa ka kërkuar nga organet komunale qasje në:

- Faturat e pagesave të qerasë nga “Viva Fresh” për gjashtë muajt e fundit
- Informatë për të punësuarit me kontratë mbi vepër
- Procesverbalet nga procesi i intervistimit të kandidatëve për pozitat ‘Furnizues në drejtorinë e Arsimit dhe shofer në QKMF’
- Shpenzimet e derivateve të zyrës së kryetarit të komunës për gjashtëmuajorin e parë të vitit.

Deri më tani nuk kemi marrë përgjigje për asnjë nga këto kërkesa. Komuna në këtë rast, ka shkelur ligjin për qasje në dokumente zyrtare, duke tejkaluar të gjitha afatet ligjore.

Komuna e Kamenicës ka mangësi të konsiderueshme në informimin e qytetarëve në lidhje me mbledhjet e Kuvendit, vendimet, takimet etj. Deri më tash i vetmi burim i informimit është ueb faqja, ku shumica e qytetarëve nuk kanë qasje në të. Për më tepër, ueb faqja nuk freskohet me të gjitha zhvillimet dhe ka mungesë të konsiderueshme të informacionit.

Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i takimeve	Numri	Në rend dite	Pjesëmarrja	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare	11	102		%
Komiteti për Politikë dhe Financa	12	84	74%	%
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli Komunal Sigurisë në Bashkësi	5		Po	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	8		50	

Llogaridhënia në Komunë

Kryetari i Kamenicës, Begzad Sinani, kryesisht ka qenë transparent për punët dhe aktivitetet e tij. Ai ka qenë prezent në pothuaj çdo mbledhje të Kuvendit dhe takime të tjera që komuna ka organizuar me qytetarët dhe disa herë është përgjigjur edhe me shkrim anëtarëve të Kuvendit. Kreu i Komunës, muajin nëntor e ka shpallur ‘muaj të transparencës’ ku qytetarët dhe të gjithë të interesuarit kanë pasur mundësi, që pa procedura burokratike të vijnë deri tek dokumentet dhe informatat që u interesojnë. Për dallim nga qeverisja e kaluar, kryetari Sinani i ka hapur dyert për shoqërinë civile dhe mediat dhe është munduar që t’i përfshijë në procesin e vendimmarrjes. Ai e ka orarin e rregullt “Takime me palë” një ditë gjatë javës, ku ambientet e komunës janë të stërmbrushura nga grupe të ndryshme dhe qytetarë.

Kryetari i Komunës ka qenë prezent në të gjitha seancat e Kuvendit Komunal, por edhe në media, kryesisht qendrore dhe regjionale, për shkak të mungesës së aktivitetit të mediave lokale. Zyra e kryetarit ia ka hapur dyert organizatave të shoqërisë civile.

Kryetari i Komunës ka qenë i pranishëm në çdo seancë të Kuvendit. Ai ka raportuar për raportin gjashtëmujor dhe nëntëmujor të shpenzimeve dhe është përgjigjur në pyetjet e asamblistëve. Gjithashtu, është vënë re tendenca e kreut të Komunës që të ndikoj në vendimet e legjislativit, duke bërë propozime dhe duke e marrë fjalën për diskutim sa herë që ka dashtë.

Në vitin 2014, ekzekutivi ka realizuar dhjetëra takime me qytetarë, ndërsa kreu i Komunës ka mbajtur dy tubime kryesore me qytetarë, për të cilat e obligon edhe ligji për Vetëqeverisje Lokale. Kryetari i Komunës ka raportuar para qytetarëve për punën dhe aktivitetet gjatë dy periudhave. Kontaktet e krerëve të komunës, gjatë vitit 2014, për dallim nga mandati i kaluar, janë shpeshtuar, por linja e komunikimit duhet të avancohet edhe më tej. Shqetësuese vazhdon të mbetet mos përfillja e vërejtjeve dhe ankesave të qytetarëve që parashtrihen gjatë tubimeve publike. Në të shumtën e rasteve, ato regjistrohen nëpër procesverbale dhe nuk përfshihen më pas në planifikime buxhetore.

Tejzgjatja e Projekteve Ndërtimore Komunale

Objekti i Komunës, Objekti i Palestrës Sportive, objekti social banesor janë objektet të cilat ende nuk janë të përfunduara në Komunën e Kamenicës. Është një shqetësim në vete, të pritet 10 vjet për një palestër sportive, 5 vjet për një banesë dhe nuk dihet sa për objektin e Komunës. Objekti i rinisë në Kamenicë akoma nuk ka një datë kur pritet funksionalizimi i tij. Është ndër objektet më të kontestuar në Kosovë, ku edhe Auditori i Përgjithshëm kishte raportuar për keqpërdorime.

Objekti i Komunës, në të cilin do të duhej të zhvendosej me punë Administrata Komunale në qershorin e vitit 2012, ka filluar të shndërrohet në cak të grabitësve. Qeveria e kaluar kishte caktuar drejtorin e Financave si person mbikëqyrës të punimeve rreth këtij objekti, por deri më tash nuk është parë një vërejtje dhe reagim publik prej Komunës për zvarritjen e punimeve. Edhe objekti Social Banesor e ka të njëjtin fat. Për dallim nga dy projektet e mëparshme, kjo banesë duket se është e gatshme për vendosjen e njerëzve, mirëpo deri tani nuk ka pasur asnjë lëvizje në këtë objekt banesor.

Mosfunksionimi i Tregut

Një problem tjetër, është mosfunksionimi i tregut të Kamenicës. Shkaktar për këtë është dhënia në shfrytëzim të 75 përqind të hapësirës rrjetit të marketeve “Viva-Fresh”. E premmtja e cila sillte sadopak gjallëri në Kamenicë është zbeh, tregtarët kanë ikë, tregu gati është mbyllë, mund të gjeshe vetëm pemë, perime, dhe ushqime tradicionale që ekspozohen nga serbët lokalë. Marketi “Viva Fresh” nuk i është përmbajt kritereve, përfshirë punësimin dhe

investimet. Gjithashtu qiraja i është zbritur pa një vendim të Kuvendit dhe nuk është e rregullt në kryerjen e obligimeve.

Rekomandimet për Komunë

Zyrës së Kryetarit të Komunës:

- Të bëhet zgjidhja e përhershme të furnizimit me ujë në komunën e Kamenicës. Të angazhohen ekspertë profesional të cilët do të japin të dhëna profesionale për sasinë e ujit dhe pastaj të sigurohen donatorë për një zgjidhje të qëndrueshme.
- Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Kompaninë e Ujësjetës "Hidromorava" të ndërmarrin masa për stabilizimet e stërvjetëruara, në mënyrë që të ndërrohen dhe riparohen, si dhe të formohet një ekip ekspertësh për zgjidhjen e problemit, në mënyrë që sezona e verës të mos i zë në befasi.
- Në mënyrë që të kemi një ambient të sigurt për mbarrëvajtjen e procesit të mesimor, Komuna, Policia dhe organet e tjera relevante, duhet të ndërmarrin masa në një të ardhme të afërt. Komuna bazuar në kompetencat e veta duhet të sigurojë që viti i ri shkollor, të gjitha shkollat të gjej me rrethoja dhe ndriçim adekuat, për të rritur sigurinë.
- Komuna përveç Kodit të Mirësjelljes, duhet të miratojë rregullat e parapara, jo vetëm për ndëshkimin e nxënësve, por edhe për të promovuar sjelljen e mirë dhe disiplinën e nxënësve..
- Duke qenë se pasiguria në trafik dhe rreziku nga qenët ende janë identifikuar si shqetësues, sidomos për nxënësit e klasave të ulëta, komuna duhet ta intensifikoj bashkëpunimin me Policinë e Kosovës, që të rris sigurinë në afërsi të shkollave dhe të identifikojë vendet me më rrezik për nxënësit.
- Shëndetësia të bëhet prioritet i qeverisë komunale. Të hartohen projekte për infrastrukturë, ilaçe e mjete për ambulanca dhe të kërkohen donacione për ta sjellë shëndetësinë më afër pacientit.
- Të përmirësohet organizimi komunal për mbledhjen e mbeturinave, duke i qartësuar përgjegjësitë brenda komunës si dhe, komuna të sigurojë se inspektorët po bëjnë zbatim rigoroz të detyrave në mënyrë që të krijohet një ambient i pastër.
- Kryetari i Komunës është i obliguar ta respektojë në përpikëri Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. LVL parasheh që kreu komunal të mbajë së paku dy takime me qytetarë. Në vitet e kaluara është mbajtur vetëm një tubim, andaj qeverisja komunale duhet t'i realizojë këto takime.
- Të mos ushtrohet presion ndaj legjislativit, përkundrazi të jetë bashkëpunues dhe të raportojë para asamblistëve sa herë që t'i kërkohet.
- Të jetë transparentë gjatë tubimeve me qytetarë, të angazhojë stafin e tij që çdo qytetar i interesuar ta ketë raportin e shpenzimeve dhe dokumentet e tjera relevante, dhe të përfshijë kërkesat e qytetarëve që dalin nga tubimet.
- Të mbledhë së paku një herë në muaj kryetarët e këshillave lokale dhe t'i trajtoj si urë lidhëse mes qytetarit dhe qeverisë komunale, të angazhohet në rregullimin çështjes së kompensimit të përfaqësuesve të këtyre Këshillave.
- Të rris bashkëpunimin me shoqërinë civile, të mos bëjë dallime ndaj OJQ-ve, dhe mos të shihen ato as si opozitë e as si mjete përmes të cilave t'i arrijë qëllimet politike, por si partnerë që në Komunë të bëhen punë më të mira.

Kryesuesit të Kuvendit:


- Ta ruaj paanshmërinë gjatë drejtimit të seancave, duke i trajtuar të barabartë të gjithë anëtarët e Kuvendit pa dallim partie e nacionaliteti.
- Të krijojë raporte korrekte me përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike.

Asamblistëve të Kuvendit:

- Ta shqyrtojnë materialin dhe të përgatiten para seancave të Kuvendit. Është një praktikë e keqe, që po e përcjellë Kuvendin, ku një pjesë e asamblistëve nuk marrin mundin të kontribuojnë në diskutime, të ngritin çështje në interes të qytetarëve dhe qëndrojnë indiferent dhe të shpërqendruar gjatë punimeve.
- Të organizojnë takime të rregullta me qytetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare aktive në komunën e Kamenicës, e cila ka munguar deri më tash.
- Të sjellin propozime individuale dhe të shkëputen nga logjika e ‘shefit’ të partisë.


Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
<i>Plani Zhvillimor Komunal</i>	Miraturar	Pro: 21 Kundër: 0 Abs: 4
<i>Korniza Afatmesme Buxhetore 2015-2017</i>	Miraturar	Pro: 20 Kundër: 5 Abs: 1
<i>Buxheti 2015</i>	Miraturar	Pro: 17 Kundër: 4 Abs: 4
<i>Amandamentimi i rregullores për taksa, tarifa</i>	Miraturar	Pro: 24 Kundër: 0 Abs: 2
<i>Rregullorja për Transparencën</i>	Miraturar	Pro: 20 Kundër: 0 Abs: 2
<i>Plani i Punës së Kuvendit për 2015</i>	Miraturar	Pro: 26 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Shitja e xhipit “Hyundai”</i>	Miraturar	Pro: 15 Kundër: 2 Abs: 7
<i>Themelimi i Komisionit të Adresave</i>	Miraturar	Pro: 16 Kundër: 7 Abs: 1
<i>Raporti i Buxhetit Janar-Mars 2014</i>	Miraturar	Pro: 15 Kundër: 4 Abs: 2
<i>Programi komunal 3 vjeçar për banim social</i>	Miraturar	Unanimisht
<i>Mbështetja financiare e 23 fermerëve</i>	Miraturar	Unanimisht
<i>Raporti gjashtëmujor i punës së Kryetarit</i>	Miraturar	Pro: 15 Kundër: 5 Abs: 2
<i>Përkrahja financiare e projektit “Fuqizimi i grave në Politikë”</i>	Miraturar	Pro: 14 Kundër: 5 Abs: 2
<i>Rinovimi i kulmit të shkollës “Dëshmorët e Kombit”</i>	Miraturar	Unanimisht




Komuna
Mitrovicë

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



7. Komuna MITROVICË

Vlerësimi i Përgjithshëm

Çfarë e karakterizoj komunën këtë vit

Gjatë këtij viti Kuvendi Komunalë është karakterizuar me tensione ndërmjet pozitës dhe opozitës, që ndonjëherë kanë përfunduar edhe me etiketime, fyerje por edhe braktisje të seancave nga ana e opozitës (PDK). Ajo shumë vështirë e ka pranuar realitetin e krijuar që ndonëse me numrin më të madh të anëtarëve të Kuvendit (14) ka mbetur opozitë koalicionit të lidhur mes LDK, AAK, AKR që kanë 16, ndërsa LVV (4) dhe PD (1).

Të paktën 4 herë në seancat e deritashme këshilltarët e PDK-së kanë lëshuar seancat në njërën prej tyre për shkak të fjalës “ju jeni hajna” nga kryetari Bahtiri për çka është kërkuara falje dhe ata janë kthyer.

Ka patur shumë debate me replika dhe kundër replika kryesisht për të mbrojtur pozitat nga subjektet që vijnë ndërsa shumë pak rreth çështjeve që kanë të bëjnë me interesin apo me mbrojtjen e qytetarëve.

Një problem që ka ndikuar në fillimin e realizimit të premtimit të kryetarit Bahtiri për vendet e reja të punës, janë dhe pengesat procedura rreth dhënies së tokës në shfrytëzim, shpesh edhe duk prishur marrëveshjet dhe dakordimet private pas ndikimeve partiake, gjë që ka detyruar kryetarin Bahtiri që të nis fabrikën e këpurdhave në pronën familjare.

Problem tjetër imediat është çështja e mbetjes së sportistëve mitrovicas pa terrene sportive për stërvitje dhe gara kampionate, si shkak i projektit të njëkohshëm të punës në ndërtimin e palestrës së re multidimensionale dhe meremetimit të palestrës “Minatori”, duke mbetur sportet që luhen me dore pa terrene, ndërsa mitrovicasit pa mundësi të përcjelljes së këtyre sporteve.

Borxhi shumë i madh i trashëguar nga pushteti i kaluar, ka pamundësuar realizimin e shumë projekteve në komunën e Mitrovicës, rezultatet e këtij ekzekutivi do ishin akoma më të mëdha nëse shuma prej mbi 630 mijë euro, sa janë kthyer të investoheshin në projektet kapitale dhe ato emergjente në komunën e Mitrovicës.

Në raportimet rreth situatës së sigurisë, ai u është përgjigjur kërkesave të këshilltarëve të caktuar rreth masave që janë ndërmarrë konform kompetencave që ka Kryetari i Komunës. Ai është ankuar në vazhdimësi nga opozita rreth mosrealizimit të premtimit që kishte bërë gjatë fushatës për investimet, përkatësisht për numrin e mijëra vendeve të reja të punës, ndonëse në muajin e fundit është nisur puna në zonën e lirë ekonomike, që mund të jetë edhe vend i investimeve, ndërkohë që së bashku me partnerët nga Korea dhe Japonia kanë nisur punën për fabrikën e këpurdhave dhe krijimin e vendeve të punës.

Në takimet avokuese të zhvilluara në komunën tonë, vetë takimi dhe pjesëmarrja në takimet publike për këshilltarët komunalë ka qenë sfiduese dhe obliguese pasi disa prej tyre vinin nga zona ku u mbajtën takimet (Kçiq dhe Vllahi), ku përveç qytetarëve kanë marr pjesë edhe ekzekutivi, këshilltarët dhe këshillat lokale të vendbanimeve.

Problemet kryesore të komunës

Procedura e shlyerjes së borxheve të trashëguara nga pushteti i kaluar, pamundësia për rishikim buxhetor për shkak të “ngërçit” institucional, mosplanifikimi real i të hyrave

vetanake konform gjendjes dhe mundësisë që rezultojë me ngecje në inkasim; Problemi i vazhimit të mbështetjes së kthimit të qytetarëve shqiptarë dhe rindërtimit të shtëpive në lagjet shqiptare si shkak i mbajtjes së zgjedhjeve, definimit të kufinjëve dhe krijimit të komunës Mitrovica e Veriut, rezultoj me ndërprerje të ndërtimeve dhe kthimin e qytetarëve në pronat dhe shtëpitë e tyre.

Pamundësia për të ofruar pronën komunale për investime bizneseve të jashtëm për shkak të procedurave të stërzgatura dhe implikimeve në procedurat nga ministritë, prishja e marrëveshjeve për prona dhe proceset gjyqësore që prolongojnë dhe “lodhin” investitorët që rrezikojnë tërheqje dhe investime në vendet tjera.

Të arriturat në vitin 2014

Rritja e efikasitetit të administratës komunale, shkurtimi i kohës së nevojshme për pajisjen me një dokument sikurse edhe përgjigja në kërkesat e qytetarëve. Kontrolli strikt i punës së ndërmarrjes rajonale që menaxhojnë me mbeturinat, rezultate të dukshme në pastrimin dhe mirëmbajtjen e qytetit. Lirimi i trotuareve nga uzurpimet në hapësirat para lokaleve afariste, posaçërisht largimi i shitësve ambulantë në rrugë si masë e Inspektoratit për kujdesin dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Shlyerja e dy të tretave të borxheve të trashëguara, rreth 600 mijë euro nga shuma e tërësishme e borxhit prej 930 mijë euro sa kishin trashëguar me marrje të pushtetit.

Vlerësimi për performancë në transparencë

Kryetari Agim Bahtiri konform kompetencave dhe përgjegjësi që ka, në periudhën e deritashme, ka qenë shumë transparent dhe i hapur, duke kërkuara masa dhe përgjegjësi si nga administrata poashtu edhe ekzekutivi në shërbim të qytetarëve.

Ndonëse shumë prej drejtorëve të ri nga mosha dhe përvoja përjashtim të atij për Financa (Nysret Maxhera) ata janë përpjekur që të jenë në nivelin e detyrave dhe obligimeve, ndonëse janë përball me vështirësi të shumta, buxhet të vogël, probleme të realizimit të planifikimeve dhe përmbushje të kërkesave të qytetarëve.

Puna dhe performanca e anëtarëve të Kuvendit ku rreth 80% e tyre janë ulur për herë të parë në ulësen e Kuvendit le shumë për të dëshiruar, ata kanë mbrojtur më shumë kërkesat dhe qëndrimet e subjekteve dhe lokaliteteve prej nga vijnë se interesin e përgjithshëm të qytetarëve.

Kryesuesi është treguar shumë bashkëpunues dhe tolerantë gjatë drejtimit, ndonëse është përball me sulme shpesh denigruese e fyese nga opozita me të cilët deri në zgjedhje ka qene në bashkëqeverisje, pasi kryesuesi vjen nga AKR që ishte koalicion me PDK në mandatin e kaluar.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Infrastrukturë rrugore në të gjitha rrugicat brenda qytetit dhe zonat rurale	Duke u realizuar në disa zona si Gushavc, Suhadoll, kanë mbetur për realizim rruga në Kçiq.
2	Kanalizime	Realizuar dy faza në Kçiq, në realizim e sipër Gushavc

3	Punë për 15 mije persona	Pa-realizuar
4.	Investime në zhvillim	Pjesërisht, dy investime ne proces, fabrika e këpurdhave dhe riciklimit
5.	Arsim cilësor	Në realizim – ngritja e cilësisë dhe digjitalizimi i shkollave
6.	Ndarjen e pagës për student	Realizuar – dhjetë studentë marrin bursa nga paga e kryetarit
7.	Dhurimin e makinës së kryetarit për shoqata të komunës	Dhënie në shfrytëzim kur ata kanë nevojë dhe e kërkojnë automjetin

Transparenca në Komunë

Lidhur me diskutimin rreth buxhetit komunal, Kuvendi Komunal për dallim nga viti i kaluar kur kishte organizuar takime me qytetarët në vetë qendrat dhe lokalitetet rurale, sivjet ka mbajtur 9 diskutime publike me qytetarët në sallën e Asamblesë Komunale.

Takimet kanë qenë me grupe të veçanta të interesit, me shoqërinë civile, shoqatat e personave me aftësi të kufizuar, komunitetet, komuniteti sportiv, bizneset, të rinjtë dhe grupet joformale të grave. Në këto takime përfaqësuesit nga grupet e veçanta kanë adresuar propozimet dhe nevojat e tyre që janë marr në konsideratë.

Seancat plenare të Asamblesë komunale janë transparente dhe përveç organizatave që monitorojnë në vazhdimësi punën e Kuvendit dhe disa nga drejtoritë e Ekzekutivit, në to marrin pjesë edhe përfaqësues të pikave të propozuara por edhe qytetarë varësisht nga interesi që kanë. Seancat xhirohen nga vetë administrata dhe ajo më pas publikohet në ueb-faqe, poashtu disa nga seancat xhirohen nga RTV Mitrovica që më pas ritransmetohen si të plota, përcjelljen nga agjensionet rajonale dhe mediat qendrore. Komitetet konsultative të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës janë: Komiteti konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komiteti konsultativ për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit, Komiteti konsultativ për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komiteti konsultativ për Shërbime Publike dhe Zhvillim Ekonomik dhe Komitetin Konsultativ për Turizëm dhe Bujqësi.

Poashtu funksionojnë edhe Komitetet e përhershme të Kuvendit të Komunës: Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komitetin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Komitetin për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit, Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komitetin për Zhvillim Ekonomik dhe Komitetin për Barazi Gjinore. Ata kanë mbajtur takimet e tyre të rregullta në bazë vjetore, ku ka marr pjesë shpesh edhe kryesuesi i Asamblesë Komunale, ndërkohë që një problem shqetësues mbetet mbarimi i afatit të anëtarësisë së disa prej anëtarëve të këtyre.

Qasja në Dokumentet Zyrtare. Kuvendi Komunal në Mitrovicë ka obliguar zyrën e informimit që të mundësoj qasje në dokumentet zyrtare të gjithë personave që kërkojnë këtë. Nga 32 kërkesa 30 janë zgjedhur pozitivisht duke ofruar qasje në dokumentet e kërkuar në mënyrë të plotë, ndërsa në vetëm në dy është miratuar qasje e kufizuar në kërkesën e parashtruar. Ka patur disa përgjigje në mënyrën elektronike, kopje, ndërsa në disa tjera edhe me mënyrën elektronike edhe me kopje. Shumë nga kërkesat janë nga gazetarët, ndërsa në 13 raste janë kërkesa të shoqërisë civile, 8 prej tyre janë individë dhe 2

studentë Sa i përket fushës për të cilat është kërkuar qasje, 15 kanë të bëjnë me buxhetin dhe shpenzimet, 5 janë vendime të komunës, 1 kontratë e Komunës, ndërsa 9 janë projekte të caktuara.

Uebfaqja komunale vazhdimisht thuhet në baza ditore freskohet me lajme dhe informacione të ndryshme, përfshirë këtu njoftime për shpallje, tenderë, vendime të miratuara, rregullore nga Asambleja, publikime nga zhvillimet në zyrën e Prokurimit etj. Në faqen e komunës, poashtu gjenden të incizuara të gjitha mbledhjet e Asamblesë Komunale të Mitrovicës, njoftime të tjera të nevojshme për qytetarët e po ashtu ekziston edhe hapësira për lajmërimin e keqpërdorimeve dhe shkeljeve. Uebfaqja ngërthen në vete edhe anketën për kënaqshmërinë e qytetarëve me punën e ekzekutivit dhe legjislativit.

Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i takimeve	Numri	Në rend dite	Pjesëmarrja	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare	10	78	88%	80%
Komiteti për Politikë dhe Financa	10	67	90%	66%
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli Komunal Sigurisë në Bashkësi	3		(Po)	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	12		50 persona	

Llogaridhënia në Komunë

Kryetari në dy raste ka ofruar raport nga puna dhe veprimtaria e tij, ndërkohë që është përball me sulme dhe kritikë nga opozita që e kanë akuzuar se nuk ka mbajtur premtimet për zhvillim, investime dhe vende të reja pune, me të cilat ka arrit të marr mbështetjen përkatësisht të bëhet kryetar i komunës.

Drejtorët përmes Bordit të Drejtorëve që mbahet në secilën të hënë bëjnë raporte të punës ditore dhe aktiviteteve që zhvillojnë, ndërsa kryetari vazhdimisht kërkon punë, angazhim dhe përgjegjësi. Në këto takime marrin pjesë përveç monitoruesve të Kuvendit edhe mediat lokale.

Në takimet me qytetarët që mbahen së fundi njëherë në muaj, marrin pjesë qytetarë jo vetëm nga komuna e Mitrovicës por edhe nga banorët dhe zonat rurale të zonave dhe lokaliteteve të komunave veriore të Mitrovicës, që tek Mitrovica gjejnë vendin e vetëm për kërkesa dhe mbështetje.

Kryesisht qytetarët kërkojnë strehim, punë dhe ndërtimin e infrastrukturës, ndërsa zyrtarët komunalë mbajnë shënime dhe procese jo vetëm nga pjesëmarrësit por edhe nga kërkesat që parashtrihen nga qytetarët përfshirë këtu edhe ata nga pjesët dhe lagjet e Mitrovicës së veriut.

Të shtohet bashkëpunimi me këshillat e lokaliteteve dhe fshatrave në njohjen me problemet dhe nevojat që kanë ata dhe adresimin e tyre drejt faktorëve që do sjellin zgjedhje,

përkatësisht të bashkëpunojnë me shoqërinë civile si një nga kontrolluesit dhe vlerësuesit më real të situatës në administratat komunale.

Në të gjitha këto takime marrin pjesë mediat qendrore qofshin ato elektronike përmes korrespondentëve të vetë në Mitrovicë, po ashtu edhe për mediat lokale qofshin ato elektronike apo të shkruara.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës gjatë vitit që po kalon ka mbajtur në 6 mujorin e parë mbledhje javore me qytetarët, duke tejkaluar normën e parashikuar të takimeve me qytetarët. Në dy-tri raste ka raportuar rreth situatës së sigurisë dhe situatës rreth gjendjes së krijuar rreth “parkut të urës” dhe protestës së organizuar.

Janë mbajtur dëgjime publike lidhur me disa rregullore të miratuara sikurse edhe prezantime të projekteve, përkatësisht ndikimit të tyre në jetën e qytetarëve në ato zona, ku ka patur propozime, vërejtje e sugjerime, mirëpo në ato vendimet janë marr me shumicë, sikurse ishte rasti i ndërtimit të mbikalimit në një nga rrugët më të frekuentuar ku kalojnë nxënësit dy nga katër shkollat e mesme të qytetit.

Ata kanë qenë pjesëmarrës interaktiv në të gjitha debatet duke patur mundësi që të diskutojnë, bëjnë vërejtje sugjerojnë por edhe të kundërshtojnë propozimet që kanë ardhur nga drejtoritë e caktuara.

Në takimet avokuese të zhvilluara në komunën tonë, vetë takimi dhe pjesëmarrja në takimet publike për këshilltarët komunalë ka qenë sfiduese dhe obliguese pasi disa prej tyre vinin nga zona ku u mbajtën takimet (Këciq dhe Vllahi), ku përveç qytetarëve kanë marr pjesë edhe ekzekutivi, këshilltarët dhe këshillat lokale të vendbanimeve.

Prolongimet e Palestrave Sportive

Nisur nga fakti se qyteti i Mitrovicës është qytet i sportit dhe sportistëve të gjithë i janë gëzuar projekteve të Bashkimit Evropian dhe Ministrisë së Sportit për ndërtimin e objektit shumë dimensional “Omnisport”, që do krijon mundësi dhe kushte më të mira për klubet, posaçërisht ato që luhen me dorë, ato që zhvillohen në palestra përfshirë këtu edhe kushtet që do krijohen për notarët me ndërtimin e pishinës gjysëmolympike sikurse edhe meremetimi i palestrës “Minatori” që ka qenë e mbetet arenë e sportit mitrovicas.

Mirëpo ky gëzim dhe eufori e të gjithë komunitetit sportiv është zbehur dhe është shuar pas vonimit të punimeve në këto objekte, sikurse edhe “gabimi” me apo pa qëllim i fillimit të meremetimit të palestrës “Minatori” dhe ndërtimit të palestrës tjetër në të njëjtën kohë duke lënë klubet dhe sportistët e sporteve me dorë, pa vend për stërvitje dhe pa vend për gara në ligat përkatëse kosovare.

Kjo vonesë dhe afatet shumë të prolonguar kanë sjell durimin qytetar në prag të reagimit, kjo është bërë nga drejtuesit e klubeve dhe sportistët që kanë patur kosto të rritur të pjesëmarrjes në gara pasi si stërvitjet poashtu edhe garat janë detyruar të i zhvillojnë jashtë Mitrovicës. Lidhur me këtë situatë kanë reaguar sportdashësit e tubuar të *Torcidës*, por edhe vetë klubet dhe sportistët.

Duke parë këtë situatë me zyrtarët e BE-së por edhe punëkryesit nga Portugalia në formë debati dhe kritike është “biseduar” shumë herë nga nënkryetari i komunës Safet Kamberi, Drejtori i DKRS Kujtim Isa, ai i Urbanizmit Sami Zeka, ndërsa ditë më parë lidhur me këtë situatë dhe gjendjen e vështirë të sportit dhe sportistëve u debatua edhe në asamblenë Komunale, ku është miratuar një konkluzion ku i kërkohet BE-së që të ndërmerr masat që të

përfundohen këto objekte (Omnisport dhe Minatori) para se të shkatërrohet sporti me dorë në Mitrovicë.

Në Kuvend në momentin e përpilimit të konkluzioneve kanë qenë të pranishëm 22 nga 35 këshilltarë që unanimisht kanë votuar kërkesat për caktimin e afatit definitiv të përfundimit të këtyre objekteve.

Kjo çështje ende mbetet e hapur pasi afat i fundit për përfundim ishte fillimi i nëntorit, ndërkohë që ka zëra që thonë se ai nuk do mund të përfundoj me këtë dinamikë as për vitin e ri.

Si kryetari, nënkryetari por edhe drejtorët janë angazhuar shumë në këtë çështje mirëpo nisur nga fakti se mjetet për këto projekte janë nga BE, përkatësisht nga Ministria, komuna është vetëm anëtare e grupit diskutues por nuk ka mekanizëm që mund të ndikoj në realizimin më të shpejtë apo sanksionimin e kompanisë punëkryese që ka shkelur të gjitha afatet që kanë qenë në projekt (mars 2014).

Përballja me Borxhin Komunal

Problemi tjetër që ka marr shumë kohë, angazhim por edhe përpjekje të ekzekutivit në vitin që po kalon padyshim është kontrolli i të gjitha projekteve në realizim apo të projektuara, përkatësisht shlyerja e borxheve që ka trashëguar ky ekzekutiv nga pushteti i kaluar, që shkon rreth 1 milionë euro.

Në këtë kontest më së shumti punë ka pasur Drejtoria e Buxhetit dhe Financave e cila ka hasur në shumë projekte në të cilat është punuar pa asnjë plan apo projekt dhe miratim, gjë që ka vënë në vështirësi edhe punën e saj, ndonëse është konfirmuar se borxhi që ka patur komuna nga pushteti i kaluar ka shkuar mbi 930 mijë euro.

Kryetari me të marr detyrën së bashku me bordin dhe drejtorët ka kërkuar që të bëjë inventarizimin përkatësisht të skanoj gjendjen ekzistuese, ndërkohë që fal kursimeve që ka bërë në fushën e mallrave dhe shërbimeve, kursimit të derivateve krahasuar me pushtetin e kaluar, uljen e shpenzimeve në telefoni dhe rrymë sikurse edhe në dreka e darka, ia ka dal që të kthej një pjesë të madhe të këtij borxhi.

Sipas zyrtarëve të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave përkatësisht drejtorit Nysret Maxhera deri në Shtator administrata komunale fal menaxhimit më të mirë të buxhetit por edhe realizimit të kursimeve në disa fusha, ia ka dal të shlyej rreth 600 mijë nga 930 mijë euro sa ka pasur borxh komuna pasi ka marr mandatin nga ekzekutivi që drejtohet nga kryetari Agim Bahtiri.

Në këtë punë të bërë Kuvendi Komunal nuk ka pasur thujtë asnjë rol, ndërkohë që ekzekutivi nën kontrollin strikte të kryetarit dhe drejtorit të Financave ia ka dal që të kthej rreth 2 të tretat e borxhit total, që mund të llogaritet si sukses, ndonëse opozita thujtë në çdo debat ka kritikuar për inkasim të dobët, për realizim të ultë të investimeve kapitale dhe mos realizimin të premtimeve nga ana e kryetarit për 15 mijë vende pune.

Kjo ka bërë që në disa pika ku është debatuar rreth raportit të kryetarit por edhe drejtorisë për shërbime publike opozita të kritikoj mungesën e investimeve, shkallën e ultë të realizimit të projekteve të parashikuara, e posaçërisht mos hapjen e vendeve të punës që janë premtuar gjatë fushatës zgjedhore, ndërkohë që kthimi i borxhit që është trashëguar nga pushteti aktual asnjëherë nuk është komentuar.

Kryetari Agim Bahtiri por edhe Drejtori i Buxhetit Nysret Maxhera janë të mendimit se ecuria e shlyerjes së deritashme të borxhit do të vazhdoj edhe në muajt në vijim duke dhënë

shpresë se ai do mund të shlyhet tërësisht apo të mbetet fare pak deri në fund të vitit në të cilin ndodhemi.

Kjo mbetet të shihet në muajt në vijim ndonëse bazuar në situatën e përgjithshme dhe “ngërçin” rreth konstituimit të institucioneve qendrore ka ndikuar edhe në pamundësinë e ribalansit të buxhetit që ka detyruar Kuvendin që të anuloi zgjedhjet e propozuara për ribalans pasi ai nuk është aprovuar nga Ministria.

Rekomandimet për Komunë

- Të krijohet mekanizmi i kontrollit komunal që në projektet që po realizohen apo do të realizohen në të ardhmen, para fillimit të një projekti qoftë në rrugë apo infrastrukturë tjetër, të skanohet gjendja para fillimit të projektit apo ndërhyrjes dhe pas projektit të kryes, nëse janë sanuar dëmtimet dhe nëse është kthyer gjendja si në fillim.
- Përmes bordeve të aksionarëve të ndikoj në rritjen e efikasitetit të shërbimeve ndaj qytetarëve për ndërmarrjet publike që ofrojnë shërbime, në radhë të parë në ato imediate siç janë furnizimi me ujë dhe menaxhimi më efikas me mbeturina përkatësisht pastrimin dhe mirëmbajtjen e qytetit.
- Të shtoj bashkëpunimin me këshillat e lokaliteteve dhe fshatrave në njohjen me problemet dhe nevojat që kanë ata dhe adresimin e tyre drejt faktorëve që do sjellin zgjedhje, përkatësisht të bashkëpunojnë me shoqërinë civile si një nga kontrolluesit dhe vlerësuesit më real të situatës në administratat komunale.

Zyrës së Kryetarit të Komunës:

- Problemi i objekteve sportive duhet të zgjidhet në intensifikimin e takimeve dhe presionit përmes donatorit të ndërtimit dhe meremetimit të këtyre objekteve siç janë BE dhe Ministria e Sportit pasi vazhdimi i status quo-s do sjell fundin e durimit të adhuruesve dhe sportistëve dhe daljen në rrugë të klubeve edhe sportistëve.
- Të rritet transparenca dhe llogaridhënia në komunë, duke krijuar edhe trupa monitorimi të punës së administratës komunale, posaçërisht në fushën e prokurimit dhe financave.
- Hapi i parë i kërkesës me konkluzionet që ka nxjerr Asambleja është bërë, sikurse edhe takimi i krerëve komunalë me zyrtarët e BE-së, mirëpo kjo nuk le hapësirë për ndalimin e presionit drejt kompanisë punëkryese që ajo sa më shpejt të përfundoj punimet qoftë me gjetjen e mundësisë së sanksionimit nëse vazhdon me trendin e deritashëm.
- Shlyerja e borxheve duhet të zgjidhet konform mundësive dhe kapaciteteve buxhetore, mirëpo kjo nuk guxon të shkoj në dëm të investimeve kapitale dhe mbështetjes së projekteve emergjente që dalin nga zona të caktuara.
- Kjo administratë tashmë ka kursyer mijëra litra derivate, ka ulur harxhimet edhe në disa kategori tjera që do mund të orientohen në nxitjen e fushatave për rritjen e inkasimit që sjellin rritje të fondit të investimeve kapitale dhe realizimin e shumë kërkesave nga zona të ndryshme rurale apo urbane për investime në infrastrukturë dhe krijimin e jetës më të mirë.

Shëndetësi

- Të rritet efikasiteti dhe përgjegjësia në institucionet shëndetësore qofshin primare apo sekondare që nga teknikët deri tek mjekët.
- Të rritet prania e mjekut në qendrat ambullantore në lokalitete, dhe të organizohet orari gjithëditor i punës në ambullanta.

Mbeturina

- Të organizohen fushata vetëdijësuese për ruajtjen dhe mbrojtjen e ambientit dhe të ngritët efikasiteti krahas krijimit të kushteve për kompanisë për menaxhimin e mbeturinave dhe mirëmbajtje të qytetit.
- **Sjellja ndaj Asambleistëve:** Të respektohet puna dhe angazhimi i asambleistëve dhe vetë Asamblesë në procesin e vendimmarrjes dhe zbatimit të kompetencave duke krijuar kushte dhe hapësirë veprimi.
- Të vazhdoen takimet publike me qytetarët jo vetëm në diskutimet publike për rregullore të caktuara, por edhe buxhet dhe planifikim që do mund të ndikonte në transparencë dhe përmbushjeve të kërkesave të qytetarëve.
- Të vlerësohet puna dhe kontributi që japin anëtarët e këshillit në bashkësi, duke adresuar çështjet që janë emergjente për shqyrtim dhe veprim në drejtim të plotësimit të nevojave imediate të qytetarëve.
- Të krijohen mekanizmi dhe nxitja e punës së këshillave lokale, duke marr parasysh punën që bëhet dhe duke kompensuar ata për punën dhe angazhimin në këshillat ku veprojnë.
- Ndonëse ka lëvizje në drejtim të bashkëpunimit dhe mbështetjes së shoqatave joqeveritare, mbetet sfidë bashkëpunimi ndërmjet OJQ si zëri i qytetarit deri tek institucionet.

Kryesuesit të Kuvendit:


- Të jetë strikt në respektimin e rregullores së punës, në kontrollin e diskutimit brenda rendit të ditës, kohëzgjatjen e diskutimit dhe replikave sikurse edhe ndërhyrjen për tejkalimin e tensioneve të ndryshme.
- Të mbaj qëndrim parimor në përputhje me rregulloren, duke ju mundësuar të zgjedhurve paraqitjen e problemeve, krahas marrëveshjes që kanë sikurse edhe rendit të ditës të përcaktuar nga KPF
- Të vazhdoj konsultimet dhe bashkëpunimin sikurse deri më tani, duke marr në konsideratë vërejtjet dhe sugjerimet që ofrojnë shoqatat posaçërisht ato që bëjnë monitorimin e punës së administratës komunale.

Asamblistëve të Kuvendit:

- Të përgatiten për seancën duke u njohur me pikat që janë në rend dite, duke diskutuar për problemet imediate e jo të shfrytëzojnë diskutimet për akuza e kundër akuza.
- Të jenë të shkurtër të qartë dhe në përputhje me rregulloren për punë në asamble, duke mos bërë deklaratat shpesh të panevojshme.
- Të bashkëpunojnë me këshillat e fshatrave dhe të shfrytëzojnë mundësinë që me forma avokimi të realizojnë propozimet për çështje të ndryshme.
- Të sjellën, me respekt, dinjitet dhe të jenë të zëshëm në mbrojtjen e interesit të qytetarëve dhe të komunës.
- Të krijojnë ura bashkëpunimi, pasi ata dhe shoqëria civile janë zëri i qytetarit të thjeshtë në institucionet lokale.

Rregulloret dhe Vendimet


Dokumenti	Statusi	Votimi
<i>Rregullorja për Transparencë</i>	Miratuar	Pro:25,Kundër:0 Abstenuan 4
<i>Rregullorja për auto-taxi dhe transport me komibus</i>	Miratuar	Pro:26 Kundër:2 Abstenuan 0
<i>Miratimi i planit Urban "Sitnica".</i>	Miratuar	Pro:27 Kundër:0 Abstenuan 2
<i>Miratohet Korniza afatmesme buxhetore 2015-2017.</i>	Miratuar	Pro:24 Kundër:10 Abs:0
<i>Rregullorja për tatim në pronë</i>	Miratuar	Pro: 27 Kundër:0 Abstenuan:3
<i>Zgjedhja për Kryesues të Kuvendit Bislim Imeri</i>	Miratuar	Pro 20, Kundër 0, abstenuan 15
<i>Vendimi për themelimin e KPF-se</i>	Miratuar	Pro 24, Kundër 3, abstenuan 5
<i>Vendimi për komisionin e draft statutit të asamblesë</i>	Miratuar	Pro 28, Kundër 0, abstenuan 3
<i>Vendimi për ndarjen e bursave</i>	Miratuar	Pro 31, Kundër 0, abstenuan 0
<i>Vendimi për themelimin e KKS-b-së</i>	Miratuar	Pro 28, Kundër 2, abstenuan 2
<i>Vendimi për caktimin e orarit të mbledhjeve të KPF dhe Kuvendit</i>	Miratuar	Pro 23, Kundër 0, abstenuan 6
<i>Vendimi për themelimin e komitetit për komunitete</i>	Miratuar	Pro 31, Kundër 0, abstenuan 0
<i>Vendimi për themelimin e komisionit për vlerësimin e pronave</i>	Miratuar	Pro 33, kundër 0, abstenuan 1
<i>Vendimi i themelimit të komisionit të ankesave</i>	Miratuar	Pro 23, Kundër 3, abstenuan 0
<i>Vendimi për themelimin e bordit të aksionarëve "Tregu", "Uniteti", "Stacioni autobusëve"</i>	Miratuar	Pro 23, Kundër 9, abstenuan 2
<i>Vendimi për qytetar nderi- Lulzim Basha, Minir Dushi</i>	Miratuar	Pro 31, Kundër 0, abstenuan 0
<i>Vendimi për emërimin e nënkryetarit të komiteteve Eroll Zekirja</i>	Miratuar	Pro 24, kundër 0, abstenuan 1
<i>Themelimi i komiteteve shëndetësi, sport, zhvillim ekonomik, planifikim, mjedis, këshilla, mbrojtje, barazi gjinore</i>	Miratuar	Pro 22, Kundër 0, abstenuan 8
<i>Vendimi për komitete konsultative</i>	Miratuar	Pro 25, Kundër 2, abstenuan 3




Komuna
Skenderaj



Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



8. Komuna SKENDERAJ

Vlerësimi i Përgjithshëm

Çfarë e karakterizoi komunën këtë vit

Kuvendi Komunal i Skenderajt gjatë këtij viti është përballur me disa probleme për shkak të neglizhencës së kryesisë dhe sekretariatit të Kuvendit në disa çështje të cilat janë zgjidhur vetëm pas ndërhyrjes së medie, Shoqërisë Civile apo partive politike opozitare. Ndër problemet kryesore veçohen mosvënia e fotografisë së Presidentes sipas Ligjit dhe Kushtetutës në sallën e mbledhjeve të kuvendit, miratimi i disa vendimeve kontradiktore rreth dhënies në shfrytëzim apo këmbimit të pronës publike, dhe dhënia e mandatit të këshilltarit komunal të dy këshilltarëve të cilët kanë qenë shërbyes civil dhe kanë marrë pagë nga buxheti i shtetit në kundërshtim me Ligjin për shërbyesit civil të Kosovës.

Megjithatë, Kuvendi Komunal i Skenderajt ka pasur edhe të arriturat e veta gjatë këtij viti, si në respektimin e rregulloreve të punës ashtu edhe në ngritjen e transparencës. Medive dhe monitoruesve të organizatave të ndryshme joqeveritare u janë ofruar kushte komode në përcjelljen e seancave. Sekretaria e Kuvendit me kohë i ka furnizuar palët e interesuara me materialin e mbledhjeve, ndërsa mbledhjet publike janë paralajmëruar me kohë sipas dispozitave dhe rregulloreve në fuqi. Po ashtu, edhe kryesuesi i Kuvendit Komunal është treguar i kujdesshëm në menaxhimin e seancave duke mos lejuar fjalor apo paraqitje jo etike të këshilltarëve në seancat e kuvendit, si dhe ka ndërmarrë masa ligjore duke i hequr nga mëditjet ata këshilltarë që pa arsye i kanë shpërfillur seancat e kuvendit. Kryesuesi po ashtu ka pasur një afërsi bashkëpunimi dhe kod të mirësjelljes në nivel të lartë me monitoruesit e punës së Kuvendit Komunal. Kryetari i Skenderajt nuk ka ushtruar për asnjë ditë funksionin e tij, pasi është rizgjedhur në krye të Komunës. E vetmja paraqitja e tij ka qenë dhënia e betimit, më 3 janar 2014. Pra, në total, kryetari i Skenderajt ka munguar për 18 muaj, duke llogaritur edhe mungesën prej 6 muajve nga mandati i kaluar. Megjithëkëtë, të gjitha detyrat dhe autorizimet i ka kryer nënkryetari, për 18 muaj rresht, ani pse Neni 60, pika 60.3 të LVL-së, nuk përcakton qartë se për sa kohë nënkryetari mund të zëvendësojë kryetarin.

Problemet kryesore të komunës

Me gjithë përparimet në disa sektorë, Komuna e Skenderajt edhe këtë vit është përballur me probleme të mëdha, kryesisht me ato socio-ekonomike dhe infrastrukture. Rritja e buxhetit të përgjithshëm nga viti në vit nuk ka ndikuar në eliminim e problemeve që e përcjellin komunën që nga paslufta. Edhe më tej ka shkallë të lartë të braktisjes së shkollimit, mungesë të ujit të pijes dhe kanalizimit, si dhe menaxhim të dobët të buxhetit, ku përveç rritjes së të hyrave vetjake, nuk është vërejtur ulje e shpenzimeve në shumë kategori si dhe nuk është vërejtur ngritje e investimeve kapitale.

Pesë problemet kryesore:

1. Problemet në arsim si braktisja e shkollimit, pakënaqësitë me konkursin e punëtorëve;
2. Mungesa e ujit të pijes në rreth 80 % të fshatrave ose 65 % e popullsisë;
3. Paaftësia për të zbatuar Rregulloren Komunale për transportin publik;
4. Mungesa e të hyrave vetanake nga qiraja dhe koncesioni;
5. Problemet me ndërtimet pa leje.

Të arriturat në vitin 2014

Komuna e Skenderajt gjatë këtij viti ka arritur progres në administratën komunale duke bërë që qytetarët të pajisen shumë shpejt me dokumente të ndryshme, duke i shmangur kështu radhët e gjata të qytetarëve që presin për një certifikatë.

Po ashtu, funksionalizimi i objektit të ri të administratës komunale, ekzekutivit dhe kuvendit ka bërë që krahas përmirësimit të shërbimit ndaj qytetarëve, të ketë edhe kushte komode pune për punëtorët e administratës publike, por edhe zvogëlim të shpenzimeve komunale, pasi më parë administrata komunale kishte qenë e shpërndarë në tri objekte të ndryshme.

Vlerësimi për performancë në transparencë

Kryetari i Komunës së Skenderajt për rrethana tashmë të njohura për publikun nuk ka qenë në vendin e tij të punës, ndërsa sipas Ligjit, detyrën e tij e ka vazhduar nënkryetari. Nënkryetari i komunës ka qenë më bashkëpunues me qytetarët dhe shoqërinë civile, dhe ka raportuar me rregull pranë Asamblesë Komunale dhe ka zhvilluar takime me qytetarë, mirëpo deri më tani nuk ka ndërmarrë asnjë hap për përmirësimin e transparencës sa i përket qasjes në dokumente publike. Edhe më tej Komuna e Skenderajt nuk lejon qasje në dokumente publike.

Shumica e drejtorëve të Drejtorive kanë qenë transparentë dhe bashkëpunues me mediat, OJQ-të dhe qytetarët, mirëpo edhe më tej shqetësues mbetet fakti se Drejtoria për Financa nuk i bënë publike shpenzimet e buxhetit sipas të gjitha kategorive, kodeve dhe nënkodeve, por vetëm ato gjenerale. Ndërsa Drejtoria e Arsimit edhe më tej është e mbyllur për opinionin publik. Është e vetmja drejtori tek e cila qytetarët vazhdimisht shfaqin ankesa të ndryshme, ndërsa zyra e drejtorit në pjesën më të madhe të orarit të punës është e mbyllur.

Këshilltarët e Asamblesë Komunale kanë qenë konstruktiv sa i përket seancave, mirëpo ata edhe më tej mbeten nën ndikimin e partisë që e përfaqësojnë duke iu shmangur kështu kërkesave të qytetarëve dhe përfaqësimit dinjitoz të interesave të tyre. Që nga marrja e mandatit, nuk është veçuar asnjë çështje që është ngritur nga ana e tyre, përveç disa pyetjeve se në planin zhvillimor të komunës dhe në planin e investimeve kapitale a është paraparë ndonjë investim në zonën që ata përfaqësojnë.

Kryesuesi i Kuvendit kohëve të fundit ka ndërmarrë disa hapa konkret në përmirësimin e menaxhimit të seancave publike. Kuvendi i Skenderajt vlerësohet për zbatim të Rregulloreve të punës, fjalorit të pastër të përdorur, debatit konstruktiv, respektimit të Rregullores për transparencë, bashkëpunimit dhe ofrimit të kushteve për mediet dhe shoqërinë civile.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Hartimi i guidave specifike për promovim biznesi	Pa-realizuar
2	Ri-funksionalizimi i repartit të Stomatologjisë	Realizuar
3	Ndërtimi i ujësjellësve në fshatrat ku ka burim uji	Pa-realizuar
4.	Ndërtimi i Objektit të QKMF-së	Pjesërisht
5.	Ndërtimi i Parkut të Biznesit	Pa-realizuar

Transparenca në Komunë

Buxheti i Komunës së Skenderajt gjatë vitit që e lamë pas ka shënuar një ngritje të lehtë, mirëpo ekzekutivi komunal nuk është treguar transparent me publikun sa i përket shpenzimit të tij. Në shumë kategori kryesore përveç pagave dhe mëditjeve ku ka një sistem unik si në tërë Kosovën, në kategoritë tjera shpenzimi i buxhetit është publikuar vetëm në mënyrë gjenerale. Nuk dihet vlera e shpenzimeve në projekte të ndryshme kapitale, nuk dihet se sa para janë shpenzuar për kategori të ndryshme për mallra dhe shërbime, e po ashtu nuk specifikohen as shpenzimet e subvencioneve dhe transefereve. Po, ashtu mediet dhe shoqëria civile kanë kërkuar që raporti vjetor i shpenzimit të buxhetit të bëhet në formë analitike me kode dhe nënkode. Kjo kërkesë është përsëritur që nga viti 2012, mirëpo zyrtarët komunal nuk e kanë përfillur këtë kërkesë me arsyetimin se raporti analitik u merr shumë kohë zyrtarëve të Drejtorisë për Financa.

Seancat plenare të Kuvendit kanë qenë të hapura për publikun. Secila palë e interesuar ka pasur qasje në Kuvend, njohuri për rendin e ditës dhe çështjet për diskutim dhe aprovim. Janë paralajmëruar seancat brenda afateve të parapara ligjore si dhe asnjëherë nuk ka pasur ankesa nga këshilltarët për mos-pajisje apo vonesa në shpërndarjen e materialit. Edhe OJQ-të që e monitorojnë punën e Kuvendit gjithnjë janë pajisur me kohë me material dhe janë njoftuar me kohë për orarin e mbajtjes së seancave si të Komitetit për Politikë e Financa ashtu edhe për ato të Kuvendit.

Komuna e Skenderajt ka pasur ngecje në formimin e Komiteteve Konsultative, ndonëse ato janë formuar vetëm sa për të përmbushur një obligim ligjor, pasi ato janë shumë pasive. Edhe viteve të kaluara ato nuk kanë zhvilluar ndonjë aktivitet, ndërsa gjatë këtij viti nuk dihet nëse kanë mbajtur ndonjë mbledhje të rregullt, pasi nuk kanë pasur asnjë komunikim me mediat dhe organizatat e shoqërisë civile. Madje, përveç Komiteteve obligative të cilat janë formuar me kohë, në formimin e Komiteteve Konsultative ka pasur vonesa për muaj të tërë. Kuvendi Komunal nuk është treguar transparent sa i përket formimit të këtyre komiteteve pasi në Komisionet për formimin e tyre asnjëherë nuk janë përfshirë përfaqësuesit e shoqërisë civile, madje në vend të këtyre të fundit janë futur emra të nëpunësve apo shërbyesve civil, mësimdhënësve dhe anëtarëve pasiv të partive politike.

Komuna e Skenderajt është njëra ndër komunat më me së paku qasje në dokumente publike në Kosovë. Nga 20 kërkesa të ndryshme të medieve, OJQ-ve dhe subjekteve politike për këtë vit në asnjërën prej tyre nuk është lejuar qasje vendim ky që është në kundërshtim të plotë me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike. Edhe pse insistimi i shoqërisë civile për këtë problematikë ka qenë sistematik, megjithatë nuk është shënuar asnjë progres në këtë drejtim. Në të shumtën e rasteve nuk është kthyer përgjigje fare, ndërsa ka pasur raste kur përgjigjet kanë qenë banale si për shembull dokumenti i kërkuar ndodhet në bodrumin e komunës dhe është vështirë për ta gjetur, apo në rastet e refuzimit me arsyetim poashtu banal se gjoja ato dokumente po përdorën për qëllime propagandistike dhe komerciale. Më e mbyllura në këtë aspekt ka qenë Zyra e Prokurimit në të cilën palët e interesuara deri më tani nuk e kanë pasur qasjen, madje as në një lëndë apo dokument të vetëm, ndërsa Drejtoritë Komunale edhe pse nuk u janë përgjigjur kërkesave për qasje, ka pasur raste kur drejtorë t janë përgjigjur gojariisht në pyetjet apo kërkesat për çështje të caktuara.

Komuna e Skenderajit, ka zyrën për informim në kuadër të së cilës është edhe mirëmbajtja e ueb-faqes dhe azhurnimi i të dhënave në të. Përveç në kategorinë e lajmeve ku publikohen ngjarjet dhe aktivitetet ditore të komunës, si dhe paralajmërimin dhe publikimin e seancave të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Asamblesë Komunale, në kategoritë tjera të rëndësishme nuk ka një mirëmbajtje të duhur.

Publikimi i planifikimit të buxhetit, realizimit të buxhetit dhe shpenzimit të buxhetit nuk ndodhë asnjë herë, ndërsa nga Zyra e Prokurimit në ueb-faqen e komunës nuk ka asnjë informacion as për kontratat as për tenderët.

Azhurnimi i fundit i prokurimit në ueb-faqen e komunës i takon vitit 2011 me një informacion të përgjysmuar.

Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i takimeve	Numri	Në rend dite	Pjesëmarrja	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare	11	35	90%	%
Komiteti për Politikë dhe Financa	8	34	100%	%
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli Komunal Sigurisë në Bashkësi	2		(Po)	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	6		40 persona	

Llogaridhënia në Komunë

Nënkryetari i Komunës së Skenderajt shpesh ka zhvilluar takime me qytetarë pothuaj në të gjitha zonat e Komunës, mirëpo ato takime nuk kanë pasur karakter raportimi, por karakter reciprok informimi për nevojat imediate të qytetarëve. Opozita këto takime i ka vlerësuar si takime elektorale anë pse ato janë zhvilluar qoftë para zgjedhjeve lokale qoftë pas marrjes së pushtetit dhe konstituimit të organeve të pushtetit lokal.

Komuna e Skenderajt, përkatësisht nënkryetari i komunës shpesh kanë qenë objekt i raportimeve, reportazheve dhe temave të ndryshme mediatike për zhvillimet në komunë. Kritikën e medieve dhe shoqërisë civile për keqmenaxhim të parashë publike, pronës publike, këmbimit dhe koncesionimit në media shpesh janë përcjellë me kundërkritikë dhe reagime nga ana zyrtarëve komunal duke përfshirë edhe nënkryetarin e komunës.

Kryetari i Komunës së Skenderajt për rrethana të njohura nuk ka raportuar në Asamble, ndërsa nënkryetari i cili sipas Ligjit është pjesë e përfaqësimit të Zyrës së Kryetarit, rregullisht ka raportuar në Asamble sipas afateve të parapara e pothuaj se ka qenë i pranishëm në të gjitha seancat e Kuvendit Komunal me përjashtim në dy raste.

Komuna e Skenderajt gjatë vitit ka mbajtur gjashtë (6) takime me publikun, ndërsa ka marrë në konsideratë rekomandimin e shoqërisë civile që takimet me qytetarë të organizohen në fshatra apo Bashkësi Lokale dhe kjo ka dhënë rezultat pasi prania e qytetarëve në këto dëgjime ka qenë e kënaqshme. Mesatarja e pjesëmarrjes ka qenë 40 qytetarë për një takim. Po ashtu, komuna ka marrë parasysh disa kërkesa të qytetarëve për projekte të ndryshme infrastrukture dhe i ka renditur ato në listën e prioriteteve në kategorinë e investimeve kapitale për vitin e ardhshëm.

Qytetarët e Skenderajt nga ana e ekzekutivit janë konsultuar në nivel të kënaqshëm duke i marrë parasysh kërkesat e tyre, natyrisht ato kërkesa të cilat i përballon buxheti i komunës.

Për dallim nga ekzekutivi, fatkeqësisht legjislativi është treguar tejet pasiv sa i përket konsultave me qytetarë. Një gjë të tillë e kanë aplikuar vetëm këshilltarët e partive politike opozitare LDK dhe LVV të cilët kanë pasur takime me qytetarë, ndërsa partia në pushtet e cila e ka shumicën absolute, takimet me qytetarë i ka zhvilluar vetëm gjatë fushatës elektorale.

Formimi i Këshillave të Fshatrave

Ndër çështjet me më rëndësi që e kanë karakterizuar administratën komunale, kanë qenë formimi i Këshillave të fshatrave dhe formimi i disa komiteteve konsultative. Edhe përkundër disa përpjekjeve të ekzekutivit në bashkëpunim me legjislativin, këshillat e fshatrave nuk janë themeluar ende, ndërsa me kontributin edhe të shoqërisë civile ku janë organizuar takime avokuese për këtë çështje, është arritur që ajo të jetë prioritare, ndërsa është planifikuar që formimi i Këshillave të Fshatrave të futet si pikë kryesore e rendit të ditës në njërin prej dy seancave të fundit të Asamblesë Komunale për këtë vit. Po ashtu edhe Komitetet konsultative janë prioritet për seancat e mbetura.

Zbatimi i Rregullores për Transport Publik

Sfidë e madhe për administratën komunale për këtë vit, po ashtu ka qenë edhe zbatimi i Rregullores Komunale për Transportin Publik e cila parasheh largimin e kombibusëve nga operimi. Asambleja Komunale me propozimin e ekzekutivit ka marrë vendim për largimin e kombibusëve, mirëpo tentimi për ta bërë një gjë të tillë është karakterizuar me protesta. Drejtoria e Shërbimeve Publike ka vënë në aksion Inspektorët të cilët gjatë vitit kishin ndërmarrë së paku dy aksione, mirëpo pa mundur ta zgjidhin çështjen, ndërsa kombibusëve u është dhënë një ultimatum për mos-operim në të kundërtën do të shqiptohen gjoba. Kombibusët vazhdojnë operimin, ndërsa drejtoria e Shërbimeve Publike ka premtuar se ky problem do të zgjidhet deri në fund të vitit.

Rekomandimet për Komunë

Zyrës së Kryetarit të Komunës:

- Ekzekutivi i Skenderajt të rrisë numrin e përfituesve të bursave për studentë, të përkrahë financiarisht nxënësit e shkollave të mesme me gjendje të rëndë ekonomike, dhe të paguaj transportin për nxënësit filloristë që udhëtojnë më shumë se 4 km.
- 50 % e buxhetit e paraparë për Investime kapitale të dedikohet ujësjellësve dhe kanalizimeve nëpër fshatra, pasi investimet kapitale janë të përqendruara kryesisht në rrugë, ndërsa kërkesat e qytetarë ve janë imediate edhe në ujë sjellë s dhe kanalizime
- Të rritet për 100 % (nga 1 në 2 euro) participimi i qytetarëve që marrin shërbime shëndetësore, ndërsa ky buxhet të ndikojë në përmirësimin e furnizimit me barëra nga lista esenciale, meqë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skenderaj por edhe në ambulancat nëpër fshatra vazhdimisht ka mungesë ta barërave nga kjo listë
- Zyra e kryetarit ta kthej ditën e mërkurë si ditë e pranimit të qytetarëve në zyrë për të dëgjuar shqetësimet e tyre ashtu siç është paraparë me Ligj. Ka më shumë se dy vite që kjo ditë e dedikuar për qytetarët është anuluar, ndërsa kërkesat e qytetarëve për takime janë të shumta.
- Zyra e kryetarit të bëjë publike vendimet për ndarjen e subvencioneve për qytetarë edhe për ato kërkesa që janë nën vlerën prej 1 mijë euro. Qarkullojnë zëra dhe dyshime për keqpërdorime të mundshme pasi që asnjëherë nuk dihet se kush janë përfituesit e këtyre subvencioneve.
- Drejtoria për Kulturë të rrisë shumë për përkrahje të klubeve sportive dhe të gjitha klubet që janë aktive dhe të regjistruara të përfitojnë shuma përafërsisht të barabarta. Klubet sportive vazhdimisht kanë pasur ankesa në ndarje jo proporcionale të këtyre mjeteve pasi shumicën e mjeteve e merr vetëm klubi i futbollit, ndërsa klubet tjera ose nuk marrin fare ose marrin shuma simbolike.
- Të zbatohet Ligji për Qasje në Dokumente Publike. Mediave, shoqërisë civile dhe gjithë qytetarëve t'u lejohet qasje në dokumente publike konform ligjit, ndërsa kërkesat e tyre të shqyrtohen brenda afateve të parapara ligjore dhe të kthehet përgjigje.

Kryesuesit të Kuvendit:

- Kryesuesi i Asamblesë Komunale ta zbatojë Rregulloren për Transparencë duke financuar mediumet lokale për publikim të seancave ashtu siç e parasheh rregullorja.
- Të përkrah opozitën në çështjet e ngritura prej tyre që janë në interes për qytetarët duke ushtruar ndikimin e tij tek shumica parlamentare.
- Të kërkojë nga Këshilltarët Komunal që t'u përgjigjen ftesave të Organizatave të Shoqërisë Civile në debatet dhe tryezat që kanë për qëllim të ngritin pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.


Asamblistëve të Kuvendit:

- Asamblistët të jenë më vigjilent në shqyrtimin e materialeve sidomos të pikave të propozuara nga ekzekutivi në veçanti buxhetin, dhe mos t'i votojnë ato propozime që nuk i kënaqin interesat e të gjithë qytetarëve, pavarësisht se propozohen nga e njëjta parti politike që janë edhe vetë pjesë e saj.
- Diskutimi mos te jetë vetëm sipërfaqësor sa për të marrë fjalën, por të analizohet thellë problematika.

- Të jenë më aktiv në sjelljen e propozimeve në Kuvend, në pajtim me kërkesat e përditshme të qytetarëve.
- Të mënjnohen hyrje-daljet e shpeshta në Kuvend gjatë kohës së seancave.
- Të bashkëpunojnë më shumë me shoqërinë civile dhe të marrin rekomandime nga ta pastaj ato t'i adresojnë në Kuvend.

Rregulloret dhe Vendimet


Dokumenti	Statusi	Votimi
<i>Rregullorja për Transparencë</i>	Miratuar	Pro: 24 Kundër: 2 Abs:0
<i>Plani Rregullues i Komunës</i>	Miratuar	Pro: 28 Kundër: 0 Abs:0
<i>Planifikimi i Buxhetit</i>	Miratuar	Pro: 25 Kundër: 0 Abs:2
<i>Raporti i Auditorit</i>	Miratuar	Pro: 23 Kundër: 3 Abs:0
<i>Vendimi për dhënien me koncesion të pronës publike</i>	Miratuar	Pro: 22 Kundër: 3 Abs:1
<i>Vendimi për këmbimin e pronës publike</i>	Miratuar	Pro: <u>22</u> Kundër: <u>3</u> Abs: <u>1</u>
<i>Rishikimi i Buxhetit</i>	Miratuar	Pro: <u>25</u> Kundër: <u>0</u> Abs: <u>2</u>
<i>Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2014-2017</i>	Miratuar	Pro: <u>24</u> Kundër: <u>1</u> Abs: <u>2</u>
<i>Rregullorja për emërtimin e rrugëve, parqeve dhe shesheve</i>	Miratuar	Pro: <u>25</u> Kundër: <u>1</u> Abs: <u>2</u>
<i>Raporti 9 mujor i shpenzimit të buxhetit</i>	Miratuar	Pro: <u>25</u> Kundër: <u>1</u> Abs: <u>2</u>
<i>Propozim vendim për planin për ngritjen e të hyrave vetanake</i>	Miratuar	Pro: <u>27</u> Kundër: <u>0</u> Abs: <u>0</u>
<i>Projekt-rregullore për menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e ambientit</i>	Miratuar	Pro: 25 Kundër: 1 Abs: <u>0</u>
<i>Rekomandim i Komisionit për intervistë për themelimin e komiteteve konsultative</i>	Miratuar	Pro: <u>25</u> Kundër: <u>1</u> Abs: <u>0</u>
<i>Propozim vendim për plotësimin e dhe ndryshimin e vendimeve nr 1-464-54621, 1-464-57445, 1-464-57458 dhe 1-464-57466</i>	Miratuar	Pro: <u>23</u> Kundër: <u>1</u> Abs: <u>1</u>




Komuna Shtime



Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



9. Komuna SHTIME

Vlerësimi i Përgjithshëm

Çfarë e karakterizoi komunën këtë vit

Ky është viti i parë i funksionimit të Kuvendit të ri të Komunës së dalur nga zgjedhjet lokale vitit 2013. Në një vlerësim të përgjithshëm, të gjithë asambleistët dhe në veçanti Kryesuesi, kanë dhënë kontribut që Kuvendi të kryej detyrat e tij me sukses. Tri elemente mund të përmenden që ndërlidhen me punën dhe funksionimin e mirëfilltë të Kuvendit. E para lidhet me seancën inauguruese kur asambleistët e LDK-së nuk ishin të pajtimit që në seancë të ndryshohet rendi i ditës, për t'u futur në rend edhe zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit. Megjithatë, me shumicë votash u ndryshua rendi i ditës në fillim të seancës dhe më pas u procedua sipas rendit edhe zgjedhja e Kryesuesit.

Çështja tjetër me rëndësi është kur në seancën e parë të asamblesë komunale, në rend dite ishte formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa, opozita kërkonte përfaqësim prej katër anëtarësh në këtë komitet, pasi pozita kishte vetëm 10 anëtarë në Kuvend, kurse opozita 11 anëtarë. Kjo nuk u pranua nga pozita, të cilët thanë se ne kemi marrëveshje koalicioni me Partinë e Drejtësisë (një anëtar në Kuvend) dhe aty për aty Kryetari i Komunës kërkoj që asamblisti i PD-së të zë ulësen nga ana e pozitës. Më pas KPF u votua me katër (4) anëtarë nga pozita dhe tre (3) nga opozita. Çështja tjetër ka të bëjë me Planin e Punës së Kuvendit, ku megjithëse hartimi i tij është proceduar mjaft herët, aprovimi final ndodhi në mbledhjen e dytë në muajin qershor.

Problemët kryesore të komunës

Sikur edhe çdo komunë tjetër që ka problemet specifike të saj, edhe komuna e Shtimes përballet me një sërë sfidash dhe problemesh. Në përgjithësi, nëse listojmë problemet në bazë të fushave më gjithëpërfshirëse, atëherë problemet në Komunën e Shtimes lidhen me:

Zhvillimin ekonomik, me gjithë investimet e bëra dhe planifikimi për investime të tjera në Zonën Ekonomike – Parku Teknologjik, investimet nga bizneset vendore apo të jashtme janë duke munguar. Për këtë vit nuk ka asnjë kërkesë të re nga ndonjë investitor, për t'u vendosur në Parkun Teknologjik dhe zhvilluar veprimtarinë e tij.

Bujqësinë, si sektori më potencial për zhvillim ekonomik lokal dhe rritje të punësimit. Edhe pse ekziston një Plan Strategjik për Zhvillim Ekonomik Lokal 2014-2018, ku bujqësia intensive është prioritet për t'u investuar dhe zhvilluar, megjithatë, në bazë të planit buxhetor 2015 -2017, sidomos nga buxheti komunal, (jo Programi i Investimeve Publike), investimet publike në bujqësi janë të vogla.

Në fushën e arsimit ka një lëvizje të theksuar për të zhvilluar arsimin lokal, duke e miratuar një Strategji për Arsimin Lokal në Shtime 2014-2018. Përkundër kësaj janë dy momente që e bëjnë zhvillimin e arsimit në Shtime mjaft sfidues. Njëri ka të bëjë me mbylljen e shkollave në ato fshatra ku numri i nxënësve është shumë i vogël si në fshatin Rancë, Karaqicë, e të tjera. Ndërsa, momenti i dytë është në lidhje me pilot projektin në shkollën Emin Duraku, për të ndjekur mësimin në sistemin tërë ditor, i cili po përcillet me mjaft probleme.

Ndotja e lumit (si pasojë e kësaj edhe dalja e lumit nga shtrati), hedhja e mbeturinave në fshatra (sidomos në fshatin Gllavicë dhe Rashincë), ndotja nga furrat e gëlqeres me djegie të gomave të automjeteve, dhe ndotja e degradimi i natyrës nga gurëthyesit, mbetet një sfidë apo problem i theksuar për Komunën e Shtimes.

Problemi/sfida e radhës që shoqëron komunën e Shtimes ka të bëjë menaxhimin e financave, përkatësisht inkasimin e të hyrave vetanake. Ka një progres të theksuar në inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë ku për periudhën janar-shtator të këtij viti janë inkasuar rreth 75 % e shumës së planifikuar, por mbeten sfidë të hyrat nga lejet e ndërtimit, dhe të hyra nga sektorë të tjerë. Në lidhje me këtë problematikë mbeten sfida për mbledhjen e borxheve të vjetra që sillet rreth 600 mijë euro që qytetarët kanë obligime ndaj komunës, dhe taksa për leje ndërtimore. Duke pas parasysh numrin e vogël të të hyrave nga taksat për leje ndërtimi, atëherë konkludimi është që ose ka shumë pak ndërtime në komunën e Shtimes ose ato bëhen pa leje.

Të arriturat në vitin 2014

- a) Funksionalizimi i Qendrës Agrobiznesi, projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Komuna e Shtimes është një e arritur. Kjo qendër tashmë i është dhënë në menaxhim një kompanie në bazë të procedurave ligjore, dhe ajo pritet të jetë një stimulim për fermerët e Shtimes që të kultivojnë produktet bujqësore dhe plasimin e tyre në tregun e jashtëm dhe të brendshëm.
- b) Aprovimi i Strategjisë së Arsimit është një veprim pozitiv për Komunën e Shtimes. Përmes kësaj strategjie synohet të zhvillohet arsimi në bazë të standardeve të avancuara evropiane. Përveç kësaj kjo do të nxitë investime më të mëdha në infrastrukturën e arsimit në Shtime, por do të nxitë edhe rritjen e cilësisë në arsim në këtë komunë.
- c) Inicimi i themelimit të Komiteteve Konsultative në komunën e Shtimes është një hap i rëndësishëm në përmirësimin e qeverisjes së mirë lokale, duke rritur pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje dhe nxjerrjen e politikave lokale më të dobishme për qytetarët.
- d) Aplikimi i sistemit online për t'u pajisur me dokumente të gjendjes civile është e arritura tjetër. Kjo është arritur falë marrëveshjes me Postën e Kosovës duke i dërguar dokumentet përmes postës. Kjo mundësi vlen edhe për bashkatdhetarët që jetojnë në botën e jashtme. E njohur si e-qeverisje është një hap përpara për të ofruar shërbime publike sa më cilësore dhe efikase.

Vlerësimi për performancë në transparencë

Kryetari – mbanë takime të rregullta me qytetarë një ditë në javë (të premteve) dhe mbanë rregullisht dy takime publike me qytetarë, obliguar sipas ligjit për vetëqeverisje lokale. Për të pasur një transparencë më të madhe të kryetarit ndaj qytetarëve apo publikut, ai duhet të organizoj takime më të shpeshta nëpër fshatra dhe lokalitete. Këtë e kanë kërkuar shumë herë qytetarët, pasi ata shprehen se zyrtarët e lartë vizitojnë ato zona vetëm gjatë kohës së zgjedhjeve.

Drejtoritë komunale bëjnë transparente aktivitetet e tyre vetëm në ato raste kur kërkohet nga nivele tjera. Kur asamblastët kërkojnë të marrin ndonjë informatë nga ndonjë drejtor ata ftohen në seancë. Drejtoritë komunale pak ndajnë informata me qytetarë, në formë të takimeve me ata, ose përgatitje të raporteve të punës dhe publikim të tyre.

Këshilltarët Komunal – në përgjithësi kanë treguar një respekt ndaj detyrës së tyre të re si asamblast. Nëse këtë vlerësim e matim përmes vijueshmërisë, diskutimeve (kuantitative) dhe dokumenteve të nxjerrura nga Kuvendi, duket se ata kanë pasur një performancë të

mirë. Por, nevojitet edhe më tutje përkushtim dhe fuqizim të rolit të kuvendit për mbikëqyrje ndaj ekzekutivit dhe lidhjes së vazhdueshme me qytetarët.

Kryesuesi i Kuvendit – në këtë periudhë të menaxhimit të kuvendit ka treguar një qëndrim të balancuar ndaj të gjithë asamblistëve, pavarësisht prejardhjes partiake. Ndaj shoqërisë civile, mediave dhe akterëve tjerë ka treguar një qasje shumë të hapur dhe bashkëpunuese. Është kujdesur që secili veprim që ndodhë në Kuvend të jetë i bazuar në ligj.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Formimin e Drejtorisë për Rini, Kulturë dhe Sport	Realizuar
2	Vazhdimi i qeverisjes së hapur ndaj qytetarëve sikur edhe deri më tani	Realizuar
3	Ndërtimi rrugës transit	Realizuar
4.	Teren Sportiv (Studion Futbollit)	Planifikuar me buxhet (vetëm me PIP)
5.	Përfundimi i Infrastrukturës gjatë 2014 (rrugët, kanalizimi, ujësjellësi,)	Pjesërisht
6.	Zhvillimi i Bujqësisë intensive – (planifikuar në disa segmente të saj por vetëm me PIP)	Pa-realizuar – planifikuar me buxhet pamjaftueshëm
7.	Krijimi i katër zonave të Biznesit	Pa-realizuar – planifikuar me buxhet pamjaftueshëm
8.	Zhvendosja e Gurëthyesëve në 2014 – në vendin e përcaktuar sipas Planit Strategjik që i plotëson standardet	Pa-realizuar
9.	Zgjidhja e shpejtë e kontestit në mes Ministrisë dhe Operatorit për Palestrën Sportive	Pa-realizuar

Transparenca në Komunë

Transparencën buxhetore në Komunën e Shtimes mund të e ndajmë në dy rrafshë. Njëri në lidhje me procesin e miratimit të buxhetit dhe transparencën ndaj qytetarëve gjatë kësaj faze dhe rrafshi tjetër ka të bëjë me transparencën gjatë ekzekutimit të buxhetit.

Në pjesën që i përket transparencës dhe përfshirjes së palëve me interes në fazat e hershme të hartimit të buxhetit ka mangësi të mjaftueshme. Përgatitja e buxhetit (edhe Kornizës Afatmesme Buxhetore për tre vitet e ardhshme), bëhet nga ekzekutivi, përkatësisht Zyra e Kryetarit, zyra e financave dhe eventualisht disa drejtor të drejtorive komunale. Qytetarët informohen vetëm në pjesën që quhet periudha verifikuese e buxhetit, pra atëherë kur nga ekzekutivi dërgohet për aprovim në Kuvend Komunal. Për pjesën e transparencës së buxhetit në lidhje me asamblistët mund të veçojmë tri sfida.

Një, është se kërkesat/propozimet e asamblistëve që mund të jenë edhe si mbështetje e kërkesave qytetare, nuk përfillen sa duhen nga ekzekutivi. Këtu nuk mund të bëjmë ndonjë dallim sa i përket prejardhjes partiake në kuvend. Dy, sfida edhe për assembleistët dhe për shoqërinë civile është mosqartësimi e vijave buxhetore me rastin e propozimit të projekt buxhetit. Ka disa projekte kapitale nga pjesa e investimeve publike të planifikuara për vitin përkatës buxhetor, të cilat nuk janë të qartësuar. Tre, sfida e fundit që lidhet me transparencën e buxhetit në raport me assembleistët dhe publikun, ka të bëjë me raportimin e shpenzimeve financiare apo të buxhetit. Edhe pse ka përmbushje ligjore të afateve

raportuese nga ekzekutivi në asamble, janë disa vërejtje që ngritën edhe nga asambleistët, kryesisht të opozitës. Raportet financiare në shifra përgjithësuese.

Seancat plenare të Kuvendit Komunal dhe të komiteteve të saj janë gjithnjë publike dhe të hapura për pjesëmarrjen qytetare. Në bazë të legjislacionit mbi qeverisjen lokale ato duhet të jenë publike, derisa në bazë akteve më të larta juridike komunale, organet komunale duhet të bëjnë sa më shumë publike secilën seancë të kuvendit apo komiteteve për të rritur pjesëmarrjen qytetare, dhe rrjedhimisht edhe transparencën ndaj publikut. Seancat e Kuvendit komunal bëhen publike nga sekretaria e Kuvendit Komunal, duke përdorur mjetet të themi konvencionale të komunikimit dhe informimit të publikut. Njoftimi për seancat e Kuvendit bëhet në radio lokale (Radio Zëri Shtimes), bëhet në tabelën e njoftimeve në hyrje të objektit komunal dhe bëhet përmes publikimit në ueb faqen komunale.

Ajo që e konsiderojmë sjellje më pak transparente në lidhje me punën e Kuvendit Komunal gjatë seancave të plenare, është mosqartësimi i vendimeve nga ana e Kuvendit, sidomos atyre vendimeve që priten të kompletohen më vonë. Të tilla vendime janë ato që kanë të bëjnë me formimin e komisioneve të ndryshme. Mangësi janë vërejtur me rastin e formimit të një Komiteti të ri jo obligativ të Kuvendit Komunal të Shtimes. E para, megjithëse në rend dite ishte propozuar si Komitet Konsultativ për Arsim, gjatë seancës Kryetari i Komunës propozoj që ky komitet të jetë Komitet jo Obligativ i Kuvendit në vend të atij konsultativ. Formimi i komiteteve është përgjegjësi e kuvendit. E dyta, përbërja e këtij komiteti është propozuar nga Kryetari i Komunës, ku ka propozuar katër (4) anëtarë nga kuvendi dhe tre (3) nga jashtë kuvendit. Për pjesën e anëtarëve jashtë kuvendit i lihet në kompetencë të vendos kryetari, që përsëri kjo përgjegjësi është e kuvendit. E ngjashme është situata edhe me formimin e komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve për Komitetet Konsultative, ku për pjesën e anëtarëve nga shoqëria civile merr përgjegjësinë Kryesuesi, dhe për pjesën nga ekzekutivi Kryetari, e që në fund do të duhej të votohej nga kuvendi, por emrat e propozuar nuk janë votuar në Kuvend.

Komitetet Konsultative ende nuk janë të themeluara në kuadër të Kuvendit Komunal të Shtimes. Në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur në muajin tetor të këtij viti, është marrë vendimi për themelimin e Komiteteve Konsultative. Edhe pse kjo po ndodhë me një vonesë të theksuar, kjo do të jetë një mundësi e mirë për përfshirje qytetare në vendimmarrjen lokale dhe mundësi për bërjen e politikave lokale më të duhura për qytetarët. Në bazë të vendimit të Kuvendit është planifikuar që të themelohen dy Komitete Konsultative. Komiteti Konsultativ për Planifikim Hapësinor dhe Komiteti Konsultativ për Biznes dhe Zhvillim Ekonomik.

Qasja në dokumente zyrtare të Komunës së Shtimes nuk paraqet ndonjë ngecje. Ky vlerësim është së paku prej qasjes tonë si organizatë monitoruese e Kuvendit Komunal në Shtime. Komuna ka një zyrtar përgjegjës që merret me ofrimin e qasjes në dokumente zyrtare për palët e interesuara për të poseduar një dokument të caktuar. Gjithashtu, në faqen e internetit të Komunës ekziston vegëza për shkarkimin e formularit për paraqitje të kërkesës për qasje në dokumente zyrtare.

Freskimi apo pasurimi i ueb-faqes së internetit të Komunës ka ngecje dhe mospërbushje me informata relevante. Ka një trend pozitiv që dokumentet që në të kaluarën nuk kanë qenë të ngarkuara në ueb-faqen të plotësohen tani, por megjithatë ende ka vend për përmirësim. Sa i takon publikimit të buxhetit dhe raporteve financiare në ueb-faqe, kjo ka nevojë për një përmirësim të theksuar. Buxheti për vitin 2014 dhe as Plani Buxhetor për vitin 2015 duke përfshirë këtu edhe Kornizën Afatmesme Buxhetore nuk janë të publikuara në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Shtimes. Rregulloret Komunale, Vendimet e Kuvendit Komunal dhe Procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit Komunal kanë

një gjendje më të mirë publikimi. Gjithashtu edhe dokumente tjera me rëndësi që janë miratuar nga Kuvendi pas muajit Prill nuk janë të publikuara.

Në lidhje me **publikimin e akteve** që vijnë nga ekzekutivi, si vendimet, plani i punës, raportet vjetore të punës, publikimi i njoftimeve për dhënie të kontratave dhe publikimi i kontratave, raportet financiare për 2014 dhe për vitetet tjera të kaluara nuk janë të publikuara në mënyrë kronologjike.

Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i takimeve	Numri	Në rend dite	Pjesëmarrja	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare	11	47	96.02%	96.53%
Komiteti për Politikë dhe Financa	9	36	85.71%	98.21%
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli Komunal Sigurisë në Bashkësi	3		Po	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	9		6 persona	

Llogaridhënia në Komunë

Janë dy momente që mund të cilësohen të ndryshme e që kanë të bëjnë me raportimin apo më mirë nëse themi në komunikimin e Kryetarit të Komunës me qytetarët apo me shoqërinë civile. Sa i takon komunikimit të Kryetarit me qytetarët ai mbanë një ditë në javë (të premteve paradite) të rezervuar për takime dhe bisedime me qytetarë. Derisa, për komunikimin me shoqërinë civile, Kryetari ka një qasje shumë bashkëpunuese, të hapur, mirëprirëse dhe mirënjohëse ndaj iniciativave nga shoqëria civile. Përveç kësaj në çdo trup punues të Kuvendit (komisione të ndryshme) synon të përfshijë përfaqësues nga shoqëria civile.

Ne, në kuadër të disa aktiviteteve të zhvilluara në lidhje me projekt buxhetin e vitit 2015, kemi synuar të krijojmë një bashkëpunim më të ngushtë me kryetarin përmes organizmit të takimeve me qytetarë. Dhe këtu është momenti i dytë, kur ne mendojmë se kryetari ka pasur mundësinë të jetë më afër qytetarëve së paku në disa prej 28 takimeve të organizuara me qytetarë. Prandaj, në këtë pjesë ndajmë një vlerësim tjetër, në lidhje me raportimin apo komunikimin e kryetarit me qytetarë. Edhe pse prezenca e së paku një drejtori komunal (z.Mehdi Salihu), nuk ka munguar pothuajse në asnjë takim të tillë, duke u përgjigjur pozitivisht në secilën kërkesë tonën për pjesëmarrje në takime me qytetarë, kjo si duket nuk ka mjaftuar për qytetarët.

Nga ajo që është vërejtur nga monitoruesit e POLIS, Kryetari dhe udhëheqësit tjerë komunal, kanë shumë pak qasje në media. Ekziston vetëm një radio lokale, por Kryetari apo ndonjë prej drejtorëve nuk ka hapësirë të rezervuar ose që e shfrytëzon vazhdimisht për të komunikuar me qytetarë në formë të rregullt, p.sh. prononcim javor drejtuar qytetarëve. Derisa rreth pjesëmarrjes në mediat televizive nacionale, ajo ndodhë vetëm kur ka ndonjë aktivitet shumë të rëndësishëm që ndodhë në komunë të Shtimes ose që ndërlihet me të. Së fundmi është bërë një përmirësim në përdorimin e mediave sociale.

Sa i përket **raportimit të Kryetarit në Asamble** mund të gjejmë dy forma të këtij raportimi e që rrjedhin nga obligimi i dy ligjeve të ndryshme. Njëri raportim rrjedhë nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale ku në nenin 58 tek Përgjegjësitë e Kryetarit pika j) thotë se kryetari: raporton para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku një herë në gjashtë muaj apo

kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës. Kurse raportimi tjetër rrjedhë nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ku në Nenin 45, Pika 4 thuhet se: Kryetari i komunës duhet të përgatitë dhe t'i dorëzojë kuvendit komunal raporte tremujore të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të tremujorit i cili sapo ka përfunduar.

Në bazë të këtyre dy lloj raportimeve në Komunën e Shtimes gjejmë të praktikuar mirë raportimin financiar periodik. Raportet përgatiten nga zyrtarja kryesore financiare dhe njëherit prezantohen nga kjo zyrtare para asambleistëve. Kryetari ndërhyjnë ose jep shpjegime atëherë kur paraqiten pyetje nga asambleistët. Për sa i takon raportimit së paku një herë në gjashtë muaj ose në bazë të kërkesave nga kuvendi lidhur me gjendjen ekonomiko financiare, këtë nuk e kemi parë të ketë ndodhur. Kjo nuk ka ardhur as si iniciativë e kryetarit dhe as si kërkesë nga kuvendi. Bazuar në këtë, raportimi i Kryetarit në Asamble, ndodhë pothuaj në çdo mbledhje në një ose formë tjetër, dhe përmes raporteve periodike financiare, por raportim duke specifikuar nenin përkatës të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si pjesë e përgjegjësisë të Kryetarit ka vend që të përmirësohet.

Takimet me qytetarë në Komunën e Shtimes lënë shumë për të dëshiruar. Janë shumë faktorë që tregojnë se cilësia e të atyre takimeve është jo e mirë. Konsiderojmë se takimet thirren sa për të u thirrur dhe sa për të përmbushur një obligim ligjor. Kjo ndjehet edhe nga qytetarët, se ato në thelb nuk kanë qëllim të konsultojnë qytetarin para vendimmarrjes, por kanë për qëllim të informojnë qytetarin se çfarë do të vendoset. Nga praktika jonë kemi vërejtur një hezitim të përgjithshëm nga qytetarët për të qenë aktiv në takimet e organizuara nga autoritetet lokale.

Komuna e Shtimes gjatë viti 2014 (janar-tetor) ka mbajtur gjithsej 9 takime me qytetarë ose si referohen ato zyrtarisht diskutime publike. Tri diskutime ka mbajtur në lidhje me tri Projekt Rregullore Komunale, katër diskutime ka mbajtur në lidhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2015-2017, një për Planin Strategjik të Arsimit 2014 -2018 dhe një për Planin Buxhetor 2015, si dhe një tubim publik me qytetarë të mbajtur nga Kryetari i Komunës sipas Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale.

Sa i përket nivelit të **pjesëmarrjes qytetare** të shprehur në shifra afërsisht është 6 qytetarë për takim. Sidomos nëse kësaj i shtojmë një fakt, se shumë nga pjesëmarrësit janë edhe zyrtarë komunal, atëherë është vështirë të bëhet një vijë e qartë ndarëse nëse kanë marrë pjesë si qytetarë apo si zyrtarë. .

Përmbytjet nga lumi dhe Fondi i Emergjencave

Një çështje që kërkon të trajtohet më me prioritet në Komunën e Shtimes janë përmbytjet apo vërshimet që ndodhin si pasojë e të reshurave të shiut dhe më pas dalja nga shtrati i saj lumi *Shtimjanja*. Me këtë problem janë ballafaquar fshatrat e rrafshit, për të cilën ka pasur ngritje shqetësimi të banorëve të asaj ane nga asambleisti Selim Shabani. Me këtë rast është kërkuar mbrojtja e hershme nga vërshimet dhe krijimi i një Fondi të Emergjencave për kompensim dëmi nga fatkeqësitë natyrore.

Kjo problematikë është ngritur si një kërkesë qytetare, pastaj ka zgjuar debat të theksuar në Asamble, duke përfshirë edhe ekzekutivin (Kryetarin e Komunës). Kryetari elaboroi se nuk mund të ketë një vijë buxhetore të tillë, pasi nëse ajo nuk shpenzohet gjatë vitit për këtë destinim atëherë kalon në suficit. Por, sa i përket këtyre rasteve, Kryetari shprehu se drejtorja për shërbime publike dhe zyrtarët nga sektori i bujqësisë kanë dalur në vende të tilla, kanë evidentuar dëmet dhe i kanë përcjellur tek autoritetet qendrore për trajtim të mëtutjeshëm.

Ky elaborim i Kryetarit para asambleistëve i ka bindur se në këtë drejtim mundet shumë pak të bëhet nga buxheti komunal. Kështu që përgjigja e Kuvendit ndaj kërkesës individuale të një qytetari të dëmtuar dërguar Kuvendit për mundësi kompensimi, ishte refuzim i kërkesës

në fjalë, me arsyetimin se nuk ka vijë buxhetore për këtë destimin. Asambleistët votuan njëzëri që kërkesa të refuzohet.

Dhënia në shfrytëzim e pronës komunale për 99 vite

Çështje tjetër që ka nxitur debat më të theksuar është dhënia e pronës komunale në shfrytëzim për palët e interesuara. Dhënia në shfrytëzim dhe këmbimi i pronës komunale është i rregulluar me ligj të veçantë. Megjithatë vlen të përmendet një rast kur një kompani afariste e cila operon në Komunën e Shtimes prej afro 10 vitesh, tani ka bërë kërkesë për vazhdimin e afatit për shfrytëzim për 99 vite, siç e parasheh ligji. Kjo çështje ka nxitur diskutim në Kuvend, pasi disa anëtarë nuk ishin të sigurt për atë që po vendosnin dhe kërkonin të shkohet me një afat më të shkurtër kohor sa i përket dhënies në shfrytëzim të pronës komunale. Ekzekutivi dhe një pjesë e anëtarëve të asamblesë nga pozita, po mbronin qëndrimin se kjo është konform rregullatives ligjore, dhe afati prej 99 vite është një garanci më e madhe për qëndrueshmëri të biznesit dhe kredi investive afatgjate. Pas diskutimeve kjo kërkesë u aprovua me vota të anëtarëve të asamblesë komunale (12 vota, 6 kundër dhe 1 abstenim), me të cilin iu vazhdua afati i shfrytëzimit të pronës komunale për këtë kompani për 99 vite.

Në lidhje me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale vlen të ceket edhe një rast tjetër, e cila praktikë është përsëritur edhe në të kaluarën, edhe pse patëm bërë vërejtje edhe në raportet tona të kaluara. Ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, thekson se propozimin për dhënien në shfrytëzim të një prone komunale e bënë kryetari dhe vendimin për aprovim paraprak e merrë Kuvendi. Në bazë të procedurave ligjore Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, merrë vendim se kush mund të e fitoj atë pronë dhe i propozon Kuvendit për aprovim final. Në këtë rast kërkesa ka ardhur në Asamble në emër të personit (subjekt juridik) se dëshiron të merrë në shfrytëzim pronën e caktuar (të specifikuar në kërkesë) për zhvillim të blegtorisë. Kjo ka shkelur rregullat ligjore. KPF kishte marrë vendim aprovues të kësaj kërkesë (4 vota për dhe 2 kundër), derisa në Asamble kjo kërkesë u refuzua (me 9 vota për dhe 8 kundër), pasi shihej si vendim favorizues. Dhe, me këtë u veprua drejtë pasi kishte mos respektim të procedurave ligjore.

Rekomandimet për Komunë

Zyrës së Kryetarit të Komunës:

- Sa i përket çështjes në lidhje me vërshimet: ne rekomandojmë për kryetarin dy zgjidhje të mundshme: a) që të bëhet zgjerimi i shtratis të lumit *Shtimjana* me ato mjete të planifikuara me buxhet, duke filluar nga pjesa e poshtme e rrjedhës së lumit, pra duke filluar nga fshati Vojnoc dhe b) lidhur me Fondin e Emergjencave, të krijohet një vijë buxhetore e cila do të ishte aktive deri në muajin qershor (kur bëhet rishikimi buxhetor) të çdo viti, për të i ikur suficitit buxhetor.
- Në lidhje me çështjen e pronës së paluajtshme: rekomandojmë që zyra e Kryetarit dhe zyrtarët tjerë përgjegjës mos të propozojnë shpalljen e zonave/pronave me interes vetëm në bazë të kërkesave qytetare, por ato të i iniciojnë në bazë të interesave të Komunës.
- Rekomandimi në lidhje me mjedisin, rekomandojmë Kryetarit që të ndërmerr masa në tre sektorë që shkaktojnë ndotje në ambient: Gurëthyesit - pasi ka qenë edhe premtim i kryetarit; Furrat e Gëlqeres – është veprimtari e theksuar në komunën e Shtimes; Mbeturinat – po thuaj se kudo në fshatra sheh pika të pa kontrolluara dhe kaotike të hedhjes së mbeturinave.
- Të paraqet para anëtarëve të Kuvendit raportet periodike financiare në bazë të nenit 45.4, që thotë se raporti financiar duhet të përmbajë edhe një përmbledhje të statusit të të gjitha projekteve kapitale të shpenzimit dhe të publikoj raportet periodike financiare në faqen e internetit të komunës, në bazë të ligjit për financat publike.
- Kryetari duhet të i kushtoj më shumë kohë takimeve me qytetarë, jo vetëm ato të cilat janë të thirrura në bazë të ligjit. Përveç kësaj takimet me qytetarë duhet të i organizoj në vendbanime të tyre, më mirë se sa të ftohen qytetarët në komunë.
- Për të realizuar buxhetimin me pjesëmarrje Kryetari duhet të mbajë zotimin se gjatë vitit të ardhshëm dhe viteve tjera, do të një shumë buxheti nga investimet kapitale prej 30% të pa destinuar, në mënyrë që ajo të destinohet në bazë të kërkesave qytetare.
- Posa të miratohet Rregullorja Komunale për Zgjedhjen e Kryetarëve të Fshatrave, Kryetarit i rekomandojmë që sa më parë të organizoj zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave dhe Lagjeve.

Kryesuesit të Kuvendit:

- Kryesuesi gjatë menaxhimit të seancave të Kuvendit dhe Komiteteve duhet të ketë parasysh respektimin e Rregullores së Punës. Në shumë raste rregullorja nuk respektohet, sidomos në kalimin e minutazhes së lejuar nga udhëheqësit e grupeve politike në Asamble, nga anëtarët Asamblesë, marrja më shumë se dy herë e fjalës nga asambleistët për të njëjtën çështje, pastaj përdorimi i telefonave në seancë etj.
- Rekomandojmë që Kryesuesi të ndikoj në rritjen e rolit të Kuvendit ndaj ekzekutivit. Sidomos për përgjegjësitë ligjore që i ka Kuvendi. Rasti me themelimin e Komitetit (jo-obligues) për Arsim, kur kjo u propozua nga Kryetari i Komunës gjatë seancës së Kuvendit. Dhe në lidhje me emërimin e anëtarëve të Komiteteve sikur është ai për Arsim, Kryetari mund të jep propozime për anëtarët nga jashtë Kuvendit, por jo t'i jepet e drejta që më pastaj të caktoj emrat. Emrat do të duhej të votoheshin nga Kuvendi.
- Kryesuesi ka një qasje shumë bashkëpunuese, afirmuese dhe mirënjohëse ndaj shoqërisë civile. Ne rekomandojmë fuqishëm Kryesuesin që qasjen e tij ndaj shoqërisë civile të e kultivoj dhe transmetoj edhe tek zyrtarë tjerë komunal, por edhe tek kolegët e tij Kryesues nga Komuna tjera.

- Rekomandojmë Kryesuesin që të kërkoj nga sekretaria e kuvendit që në procesverbale të shënoj edhe emrat e anëtarëve gjatë votimit, pasi kjo nuk jep qartësi në procesverbale se si kanë votuar asambleistët për një çështje, në veçanti nuk dihet për rastet kur një ose më shumë asambleist votojnë kundër ose abstenojnë. Qytetarët do të duhej të dinë se si kanë votuar përfaqësuesit e tyre në asamble.


Asambleistëve të Kuvendit:

- Meqë shumica e asambleistëve janë për herën e parë anëtarë të kuvendit komunal, ne i rekomandojmë që asambleistët të i kushtojnë më shumë kohë shqyrtimit të dokumenteve të Kuvendit para se ato të diskutohen dhe miratohen.
- Asambleistët duhet të e përqendrojnë diskutimin e tyre në bazë të përfaqësimit të qytetarëve në Kuvend përpara se atë partiak. Kemi raste të shumta kur diskutimi rreth një çështjeje orientohet në bazë të qëndrimeve politike partiake (pozitë dhe opozitë), dhe jo rreth substancës që diskutohet.
- Asambleistët duhet të ushtrojnë më shumë rolin e tyre ndërlidhës me qytetarë. Ata duhet të ndërmarrin më shumë nisma apo propozime, qoftë që ndërlidhen me nevoja dhe kërkesa qytetare, qoftë edhe politika të caktuara lokale.
- Asambleistëve të pozitës që të jenë më aktiv në ngritjen e çështjeve dhe bërjen e pyetjeve ndaj vendimeve apo veprimeve të Kuvendit. Nuk iu kërkojmë atyre që të mos mbështesin vendimet e ekzekutivit, vetëm se kur ata kërkojnë më shumë informata nga ekzekutivi, atëherë do të vërehet një konstruktivitet më i theksuar në Kuvend.
- Asamblesitët e opozitës dhe të pozitës duhet të kërkojnë më shumë informata nga zyrtarët e ekzekutivit. Ata e kanë këtë të drejtë me ligj, dhe i rekomandojmë se duhet të kërkojnë informata të veçanta për çdo veprim që ndodhë në Kuvend. Jo vetëm për çështje të përgjithshme si psh. informatë për gjendjen në arsim, ose raport nga zyra e prokurimit, por të kërkojnë informata specifike.
- Rekomandojmë që asamblesitët që të kenë një bashkëpunim më të shtuar me shoqërinë civile. Ndonjëherë të marrin vetë iniciativa për të ftuar shoqërinë civile për të diskutuar një çështje të caktuar. Si dhe të marrin pjesë në sa më shumë takime që organizohen nga shoqëria civile, qoftë me qytetarë apo takime të tjera.

Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
<i>Rregullorja Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjopa për vitin 2014</i>	Miraturar	Pro: 20 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Rregullore mbi Transparencën</i>	Miraturar	Pro: 18 Kundër: 2 Abs: 0
<i>Rregullore për Tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015</i>	Miraturar	Pro: 12 Kundër: 3 Abs: 3
<i>Korniza Afatmesme Buxhetore 2015 – 2017</i>	Miraturar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Plani i Punës së Kuvendit për Vitin 2014</i>	Miraturar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Plani i Punës së Kuvendit për Vitin 2015</i>	Miraturar	Pro: 18 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Plani buxhetor komunal 2015-2017</i>	Miraturar	Pro: 10 Kundër: 8 Abs: 0
<i>Plani strategjik për arsimin në Komunën e Shtimes 2014/15-2018/19</i>	Miraturar	Pro: 18 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Vendim – Për ndarjen e çmimit “Sakrifica e Reçakut 1999” z. Adem Demaçi</i>	Miraturar	Pro: 21 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Vendim – Për përfaqësimin në KPF – 4 anëtarë nga Pozita dhe 3 nga Opozita</i>	Miraturar	Pro: 11 Kundër: 10 Abs: 0
<i>Vendim – Formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa me emra të propozuar</i>	Miraturar	Pro: 21 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Vendim – Për riorganizimin e dhe caktimin e Drejtorive në Komunën e Shtimes</i>	Miraturar	Pro: 18 Kundër: 2 Abs: 1
<i>Vendim – Për themelimin e KKSB-së</i>	Miraturar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 1
<i>Vendim – Për aprovimin e Raportit Financiar të Komunës së Shtimes 2013</i>	Miraturar	Pro: 11 Kundër: 8 Abs: 1
<i>Vendim – Për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale (mandat një vjeçar)</i>	Miraturar	Pro: 20 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Vendim – Për korrigjimin e Vendimit 01-21 për Zgjedhjen e KKSB-së (pas kërkesës nga MAPL)</i>	Miraturar	Pro: 21 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Vendim – Për ndarjen e 25 ari truall për ndërtimin e Objektivit me banim social</i>	Miraturar	Pro: 18 Kundër: 2 Abs: 0
<i>Vendim – Refuzim i dy Listave me Kërkesave (13 kërkesa) në pako, sipas rekomandimit të KPF-së (pa diskutim)</i>	Refuzuar	Pro: 11 Kundër: 8 Abs: 1
<i>Vendim – Për aprovimin e Listës Prioritare të për strehim dhe ndërtim</i>	Miraturar	Pro: 18 Kundër: 1 Abs: 1
<i>Vendim – Për Raportin Financiar Janar – Mars 2014</i>	Miraturar	Pro: 12 Kundër: 7 Abs: 1
<i>Vendim – Për rishikimin e buxhetit të Komunës së Shtimes për vitin 2014</i>	Miraturar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 2
<i>Vendim – Për Raportin Financiar Janar – Qershor 2014</i>	Miraturar	Pro: 10 Kundër: 8 Abs: 1
<i>Vendim – Për kërkesën e z. Fisnik Sejdiu, Kompania Bageri 1, për shfrytëzimin e pronës komunale për gurore</i>	Refuzuar	Pro: 18 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Vendim – Për kërkesën e z.Bujar Shabani, Kompania Bageri 1, për shfrytëzimin e pronës komunale për gurore</i>	Refuzuar	Pro: 18 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Vendim – Për kërkesën e Zyrës së Kryetarit për</i>	Refuzuar	Pro: 8 Kundër: 9 Abs: 0


<i>shpalljen me interes të veçantë zonën me ngastër kadastrale 02666-3</i>		
<i>Vendim – Për vazhdimin e afatit për 99 vjet për shfrytëzim të pronës komunale në Zonën Ekonomike në sipërfaqe prej 0.70 ha, Kompanisë Etlinger</i>	Miratuan	Pro: 12 Kundër: 6 Abs: 1




Komuna Viti



Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



10.Komuna VITI

Vlerësimi i Përgjithshëm

Çfarë e karakterizojë komunën këtë vit

Përbërja e re e Kuvendi Komunal të Vitisë, e dalë nga zgjedhjet e lokale të 03 nëntorit 2013, është konstituuar më 20 dhjetor 2013. Kryesia e Kuvendit Komunal, është zgjedhur më 13 janar 2014, ku në pozitën e kryesuesit të KK-së u zgjodh Naim Piraj nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Në bazë të rezultateve zgjedhore, përbëhej nga këto subjekte politike, LDK me 9 këshilltarë, PDK me 6, Vetëvendosje me 5 , AAK me 5, AKR me 1 këshilltarë dhe Ekrem Abazi si këshilltarë i pavarur. Mbi bazën e përfaqësimit të subjekteve politike në kuvend u zgjodhën edhe komitet obligative, ku në Komitetin për Politikë dhe Financa LDK u përfaqësua me 2 anëtarë dhe kryesuesin e KK-së, PDK me 2, AAK e VV me nga 1 anëtarë. Kurse, në Komitetin për Komunitete, VV e AAK me nga 1 anëtarë, dhe 3 anëtarë nga radhët e komunitetin serb, kroat dhe atij Romë e Ashkali.

Karakteristika të KK-së së Vitisë, gjatë vitit 2014, në aspektin pozitiv të funksionimit ishin: Themelimi me kohë i komiteteve të përhershme dhe jo obligative, si dhe inicimi i procedurës për themelimin e dy këshillave konsultativ; Zbatim më i mirë i rregullores së punës së KK-së në aspektin teknik dhe përmbajtësor duke filluar nga caktimi i orarit të seancave, shpërndarja e materialeve, fillimi me kohë i seancave, respektimi i rregullores për sa i përket përdorimit të telefonave, kohëzgjatjes së diskutimeve për pikat e rendit të ditës, ndërhyrjeve të kryesuesit në fjalën e këshilltarëve komunal, replikat etj.

Karakteristika të KK-së së Vitisë, gjatë vitit 2014, në aspektin negativ të funksionimit ishin : Lëvizjet e këshilltarëve nga një grup i këshilltarëve në grupin tjetër, veprim ky që krijoi situata që ç' rregulluan përbërjen dhe punën e KK-së dhe të komiteteve obligative, e ku për shkak të kësaj në disa raste patëm bojkot të punës në KK nga këshilltar të PDK-së dhe të VV-së ; mos funksionalizimi i komiteteve jo obligative të themeluara nga kuvendi, mungesa e interesimit të shumicës së këshilltarëve komunal që të jenë pjesë e takimeve publike për buxhet të organizuara nëpër lokalitete të ndryshme etj.

B. Problemet kryesore të komunës

Problemet më të theksuara të Komunës së Vitisë, gjatë vitit 2014 ishin :

- Borxhet e trashëguara nga vitet paraprake – Komuna e Vitisë nga vitet paraprake ka trashëguar borxhe në shumë prej mbi 291 mijë e 976 euro. Këto borxhe kanë ndikuar në realizimin e projekteve kapitale të nisura më herët si ato që kanë të bëjnë me rregullimin e rrjeteve të ujësjellësit, shkollave dhe kanalizimeve nëpër fshatra.
- Planifikimi jo i drejtë i buxhetit komunal për vitin 2014 – Planifikimi i buxhetit për vitin 2014, mbi baza jo reale, ka ndikuar që projektet me afat dy vjeçar si kanalizimi në Tërpezë dhe Smirë, si dhe projektet e planifikuara mbi baza jo reale të tregut, të ndikojnë në ngecje në kohë në realizimit të këtyre projekteve, si dhe të shtyjnë Kuvendin Komunal që në rishikimin e buxhetit të miratoi vendimin mbi bazën e të cilit Komuna e Vitisë vendosë që 568 mijë euro të planifikuara për projekte kapitale ta ri destinon në projekte tjera.
- Vonesat në ekzekutimin e buxhetit komunal të planifikuar për investime kapitale– Vonesa e Qeverisë së Kosovës , për miratimin e vendimit të KK-së së Vitisë për rishikim të buxhetit të vitit 2014, të miratuar në korrik , ka ndikuar në trendin e realizimit të projekteve kapitale. Shkaku i kësaj vonese Komuna e Vitisë , gjatë

periudhës janar – shtator 2014, ka realizuar vetëm 33.33 përqind të buxhetit të planifikuar për investime kapitale. Koha e shkurtër e mbetur deri në fund vit, për shpenzimin e buxhetit për investime kapitale rrezikon që mjetet e dedikuara për këtë kategori të shkojnë në suficit, apo që projektet të cilat realizohen të mos jenë në cilësi të duhur shkaku i ngutisë për të kryer punët.

- Shkurtime të buxhetit për investime kapitale – Si pasojë e vendimit të qeverisë së Kosovës, për ngritje të pagave të shërbyesve civil, buxheti për investime kapitale në Komunën e Vitisë për vitin 2015, është shkurtuar për rreth 200 mijë euro.
- Mungesa e një fondi për emergjencë – Komuna e Vitisë, është një nga rajonet më të goditura nga vërshimet, gjë që ndikon që fermerët e kësaj komune çdo vit të pësojnë dëme të mëdha në kulturat e tyre bujqësore. Në vitin 2014, si pasojë e vërshimeve fermerët e Vitisë, kanë pësuar dëme në shumë prej mbi 197 mijë euro, shumë kjo që mbetet e pa kompensuar shkaku i mungesës së fondit komunal për emergjencë.

C. Të arriturat në vitin 2014

Komuna e Vitisë e para në raportin vlerësues të Indeksit të Konkurrencës në Kosovë

Të arriturat më të mëdha të komunës së Vitisë, gjatë vitit 2014 janë:

- **Raporti në nivel të Kosovës për Indeksin e Konkurrencës (IKK)** – Komuna e Vitisë është renditur e para në Raportin për Indeksin e Konkurrencës në Komuna 2014, i publikuar nga UBO Consulting. Rezultatet IKK 2014 tregojnë një përmirësim të mjedisit biznesor më gradual, por njëkohësisht edhe më të shpërndarë. Këtë vit, komuna e Vitisë gjendet në krye të renditjes, e përcjellur afër nga Lipjani dhe Vushtrria. Në fakt, diferencat në mes të rezultateve të këtyre tri komunave këtë vit janë shumë të vogla. Gjakova, Dragashi, dhe Kaçaniku vazhdojnë të shënojnë performancë të mire këtë vit poashtu, deri sa komunat në veri të Leposaviqit, Zubin Potokut, dhe Zveçanit, krahasimisht, mbesin ulët në cilësinë e mjedisit të tyre biznesor. Gjatë rishikimit të performances komunale për katër vitet e fundit, Vushtrria ka bërë përmirësimin më të madh në mjedisin e vet biznesor. Vitia, Shtërpca, dhe Lipjani vijnë më pas si komuna me përmirësim më të madh për katër vitet e kaluara. Në rrumbullakësimin e listës së pesë reformatoreve gjendet Peja, e cila edhe pse në vitin 2011 ka filluar prej një niveli të ulët të performancës, ka treguar një përmirësim të konsiderueshëm gjatë periudhës së shkuar katër vjeçare (<http://www.uboconsulting.com/indexalb.html>)
- **Nënshkrimi i marrëveshjes mes Komunës së Vitisë dhe Institut për Shëndetin Publik të Kosovës, për analiza bakteriologjike dhe kimike të ujit të pijes në shkolla dhe institucione tjera publike** – Kjo marrëveshje mes Komunës së Vitisë dhe Institutit të Shëndetit Publik, erdhi si rezultat i fushatës avokuese të OJQ ELITA në mbështetje të Institutit Kosovar për Demokraci KDI për zgjidhjen e problemit të ujit të pijes në shkollat e Komunës së Vitisë.

D. Vlerësimi për performancë në transparencë

Kryetari i Komunës së Vitisë, ka pas një performancë në nivel të kënaqshëm, për sa i përket transparencës në punë. Pos takimeve të rregullta me palë, kryetari Haliti, ju ka përmbajt ligjit për sa i përket takimeve publike me qytetarë, ka organizuar konferenca të rregullta për media, ka organizuar takime të përbashkëta me përfaqësues të partive politike dhe shoqërisë civile si dhe grupe tjera të interesit, ka iniciuar memorandumën e bashkëpunimit me shoqërinë civile që ajo të jetë prezentë në hapjen e ofertave për përzgjedhjen e kompanive punë kryese në realizimin e projekteve kapitale etj.

Drejtorët e drejtorive komunale me iniciativë të kryetarit të komunës, me qëllim të ngritjes së transparencës, ishin të obliguar që të mbajnë konferenca të rregullta për media ku kanë raportuar për punën dhe planet në drejtoritë që udhëheqin. Si më të dalluarat për performancën e treguar në transparencë dhe në punë ishin drejtoria për ekonomi, drejtoria për arsim dhe ajo drejtoria për kulturë rini e sport.

Këshilltarët komunal varësisht prej subjektit që i takonin, rolit që kishin në kuvend, si dhe përvojës në punë, kanë dhënë edhe performancën e tyre në transparencë dhe në punë. Problem i pjesës dërmuese të këshilltarëve komunal në performancën e tyre vazhdon të mbetet praktika e shkëputjes së tyre nga baza zgjedhore, pasi pjesa më e madhe e këshilltarëve komunal nuk janë aktiv në takimet publike me qytetarë, nuk mbajnë kontakte të rregullta me votues, nuk i kanë funksionalizuar komitetet jo obligative ku ishin të zgjedhur, si dhe nuk marrin pjesë në takimet që organizohen nga shoqëria civile e ku adresohen çështje me interes të përgjithshëm.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, ka pas një performancë të kënaqshme për sa i përket transparencës dhe performancës në punë. Ishte bashkëpunues me gjitha grupet e këshilltarëve si dhe me shoqërinë civile, ka marr parsh rekomandimet e më hershme të KDI-së për përmirësimin e punës në kuvend, ju ka përmbajtur planit për organizimin e seancave të rregullta dhe të jashtëzakonshme të kuvendit, ka iniciuar themelimin e këshillave konsultative, etj.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Zbatim të ligjit dhe rregulloreve për raportim në Kuvendin Komunal dhe para qytetarëve	Realizuar
2	Organizimi i takimeve me shoqërinë civile dhe me qytetarë nëpër lokalitetet e komunës	Realizuar
3	Pavarësimi i shkollës së mesme në Pozheran	Realizuar
4.	Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore	Realizuar
5.	Zgjerimi i hapësirave të gjelbëruara në Viti dhe fshatra	Realizuar
6.	Ndërtimi i fushave të vogla sportive në shumicën e fshatrave	Realizuar
7.	Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në fshatin Beguncë	Planifikuar me buxhet
8.	Rregullimi i sistemit të ujësjellësit në Viti	Planifikuar me buxhet
9.	Rregullimi i shtratit të lumit Morava	Pjesërisht
10.	Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Pozheran	Realizuar
11.	Ndërtimi i palestrës sportive në Viti	Planifikuar me buxhet pamjaftueshëm
12.	Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në fshatin Pozheran	Planifikuar me buxhet pamjaftueshëm
13.	Zhvillimi ekonomik dhe zbutja e papunësisë	Pa u realizuar
14.	Hapja e zyrës për diasporë dhe tërheqje të investimeve	Pa u realizuar

Transparenca në Komunë

Zyra e kryetarit të Komunës dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa e Komunës së Vitisë, në baza tre mujore ka raportuar para Kuvendit Komunal pasqyrat financiare për shpenzimet dhe të hyrat e buxhetit komunal. Pasqyrat financiare të raportuar nga kjo drejtori janë përgatitur në format të thjeshtë dhe të kuptueshëm për këshilltarët dhe në këto pasqyra, drejtoria ka prezantuar të dhënat për buxhetin e planifikuar, buxhetin e flokuar si dhe buxhetin e shpenzuar për periudhën raportuese, për zyrën e kryetarit, drejtoritë komunale, kuvendin komunal si dhe zyrën për komunitete. Po ashtu janë pasqyruar edhe shpenzimet e buxhetit komunal për investimet kapitale si dhe projektet e realizuara. Në periudhën gjashtëmujore janë pasqyruar në mënyrë të detajuar edhe shpenzimet për dreka zyrtare. Pasqyrat financiare kanë përmbajtur edhe krahasimin e shpenzimeve të buxhetit komunal mes këtij viti dhe vitit të kaluar, si dhe të dhënat mbi të hyrat vetanake me të dhëna krahasuese rreth shkallës së realizimit me vitet paraprahe. Këto pasqyra në vija të trasha janë prezantuar edhe para qytetarëve në takimet publike me qytetarë të kryetarit të komunës, si dhe në takimet me qytetarë gjatë procesit të planifikimit të buxhetit komunal për vitin 2015.

Kuvendi Komunal i Vitisë, 2-7 ditë para seancave plenare, përmes faqes zyrtare të internetit ka njoftuar qytetarët për datën, kohën, vendin dhe rendin e ditës së këtyre seancave. Por, njoftimi publik për seancat e kuvendit komunal, nuk është bërë edhe përmes tabelave publike të vendosura për këto çështje në lokalitetet e Komunës së Vitisë, si dhe në mediat lokale. Gjithashtu KK, në faqen zyrtare të internetit ka publikuar të gjitha vendimet dhe rregulloret e miratuara. Por problem mbetet diskutimi publik i rregulloreve dhe vendimeve që janë me interes për qytetarë, pasi në përjashtim të rregulloreve për vullnetarizëm dhe asaj për organizimin e transportit, si dhe draft buxheti komunal, rregulloret apo vendimet tjera nuk kanë dalë në diskutim publik ose së paku qytetarët nuk kanë qenë të njoftuar për këto rregullore apo vendime.

Kuvendi Komunal i Vitisë, në bazë të udhëzimit administrativ për organizimin dhe funksionimin e komiteteve konsultative në komuna me numër 2008/10 të MAPL-së, ka formuar dy komiteteve konsultative, komitetin për pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrje dhe komitetin për persona me nevoja të veçanta. Këto komitete që përbëhen nga përfaqësues të shoqërisë civile, janë në proces të hartimit të planeve të punës, dhe deri më tani nuk kanë iniciuar ndonjë çështje për zgjidhje në Kuvendin Komunal.

Komuna e Vitisë, ka të angazhuar zyrtarin komunal për ofrimin e shërbimeve për qasjen e qytetarëve në dokumentet zyrtare. Kjo i ka mundësuar qytetarëve dhe grupeve tjera të interesuara për qasje në dokumente zyrtare të vijnë më lehtë tek kërkesa dhe marrja e përgjigjes nga komuna. Në vitin 2014, qasje në dokumentet zyrtare në komunën e Vitisë, kanë kërkuar 17 palë të interesuar si OJQ, këshilltarë komunal, parti politike dhe qytetarë. Kërkesat e tyre kryesisht kishin të bënin me vendimet e komunës rreth konkurseve për punësim, ndarje të subvencioneve, shpenzimeve të buxhetit komunal, borxhet e trashëguara, rregulloret komunale etj. Gjitha këto kërkesa kanë marrë përgjigjeje me shkrim apo gojë nga komuna.

Faqja zyrtare e internetit e Komunës së Vitisë (<https://kk.rks-gov.net/viti/>), përmban të dhënat kryesore për komunë, shërbimet që ofron komuna, si dhe shënimet tjera që kanë të bëjnë me konkurset dhe shpalljet publike, lajmet ditore, rregulloret, vendimet, statutin e komunës, buxhetin, pasqyruar e shpenzimeve të buxhetit komunal dhe të dhëna tjera me rëndësi. Pjesa dërmuese e këtyre të dhënave freskohen rregullisht. Përparësi për sa i përket freskimit të faqes zyrtare të internetit këtë vit është mundësia e qytetarëve që seancat e Kuvendit Komunal ti përcjellin edhe përmes incizimeve në video-xhirime dhe mundësia që të informohen edhe përmes llogarisë së komunës që është hapur në rrjetin social Facebook. Mangësitë në freskimin me të dhëna në faqen zyrtare të internetit vërehen tek të dhënat që

kanë të bëjnë me prokurimin publik, investimet kapitale, procesverbalet apo minutat e diskutimeve në mbledhjet e Kuvendit Komunal si dhe raportet e kryetarit të prezantuar para kuvendit komunal.

Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i takimeve	Numri	Në rend dite	Pjesëmarrja	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare	10	44	93.57 %	31.36 %
Komiteti për Politikë dhe Financa	9	41	95.23 %	14.28 %
		Gjithsej Takime	Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli Komunal Sigurisë në Bashkësi	4		PO	
		Gjithsej	Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	16		35 PERSONA	
Takimet me publikun	Numri		Pika në Rend dite	

Llogaridhënia në Komunë

Kryetari i Komunës së Vitisë, z. Sokol Haliti si dhe drejtorët komunal , ju kanë përmbajtur ligjit për sa i përket raportimit të punës së tij para qytetarëve, pasi në fund të periudhës gjashtëmujore ka organizuar takimin publik me qytetarë , ku ka prezantuar raportin e punës për gjatë periudhës gjashtëmujore në komunë.

Kurse, sa i përket raporteve më shoqërinë civile, kryetari i komunës dhe drejtorët komunal, kanë mbajtur takime të herëpashershme me përfaqësues të shoqërisë civile, u kanë mundësuar përfaqësuesve të shoqërisë civile pjesëmarrje në këshilla apo komisione të ndryshme, si dhe kanë iniciuar memorandumit e bashkëpunimit me shoqërinë civile për monitorimin e punës në zyrën e prokurimit publik gjatë procesit të përzgjedhjes së kompanive punë kryese që kontraktohen nga komuna.

Kryetari i Komunës si dhe drejtorët komunal, kanë organizuar konferenca të rregullta për media ku kanë prezantuar punën e tyre. Komuna së fundmi ka emëruar edhe zëdhënësin e saj për të mbajtur kontaktet me mediat.

Kryetari i komunës, ka prezantuar raportin gjashtëmujor të punës së tij dhe drejtorive në Kuvendin Komunal. Ai gjithashtu ishte prezent në shumicën e kohës së seancave plenare të kuvendit komunal, ku u është përgjigjur pyetjeve dhe interesimeve të këshilltarëve komunal për çështje të ndryshme.

Zyra e kryetarit të komunës dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, në procesin e planifikimit të Kornizës Afatmesme buxhetore 2015-2017, ka zhvilluar 14 dëgjime publike me qytetarë të lokaliteteve të ndryshme , si dhe grupe të ndryshme të interesit. Aspekti pozitiv i këtyre dëgjimeve ishte: shtrirja territoriale e organizmit të takimeve publike me qytetarë , që ka ndikuar në përfshirjen e qytetarëve në hartimin e listës së projekteve për investime kapitale; gatishmëria e komunës që në listën e investimeve kapitale të përfshijë projektet që propozohen nga komuniteti; organizimi i debateve edhe me grupet e marginalizuar në shoqëri si ai për persona me aftësi të kufizuara, minoritete dhe me gratë; gatishmëria e komunës që të marr parasysh shqetësimet e qytetarëve për sa i përket rritjes së cilësisë së investimeve kapitale; mbulueshmëria e mirë mediale e debateve publike për buxhet. Kurse , mangësitë e debateve publike me qytetarë ishin :Pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në debate mesatarisht 20 qytetarë për debat: Mospjesëmarrja e femrave në

debate publike për buxhet në lokalitete; mos interesimi i këshilltarëve komunal që të jenë pjesë e debateve publike edhe në lokalitetet prej nga vijnë.

Borxhet e trashëguara

Borxhet e trashëguara nga vitet paraprake – Komuna e Vitisë nga vitet paraprake ka trashëguar borxhe në shumë prej mbi 291 mijë e 976 euro. Këto borxhe kanë ndikuar në realizimin e projekteve kapitale të nisura më herët si ato që kanë të bëjnë me rregullimin e rrjetit të ujësjellësit për fshatrat Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Poshtme, Tërstenik, Sadovinë e Jerlive, Sadovinë e Muhagjerëve, Gërmovë e Goshicë, ku parashihej edhe participimi i komunës ashtu edhe projektet që kanë të bëjnë me ndërtimin e shkollave në Sllatinë të Epërme dhe Ballancë, si dhe faza e dytë e kanalizimeve në fshatrat Smirë e Tërpezë. Për zgjidhjen e problemit me borxhet e trashëguara, udhëheqja komunale ka vendosur masat e kursimit të shpenzimeve komunale në telefoni mobile, dreka zyrtare dhe në kategori tjera të shpenzimeve në mallra dhe shërbime. Kryetari për tejkalimin e këtij problemi ka arritur që të nënshkruaj një marrëveshje me Zyrën zvicerane për bashkëpunim dhe zhvillim, për bashkëfinancim të projekteve që kanë të bëjnë me shtrirjen e rrjeteve të ujësjellësit në disa lokalitete të Komunës së Vitisë, ku parashihet investimi prej mbi 760 mijë euro nga qeveria zvicerane dhe rreth 300 mijë euro nga komuna. Me këtë marrëveshje është mundësuar financimi i projekteve të ujësjellësit në Smirë dhe Verban, mjete këto të planifikuara nga buxheti komunal e që me vendim për ridesnim të mjeteve të buxhetit komunal kanë kaluar në financimin e projekteve të mbetura në gjysmë dhe në mbulimin e borxheve që komuna ka trashëguar nga vitet paraprake. Kuvendi Komunal është marrë me këtë problematik dhe krahas debatit për borxhet, kuvendi ka miratuar vendimin për ri destinim të mjeteve me të cilat janë mbuluar një pjesë e borxheve të trashëguara. Ky vendim është miratuar me 19 vota pro, 2 abstenime dhe 5 kundër. Pas vendimit të KK-së dhe veprimeve të marrura nga komuna, shumica e borxheve që është paguar është 268 mijë euro.

Rreziqet nga vërshimet

Komuna e Vitisë është një nga rajonet më të goditura nga vërshimet, gjë që ndikon që fermerët e kësaj komune çdo vit të pësojnë dëme të mëdha në kulturat e tyre bujqësore. Në vitin 2014, si pasojë e vërshimeve fermerët e Vitisë, kanë pësuar dëme në shumë prej mbi 197 mijë e 865 euro. Kryetari i komunës problemin e vërshimeve nga lumi Morava dhe përroskat tjera, e kishte vendosë si prioritet dhe ishte një nga premtimet e tija zgjedhore për banorët e zonave që atakohen nga këto vërshime. Për zgjidhjen e këtij problemi Komuna e Vitisë, ka hartuar një projekt detal që kap shumën prej mbi një milion euro, dhe me këtë projekt ka konkurruar tek Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë. Kurse, deri në sigurimin e fondeve nga donatorët, komuna në bashkëpunim me këshillat e fshatrave dhe kompanitë private, muajin tetor 2014, ka ndërmarrë një aksion të gjerë pastrimi të shtratit të lumit Morava. Problemi i vërshimeve disa herë është ngritur edhe si çështje në Kuvendin Komunal, ku këshilltarët komunal kanë adresuar shqetësimet e qytetarëve rreth këtij problemi duke kërkuar nga udhëheqja komunale që të ndërmarrë veprime konkrete në drejtim të zgjidhjes së këtij problemi. Ky problem është adresuar edhe nga qytetarët e vendbanimeve Budrikë, Radivojc, Skifterakj, Remnik si dhe lokalitete tjera të cilët në takimet publike të komunës me qytetarë e adresojnë si një nga çështjet që komuna duhet ta trajtojë me prioritet.

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës

- Rritja e kontrollit financiar rreth shpenzimeve të buxhetit komunal – Kryetari i komunës, duhet të shtoi kontrollin financiar rreth shpenzimeve të buxhetit komunal, në mënyrë që të ndërpresë praktikën e borxheve që trashëgojen, vit pas viti.
- Zbatimi i rekomandimeve që dalin nga raporti i auditorit gjeneral – Kryetari i komunës, duhet të insistoi që shërbimet e komunës të zbatojnë rekomandimet që dalin nga auditivi gjeneral i komunës, pasi kjo i ndihmon komunës në mbikëqyrje më të madhe të shpenzimeve të buxhetit komunal.
- Realizimi i projektit për rregullimin e shtratit të lumit Morava dhe përroskave tjera- Kryetari i komunës duhet ta vendosë në listën e projekteve më me prioritet rregullimin e shtratit të lumit Morava dhe përroskave tjera, pasi ky projekt mundëson parandalimin e problemit të vërshimeve dhe zvogëlimin e dëmeve për fermerët, si dhe zhvillimin ekonomik të komunës.
- Hapja dhe funksionalizimi i zyrës komunale për diasporë dhe tërheqje të investimeve – Kryetari i komunës duhet të ndërmarrë veprime konkrete për krijimin e kushteve për hapjen e zyrës komunale për tërheqje të investimeve, pasi kjo zyrë do të jetë shtytëse e realizimit të projekteve që ndihmojnë në zhvillimin ekonomik dhe në uljen e shkallës së papunësisë në komunë
- Funksionalizimi i punkteve shëndetësore në fshatra – Kryetari i komunës duhet të krijoj kushte që ambulancat ekzistuese në fshatra të jenë funksionale me mjek dhe staf teknik të përhershëm, pasi kjo ndihmon në ofrimin e shërbimeve shëndetësore më afër qytetarëve.
- Ndërtimi i objekteve shkollore në Pozheran e Beguncë – Kryetari i komunës duhet të angazhohet në sigurimin e fondeve që sa më shpejt të jetë e mundur të realizoi projektet për ndërtimin e objekteve shkollore në Pozheran e Beguncë, pasi këto shkolla as për së afërmi nuk i plotësojnë kushtet për procesin edukativo-arsimor.
- Zbatimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave - Kryetari i komunës, duhet të angazhohet që të zbatoi planin për menaxhim të mbeturinave të hartuar nga Projekti LOGOS i qeverisë zvicerane dhe i miratuar nga Kuvendi Komunal në vitin 2012. Zbatimi i këtij plani i mundëson komunës mjedis më të pastër jo vetëm në qytetin e Vitisë por edhe në fshatra.
- Publikimi në ueb sajtin zyrtar të njoftimeve, shpalljeve dhe kontratave të tenderëve , si dhe lisën e investimeve kapitale–Kryetari i komunës duhet të angazhohet që në faqen zyrtare të komunës, të bëjë publike gjitha shpalljet, njoftimet dhe kontrata që komuna lidhë me operatorë të ndryshëm për investime kapitale. Gjithashtu në faqen e internetit duhet të publikohen edhe listat e projekteve të investimeve kapitale që janë realizuar apo që janë në realizim e sipër.

Kryesuesin e Kuvendit Komunal

- Informimi i qytetarëve për seancat e Kuvendit Komunal – Kryesuesi i Kuvendit Komunal, duhet të angazhohet që përmes drejtorisë së administratës komunale, të siguroi një mirëmbajtje më të mirë të tabelave për njoftime publike në lokalitete, dhe këto tabela të përdoren për njoftimin e rregullt të qytetarëve rreth orarit të seancave, vendimeve dhe rregulloreve dhe akteve tjera që miratohen në Kuvendin Komunal. Kjo i

siguron kryesuesit një pjesëmarrje më aktive të qytetarëve në seanca, si dhe transparencë në miratimin e vendimeve dhe rregulloreve në kuvend.

- Diskutimi publik i rregulloreve dhe vendimeve që janë në interes të qytetarëve – Kryesuesi i Kuvendit Komunal, duhet të insistoi që gjitha drejtoritë të cilat propozojnë rregullore apo vendime që janë në interes të përgjithshëm publik, këto akte juridike paraprakisht ti diskutojnë me qytetarët apo grupet e interesit. Kjo siguron zbatim më efektiv të rregulloreve dhe vendimeve të Kuvendit Komunal.
- Funksionalizimi i komiteteve jo obligative – Kryesuesi i Kuvendit Komunal duhet të insistoi tek subjektet politike që ato të angazhohen më tepër për funksionalizmin e komiteteve jo obligative, pasi praktika e deri tanishme ka treguar se këto komitete zakonisht mbesin vetëm në letër. Funksionalizimi i këtyre komiteteve siguron efikasitet më të madh në punën e kuvendit komunal me rastin e miratimi të akteve nënligjore.


Anëtarët e Kuvendit

- Ngritja e efikasitetit në punë e këshilltarëve komunal – Këshilltarët komunal si nga radhët e pozitës ashtu edhe opozitës, duhet që para çdo seance të konsultojnë mirë materialin dhe të jenë më të përgatitur për diskutime në kuadër të rendit të ditës, pasi praktika e deritanishme ka treguar se shumica e këshilltarëve pak e konsultojnë materialin dhe janë pasiv në seancat e kuvendit komunal. Kjo u ndihmon këshilltarëve komunal që të përfaqësojnë më drejtë votuesit e tyre.
- Respektimi i rregullores së punës së Kuvendit Komunal – Këshilltarët komunal duhet ta jenë më të përgjegjshëm në respektimin e rregullores së punës së KK-së, ku janë të përshkruara qartë rregullat e sjelljes dhe diskutimeve në seanca të kuvendit komunal, për sa i përket shfrytëzimit të telefonave mobile, daljes dhe hyrjes në seancë, kohëzgjatjes së diskutimeve dhe replikave etj. . Kjo mundëson seanca më efikase të kuvendit komunal dhe një pasqyrë më reprezentative të Kuvendit Komunal para qytetarëve.
- Kontaktet e rregullta me bazën – Këshilltarët komunal, duhet të jenë më aktiv në takime publike me qytetarë që organizohen nga komuna apo shoqëria civile, pasi kjo u ndihmon atyre që të identifikojnë më drejtë nevojat e qytetarëve dhe që ato ti iniciojnë për zgjidhje në kuvendin komunal.



Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi		
Vendimi për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit Komunal	Miraturar	Pro:17	Kundër: 6	Abs: 3
Vendimi për formimin e Komitetit për Politik dhe Financa	Miraturar	Pro: 26 0	Kundër : 0	Abs.: 0
Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete	Miraturar	Pro: 26 0	Kundër : 0	Abs.: 0
Vendimi për themelimin e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi	Miraturar	Pro: 21 0	Kundër : 6	Abs.: 0
Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtatores së dëshmorit Rashit Mustafa-Komandant Kardaku	Miraturar	Pro: 21 0	Kundër : 6	Abs.: 0
Pasqyrat Financiare për buxhetin komunal në periudhën kohore Janar – Dhjetor 2013	Miraturar	Nuk votohen		
Vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2013 në vitin 2014	Miraturar	Pro: 27 0	Kundër : 0	Abs.: 0
Ndryshimi dhe plotësimi i rregullores së punës së Kuvendit Komunal të Vitisë	Miraturar	Pro: 17 5	Kundër : 0	Abs.: 0
Ndryshimi dhe plotësimi i rregullores për transparencë	Miraturar	Pro: 22 5	Kundër : 0	Abs.: 0
Vendimi për dhënien e pëlqimit për kompaninë private Eco inzhiniering, për hulumtime në fushën e energjisë	Miraturar	Pro: 27 0	Kundër : 0	Abs.: 0
Vendimi për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë	Miraturar	Pro: 24 2	Kundër : 0	Abs.: 0
Plani i Punës së Kuvendit të Komunës	Miraturar	Pro: 26 0	Kundër : 0	Abs.: 0
Rregullore për organizimin e transportit 119renda territorit të Komunës së Vitisë	Aprovuar	Pro: 27 0	Kundër : 0	Abs.: 0
Pasqyrat financiare për periudhën Janar – Mars 2014	Shqyrtuar	Nuk votohen		
Vendimi për formimin e Komiteteve Konsultative	Miraturar	Pro: 24 0	Kundër : 0	Abs.: 0
Vendimi për formimin e jo obligative.	Miraturar	Pro: 24 0	Kundër : 0	Abs.: 0
Vendimi për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve në Komunën e Vitisë	Miraturar	Pro: 24 0	Kundër : 0	Abs.: 0
Vendimi për shpalljen e 119rend me 119renda119t ë përgjithshëm, ngastra kadastrale nr.823/0, zona kadastrale në Ramjan	Miraturar	Pro: 19 5	Kundër : 0	Abs.: 0
Vendimi për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim	Miraturar	Pro: 22 0	Kundër : 0	Abs.: 0
Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Kompanisë Publike për furnizim me energji KEDS	Miraturar	Pro: 22 0	Kundër : 0	Abs.: 0
Vendimi për këmbimin e pronës komunale parcela numër 3624-1, me parcelën me numër	Miraturar	Pro: 22 0	Kundër : 0	Abs.: 0

3392-5 dhe numër 3392-3 në pronë private		
Rregullore komunale për organizimin e transportit 12orenda territorit të Komunës së Vitisë	Miratur	Pro: 23 Kundër : 0 Abs.: 0



Komuna Malishevë



11. Komuna MALISHEVË

Vlerësimi i Përgjithshëm

Çfarë e karakterizojë komunën këtë vit

Në zgjedhjet lokale të vitit 2013 Iniciativa Qytetare për Malishevën (IQM) del si subjekti politik më i fuqishëm për Kuvendin e Komunës së Malishevës, fuqi kjo që e bëri këtë subjekt që të vendos që mos të hyjë në koalicion me asnjë parti tjetër politike dhe përbërja e ekzekutivit të jetë po nga kjo parti. Veprim ky i cili u reflektua edhe në përbërjen e Kuvendit i cili i ka gjithsejtë 31 anëtarë, ku për herë të parë Kuvendi i komunës së Malishevës u përbë nga shumica opozitare me 20 anëtarë (PDK 8, LDK 8, LVV 2, AAK 1, dhe AKR-ja 1), ndërsa IQM-ja si parti qeverisëse me 11 anëtarë.

Kjo karakteristik bëri që në të shumtën e rasteve agjendat e qeverisë komunale dhe vendimet për çështjet e ndryshme të imponoheshin nga opozita, si dhe ka pas raste kur edhe janë ndërprerë (bojkotuar) mbledhjet e Kuvendit për arsye të mungesës së kuorumit. Mungesa e gatishmërisë së opozitës për të qenë pjesë e punimeve të seancës në zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës gati sa nuk e qoi në zgjedhje të reja këtë për Kuvendin e Komunës së Malishevës. Po ashtu ajo që e ka karakterizuar këtë vit Kuvendin e komunës së Malishevës ka qenë edhe acarimi i shpeshtë në mes të anëtarëve të Kuvendit qoftë me kryesuesin, kryetarin e komunës, drejtorët apo edhe në mes tyre.

Çështje mjaftë shqetësuese ka qenë edhe mos krijimi i kushteve adekuate për përcjelljen e seancave si nga qytetarët e interesuar, OJQ-të e po ashtu edhe nga drejtorët e ekzekutivit të cilët shpeshherë në mungesë të ulëseve në sallë për kohë të caktuar kanë vazhduar të qëndrojnë në këmbë për kohë të caktuar, deri në ardhjen e ulëseve nga zyre tjera. Kryesuesi i Kuvendit, por edhe kryetari i komunës duhet të mendojnë seriozisht për marrjen e masave në mënyrë që të evitohet ky problem i cili do të ndikonte drejtpërsëdrejti edhe në përmirësimin e transparencës së punës së Kuvendit si organi më i lartë i komunës.

Problemët kryesore të komunës - Duke u bazuar në takimin në mes të qytetarëve të komunës Malishevës dhe kryetare të fshatrave rreth hartimit të buxhetit komunal për tri vitet në vijim, dhe bazuar në nevojat e tyre ka dalë të jetë se problemet kryesore në këtë komunë janë:

- Papunësia
- Asfaltimi i rrugëve dhe rrugicave nëpër fshatra
- Ndërtimi i dhe renovimi i shkollave
- Ndërtimi i kanalizimeve dhe menaxhimi i ujërave të zeza
- Ndriçimi publik

Të arriturat në vitin 2014

Edhe përkundër limiteve buxhetore për investimet kapitale komuna e Malishevës në kuadër të investimeve dhe përmirësimit të infrastrukturës rrugore përgjatë vitit të kaluar ka realizuar një numër të projekteve të ndryshme, të cilat do të kenë ndikim të drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve për qytetarët e komunës së Malishevës, si asfaltimi i disa rrugëve nëpër lagje dhe fshatra, realizimi i projekteve për ujësjellës, kanalizime, si dhe përkrahja në bujqësi.

E arritur tjetër po ashtu mjaftë e rëndësishme dhe e domosdoshme për qytetarët e komunës së Malishevës, e sidomos për fëmijët e vegjë në veçanti është edhe realizimi i projektit për ndërtimin e çerdhes për fëmijë, projekt ky i cili do të ketë efekt pozitiv sidomos në fushën e arsimit dhe edukimit.

Vlerësimi për performancë në transparencë

Kryetari – Kryetari i komunës së Malishevës z.Ragip Begaj, që nga zgjedhja e tij në krye të ekzekutivit është munduar që të ketë qasje konstruktive, të tregojë angazhim dhe tu bëjë ballë sfidave që janë mjaftë të mëdha në komunën e Malishevës. Krahasuar me paraardhësin e tij zoti Begaj ka dëshmuar se është më i hapur, më komunikues dhe bashkëpunues qoftë me qytetarët, partitë opozitare, por edhe shoqërinë civile dhe grupet tjera të interesit. Duke e pasur parasysh se ai është vetëm në vitin e parë të mandatit të tij, mbetet shihet se sa do të punojë në lehtësimin jetës së qytetarëve dhe informimin e tyre në punën e organeve të qeverisë lokale gjë e cila do të mundë edhe ta bënte qeverisjen e tij si transparente.

Drejtorive - Ajo që bie në sy është se performanca dhe transparenca nuk ka qenë në trendet e dëshiruara tek të gjitha drejtorit, pasi që ato kanë mundësi dhe mund të bëjnë edhe më shumë në cilësinë e kryerjes së shërbimeve por edhe punëve në teren. Shpeshherë gjatë prezantimit të raporteve apo edhe punëve të tyre informacionet kanë qenë ën vija të trash dhe nuk kanë përmbajtur hollësi të nevojshme, çka ka ndikuar edhe në mungesë transparence, shqetësime këto për të cilat e kanë ngritur zërin edhe anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesit të Kuvendit - Kryesuesi i Kuvendit të komunës së Malishevës, gjatë periudhës një vjeçare si prijës i Kuvendit është munduar që seancat e Kuvendit ti udhëheqë në përputhje me Rregulloren e punës së këtij institucioni, duke u mundësuar që anëtarëve tu japë kohë maksimale në trajtimin dhe shtjellimin e pikave të rendit të ditës. Por shpeshherë kjo tolerancë ka ndikuar që nga anëtarë të caktuar të cilët pos tejkallimeve të limitit kohorë kanë ndërhyrë edhe në fjalimet e tjerëve, duke ndikuar kështu negativisht na mbarëvajtjen e seancave dhe shkeljen e rregullores së punës.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Realizimi i projekteve për shtrimin e rrugëve në disa fshatra si: Balincë, Astrazup, Lumnishtë, Turjakë, Tërpezë, Fshati i Ri, Bellanicë, Bardhë,	Pjesërisht (në të gjitha fshatrat e cekur janë shtruar disa rrugë)
2	Projekti i ujësjellësit për fshatin Drenoc	Pjesërisht - faza (I)
3	Akumulacioni i ujërave të shpella e Panorcit (2015-2016)	Pjesërisht Fillimi i realizimit të projektit nëntor 2014
4.	Ndërtimi i shkollës fillore Bubavec	Fillimi i realizimit të projektit
5.	Ndërtimi i shkollës fillore Gollubovc	Pjesërisht
6.	Ndërtimi i shkollës fillore Carralluk	Pjesërisht - Fillimi i ndërtimit
7.	Ndërtimi i shkollës fillore Gurisht	Pjesërisht

Transparenca në Komunë

Transparenca në Buxhet - Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve, duke i kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave të të gjithë qytetarëve pa dallim. Qeveria komunale gjegjësisht drejtoria për Ekonomi dhe Financa ka raportuar vazhdimisht para Kuvendit për periudhën tre mujore financiare, derisa raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën gjashtë mujore Janar-Qershor 2014 është prezantuar nga kryetari i komunës së Malishevës z.Ragip Begaj, ndërsa ajo që vlen të theksohet është se duhet ketë ngritje edhe më të madhe të transparencës edhe sidomos tek vendi, hartimi dhe mbikëqyrja e investimeve tek projektet kapitale publike.

Seancat Plenare – Ajo që e ka karakterizuar këtë vit Kuvendin e komunës së Malishevës gjatë mbajtjes së mbledhjeve ka qenë trajtimi jo i adekuat i të gjitha materialeve të pikave të rendit të ditës nga disa anëtarë, ndoshta kjo për faktin se Kuvendi i Komunës së Malishevës këtë vit është përbërë nga një numër i konsiderueshëm i anëtarëve të rinj të cilët për herë të parë kanë qenë pjesë e Kuvendit, bojkotimi i seancave nga anëtarët e opozitës, mbledhjet e stërzgjatura, mos koordinimi i duhur legjislativ-ekzekutiv rreth informimit për miratimin e rregulloreve se a ju kanë nënshtruar konsultimeve publike, e po ashtu ka pasuar raste kur është shkelur rregullorja e punë së Kuvendi.

Komitetet Konsultative – Kuvendi i komunës themelon komitete këshillëdhënëse sektoriale me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Anëtarësia e komiteteve duhet të përbëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare. Po ashtu MAPL-ja qysh në vitin 2008 kishte miratuar U.A 2008/10 për organizimin dhe funksionimin e këtyre komiteteve. Kuvendi i komunës së Malishevës më parë ka formuar tri komitete jo obligative por jo sipas kriterëve të përcaktuara në U.A 2008/10, andaj në mbledhjen e mbajtur me dt.26.09.2014 Kuvendi i komunës së Malishevës ka marrë vendim për themelimin e komiteteve konsultative në pajtim me Udhëzimin Administrativ 2008/10 të MAPL-së.

Qasja në Dokumentet Zyrtare - Sa i përket qasjes në dokumente publike Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) disa herë ka bërë kërkesë për qasje në dokumente publike, kryesisht në shpenzimet e parasë publike, prandaj tek kjo çështje nuk kemi hasur në pengesa apo kundërshtime. Por sipas informatave në teren kjo nuk ka qenë aq e lehtë edhe për grupet tjera si qytetarët, bizneset apo edhe partitë politike.

Freskimi i Ueb-faqes së Komunës – Mekanizëm mjaft i rëndësishëm për ngritjen e transparencës së institucioneve lokale janë edhe ueb faqet e komunave. Zyra për komunikim me institucione apo në mungesë të saj, zyrtari i ngarkuar për komunikim me publikun është përgjegjës për redaktimin dhe përditësimin e të dhënave në ueb faqen e institucionit. Sa i përket kësaj çështje komuna e Malishevës ka bërë hapa para drejtë përmirësimit në këtë fushë duke u munduar që të pasqyrohet në vazhdimësi puna e qeverisë komunale, ku mundë të theksohet se me anë të një vendim Kuvendi i komunës së Malishevës me shumicë të votave ka vendosur që të gjitha procesverbalet e mbledhjeve të KPF-së dhe Kuvendit të publikohen në ueb-faqen zyrtare të komunës, por për arsye të ndryshme edhe këto procesverbale nuk po publikohen në vazhdimësi, që lë për të nënkuptuar se freskimi i ueb-faqes së komunës duhet të fuqizohet edhe më tepër.

Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i takimeve	Numri	Në rend dite	Pjesëmarrja	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare	13	67	74%	%
Komiteti për Politikë dhe Financa	12	67	74%	%
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli Komunal Sigurisë në Bashkësi	6		(Po)	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	2		20-25 persona	

Llogaridhënia në Komunë

Raportimi i Kryetarit dhe Drejtorëve: Edhe drejtorët e qeverisë komunale të Malishevës, krahasuar me atë të shkuar kanë qenë më aktiv në raportimet e tyre sidomos karshi Kuvendit, kjo ndoshta për faktin se përbërja e Kuvendit ka qenë e tillë ku pozita nuk ka qenë shumicë, prandaj kjo edhe ka ndikuar që asamblistët të jenë më këmbëngulës në kërkesat e tyre ndaj ekzekutivit, kur kanë qenë në pyetje raportet e ndryshme qofshin ato financiare të parapara me ligj, por edhe raporte të tjera, si raporti auditorit të brendshëm, kompanive publike, dhe të drejtorive komunale si raporti i DKA-së, raporti i drejtorisë së Bujqësisë etj. Ndërsa sa i përket raportimit para medieve ka qenë i mangët për pasi që në komunën e Malishevës pos një radio lokale mungojnë, qoftë një TV, apo media tjera elektronike. Kjo zbrazësi është munduar të kompensohet nga media e shkruara gjegjësisht nga gazetarët korrespondent, pasi që interesimi i atyre qendrore nuk ka qenë edhe aq i madh.

Raportimi i Kryetarit në Asamble: Duke u bazuar në Ligjin për Qeverisja Lokale në nenin 58 pika j), ku thuhet se: Kryetari i komunës raporton para Kuvendit të komunës për situatën ekonomik-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës, kryetari i komunës së Malishevës gjatë mandatit të parë të tij për vitin 2014 e ka përmbushur këtë obligim ligjor. Një gjë tjetër mjaftë me rëndësi sa i përket raportimit të kryetarit të komunës së Malishevës në asamble, është ajo se ai që nga marrja e mandatit në fund të vitit 2013, dhe përgjatë të gjitha seancave të asamblesë në vitin 2014 ai vazhdimisht ka qenë pjesëmarrës, nga ka është munduar që japë sqarime për punën e qeverisë dhe tu përgjigjet pyetjeve të ndryshme të asamblistëve.

Cilësia e Takimeve me Qytetarë: Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj në muajin qershor ka mbajtur takimin e parë publik me qytetarë, ku i ka njoftuar ata për punën e kryetarit dhe qeverisë komunale në gjashtë mujorin e parë të qeverisjes për vitin 2014, e ku më pas ka zhvilluar debat me qytetarët, lidhur me punët e bëra si dhe ka dëgjuar edhe kërkesat e qytetarëve, lidhur me nevojat e tyre dhe mundësisë së futjes së këtyre kërkesave në hartimin e projekteve kapitale në buxhetin komunal për vitin e ardhshëm.

Komuna e Malishevës gjegjësisht qeveria komunale përgjatë vitit 2014 në periudhën e hartimit të buxhetit komunal 2015-2017 në bashkëpunim edhe me OSBE-në po ashtu ka mbajtur një takim në mesë të kryetarëve të fshatrave të Malishevës, qëllimi i të cilit kishte qenë që vetë qytetarët të jenë pjesë e hartimit të prioritetëve në investimet kapitale për vitet në vijim, derisa për arsye të mospjesëmarrjes së qytetarëve ka dështuar dëgjimi publik mbi Projekt Buxhetin 2015-2017 organizuar nga drejtoria për Buxhet dhe financa dt.05.09.2014, derisa ditën e premte kryetari i komunës së Malishevës e ka rezervuar për takime të rregullta javore me qytetarë.

Pakënaqësitë me konkurse për arsim

Çështje mjaftë e shqetësuese që e ka karakterizuar gjatë kësaj periudhe Komunën e Malishevës ka qenë gjendja e krijuar në arsimin, pas protestave të arsimtarëve të cilët kanë humbur vendet e tyre të punës, e ku po pretendonin se iu është bërë një padrejtësi nga partia në pushtet, dhe se vendimi për largimin e tyre nga puna ishte bërë për motive politike. Për të trajtuar këtë problem Kuvendi I Komunës së Malishevës me dt. 29.09.2014 ka mbajtur një seancë të jashtëzakonshme.

Pas akuzave të anëtarëve të opozitës, nga radhët e PDK-së dhe LVV-së, të cilët shprehën shqetësimin e tyre në lidhje me largimin e disa mësimitdhënëseve nga procesi mësimor, përgjigje u dhe drejtori i Arsimit, i cili i hodhi poshtë të gjitha akuzat, duke thënë se të gjithë ata kandidatë që kanë qenë në këtë konkurs, e që i kanë plotësuar kriteret për vendin e punës janë punësuar. Ndërsa kryetari z.Ragip Begaj, duke ju drejtuar anëtarëve tha se ka filluar të vendoset një rend në shkollat e Malishevës dhe qëllimi im është që ti eliminoj dukuritë negative në shkollat tona, por këtë mund ta bëjë vetëm me ndihëm e juaj. Ai siguroi se rreth konkursit të pranimit të kuadrit në shkollat qëllimisht nuk është bërë asnjë shkelje, por në rast se ka ndonjë rast të shkeljesh gjatë pranimit të kuadrit jam në krah të tyre për gjetjen e zgjidhjes por në mënyrë ligjore”, prandaj ky premtim duhet që mos të mbetet vetëm fjalë e thënë e kryetarit të Komunës, por kjo të dëshmohet edhe me fakte konkrete.

Humbja e Dosjes së Tenderit

Problem tjetër mjaftë shqetësues që e ka karakterizuar administratën komunale të Malishevës ka qenë edhe humbja e Dosjes së Tenderit nga zyra komunale e Prokurimit të operatorit ekonomik “SHPK ALBAKOS&NNSH KORBEN”, kompani kjo e cila kishte konkurruar për ndërtimin e një shkolle fillore në fshatin Bubavec, komuna e Malishevës.

Duke e pasur parasysh rëndësinë dhe përgjegjësinë që ka zyra në fjalë kjo vepër mund të konsiderohet tejet e rëndë dhe me pasoja serioze sa i përket llogaridhënies dhe transparencës në Komunën e Malishevës, ku si pasoj edhe e ankesës në fjalë OSHP-ja kishte urdhëruar autoritetin kontraktues, në këtë rast komunën e Malishevës që këtë projekt me Nr. Të Prokurimit: 62500/14/078/521, ta kthej në ri-tenderim, si dhe ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues që të marrë në përgjegjësi personat përgjegjës për zhdukjen e ofertës origjinale, duke e konsideruar si ndërhyrje flagrante në këtë ofertë.

Andaj për këtë rast kryetari i komunës së Malishevës në njërën nga seancat e Kuvendit ka deklaruar se si masë ndëshkuese ai kishte suspenduar nga puna 4 zyrtarë të zyrës së Prokurimit, derisa me tatë 23.07.2014 A.K përmes shkresës elektronike kishte lajmëruar OSHP-në se e kanë gjetur ofertën origjinale të operatorit ekonomik në fjalë.

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës

- Përfshirjen e qytetarëve në procesin e hartimit të buxhetit (buxheti me pjesëmarrje), çdoherë të konsultohen qytetarë për nevojat që ata kanë dhe projektet e tyre me prioritet.
- Qytetarët të informohen në vazhdimësi për aktivitetet e komunës qoftë nëpërmjet medieve lokale, apo edhe të organizohen intervista dhe fushata informuese edhe me media qendrore.
- Takimet publike të organizohen për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme në interes të publikut të gjerë, si dhe të merren masa që informimi i qytetarëve të jetë gjithëpërfshirës.
- Kryetari i komunës të bashkëpunojë ngushtë me Kuvendin në mënyrë që të koordinohen punët dhe vendimet që dalin nga këto dy institucione, në mënyrë që transparenca dhe llogaridhënia të jenë në nivelin e duhur.
- Të respektohet në përpikëri Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji për Planifikimin Hapësinorë, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Udhëzimin administrativ 05/2013 për transparencë në komuna, si dhe Rregulloren për transparencë në komunë.
- Të urdhërojnë marrjen e masave nga inspektorët komunal në parandalimin e hedhjes së mbeturinave përgjatë rrugëve që qojnë në për fshatra.

Kryesuesit të Kuvendit

- Të merren masa në menaxhimin sa më të duhur të seancës, të respektohet në përpikëri rregullorja e punës së Kuvendit,
- Të ruaj neutralitetin dhe të trajtojë barabartë të gjithë kuvendarët pa anime politike.
- Të krijoj kushte adekuate për pjesëmarrje të qytetarëve dhe shoqërisë civile gjatë punimeve të seancave.
- Të pajisen me materiale përcjellëse të interesuarit tjerë për pjesëmarrje në seancë, qoftë për qytetarët, mediat apo shoqërinë civile, në mënyrë që tu mundësohet edhe atyre që të kenë qasje në vendimet Komunale.
- Të merren masa dhe të intensifikohet edhe më shumë bashkëpunimi në mesë të opozitës dhe kryesuesit të Kuvendit, në mënyrë që interesi komunal të dominojë atë politik.
- Të ketë bashkëpunim më të madh dhe të forcohen edhe më tej marrëdhëniet në mesë të Kryesuesit të Kuvendit dhe OSHC-ve në përgjithësi, por sidomos të atyre lokale pasi që kontributi i tyre do të ishte i shumë i dobishëm për komunën e Malishevës.
- Të krijohen sa më parë Komitetet Konsultative dhe të miratohet Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e këtyre komiteve konsultative.

Asamblastëve të Kuvendit

- Kontribuoni me informacione dhe kërkoni informata shtesë gjatë shqyrtimit të të gjitha dokumenteve komunale.
- Të jeni pjesë aktive në debate, dhe të shtoni mbikëqyrjen ndaj ekzekutivit

- Kërkimi i vazhdueshëm i raporteve financiare dhe respektim të afateve kohore konform ligjit për menaxhimin e financave dhe përgjegjësit me qëllim të kontrollimit të shpenzimit të parasë publike nga kuvendi i Komunës, si dhe të shikohen mundësitë për rritjen e mbikëqyrjes së zbatimit të investimeve kapitale.
- Të shmangeni nga ofendimet dhe inatet personale.
- Të sigurojnë informata mbi kërkesat, problemet dhe rekomandimet e qytetarëve.
- Të mundohen të arrijnë konsensus lidhur me ato çështje që janë në interes të banorëve të komunës.
- Anëtarët e Kuvendit të Komunës të kërkojnë raportet e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për aktivitetin që kanë realizuar dhe të njoftohet publiku i gjerë rreth punës së këtij mekanizmi.

Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
<i>Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2014</i>	Miratuar	Pro: 15 Kundër: 1 Abs: 0
<i>Projekt-Rregullorja për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2015</i>	Miratuar	Pro: 23 Kundër : 0 Abs: 0
<i>Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave në periudhën Janar-Mars 2014</i>	Shqyrtuar	Pro: ... Kundër : ... Abs: ...
<i>Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave në periudhën Janar-Qershor 2014</i>	Refuzuar	Pro: 12 Kundër: 13 Abs: 3
<i>Vendimi për formimin e KPF-së.</i>	Miratuar	Pro: 28 Kundër: 0 Abs: 2
<i>Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete.</i>	Miratuar	Pro: 30 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Vendimi për publikimin e procesverbaleve të seancave të Kuvendit dhe KPF-se në ueb-faqe zyrtare të komunës.</i>	Miratuar	Pro: 18 Kundër: 0 Abs: 9
<i>Vendimi për formimin e KKSB-së</i>	Miratuar	Pro: 14 Kundër: 5 Abs: 0
<i>Vendimi për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit</i>	Miratuar	Pro: 24 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Vendim për funksionalizimin e komisionit të aksionarëve të Komunës së Malishevës.</i>	Miratuar	Pro: 24 Kundër: 0 Abs: 1
<i>Vendimi për formimin e komisionit për ndryshimin e statutit të Komunës së Malishevës</i>	Miratuar	Pro: 25 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Vendimi që pishinat në Banjë, të mos jepen me qira, por të menaxhohen nga vet komuna.</i>	Miratuar	Pro: 17 Kundër: 8 Abs: 1
<i>Vendimi për mbrojtjen e Vlerave të Natyrës në komunën e Malishevës.</i>	Miratuar	Pro: 29 Kundër: 0 Abs: 0
<i>Vendimi për formimin e komiteteve jo-obligative</i>	Miratuar	Pro: 30 Kundër : 0 Abs: 0
<i>Vendimi për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve në Komunën e Malishevës.</i>	Miratuar	Pro: 30 Kundër : 0 Abs: 0
<i>Vendimi për formimin e këshillit organizativ për kremtimin e 16 Qershorit, ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.</i>	Miratuar	Pro: 27 Kundër : 0 Abs: 2
<i>Vendimi për miratimin e KAB-it 2015-2017.</i>	Miratuar	Pro: 27 Kundër : 0 Abs: 2
<i>Vendimi i Miratimit të Projekt Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2015.</i>	Miratuar	Pro: 27 Kundër : 0 Abs: 2
<i>Vendimi për dhënien në shfrytëzim të hapësirës publike për vendosjen e antenave të telefonisë mobile.</i>	Miratuar	Pro: 29 Kundër : 2 Abs: 0
<i>Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve nëpër Vendbanime dhe Fshatra të Komunës së Malishevës</i>	Miratuar	Pro: 23 Kundër : 1 Abs: 2
<i>Vendimi për themelimin e Komitetit Konsultativ</i>	Miratuar	Pro: 24 Kundër : 0




Komuna Junik

SHOQATA E INTELEKTUALËVE TË PAVARUR




ASSOCIATION OF INDEPENDENT INTELLECTUALS

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



12. Komuna JUNIK

Vlerësimi i Përgjithshëm

Çfarë e karakterizojë komunën këtë vit

Komunën e Junikut gjatë kësaj periudhe e ka përshkruar krijimi i institucioneve lokale dhe fushata për zgjedhjet nacionale, sikurse në gjitha komunat tjera të Kosovës. Kryetari i kësaj komune, Agron Kuçi, i cili është në mandatin e tij të dytë si kryetar komune, ka bërë ndryshime në përbërje e kabinetit të tij qeveritar, për dallim nga mandati i kaluar. Edhe legjislativi i kësaj komune ka pësuar ndryshime në përbërje, ku Lëvizja Vetëvendosje bëhet pjesë e këtij organi vendimmarrës. Nga zgjedhjet e fundit lokale (2013), AAK-ja ka marrë më së shumti ulëse, 6 nga 15, e ndjekur nga LDK-ja me 5 ulëse, ndërsa VV-ja dhe PDK-ja kanë nga dy këshilltar komunal. Punën e organeve komunale (ekzekutivit dhe legjislativit), gjatë vitit 2014, e karakterizojnë mos marrëveshjet dhe mos koordinimi i duhur, duke shkëmbyer edhe akuza e kundër akuza për shkelje ligjore dhe pengim të proceseve zhvillimore. Si rezultat i këtyre mosmarrëveshjeve ka ndodhur që disa vendime mos të merren, sikurse që ishte vonesa në planifikimin dhe aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Problemet kryesore të komunës

Komuna e Junikut, disponon me resurse të mira zhvillimore, qoftë turistike apo bujqësore. Këtë privilegj ua mundëson masivi i Bjeshkëve, sikurse edhe toka e pëlleshme bujqësore. Kjo komunë pasi disponon me resurse të shumta turistike, ka pretendime të behët komunë turistike duke hap edhe qendrën rajonale për turizëm. Mirëpo, përkundër këtyre resurseve, kjo komunë përballët edhe me probleme të natyrave të ndryshme, si:

- Pastrimi nga mbeturinat inerte dhe llojet tjera të hedhura përgjatë rrugëve, lumenjve, hapësirave të gjelbëruara dhe hapësira tjera, të cilat japin imazh të keq kësaj komune.
- Ruajtja e pasurisë kombëtare, Bjeshkët e Nemuna, që është shqetësim i vazhdueshëm i qytetarëve të kësaj komune.
- Papunësia, vazhdon të mbetet problem serioz, jo vetëm në Junik, por në gjithë Kosovën.
- Trajtimi i ujërave të zeza është ndër preokupimet e banorëve të kësaj komune.
- Mungesa e një hapësire të duhur, (e që do ishte e rregulluar), e cila do shfrytëzohej nga qytetarët për blerje dhe shitje të mallrave të tyre (Tregu i gjelbër)

Të arriturat në vitin 2014

Komuna e Junikut, është ndër komunat më të vogla të Kosovës, çka do thotë se, edhe buxheti i saj është buxhet i cili as për së afërmi nuk mund ti plotëson nevojat e qytetarëve. Mirëpo, me përkrahjen e donatorëve vendor dhe ndërkombëtar, ekzekutivi i kësaj komune, ka realizuar disa projekte zhvillimore dhe infrastrukturore. Ndër projektet më të rëndësishme për junikasit mund të konsiderohen: ndërtimi i fabrikës për grumbullim dhe përpunim të frutave të malit; ndërtimi i palestrës sportive, hapja e rrugës nga Juniku në drejtim të "Gjeravicës", rrugë e cila do mundëson zhvillimin e turizmit veror e dimëror. Pos këtyre projekteve kjo komunë ka realizuar edhe projekte infrastrukturore. Në projektet infrastrukturore janë bërë investime në ujësjellës, infrastrukturë rrugore, rregullim të shtratit të lumit "Erenik", kanale të ujitjes, etj.

Vlerësimi për performancë në transparencë

Kryetari i komunës, Agron Kuçi, që vjen nga radhët e AAK-së, vazhdimisht është shprehur i hapur për bashkëpunim, qoftë me media apo shoqëri civile. Ai, me një buxhet të vogël të investimeve kapitale, ka arritur të realizon projekte në fusha të ndryshme, duke marrë përkrahje edhe Qeveria qendrore dhe donatorët, qofshin vendor apo ndërkombëtar.

Mirëpo, Z. Kuçi për dallim nga mandati paraprak, ka një përplasje apo mos koordinim të angazhimeve me legjislativin e komunës, duke bërë që komunikimi mes këtyre dy institucioneve të mungon. Kuçi, shumë herë nuk ka gjetur përkrahjen e këshilltarëve komunal, qoftë për vendimet e tij që kanë të bëjnë me planifikimin buxhetor, por edhe në vendime tjera, çka edhe kishte shprehur pakënaqësinë e tij, ndaj kundërshtimeve të ardhura nga këshilltarët komunal. Kryetari i komunës, qysh në vitin e parë të mandatit, ka bërë ndërrime të drejtorëve të drejtorive (Arsimit dhe Shëndetësisë), ku për disa muaj (deri në fund të vitit 2014) këto dy Drejtori, kishin mbetur pa personat kyç (drejtor).

Drejtorët e Drejtorive Komunale si këshilltar të kryetarit të komunës, kanë treguar një performancë relative. Juniku si komunë e vogël, me një numër të vogël të stafit administrativ ka numër më të vogël të drejtorive (shtatë sosh), që kryesisht janë drejtor nga radhët e AAK-së. Pra, për dallim nga mandati i kaluar, ekzekutivi komunal përbëhet vetëm nga përfaqësuesit e partisë më të madhe, asaj të AAK-së, edhe pse nuk ka shumicën në Kuvend. Performanca e drejtorëve është kryesisht pozitive, përkundër faktit se kryetari i komunës ka bërë ndërrimin e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë.

Këshilltarët komunal si përfaqësues të qytetarëve janë të obliguar që shqetësimet e qytetarëve të ngrehin në nivel diskutimi dhe të marrin vendime në interes të përgjithshëm të banorëve të kësaj komune në përputhje me bazën ligjore. Mirëpo, llogaridhënia e tyre ndaj qytetarëve ka munguar, sepse kanë munguar takimet e tyre të drejtpërdrejta me qytetarët, me qëllim të ballafaqimit dhe marrjen e shqetësimeve të tyre. Përfaqësuesit e këtyre subjekteve, pozitivisht iu janë përgjigj ftesës së shoqërisë civile për takime me qytetar, çka kanë treguar se bashkëpunimi i tyre dhe organizatave të shoqërisë civile, ishte në nivelin e duhur.

Menaxhimi i seancave të Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa bëhet nga kryesuesi i Kuvendit sipas mandatit që i takon, duke mos reflektuar anime partiake. Kryesuesi, si në seancat e Kuvendit, ashtu edhe në takimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, kishte krijuar hapësira të mjaftueshme për diskutime dhe shprehje të ideve. Nuk ka pasur raste kur kryesuesi është detyruar të ndërmer masa për ndërprerje të diskutimeve, dhe nuk kishte raste kur kryesuesi është detyruar të ndërpres fjalën e këshilltarëve, për shkak të tejkalimit të minutazhit të paraparë. Duhet cekur edhe gjuhën e përdorur nga këshilltarët komunal që ishte gjuhë e respektit, pa fyerje, as ndaj kryesuesit, por as ndaj njëri-tjetrit.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Fabrika për grumbullimin dhe përpunimin e frutave të malit	Realizuar
2	Stacioni i autobusëve	Realizuar
3	Përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	Pjesërisht
4	Ndërtimi i kompleksit turistik "Moronica",	Pjesërisht

5.	Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm	Pjesërisht
6.	Tregu i gjelbër	Pa realizuar

Transparenca në Komunë

Transparenca në buxhet Edhe pse, si ekzekutivi ashtu edhe legjislativi, janë të obliguar të konsultojnë qytetarët në planifikimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe planifikimin vjetor, kjo gjë nuk ka ndodhur. Si planifikimi, ashtu edhe shpenzimi i buxhetit nuk bëhet publik përmes faqes zyrtare apo formave tjera të publikimeve. Kuvendi i Komunës, pasi kishin kaluar gjitha afatet ligjore, ka aprovuar dokumentin e ofruar nga ekzekutivi i komunës për planifikimin buxhetor 2015-2017.

Në përgjithësi, legjislativi i komunës ka qasje pozitive ndaj shoqërisë civile dhe mediave, duke ofruar hapësira të duhura për të qenë pjesë e proceseve të vendimmarrjes. Mirëpo, kjo komunë vazhdon të mos këtë zyrtar për informim, sikurse nuk ka të themeluar komitete konsultative. Nga OJQ-të vendore, monitorimin e punës së komiteteve dhe seancave plenare, e bën vetëm SHIP-KDI, ndërsa nga ato ndërkombëtare OSBE-ja dhe KFOR-i (Njësit për ndërlidhje dhe monitorim-LMT).

Ueb Faqja zyrtare e komunës së Junikut kryesisht freskohet me aktivitetet e zhvilluara nga kreu komunal. Mirëpo, pas sugjerimeve të bëra nga shoqëria civile dhe këshilltarët komunal, ka filluar të freskohet dhe të plotësohet me dokumente të cilat janë publike për qytetarët, por jo edhe me, buxhetin komunal, procesverbale të takimeve apo të natyrave të ngjashme. Mungesa e interesimit të qytetarëve dhe subjekteve të ndryshme për qasje në dokumente zyrtare, ka bërë që një numër i vogël i kërkesave të adresohen në zyrën për qasje në dokumente zyrtare, pranë kuvendit komunal.

Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i takimeve	Numri	Në rend dite	Pjesëmarrja	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare	11	44	97.6%	95.4%
Komiteti për Politikë dhe Financa	11	44	100%	100%
		Gjithsej Takime	Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli Komunal Sigurisë në Bashkësi	3		Po	
		Gjithsej	Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	2		50 persona	

Llogaridhënia në Komunë

Raportimi i Kryetarit dhe Drejtorëve Bazuar edhe në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale dhe Statutin Komunal, kryetari i komunës është i obliguar së paku dy herë në vit, të raporton para qytetarëve, për angazhimet e tij dhe stafit, raport i prezantuar edhe me shkrim. Gjatë këtij viti, kryetari i komunës ka raportuar për vitin paraprak, ndërsa raportimi gjashtëmuor nuk ka ndodhur, si rezultat i asaj që ky vit ishte edhe vit i zgjedhjeve lokale.

Komuna e Junikut, është e hendikepuar për nga mbulimi medial pasi që kjo komunë përkundër përpjekjeve të disa medimeve që të mbulojnë ngjarjet, nuk kanë korrespondent

të angazhuar nga mediumet kosovare. Këshilltarët komunal nuk kanë organizuar ndonjë takim me qytetar, pos atyre gjatë fushatës zgjedhore. Mirëpo, gatishmëria e tyre për të marrë pjesë në takime të organizuara nga shoqëria civile ishte e një niveli të mirë.

Menaxhimi i Mbeturinave dhe Pyjeve

Natyra e Junik vazhdon të shkatërrohet çdo ditë e më shumë. Hedhja e mbeturinave në çdo vend po shëmton këtë komunë që pretendon të bëhet turistike sikurse që janë edhe komuna e Pejës, Istogut dhe Deçanit. Stoque të shumta, deponit ilegale, niveli i ulet i vetëdijes qytetare për mjedis të pastër, dhe mungesa e shërbimeve të duhura institucionale, po japin imazh të keq për investitorët që vijnë të investojnë kapitalin e tyre në resurset zhvillimore të kësaj komune.

Po ashtu, masivi i bjeshkëve të Nemuna paraqet resurs të madh të zhvillimit, jo vetëm për Junikun, por edhe më gjerë. Këto resurse natyrore, janë duke u shkatërruar nga prerjet legale dhe ilegale, duke bërë që Juniku të humb shumë në aspektin material dhe shpirtëror. Gjendja në pyjet e kësaj komune është alarmante, duke qenë përgjegjës për këtë gjendje të gjitha institucionet, qofshin lokale apo qendrore. Junikasit kritikojnë qeverinë qendrore për këtë gjendje të mjerë, që sipas tyre, pyjet e Junikut po shkatërrohen me letra përmes tenderëve.

Në Junik është shqetësuese edhe dukuria e vjedhjeve të shtëpive nëpër çdo lokalitet të kësaj komune, duke bërë që siguria publike të jetë temë diskutime si nëpër institucione, ashtu edhe lokale dhe ndryshme. Qytetarët duke mos u pajtuar me neglizhencën institucionale për kapjen e kryesve të veprave të tilla, janë detyruar të vet organizohen në ruajtje të pronave të tyre.

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës:

- Në afatin sa më të shkurtër të bëhet emërimi i një zyrtari për informim, i cili do mundëson komunikimin më të lehtë me media dhe qytetar, sikurse do pasuron më të dhëna zyrtare, faqen e kësaj komune.
- Të konsultohen, bashkëpunoni, dhe të raportoni para këshilltarëve komunal, por edhe të merrni pjesë në takimet e KPF-së dhe seancat plenare të Kuvendit.
- Vendimet, Procesverbalet, Rregulloret komunale, dhe dokumentet tjera publike, të publikohen në faqen zyrtare të komunës, që do mund të shikohen dhe të shkarkohen nga të interesuarit.
- Të hartohet, dhe pas aprovimit të implementohet Rregullorja për funksionimin e këshillave të fshatrave, e cila do ndikon në rritjen e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies institucionale.

Kryesuesit të Kuvendit:


- Në takime të drejtpërdrejta apo edhe forma tjera ti inkurajoni organizatat e shoqërisë civile që të jenë më aktive në mbikëqyren e organeve komunale dhe të bëhen pjesë e proceseve të vendimmarrjes.
- Të konsultoheni, bashkëpunoni, por edhe të kërkonit përgjegjësi institucionale nga ekzekutivi komunal, qoftë me pjesëmarrjen e tij në takimet e KPF-së apo edhe në seancat plenare të Kuvendit.

Asamblistëve të Kuvendit:

- Të arsyetoni besimin e marrë nga qytetarët, duke konsultuar dhe njohur me hallet e tyre, e të njëjtat të ngritën dhe prezantohen në seancat e Kuvendit.
- Të mbani takime të drejtpërdrejta me qytetar, me qëllim të njohjes me hallet dhe kërkesat e tyre.
- Të shqyrtohet, aprovohet dhe zbatohet Rregullorja për funksionimin e këshillave të fshatrave, e cila do mundëson rritjen e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies.


Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
<i>Korniza Afatmesme Buxhetore</i>	Miraturar	Pro: 11; Kundër: 3; Abs: 1
<i>Rregullorja për transport lokal në komunën e Junikut</i>	Miraturar	Pro: 13; Kundër: 0; Abs: 0
<i>Vendimi për shpalljen e parcelave kadastrale 3298/1 dhe 490 interes publik i komunës së Junikut,</i>	Miraturar	Pro: 12; Kundër: 0; Abs: 0
<i>Themelimin e Komitetit për Shërbime Publike</i>	Miraturar	Pro: 15; Kundër: 0; Abs: 0
<i>Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi</i>	Miraturar	Pro: 15; Kundër: 0; Abs: 0
<i>Planifikimi Buxhetor 2015</i>	Miraturar	Pro: 10; Kundër: 3; Abs: 2
<i>Planit për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Junikut për periudhën (2014-2019)</i>	Miraturar	Pro: 13; Kundër: 0; Abs: 0
<i>Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2013</i>	Shqyrtuar	




Komuna Mamushë

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



13. Komuna MAMUSHË

Vlerësimi i Përgjithshëm

Cfarë e karakterizojë komunën këtë vit

Komuna e Mamushës është një komunë e re e themeluar ndër Pilot-projekt Komunitat e cila kryesisht banohet nga qytetarë të komunitetit turk dhe nga disa familje shqiptare. Popullsia e kësaj Komune kryesisht merret me bujqësi dhe tregti. Një pjesë e rinisë së Mamushës merren me studime dhe kryesisht shkojnë për studime në Turqi. Komuna e Mamushës me ekzekutiv të ri dhe ambicioz është munduar të angazhohet rreth përmirësimit të infrastrukturës por ata duhet të angazhohen në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Komuna e Mamushës edhe sivjet organizoj festivalin e domates i cili ka filluar të bëjë një jehonë të madhe në Kosovë si ndodhi e rëndësishme në bujqësi.

Problemet kryesore në Mamushë :

1. Mungesa e punësimit të rinjve në këtë Komunë
2. Mos rregullimi i shtratit të Lumit Topllua.
3. Mungesa e ujit të pijes dhe infrastruktura rrugore
4. Mungesa e një çerdheje për fëmijë e Shtëpisë së Kulturës dhe e një qendre sportive dhe rekreative
5. Mungesa e subvencionet ndaj fermerëve
6. Mungesa e mbështetjes së të rinjve në aktivitetet e tyre
7. Mungesa e stafit mjekësor në Qendrën e Mjekësisë Familjare në orët e pasdites.

Të arriturat në vitin 2014

Komuna e Mamushës në vitin 2014 ka vazhduar investimet në infrastrukturë rrugore dhe në rrjetin e kanalizimeve dhe ujësjellësit. Ka investuar në mirëmbajtjen e parkut të qytetit si dhe në mirëmbajtjen e varrezave të qytetit. Mamusha të gjitha këto investime i ka bërë fal të hyrave buxhetore vetanake si dhe grantit qeveritar.

Vlerësimi për performancë në transparencë

Kryetari Komunës së Mamushës z. Arif Bütüq I cili ka fituar postin e të parit të Mamushës për herë të dytë konsiderohet si njeri me ndikim në komunë dhe bashkëpunues me monitoruesit e shoqërisë civile sidomos me KDI . Mirëpo Kyetari z. Arif Bütüq duhet të jetë prezent në mbledhjet e seancave të kuvendit Komunal dhe ti përgjigjet takimeve publike me qytetarët e komunës së Mamushës.

Drejtoritë Komunale Komuna e Mamushës ka 6 drejtori, ato, janë të ngarkuara me më shumë departamente dhe puna e tyre është më e vështirë. Drejtoria e urbanizmit dhe ajo e shërbimeve publike duket se janë më mirë të organizuara me angazhimet e tyre por megjithatë të gjitha drejtoritë duhet të angazhohen për një efikasitet më të madh si dhe të jenë më transparente sa i përket shpenzimeve të parasë publike. Po ashtu të gjitha drejtoritë

duhet ti publikojnë në ueb faqe të gjitha dokumentet publike që qytetarët të kenë qasje në të.

Anëtarët e Kuvendit Gjatë seancave të cilat janë mbajtur në komunën e Mamushës jo të gjithë anëtarët e kuvendit ishin aktiv si nga pozita ashtu edhe nga opozita. Vetëm dy apo tre anëtarë të kuvendit të Mamushës janë më aktivë në seanca, si dhe duhet të krijohet një kulturë e komunikimit në seancë dhe jo të diskutohet pa marrë fjalën nga Kryesuesi i seancës.

Kryesuesit të Kuvendit: Kryesuesi është mjaft aktiv në punën e tij dhe është munduar që të menaxhojë seancat me vullnet mirëpo ka nevojë të jetë më i prerë në qëndrime si dhe të mos lejojë që seancat bëhet një arenë e diskutimeve dhe se toleranca e tij po lejon që të keqpërdoret nga anëtarët e kuvendit të cilët flasin pa ju dhënë fjalën Kryesuesi.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Shtimi i numrit të serave	Pa-Realizuar
2	Rregullimi i sistemit të ujërave për tokat bujqësore	Pa-Realizuar
3	Themelimi i një universiteti në Mamushë	Pa-Realizuar
4.	Përmirësimi i performancës në arsim , shëndetësi dhe kulturë	Pjesërisht
5.	Ngritja e kualiteti të jetës	Pjesërisht

Transparenca në Komunë

Komunën e Mamushës gjatë këtij viti të monitorimit 2014 kishte përmirësim nga viti i kaluar në aspektin e përkthimit simultant gjatë seancave të Asamblesë dhe Komiteteve të ndryshme por megjithatë kishte dokumente të ndryshme si dhe procesverbale të cilat jepen vetëm në gjuhën turke, kishte mungesë të respektimit të fjalës në seanca , gjatë diskutimit nuk flitet sipas renditjes që e cakton Kryesuesi, po ashtu nuk respektohet koha e paraparë për diskutim. Mangësi tjetër është edhe mungesa e një zyrtari për informim dhe se komuna nuk ka një adresë ku mund të bëhet kërkesë në qasje për dokumente zyrtare.

Edhe përkundër raporteve të mira konsiderojmë që zyrtarët administrativ duhet të jenë më bashkëpunues me Shoqërinë Civile. Komuna e Mamushës akoma nuk ka formuar komitete konsultative, mirëpo Kryetari i Komunës ka deklaruar që është i nevojshëm formimi i tyre.

Mediat e shkruara dhe elektronike gjatë aktiviteteve të legjislativitetit dhe Ekzekutivitetit nuk kanë qenë prezent. Jo prezenca e tyre është bërë duke mos bashkëpunuar dhe informuar mediat lokale të Prizrenit, por edhe nga mos-interesimi i mediave për punën e Kuvendit në Komunën e Mamushës.

Aktivitetet dhe veprimtarinë e Komunës e monitorojmë OJQ-të nga qyteti i Prizrenit si KDI po ashtu edhe OSBE dhe ndonjëherë edhe OJQ Ec ma Ndryshe. KDI përgatitë raporte të rregullta mujore për të gjeturat në këtë komunë dhe dalim me komunikata në gazeta , portale dhe media.

Mos prezenca e mediave lokale i kontribuon edhe fakti që Komuna e Mamushës nuk ka TV lokale që do të ishte informator i drejtpërdrejt i qytetarëve të kësaj Komune për punën e Kuvendit Komunal.

Qasja në dokumente zyrtare në Komunë, duke u bazuar në kërkesat e KDI si dhe informatat e disponueshme është e kënaqshme. Megjithatë, duhet të potencohet fakti se mungojnë zyrtarët adekuat që ky proces të realizohet sipas rregullave, ngase mungon një zyrtar i protokollimit, po ashtu mungon edhe zyrtari i informimit. Mungesa e këtyre zyrtarëve bën që sekretarja e Kryetarit të kryejë funksionin e protokolluesit, si dhe të informohet nga zyrtarë të ndryshëm.

Përkundër rekomandimeve të KDI-së që komuna të azhurnoj ueb faqen e saj, kjo Komunë nuk e ka bërë një gjë të tillë prandaj mungojnë informata për seanca, komitete, mungojnë raportet financiare, procesverbalet, rregulloret, dhe vendimet.

Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i takimeve	Numri	Në rend dite	Pjesëmarrja	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare	13	65	94%	84%
Komiteti për Politikë dhe Financa	12		74%	75%
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli Komunal Sigurisë në Bashkësi	0			
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	1		22 persona	

Llogaridhënia në Komunë

Raportimi i Kryetarit dhe Drejtorëve: Gjatë seancave kur është obligative të raportohet për raportet financiare nuk ka qenë prezent Kryetari e as shumica e drejtorëve tjerë të ekzekutivit. Raportin e ka përgatitë dhe ka raportuar udhëheqësja e sektorit të financave në komune. Sidoqoftë, prezent në takime të asamblesë zakonisht kanë qenë drejtori i administratës dhe ai i urbanizmit derisa të tjerët nuk kanë marrë pjesë.. Kryetari nuk raporton për punët e realizuara të tij, apo vendimet e marra.

Raportimi i Kryetarit në Asamble: Kryetari i Mamushës me mos-prezencën e tij në seanca të Kuvendit të Komunës nuk i përmbush obligimet e tij duke u dhënë llogari asamblistëve dhe qytetarëve për punën që realizon në baza mujore dhe vjetore. Kryetari i Mamushës ka bërë shkeljen e Ligjit për Menaxhim të Financave dhe Përgjegjësitë, neni 45.5 i cili thotë “Kryetari i komunës duhet të përgatitë dhe t’i dorëzojë kuvendit komunal raporte tremujore të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të tremujorit i cili sapo ka përfunduar. Këto raporte duhet t’i dorëzohen Kuvendit komunal dhe një kopje duhet t’i dorëzohet ministrit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të çdo tremujori dhe më pas duhet të publikohen nga Kryetari i komunës në faqen e internetit të Komunës.

Cilësia e Takimeve me Qytetarë: Për tërë vitin Komuna e Mamushës ka mbajtur vetëm një debat publik, të cilin e ka bërë duke u mbështetur nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe ka organizuar debatin me qytetarët e Mamushës me temën 'Pjesëmarrja e qytetarëve dhe kontributi në hartimin e buxhetit komunal' për vitet 2015-2017.

Edhe pse pjesëmarrja e qytetarëve ishte e vogël, ata ishin aktiv në shprehjen e nevojave për investime kapitale si në : Infrastrukturë, ndriçim publik, mirëmbajtje të rrugëve dhe

parqeve, kanalizim etj. Të gjithë të pranishmit ishin të pajtimit që investimet për aktivitet rinore duhet të shtohen si dhe në të ardhmen të ndërtohet një qendër rinore në komunë.

Ndërsa sa i përket aktiviteteve ku asambleistët mund të kontaktonin me qytetarë, nuk është parë asnjë aktivitet i tillë, dhe kjo ka rrjedhur edhe si pasojë e mos vetëdijesimit të qytetarëve se e kanë një adresë tjetër ku mund t'i shfaqin shqetësimet e tyre.

Kyçja në Autostradë

Në Komunën e Mamushës çështje më prioritare është lidhja e kësaj Komune me Autostradën për Prishtinë. Në këtë kontekst Komuna e ka miratuar në kuvend këtë projekt me shumicë absolute të votave dhe ka kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës ndihmë në këtë drejtim. Autostrada Mamushë-Prishtinë, rrugë kjo mjaft e rëndësishme që lidh Mamushën me Prishtinë dhe Komuna tjera do të ndihmonte zhvillimin ekonomik dhe lehtësimet në tregti të lëvizjes së mallrave dhe njerëzve. Autostrada është e gjatë 5 km dhe këtë vit ka filluar ndërtimi i saj që pritet të finalizohet në vitin 2015.

Shpenzimet e këtij projekti do të mbulohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe me participim të Komunës e cila ka ndarë një vijë buxhetore në vlerë prej diku rreth 40,000 euro. Iniciativa për një projekt të tillë ka qenë nga Kryetari i Komunës i përkrahur nga ekzekutivi dhe legjislativi komunal. Ndërtimi i autostradës do të mundësonte rritjen e mirëqenies sociale, zhvillimin ekonomik lokal si dhe zhvillim më të madh të bujqësisë dhe zgjerim të tregtisë por edhe turizmit në të ardhmen si dhe rritjes së mirëqenies sociale dhe punësimit të qytetarëve të Mamushës si në Komunë e tyre ashtu edhe punësimit të tyre në komuna tjera pasi që përmes kësaj rruge është më i lehtë qarkullimi dhe lëvizja e lirë e njerëzve, mallrave dhe shërbimeve.

Buxhet për aktivitete rinore

Në Komunën e Mamushës ka qenë një çështje tjetër që është dashur Komuna ti kushtojë rëndësi, e ajo është perspektiva e rinisë dhe angazhimet e saj në aktivitete rinore me qëllim të integritetit të rinjve në jetën ekonomike, kulturore dhe sportive si dhe në vendimmarrje, me qëllim të hapjes së perspektivës së tyre në Komunën e Mamushës. KDI ka organizuar debatin me Rininë e komunës së Mamushës me qëllim që të njoftohet për së afërmi me kërkesat dhe nevojat e rinisë së Mamushës si dhe të avokojë tek organet komunale për realizimin e tyre.

Të rinjtë në Komunën e Mamushës kishin nevoja për kurse në gjuhën shqipe dhe angleze, mbështetje në aktivitete sportive për femra, organizimi i koncertit dhe mbrëmje rinore për të rinjtë në Mamushë, kurse artizanale dhe punëdore për femra, zhveshtore për femra në lenden e edukatës fizike etj.

KDI kishte avokuar që të ndahet një vlerë buxhetore nga subvencionet për mbështetje të rinjve nga Komuna e Mamushës dhe për vitin 2015 Komuna ka ndarë 5.000 euro për aktivitete rinore që nuk është e mjaftueshme për realizimin e kërkesave që kanë të rinjtë e kësaj Komune.

Rekomandimet për Komunë

- Komuna e Mamushës duhet të punësojë një Zyrtar për informim i cili do të jetë në kontakt me shoqërinë civile si dhe do të kujdeset për adresim të çështjeve me interes të qytetarëve.
- Komuna e Mamushës duhet të azhurnoj ueb-faqen si dhe duhet që të publikojë dokumentet zyrtare në ueb-faqe si: procesverbalet nga takimet e kuvendit ashtu edhe vendimet e kryetarit dhe të gjitha dokumentet e rëndësishme tjera zyrtare. Ato duhet ti publikojë me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies karshi qytetarëve.

Kryetari të Komunës

- Komuna dhe Kryetari i saj duhet të angazhohen në finalizimin e rrugës kryesore të autostradës që lidh Mamushën me Prishtinën si dhe komunat tjera. Kjo rrugë do të ndihmonte rritjen e punësimit në këtë komunë pasi brenga kryesore e qytetarëve të Mamushës është punësimi.
- Të angazhohet në organizimin e pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga rrugët e Mamushës si dhe të përcaktohet vendi i hedhjes së mbeturinave ngase hedhja e tyre kudo shkakton kundërmim por edhe infeksion të qytetarëve.
- Në bazë të premtimit për një shëndetësi më të mirë të krijojë vende të reja pune në e Qendrën e Mjekësisë Familjare në Mamushë, ngase në raste urgjente gjatë natës Qendra është e mbyllur dhe qytetarët detyrohen të marrin rrugë deri te qendra e ndonjë komune tjetër.
- Kryetari duhet të respektoj më me përpikëri Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, duke filluar nga tubimet me qytetarë si dhe raportimet e detyrueshme financiare dy herë në vit me qëllim të rritjes së llogaridhënies/transparencës rreth punës së tij dhe vendimeve të ndryshme që merr gjatë vitit. Kryetari duhet të raportojë para kuvendit dhe qytetarëve për punën që e zhvillon në baza mujore dhe vjetore duke zbatuar Rregulloret Komunale dhe Udhëzimet Administrative.
- Kryetari duhet të kujdeset për përfshirje më të madhe të të rinjve dhe qytetarëve në vendimmarrje duke u angazhuar për plotësimin e kërkesave dhe nevojave të të rinjve në Mamushë si dhe të jetë më transparent duke njoftuar qytetarët për aktivitete në komunë dhe nevojat e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje.
- Kryetari duhet të angazhohet me shumë për përfshirjen e grave në vendimmarrje si dhe përfshirjen e rinisë në aktivitete të ndryshme si dhe të funksionojnë Këshillat lokal ngase këto këshilla janë indikatorë për hartimin e politikave e planeve të veprimit në Komunë.
- Kryetari i Komunës duhet të angazhohet për një qasje më të hapur ndaj shoqërisë civile si dhe të respektojë rekomandimet e arsyeshme që dërgohen në komunë me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies për shpenzimin e parasë publike si dhe qasjes më dokumente zyrtare.

Kryesuesit të Kuvendit:

- Kryesuesi gjatë menaxhimit të seancave të Kuvendit Komunal, duhet të respektoj me përpikëri rregulloren e punës së Kuvendit, duhet të kujdeset që rendi dhe qetësia publike të ruhet në kuvend
- Kryesuesi duhet të respektoj edhe të drejtën e anëtarëve të kuvendit për fjalën që marrin si dhe mos të diskutoj me ta gjatë fjalës së dhënë.


- Kryesuesi duhet të kufizoj kohën e drejtorëve që marrin fjalën në asamble sidomos atëherë kur nuk ju jepet fjala.
- Kryesuesi duhet të jetë faktor unifikues në mes të pozitës dhe opozitës në Asamble Komunale si dhe të ketë qasje neutrale gjatë udhëheqjes së seancave duke qenë i barabartë me të gjithë kuvendarët, përfshi të gjitha partitë politike.
- Kryesuesi duhet të angazhohet për bashkëpunim më të ngushtë me OJQ-të në organizimin e takimeve me qytetarë, që së bashku ta informojnë qytetarin për vendimet e asamblesë si dhe të bëjnë pjesë në vendimmarrje të gjithë qytetarët.

Asamblistëve të Kuvendit

- Anëtarët e Kuvendit duhet ti shqyrtojnë me kujdes të gjitha dokumentet që ju ofrohen 7 ditë para takimit në Kuvend dhe dokumentet e dërguara nga sekretariati i Kuvendit para se të mbahen takimet ti analizojnë me përpikëri me qëllim të mos marrjes së vendimeve të gabuara.
- Anëtarët e Kuvendit duhet të takohen më shpesh me qytetarët, dhe të angazhohen që problemet e qytetarëve të adresohen në Kuvend.
- Grupi i Grave anëtare të Kuvendit të fuqizojnë vlerat e tyre përmes ngritjes së zërit të tyre në Kuvend dhe të avancohen në vendimmarrje si dhe adresim të çështjeve me rëndësi për barazi gjinore.
- Anëtarët e Kuvendit duhet rrisin raportet me OJQ-të dhe të bashkëpunojnë me shoqërinë civile sepse mundë të kenë informatat e sigurta nga OJQ-të mbi nevojat dhe problemet që preokupojnë qytetarët.

Rregulloret dhe Vendimet


Dokumenti	Statusi	Votimi
<i>Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2015-2017</i>	Miraturar	Pro: 14 Kundër: 1 Abs: 0
<i>Rregullorja për Tatimin në Pronë për vitin 2014</i>	Miraturar	Pro: 13 Kundër:1 Abs:1
<i>Vendim për Transfer, Harmonizim dhe Ri-destinim të mjeteve 2014.</i>	Miraturar	Pro: 12 Kundër: 1 Abs:1
<i>Raporti i menaxhimit financiar Janar – Qershor 2014</i>	Miraturar	Pro: 13 Kundër: 1 Abs:0
<i>Vendimi për krijimin e komisionit për emërtimin e rrugëve</i>	Miraturar	Pro: 14 Kundër:0 Abs:0
<i>Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për siguri në Bashkësi.</i>	Miraturar	Pro: 14 Kundër:0 Abs:0
<i>Vendim për binjakëzimin e Komunës së Mamushës me Komunën e Kizilica Hamam të Turqisë</i>	Miraturar	Pro: 14 Kundër:0 Abs:0




Komuna
Graçanicë

SDY

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



14. Komuna GRAÇANICË

Vlerësimi i Përgjithshëm

Çfarë e karakterizoj komunën këtë vit

Organet vetëqeverisëse lokale përbëjnë nivelin e qeverisjes më të afërt për qytetarët. Organet vetëqeverisëse lokale kanë për detyrë të zgjidhin problemet e përditshme të qytetarëve, siç janë shëndetësia, arsimi, kanalizimi, transporti publik, terrenet sportive, shkollat, ngrohja dhe të gjitha problemet tjera me të cilat përballen qytetarët.

Ky raport i monitorimit të Kuvendit Komunal të Graçanicës ka për qëllim vlerësimin e punës së organeve vetëqeverisëse lokale. Qëllime të këtij monitorimi janë që t'ia afrojë punën e Kuvendit Komunal të Graçanicës qytetarëve, përfshirja e shoqërisë civile në punën e kuvendit komunal, si dhe shtjellimi i problemeve me të cilat përballen komuna. Ky raport mund të nxisë përfshirje më madhe të qytetarëve në punën e organeve vetëqeverisëse lokale. Duke shfrytëzuar rezultatet e këtij raporti do të mund të sajoheshin nisma të cilat trajtojnë probleme konkrete, duke nxitur kështu funksionim më të mirë të komunës. Raporti është rezultat i monitorimit dyvjetor nën ombrellën e projektit “Përfshirja civile në transparencë dhe llogaridhënie në nivel lokal” të zbatuar nga organizata joqeveritare Rinia Demokratike Serbe (RDS), në koordinim me Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), të financuar nga UNDEF.

Pas 20 muajsh mbikëqyrjeje aktive të punës së komunës së Graçanicës, takimeve me qytetarë dhe organizata të shoqërisë civile kemi identifikuar një numër të madh problemesh me të cilat përballen qytetarët e komunës së Graçanicës.

Problemët kyç në komunën e Graçanicës:

1. Problemet me komunalin (furnizimi i ujit, furnizimi i energjisë elektrike, largimi i mbeturinave);
2. Mungesa e medikamenteve dhe pajisjeve mjekësore në institucione shëndetësore;
3. Siguria në bashkësi;
4. Shkalla e papunësisë.

Një vit pas raportit të fundit mbi problemet dhe ngjarjet në komunën e Graçanicës, problemet mbesin të njëjtat. Gjatë debateve me qytetarë, të organizuara nga ana e organizatave të shoqërisë civile dhe organeve vetëqeverisëse lokale, problemet më të mëdha ndërlidhen me komunalitet. Restriksionet në furnizim të ujit dhe rrymës, si dhe grumbullimi i mbeturinave përbëjnë probleme me të cilat janë përballur dhe vazhdojnë të përballen qytetarët e Graçanicës. Problemi i furnizimit me ujë është një nga problemet më të mëdha në komunën e Graçanicës, ku restriksionet janë të përditshme.

Në pjesët rurale të komunës së Graçanicës ka pasur shumë ankesa për restriksionet e shpeshta të energjisë elektrike. Problem i cili vazhdon të imponohet është grumbullimi i mbeturinave. Qytetarët gjatë debateve kanë kërkuar nga autoritetet lokale, respektivisht përfaqësuesit e Komunës së Graçanicës që ta zgjidhin këtë problem, në mënyrë që të evitohen epidemitë e mundshme, sepse këto deponi kryesisht ndodhen afër vendbanimeve e fushave të lojës ku luajnë fëmijët e të rinjtë.

Përfaqësuesit e komunës theksuan se ata janë të vetëdijshëm për këto probleme se kanë organizuar aksione të shumta për largimin e deponive të egra dhe se këto probleme kanë

rrjedhë nga mospajtimet që i kanë pasur me një kompani komunale lokale me të cilën Komuna e Graçanicës ka kontratë. Gjithashtu është theksuar se Komuna ka në plan themelimin e një ndërmarrjeje komunale, e cila do të ndikonte dukshëm në çrrënjosjen e këtij problemi madhor. Problemet me mungesë të mjeteve dhe medikamenteve në institucione shëndetësore vazhdon të ekzistojë, por jo në masën e fillimit të vitit 2014. Megjithatë, edhe më tej pacientët e institucioneve në fjalë duhet të kërkojnë shërbime shëndetësore dhe medikamente në Mitrovicë të Veriut apo madje edhe në Serbi qendrore ku udhëzohen nga mjekët vendorë.

Probleme të ndërlidhura me sigurinë vazhdon të ketë dhe to janë të vetëdijshëm edhe zyrtarët lokalë. Sipas Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, problemet e tilla janë më të përhapura në pjesët rurale të komunës së Graçanicës, respektivisht në vendbanimet të cilat gjenden në cepa të territorit të komunës. Përparim të dukshëm Komuna e Graçanicës ka shënuar në fillim të vitit 2014 kur ka punësuar mbi 200 të rinj, kryesisht në sektorin e arsimit. Edhe përkrah kësaj nisme numri i të papunësuarve në komunën e Graçanicës vazhdon të jetë i madh.

Të arriturat në vitin 2014

Të arriturat më të mëdha të Komunës së Graçanicës janë patjetër në fushën e kulturës. Janë vendosur përmendore kulturore, është rregulluar Shtëpia e Kulturës, janë krijuar kushtet për Graçanicën që të bëhet me kinema, është hapur skena teatrore në mënyrë që qytetarët të mund t'i shohin disa vepra artistike.

Gjithashtu, është vazhduar praktika e mirë e integritit të komuniteteve pakicë në jetën shoqërore e politike në Komunën e Graçanicës. Në këtë rast, integrimi ka të bëjë me përfshirjen e komuniteteve pakicë në marrjen e vendimeve në nivel lokal, nga çka mund të nxirret konkluzioni se komuniteti multietnik ka arritur një nivel në të cilin mund të funksionojë.

Vlerësimi i punës

Kryetari i Komunës: Llogaridhënia dhe transparenca e kryetarit të komunës së Graçanicës kundrejt qytetarëve ka shënuar përmirësim të dukshëm në krahasim me vitet paraprake. Megjithatë, për të qenë kabineti i kryetarit të komunës më transparent dhe më i përgjegjshëm para qytetarëve, duhet që të prezantohen raportet e punës së Komunës për vitin paraprak, edhe para kuvendit të komunës edhe para qytetarëve.

Drejtoritë Komunale: Në punën e drejtorive të Komunës së Graçanicës është vërejtur ngritje e transparencës, që më së miri vërehet me prezantime publike të vazhdueshme dhe raportim më të rregullt para Kuvendit. Ajo që mbetet brengosëse është prania e një numri të vogël qytetarësh në këto prezantime publike si dhe interesimi i pamjaftueshëm i drejtorive për të zgjidhur këtë problem.

Anëtarët e kuvendit të komunës: Papërgjegjësia ndaj qytetarëve që i kanë zgjedhur ishte karakteristikë e disave prej anëtarëve të kuvendit të komunës së Graçanicës. Këtë e dëshmojnë të dhënat se në punën e kuvendit komunal aktivë janë më pak se 50% e anëtarëve të tij, me gjithë praninë e shumicës prej tyre. Është inkurajues fakti se më në fund po zhvillohen debate lidhur me çështje që janë me interes për qytetarët, që nuk ka qenë praktikë e viteve të kaluara.

Kryesuesi i Kuvendit: Pas nëntë muajve të parë të vitit 2014, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës u ndërrua, pasi që anëtari i emëruar si kryesues fillimisht dha dorëheqje për arsye private, duke qenë se nuk ishte në gjendje që në mënyrë të përgjegjshme të udhëheqë

punimet e Kuvendit të Komunës së Graçanicës për shkak të mungesave të shpeshta nga seancat. Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Graçanicës që u emërua rishtas udhëhiqte seancat e kuvendit të komunës duke respektuar normat demokratike dhe dispozitat ligjore, duke marrë pjesë në shumicën e debateve publike, ku mes tjerash paraqiste edhe qëndrimet e veta.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Ndërtimi i qendrës së shkollës së mesme	Nuk është realizuar
2	Aftësimi i sistemit për sjellje të ujit nga liqeni i Gazivodës në atë të Badovcit	Është realizuar
3	Sistemi alternativ i ujësjellësit	Është realizuar
4.	Ndërtimi i azilit për kafshë	Ka filluar
5.	Avancimi i sistemit shëndetësor – sigurimi i pajisjeve mjekësore për institucionet shëndetësore	Ka filluar

Transparenca në Komunë

Buxheti i Komunës së Graçanicës për vitin 2015 është më i lartë se sa ai i vitit 2014, por mjetet për projekte kapitale janë bindshëm më të ulëta. Shtimi i buxhetit është pasqyrim i ngritjes së linjave buxhetore për paga dhe mëditje. Kur flitet për prezantime publike të buxhetit, transparenca e organeve lokale ka qenë në nivel të kënaqshëm. Gjatë prezantimeve të buxhetit (pesë sish) nëpër vendbanime të komunës së Graçanicës, përfaqësues të autoriteteve lokale kanë paraqitur buxhetin, duke përshkruar në detaje listën e projekteve kapitale për vitin 2015.

Edhe përkundër pranisë së mirë nëpër këto prezantime, komuna nuk ka mundur asnjëherë të hartim të buxhetit apo materiale përcjellëse për diskutime publike. Përveç këtyre prezantimeve, buxheti, borxhi publik i komunës dhe raportet financiare nuk është e mundur të gjenden në faqen zyrtare të Komunës së Graçanicës në internet. Duhet që faqja zyrtare e komunës në internet të azhurnohet me raporte financiare, raporte mbi borxhin publik, auditime, plane të prokurimit, buxhet të komunës, si dhe raportin e punës së Komunës së Graçanicës për vitin paraprak.

Komuna e Graçanicës njoftimet publike mbi seancat plenare të caktuara i poston në faqet e veta në internet. Komuna e Graçanicës ka rregullore për transparencë, posedon numër të konsiderueshëm të resurseve, megjithatë mungojnë edhe disa gjëra që do të bënin që transparenca të jetë në nivel të kënaqshëm. Afati për njoftimin e qytetarëve i është përmbajtur rregullores për transparencë. Komuna e Graçanicës dukshëm e ka përmirësuar komunikimin me qytetarë, duke qenë se këtyre të fundit njoftohen përmes faqes zyrtare në internet dhe rrjeteve sociale (Facebook) mbi punën dhe vendimet e komunës dhe kuvendit të komunës.

Procesverbalet dhe vendimet e Kuvendit Komunal të Graçanicës tani mund të gjenden edhe në faqet zyrtare të Komunës së Graçanicës, duke u ofruar qytetarëve mundësi të informimit mbi zhvillimet brenda kuvendit komunal. Edhe njoftimet për mbledhjet e rregullta të komiteteve Komuna e Graçanicës i ka publikuar në faqet zyrtare të Komunës së Graçanicës, megjithatë, gjatë këtij monitorimi të komiteteve të rregullta, qytetarët nuk kanë marrë pjesë

në to. Edhe pse qytetarëve u lejohet pjesëmarrja në seanca të Kuvendit, në mënyrë që mund të paraqesin problemet e tyre, është fare i vogël numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë në to. Siç u përmend edhe më parë, procesverbalet e komiteteve mund të gjenden në faqet zyrtare të Komunës së Graçanicës, andaj, të gjithë qytetarët e interesuar mund t'u qasen këtyre të dhënave përmes tyre.

Prania e mediave në seanca të Kuvendit të Komunës nuk është në nivel të kënaqshëm, gjë që dëshmohet me faktin se nga 12 seancat plenare në vitin 2014 mediat kanë qenë të pranishme në vetëm një seancë. Në përgjithësi, mediat e kanë përcjellë punën e komunës ndërsa është vërejtur edhe raportim i mediave në diskutime publike. Zhvillimi më i theksuar në kuptim të përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve, përfshirë këtu edhe mediat, ka qenë caktimi i një radio termini gjatë të cilit pyetjeve të qytetarëve në emetim të drejtpërdrejtë u përgjigjen zyrtarët e komunës. Faqja zyrtare e komunës së Graçanicës në internet azhurnohet çdo ditë me lajme, të arritura të komunës dhe të arritura të qytetarëve të komunës.

Të dhënat e hulumtimeve të organizatave të shoqërisë civile tregojnë se transparenca e Komunës së Graçanicës nuk është në nivel të kënaqshëm, veçanërisht tek dega ekzekutive.

Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i takimeve	Numri	Në rend dite	Pjesëmarrja	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare	12	116	93.81%	30.5% ¹
Komiteti për Politikë dhe Financa	12	50	88%	23%
	Gjithsej mbledhje		Prania e shoqërisë civile	
Këshilli Komunal Sigurisë në Bashkësi	1		(Po/Jo)	
	Gjithsej		Prania mesatare	
Takimet me publikun	182		30	

Llogaridhënia në komunë

Kabineti i kryetarit dhe nënkryetarit të komunës, si dhe ata të drejtorëve të drejtorive komunale, përveç takimeve të rregullta javore me qytetarë, kanë bërë praktikë organizimin e takimeve me qytetarë nëpër vendbanime të komunës për tu njohur me problemet e qytetarëve dhe për t'i njoftuar ata lidhur me punët aktuale në komunë, prioritetet e komunës dhe gjendjen e gjithmbarshme në komunën e Graçanicës. Megjithatë, kryetari dhe udhëheqësia e komunës nuk kanë parashtruar raporte në formë të shkruar, me të cilat qytetarët do të informoheshin mbi punën e komunës, prandaj raportet zyrtare mbi punën e Komunës së Graçanicës nuk mund të gjenden në faqet zyrtare të Komunës së Graçanicës.

Sipas Statutit të Komunës së Graçanicës, kryetari i komunës është i obliguar që çdo gjashtë muaj të parashtrojë para Kuvendit të Komunës raport mbi gjendjen ekonomike-financiare në komunë, si dhe çdo tre muaj t'i njoftojë ata mbi punën e organeve ekzekutive. Kryetari i Komunës ka marrë pjesë në shumicën e seancave të kuvendit komunal dhe ka kontribuar në zgjidhjen e problemeve të saj, por ai nuk ka parashtruar raport gjashtëmuajor për punën e komunës para kuvendit. Drejtorët e drejtorive gjithashtu e kanë informuar rregullisht kuvendin mbi problemet që ndërlidhen me drejtoritë komunale përkatëse, si dhe me pikat e rendit të ditës që janë iniciuar nga drejtoritë përkatëse. Drejtori i financave ka parashtruar para kuvendit komunal raporte të rregullta tremujore dhe gjashtëmujore dhe deri tani nuk ka pasur ndonjë vërejtje lidhur me to nga anëtarët e kuvendit.

Gjatë këtij viti, organet ekzekutive komunale kanë mbajtur 18 diskutime publike dhe mbi dhjetë takime me qytetarë të Komunës së Graçanicës. Në krahasim me vitet paraprake është ngritur numri i pjesëmarrësve në to, d.m.th. qytetarëve që kanë marrë pjesë në takime, gjë që më së miri u vërejt gjatë prezantimit të buxhetit për vitin 2015. Gjithashtu, çdo të dytën të premte të muajit mbahen takime zyrtare me qytetarë, ku zyrtarët e komunës bashkëbisedojnë me ta lidhur me problemet në komunitet. Por, brengosë prezenca e vogël anëtarëve të kuvendit komunal në konsultime publike, duke qenë se në pesë sish kanë marrë pjesë vetëm tre anëtarë, përjashtojnë këtu kryesuesin e kuvendit të komunës, duke bërë që të arrihet konkluzioni se organet ligjvënëse kanë qenë pasive dhe nuk janë kujdesur sa duhet për brengat e qytetarëve të cilët është dashur t'i përfaqësojnë. Nuk jemi në dijeni nëse përfaqësuesit e strukturave opozitare kanë mbajtur konsultime publike me qytetarë, ndera brengosë edhe niveli i përfaqësimit të problemeve të qytetarëve nga ana e anëtarëve të kuvendit komunal gjatë seancave të të njëjtit.

Mes pyetjeve të shumta me të cilat Komuna e Graçanicës është marrë këtë vit kanë dominuar problemet me komunali, d.m.th. problemet e grumbullimit të mbeturinave dhe evitimit të tij. Organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët bashkërisht me komunën kanë ndërmarrë iniciativa dhe aksione për ta zgjidhur këtë problem, gjë që ka rezultuar me aksione vullnetare dhe me punë shtesë në terren nga drejtoria e inspeksionit, si dhe me inicimin e krijimit të ndërmarrjes publike komunale në Graçanicë, e cila tani është në fazë të themelimit. Megjithatë, problemet me komunali vazhdojnë të jenë të pranishme, por përfaqësuesit e komunës së Graçanicës kanë premtuar se të njëjtat do të zgjidhen në të ardhmen e afërt.

Rekomandimet për Komunë

Kryetarin e Komunës:

- Të parashtrojë raport gjashtëmuor të veprimtarisë (raporti i punës së Komunës së Graçanicës, planet zhvillimore të komunës, raportet për konsultimet publike me qytetarë, etj.)
- Të parashtrojë raport të punës së komunës para kuvendit komunal.
- Të joshë investitorë të huajë, investojë në ekonomi, subvencionojë ndërmarrjet e vogla, gjë që do të rezultonte me hapjen e vendeve të reja të punës dhe uljen e normës së papunësisë.
- Të sigurojë transparencë të shpenzimeve komunale (në rast të kërkesës të publikojë shpenzimet komunale, raportet tremujore të shpenzimeve, listën e pronave komunale, etj.)
- Linja telefonike pa pagesë – të sigurojë një linjë telefonike pa pagesë për brenga të qytetarëve.
- Të ofrohen shërbime të transportit publik në nivel lokal dhe rajonal, në veçanti në orët e pasdites.
- Të përmirësohen shërbimet e komunalive (pastrimi publik), duke gjetur një zgjidhje afatgjatë për largim të mbeturinave dhe eliminim të deponive të egra.
- Të raportohet para qytetarëve dhe shoqërisë civile, tu ofrohen atyre dokumentacione të rëndësishme të lartë, të mbahen konsultime të rregullta me qytetarë, në mënyrë që puna e autoriteteve lokale të jetë më transparente.
- Të fillohet me mbajtjen e seancave të këshillit për siguri në bashkësi, në të cilin do të merren vendime që do të ngritin sigurinë në territorin e komunës së Graçanicës.
- Të krijohen këshillat tjerë të paraparë nga kuvendi i komunës, me qëllim të shqyrtimit të detajuar të problemeve me të cilat përballet komuna.
- Të sigurohet një qasje më serioze dhe përfshirje e mediave në diskutimet dhe mbledhjet publike, me qëllim të sigurimit të pranisë së shtuar të qytetarëve.

Kryesuesin e Kuvendit:


- Të inkurajojë të gjithë anëtarët e kuvendit komunal për zgjidhje më efikase të problemeve në shqyrtim para komunës.
- Të organizojë konsultime të kuvendit me shoqërinë civile mbi probleme të rëndësishme për komunitetin.
- Tu ofrojë organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve prani të papenguar në seancat e kuvendit të komunës dhe të komiteteve të tij.

Anëtarët e Kuvendit



- Të marrin pjesë më aktivisht në diskutimet gjatë seancave.
- Të njihen me problematikën e pikave në rendin e ditës, të studiojnë tërë materialin para fillimit të seancave.
- Të kenë diskutime më cilësore, duke analizuar thelbin e problemeve.
- Të organizojnë takime të rregullta me qytetarë në vise rurale.
- Të përfaqësojnë qytetarët dhe të punojnë për të mirën e tyre, si dhe të kenë komunikim të rregullt me qytetarët dhe shoqërinë civile.

Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
Raporti financiar vjetor për vitin 2013	Miratu	Për: 18 Kundër: 0
Vendimi për anulimin e Vendimit për hartimin e planeve rregullative urbane hapësinore	Miratu	Për: 18 Kundër: 0 Abstenime: 0
Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi	Miratu	Për: 18 Kundër: 1 Abstenime: 0
Ridestnimi i projekteve kapitale	Miratu	Për: 19 Kundër: 0 Abstenime: 0
Anulimi i vendimeve të kuvendit të komunës për themelimin e institucionit parashkollor "Petar Pan"	Miratu	Për: 19 Kundër: 0 Abstenime: 0
Miratimi i raportit financiar tremujor për vitin 2014.	Miratu	Për: 17 Kundër: 0 Abstenime: 0
Ndryshimi dhe plotësimi i tarifave për lëshim të sipërfaqes publike komunale, miratu me vendimin.	Miratu	Për: 17 Kundër: 0 Abstenime: 0
Miratimi i planit zhvillimor të komunës së Graçanicës për periudhën 2014-2029.	Miratu	Për: 12 Kundër: 4 Abstenime: 1
Miratimi i plotësimit të rregullores për taksat administrative për lëshim të lejeve ndërtimore dhe tarifave për rregullim të infrastrukturës.	Miratu	Për: 17 Kundër: 0 Abstenime: 0
Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Graçanicës 2015-2017	Miratu	Për: 17 Kundër: 0 Abstenime: 0
Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për raportin financiar gjashtëmujor për vitin 2014	Miratu	Për: 18 Kundër: 0 Abstenime: 1
Vendimi për rishqyrtim të buxhetit të vitit 2014	Miratu	Për: 18 Kundër: 0 Abstenime: 0
Vendimi për ndarjen e subvencioneve në vlerë prej 50.000,00 euro për kooperativën bujqësore	Miratu	Për: 18 Kundër: 0 Abstenime: 0
Vendimi për miratimin e buxhetit për periudhën 2015-2017	Miratu	Për: 17 Kundër: 0 Abstenime: 0
Rregullore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015	Miratu	Për: 18 Kundër: 0 Abstenime: 0
Vendimi për pranimin e gjuhës rome si gjuhë në përdorim zyrtar	Miratu	Për: 14 Kundër: 0 Abstenime: 4
Vendimi për bartjen e kursimeve në projekte kapitale	Miratu	Për: 17 Kundër: 0
Vendimi për miratimin e kërkesave për raportin financiar nëntëmujor	Miratu	Për: 16 Kundër: 0 Abstenime: 0
Rregullore për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe shërbimet publike të komunalive	Miratu	Për: 16 Kundër: 0 Abstenime: 0
Vendimi për planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Graçanicës për vitin 2015	Miratu	Për: 17 Kundër: 0 Abstenime: 0
Vendimi për formimin e Komitetit për Shërbime Publike	Miratu	Për: 17 Kundër: 0 Abstenime: 0
Vendimi për themelimin e ndërmarrjes publike komunale	Miratu	Për: 19 Kundër: 0 Abstenime: 0
Miratimi i kërkesës për bartje të mjeteve nga kursimet në investime kapitale tek mallrat dhe shërbimet	Miratu	Për: 16 Kundër: 0 Abstenime: 0



Komuna Prizren



15. Komuna PRIZREN

Parregullsitë

Kuvendi i Komunës së Prizrenit pas zgjedhjeve lokale të vitit 2013, në fillim të këtij viti është marrë me konstituimin e trupave ndihmëse të Kuvendit përkatësisht në themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe Komitetit për Komunitete. Edhe në fillim të mandatit nga ana e organit më të lartë vendimmarrës kishte shkelje procedural dhe ligjore në drejtim të konstituimit.

Komisioni në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ

Udhëzimi Administrativ 2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesuesit thotë “ Kuvendi i komunës me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Kuvendit të Komunës formon komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit i cili përbëhet nga tre (3) deri në pesë (5) anëtarë të Kuvendit të Komunës”.Gjatë procedurave të zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Kuvendi ka bërë shkelje procedurale dhe në kundërshtim me UA 2009/1, duke themeluar Komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit për Kryesues të Kuvendit prej 7 anëtarëve.

Nënkryetari për Komunitete

Nenin 61 i LVL-së thotë se “Komunat ku të paktën 10% e qytetarëve i përkasin komuniteteve jo shumicë do të kenë një nënkryetar për komunitete. Emërimi dhe shkarkimi i Nënkryetarit për Komuniteteve propozohet nga Kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve jo shumicë”.

Mirëpo, Kuvendi i Komunës së Prizrenit bashkë me Kryetarin e Komunës edhe pas një viti të konstituimit të organeve të vetëqeverisjes lokale kanë dështuar në zgjedhjen e Nënkryetarit për Komunitete.

Shkelje ligjore gjatë thirrjes së seancës së jashtëzakonshme

Kuvendi i Komunës së Prizrenit gjatë muajit shkurt në mbajtjen e seancës së parë të jashtëzakonshme ka shkelur nenin 44.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Seanca e jashtëzakonshme është thirrur me datë 10.03.2014 dhe është mbajtur me datë 12.03.2014 e cila është në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatësisht nenin 44.4 të LVL-së i cili thotë se “takimi i jashtëzakonshëm i kuvendit të komunës nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës dhe publiku nuk janë njoftuar me shkrim, siç kërkohet me rregulloret e punës, së paku tri (3) ditë pune para datës së mbajtjes së takimit”.

Afatet kohore për raportim financiar vjetor

Në kuadër të monitorimit të punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit është hasur edhe në mos respektim të afateve kohore në raportim financiarë nga ana e Kryetarit të komunës së Prizrenit i cili në bazë të ligjit për menaxhimin e financave publike detyrohet që të raportojë për vitet paraprake fiskale në kuvendin e Komunës jo më vonë se 31 mars të vitit kalendarik.

Shpenzime enrome në disa kategori në vitin 2013

Edhe në vitin 2013, nga qeveria lokale e Prizrenit është vazhduar me shpenzime enorme dhe jashtë çdo standardi për situatën ekonomiko-financiare në komunën e Prizrenit.

Lidhur me këtë, në kodin buxhetorë 13780, qeveria komunale e Prizrenit në vitin 2013 ka shpenzuar 133.345 euro karburant për vetura. Me një përlllogaritje të vogël kjo qeveri në

vitin e kaluar ka shpenzuar 365 euro në ditë karburant për vetura ($133.345/365=365$ euro), pra shpenzime ditor duke llogaritur çdo ditë të vitit kalendarik përfshirë këtu edhe ditët e vikendit dhe festat zyrtare.

Mungesa e reflektimit në gatishmërinë e qeverisë lokale të Prizrenit në shkurtime dhe shpenzimeve enorme në disa kategori bie ndesh me parimin e mirëqeverisjes dhe shpenzimit të parësor publik në mënyrë efektive në dobi të qytetarëve.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Shtimi i kapaciteteve të ujit të pijes	Pjesërisht
2	Ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujërave të zeza	Pa realizuar
3	Ndërtimi I tregjeve dhe parkingjeve me partneritet PP	Pa realizuar
4.	Trafiku urban me Partneritet PP	Pa realizuar
5.	Ndërtimi I sheshit të lidhjes së Prizrenit	Ne ndërtim e sipër(faza përfundimtare)
6.	Kompletimi i planit për menaxhim të mbeturinave	Realizuar
7.	Ndërtimi I objektit të bibliotekës	Fillimi i realizimit të projektit

Transparenca e Komunës

Kuvendi i Komunës së Prizrenit gjatë këtij viti ka çaluar edhe si ai i përket transparencës. Kuvendi i Prizrenit nuk ka respektuar dispozitat e tilla ligjore në njoftimin e publikut përmes ueb faqeve për mbajtjen e mbledhjeve të këtyre institucioneve.

Po ashtu, në bazë të përcjelljes së ueb faqeve të Komunave mbi respektimin e Udhëzimit Administrativ në Komuna 05/2013, del se vendimet e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, kanë pasqyruar pjesërisht vendimet e marruara në seancat e kuvendit në gjashtë muajt e parë të vitit 2014. Një pjesë tjetër e mungesës së transparencës së punës së këtij organi ka qenë edhe mungesa e njoftimeve me kohë për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitet si dhe mungesa e pasqyrimit të procesverbaleve të mbledhjeve të këtyre trupave ndihmës në ueb faqen zyrtare të Komunës.

KDI gjatë muajit prill 2014, ka proceduar disa kërkesa për qasje në dokumente publike. Bazuar në afatin kohor të përcaktuar me ligjin për qasje në dokumente publike ku specifikon se “institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesshëm dhe informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim”. Komuna e Prizrenit ishte njëra ndër komunat të cilat nuk ka respektuar afatin kohorë në kthimin e përgjigjes për lejimin ose mos lejimin e qasjes në dokumente publike.

Problemet në Kuvendin e Komunës

Në njërën nga seancat e mbajtura në këtë vit kishte edhe përplasje ndërmjet Kryetarit të Komunës dhe një anëtarit të Kuvendit duke rezultuar me shantazh të Kryetari ndaj anëtarit të Kuvendit për shkak të kërimit të tij për dorëheqje morale pas vendimit të gjykatës themelore që gjeti fajtorë Kryetarin e Komunës së Prizrenit me rastin e dhënies së pronave komunale në shfrytëzim.

Lidhur me këtë, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) reagimin e kryetarit të Komunës së Prizrenit e cilësoj si shantazh dhe kërcim ndaj anëtarit të kuvendit duke i bërë thirrje kryetarit të kërkojë falje publike dhe njëherit Kryesuesit të Kuvendit të Komunës në respektim të Rregullores së punës së Kuvendit për një disiplinë dhe rend më të mirë për mbarëvajtjen e seancave të kuvendit të Komunës së Prizrenit.


KKSB as planin as raportime në Kuvendin e Komunës

Pas konstituimit të institucioneve vetëqeverisëse lokale, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka ndërmarrë hapa në drejtim të themelimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Mirëpo, edhe në themelimin e këtij mekanizmi, Kuvendi i Komunës së Prizrenit çaloj që të kërkojnë nga ky mekanizëm të prezantojë Planin Vjetor të punës dhe të kërkojnë nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) raportime për aktivitetet dhe punën e këtij mekanizmi institucional.


Rekomandimet për Komunë

- Kuvendi i Komunës së Prizrenit bashkë me Kryetarin e Komunës, duke u bazuar në neni 61 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, duhet që sa më parë të bëjë zgjedhjen e Nënkryetarit për Komunitete
- Kuvendi i Komunës së Prizrenit duhet të respektojë dispozitat ligjore dhe të bëjë njoftimin e publikut përmes ueb-faqes zyrtare për mbajtjen e mbledhjeve të institucioneve komunale , si dhe të pasqyrojë në tersi vendimet e marruara në seancat e kuvendit.
- Të respektohen afatet ligjore për raportim financiarë vjetorë nga ana e Kryetarit të Komunës, i cili në bazë të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë detyrohet që të raportojë për vitet paraprake fiskale në Kuvendin e Komunës jo më vonë brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tre mujori.
- Të praktikohet publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kuvendit si dhe atyre Komitetit për Politik dhe Financa në ueb-faqen zyrtare të Komunës.
- Kuvendi i komunës së Prizrenit duhet të kërkojë prezantimin e planin, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi , si dhe të kërkojë raportime për aktivitetet dhe punën e këtij mekanizmi institucional.
- Të ndërpriten shpenzimet enorme nga ana e qeverisë komunale të Prizrenit në disa kategori , të cilat bien ndesh me parimin e mirëqeverisjes dhe shpenzimin e parasë publike në mënyrë efikase dhe në dobi të qytetarëve.




Komuna Suharekë

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



16. Komuna SUHAREKË

Parregullsitë

Kuvendi i Komunës së Suharekës pas zgjedhjeve lokale të vitit 2013, në fillim të këtij viti është marrë me konstituimin e trupave ndihmës të Kuvendit përkatësish në themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe Komitetit për Komunitete. Edhe në fillim të mandatit nga ana e organit më të lartë vendimmarrës kishte shkelje procedurale dhe ligjore në drejtim të konstituimit.

Afatet kohore për raportim financiarë

Në kuadër të monitorimit të punës së Kuvendit të Komunës së Suharekës është hasur edhe në mos respektimin e afateve kohore në raportim financiarë nga ana e Kryetarit të komunës së Suharekës i cili në bazë të ligjit për menaxhimin e financave publike detyrohet që të raportojnë për vitet paraprake fiskale në kuvendin e Komunës jo më vonë se brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tre mujori.

Duke iu referuar nenit 45.4 të Ligjit Nr.04/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit. “Kryetari i komunës duhet të përgatitë dhe t’i dorëzojë kuvendit komunal raporte tremujore të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të tremujorit i cili sapo ka përfunduar. Këto raporte duhet t’i dorëzohen kuvendit komunal dhe një kopje duhet t’i dorëzohet ministrit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të çdo tremujori dhe më pas duhet të publikohen nga kryetari i komunës në faqen e internetit të komunës”.

KDI rithekson nevojën e raportimit financiarë të ekzekutivit të komunës karshi kuvendit si institucion më i lartë i vetëqeverisjes lokale dhe si të tilla këto raporte të ekzekutiveve komunale të jenë rregullta dhe periodike në bazë të legjislacionit në fuqi.

Transparenca në Komunës

Në Kuvendin e Komunës së Suharekës edhe pas konstituimit të këtij organi pas zgjedhjeve lokale 2013 është vazhduar me trendin e vjetër në hartimin e procesverbaleve prej vetëm 2-3 faqesh raport nga mbledhjet e Kuvendit. Kjo situatë, edhe në vitin 2014 ka kontribuar në pamundësinë e informimit të plotë dhe të drejtë të qytetarëve mbi diskutimet e realizuara nga të zgjedhurit e tyre në organin më të lartë të vetëqeverisjes lokale.

Në bazë të përcjelljes të ueb faqes së Komunës së Suharekës mbi respektimin e Udhëzimit Administrativ në Komuna 05/2013 për transparencë në Komuna, del se vendimet e kuvendit nuk janë të pasqyruara në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kësisoj, Kuvendi i Komunës së Suharekës çalojë sa i përket respektimit të dispozitave ligjore në publikimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës në ueb faqen zyrtare duke pamundësuar qytetarëve të kësaj komune të njihen me punën dhe vendimet e këtij institucioni.

KDI gjatë muajit prill 2014, në drejtim të kuvendeve të komunave të regjionit të Prizrenit ka kërkuar qasje në dokumente publike. Bazuar në afatin kohor të përcaktuar me ligjin për qasje në dokumente publike ku specifikohet se “institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishtëm dhe informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim”.

Komuna e Suharekës ishit njëra ndër dy komunat e regjionit të Prizrenit e cila nuk ka respektuar afatin kohorë në kthimin e përgjigjes për lejimin ose mos lejimin e qasjes në dokumente publike.

Buxheti për vitin 2015

Kuvendi i Komunës së Suharekës, ishte i vetmi institucion në komunat e regjionit të Prizrenit i cili nuk arriti të miratojë projektbuxhetin e komunës për vitin 2015 në kohën e paraparë dhe në pajtim me dispozitat ligjore.


Qarkorja Buxhetore 2015/1 e datës 14 maj, e lëshuar nga ana e Ministrisë dhe Financave, 30 shtatorin 2014 ka specifikuar afatin kohor kur komunat duhet të miratojnë projektbuxhetin e vitit 2015. Si rezultat i mungesës së numrave dhe kundërshtimit të këtij projekt buxheti nga ana e opozitës, Kuvendi i Komunës dështoi që me 30 Shtator të miratojë këtë politikë publike. Si rezultat i saj, Kuvendi i Komunës së Suharekës, këtë politikë publike ka miratuar me vonesë në një seancë të thirrur si të jashtëzakonshme me datë 01.10.2014.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Punësimi i te rinjve përmes biznesit me ane të subvencioneve	Pa realizuar (Parashikimi-180 mijë euro janë paraparë për realizimin e këtij premtimi për 2015-2017)
2	Përkrahje OJQ-ve në Suhareke përmes projekteve, në vlerë prej 300 mijë euro	Pjesërisht
3	Hulumtimi dhe hartimi i projektit detal të ujërave të zeza në Suhareke	Pa realizuar (Premtimi përgjatë mandatit katër vjeçar)
4.	Ndërtimi i shkollave Nishor, Leshan, dhe ndërtimi i 3 çerdheve për fëmijë	Pa realizuar (Premtimi 2015)
5.	Ndërtimi i terreneve sportive në disa vendbanime në vlerë prej 900.000 euro	Realizuar (Pjesërisht)
4.	Ujësijellësi (Investime në ato banime që nuk kanë ujësijellës fare apo e kanë të rrjetin e dobët në vlerë prej 736900 euro)	Pjesërisht
5.	Ndërtimi i shkollës në Duhel dhe Sllapuzhan	Pjesërisht


Rekomandimet për Komunë

- Të përdoret më shumë ueb-faqja e komunës për publikimin e çdo vendimi dhe dokumenti strategjik të nivelit lokal.
- Të respektohen afatet ligjore për raportim financiarë vjetorë nga ana e Kryetarit të Komunës, i cili në bazë të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë detyrohet që të raportojë për vitet paraprake fiskale në Kuvendin e Komunës jo më vonë brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tre mujori.
- Kuvendi i Komunës së Suharekës, duhet ta ketë parasysh në të ardhmen që të arrijë me kohë dhe në pajtim me dispozitat ligjore të miratojë projektbuxhetin e komunës për vitet paraprake.
- Të praktikohet publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kuvendit si dhe atyre të Komitetit për Politik dhe Financa në ueb-faqen zyrtare të Komunës.




Komuna Rahovec

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



17. Komuna RAHOVEC

Kuvendi i Komunës së Rahovecit pas zgjedhjeve lokale të vitit 2013, në fillim të këtij viti është marrë me konstituimin e trupave ndihmëse të Kuvendit përkatësisht në themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe Komitetit për Komunitete. Edhe në fillim të mandatit nga ana e organit më të lartë vendimmarrës kishte shkelje procedural dhe ligjore në drejtim të konstituimit.

Parregullsitë

Komiteti për Komunitete

Me rastin e Konstituimit të Komitetit për Komunitete, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka bërë shkelje të nenit 43.2 të Statutit të Komunës së Rahovecit i cili thotë se “numri i anëtarëve të Komitetit për Komunitete duhet të jetë prej 7 anëtarëve”. Këtë dispozitë ligjore të Statutit të Komunës nuk e kanë përfillë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit dhe si rezultat, Komitetin për Komunitete e kanë rritur në 11 anëtarë. Edhe miratimi i emrave për Komitetin për Politikë dhe Financa ka rezultuar të ketë shkelje ligjore ngase një anëtarë i Kuvendit të Komunës së Rahovecit ende pa dhanë betimin si anëtarë i këtij institucioni është votuar të jetë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Shkelje ligjore gjatë thirrjes së seancës së jashtëzakonshme

Kuvendi i Komunës së Rahovecit gjatë thirrjes së seancës së jashtëzakonshme gjatë muajit Shkurt ka shkelur ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Thirrja e seancës me pikë të vetme të rendit të ditës dhe shtimi i dy pikave të reja në rend dite është shkelje ligjore të nenit 44.3 të LVL-së i cili thotë se “pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes”.

Afatet kohore për raportim financiar

Kuvendi i Komunës së Rahovecit gjatë vitit 2014, nuk ka respektuar afatin rreth obligimeve ligjore që rrjedhin nga ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit lidhur me raportimet tre mujore financiare.

Referuar nenit 45.4 të Ligjit Nr.04/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit. “Kryetari i komunës duhet të përgatitë dhe t'i dorëzojë kuvendit komunal raporte tremujore të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të tremujorit i cili sapo ka përfunduar. Këto raporte duhet t'i dorëzohen kuvendit komunal dhe një kopje duhet t'i dorëzohet ministrit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të çdo tremujori dhe më pas duhet të publikohen nga kryetari i komunës në faqen e internetit të komunës”.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Plani rregullativ për qytetin e Rahovecit	Pa realizuar
2	Përmirësimi me ujë te pijshëm për Rahovec	Pjesërisht
3	Ndërtimi i objektit banimi për familjet e dëshmoreve	Pa realizuar
4.	Krijimi i një trupe amatore, skulptore si dhe përkrahje ansambleve te komunës se Rahovecit	Pa realizuar

5.	Ndërtimi i stacionit të pompave të ujit në Bërnjak me rezervuar	Pa realizuar
6.	Plani regullativ për qytetin e Rahovecit	Pa realizuar
7.	Përmirësimi me ujë të pijshëm për Rahovec	Pjesërisht

Transparenca në Komunë

Gjatë gjashtë mujorit të parë të këtij viti kishte lëshime të dukshme nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit në njoftimin e publikut përmes ueb faqes së komunës për mbajtjen e mbledhjeve duke mos respektuar dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale si dhe Udhëzimin Administrativ 05/2013 për transparencë në Komuna.

Po ashtu, në bazë të përcjelljes të ueb faqeve të Komunave mbi respektimin e Udhëzimit Administrativ në Komuna 05/2013, del se vendimet e kuvendit të Komunës së Rahovecit nuk kanë qenë të pasqyruara në ueb faqen e Komunës së Rahovecit duke thelluar edhe më tej transparencën e këtij institucioni karshi publikut. Së fundmi, Komuna e Rahovecit ka mbetur edhe pa Zyrtarë për Informim. Mungesa e një zyrtari për informim të publikut ka rënduar edhe më tepër mungesën e transparencës së pushtetit lokal në Rahovec.

Mbledhjet e Kuvendit

Mungesa e vazhdueshme e Kryetarit të Komunës në mbledhjet e Kuvendit të Komunës nuk mund të arsyetohet. Kryetari i Komunës nuk duhet të jetë indiferent ndaj mbledhjeve të kuvendit dhe duhet të jetë pjesë e mbledhjeve ngase rendi i ditës dhe vendimet që merren gjatë punimeve të seancës caktohen nga kryesuesi në marrëveshje me Kryetarin dhe ato vendime vinë si propozime të tij si udhëheqës i ekzekutivit komunal.

Mungesa permanente e Kryetarit të Komunës në mbledhjet e Kuvendit është e pa justifikueshme dhe ai duhet gjithsesi të jetë i pranishëm, mbi gjitha duhet të respektohet edhe Kuvendi i Komunës si institucion më i lartë i vetëqeverisjes lokale. Andaj edhe i bëjmë thirrje Kryetarit të komunës së Rahovecit që të jetë i pranishëm në mbledhjet e Kuvendit me gjithë kabinetin e tij qeverisës duke përfshirë edhe Nënkryetarin në këtë rast.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës


Në seancën e muajit mars të Komunës së Rahovecit, gjatë punimeve është përdorë gjuhë jo-parlamentare dhe fyese për anëtarin e këtij institucioni nga ana e drejtorit komunal. Përdorimi i gjuhës jo parlamentare dhe fyese në kuvendin e komunës së Rahovecit tregon për nivelin e ultë të kulturës institucionale. Drejtorët e drejtorive komunale si dhe anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit duhet të përmbahen dhe të respektojnë diversitetin e mendimeve dhe ideologjitë partiake dhe vetë institucionin e Kuvendit të Komunës së organ më i lartë i vetëqeverisjes lokale.

KKSB as planin as raportime në Kuvendin e Komunës


Pas konstituimit të institucioneve vetëqeverisëse lokale, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka ndërmarrë hapa në drejtim të themelimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) duke themeluar këtë mekanizëm mjaft domethënës në vetëqeverisjen lokale. Mirëpo, edhe në themelimin e këtij mekanizmi, Kuvendi i Komunës së Rahovecit çaloj që të kërkojnë nga ky mekanizëm të prezantojë Planin Vjetor të punës dhe të kërkojnë nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) raportime për aktivitetet dhe punën e këtij mekanizmi institucional.

Rekomandimet për Komunë


- Kryetari i Komunës së Rahovecit duhet të jetë pjesë e mbledhjeve të Kuvendit ngase rendi i ditës dhe vendimet që merren gjatë punimeve të seancës caktohen nga kryesuesi në marrëveshje me Kryetarin dhe ato vendime vinë si propozime të tij si udhëheqës i ekzekutivit komunal.
- Të eliminohet gjuha fyese dhe jo-parlamentare ndaj anëtarëve të Kuvendit. Drejtorët e drejtorive komunale si dhe anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit duhet të përmbahen dhe të respektojnë diversitetin e mendimeve dhe ideologjitë partiake.
- Me rastin e Konstituimit të organeve dhe trupave të Kuvendit, Komuna së Rahovecit duhet të ketë kujdes në mënyrë që mos të bëjë shkelje të Statutit të Komunës.
- Kuvendi i komunës së Rahovecit duhet ta miratoj planin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si dhe të kërkoj raportime për aktivitetet dhe punën e këtij mekanizmi institucional.
- Komuna e Rahovecit duhet ta funksionalizoj dhe ta fuqizojë zyrën për marrëdhënie me publikun.
- Të respektohen afatet ligjore për raportim financiarë vjetorë, rreth obligimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë lidhur me raportimet tre mujore financiare.
- Të praktikohet publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kuvendit si dhe atyre të Komitetit për Politik dhe Financa në ueb-faqen zyrtare të Komunës.



Komuna Dragash



Dega Ekzekutive



18. Komuna DRAGASH

Parregullsitë

Mos zbatimi i obligimeve Ligjore

Duke u bazuar në nenin 61 të LVL-së i cili thotë se “Komunat ku të paktën 10% e qytetarëve i përkasin komuniteteve jo shumicë do të kenë një nënkryetar për komunitete. Emërimi dhe shkarkimi i Nënkyetarit për Komuniteteve propozohet nga Kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve jo shumicë”

Kuvendi i Komunës së Dragashit ka dështuar në zgjedhjen e nënkryetarit të komunës nga komunitetit edhe përkundër tentativës që me shkelje procedurale të emërohet nënkryetari për shkak të propozimit të dy emrave për nënkryetarë dhe votimit me vota të fshehta nga subjektet politike minoritare të përfaqësuara në këtë institucion. Andaj Kryetari i Komunës së Dragashit përgjatë një viti të plotë të mandatit të tij qeverisës nuk ka arritur të ketë nënkryetarin e Komunës nga radhë e Komunitetit.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në kuadër të gjeturave të monitorimit dhe raportimeve të rregullta i ka rekomanduar kryetarin në fjalë që të plotësojë këtë vakum institucional mirëpo në këtë dymbëdhjetë muaj përgjatë vitit 2014, ky rekomandim i KDI-s nuk ka gjetur zbatim nga ky institucion. Lidhur me këtë çështje, nuk është vërejtur ndonjë intervenim edhe nga ana e MAPL-së si organ mbikëqyrës për evitimin e këtij vakumi institucional, që pos tjerash konsiderohet shumë i rëndësishëm në integrimin dhe avancimin e pozitës së komuniteteve në komunat përkatëse.

Shkeljet Ligjore

Shkresa e institucioneve qendrore (MAPL) dërguar Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës së Dragashit, duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr.02/2011, për fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit Nr.06-6541/2, të datës 29.04.2013, të Kuvendit të komunës së Dragashit ka konstatuar se:

Kuvendi I Komunës së Dragashit në miratimin e vendimit N. 06-6541, ka vepruar në kundërshtim me nenin 19.2 të Ligjit Nr. L-53 për Gjuetinë, dhe në kundërshtim me UA Nr. 10/207, për Kriteret e Caktimit të Zonave për Themelimin e Vendgjethive.

Kuvendi i Komunës së Dragashit, fillimisht duhet të merr pëlqim paraprak nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e më pastaj të fillojë procedurat tjera konform Ligjit të lartcekur dhe Udhëzimit Administrativ.

Andaj Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 81 pika 4 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ka kërkuar nga Kuvendi I Komunës së Dragashit që të ndërmarrë veprime konkrete dhe në afat prej 30 ditësh ta bëjë rishqyrtimin e vendimit Nr. 06-6541/2.

Po ashtu shkresa tjetër e institucioneve qendrore (MAPL) dërguar Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës së Dragashit, duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë Nr.02/2011, për fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit Nr. 020-17767/6 të datës 29.10.2014, të Kuvendit të Komunës së Dragashit, ka konstatuar se:

Vendimi me Nr.020-17767/6 është në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Kuvendi i Komunës së Dragashit nuk mundë të jep pronën e paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë duke mos I respektuar procedurat të cilat përcaktohen në ligjin e lartshënuar.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 81 pika 4 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Dragashit që të ndër marrë veprime konkrete që në afat prej 30 ditësh të bëjë rishqyrtimin e Vendimit nr. 020-17767/6 të Kuvendit të Komunës së Dragashit.

Statusi i Premtimeve Zgjedhore

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Planet zhvillimore dhe urbane	Pa realizuar
2	Investime në rrjetin e rrugëve Ndërtimi i rrugës që lidh Dragashin me Republikën e Maqedonisë dhe ndërtimi dhe meremetimi i rrugës Dragash-Zhur	Meremetimi - pjesërisht, rruga Dragash-Maqedoni Pa realizuar
3	Ndërtimi i shkollave në Lapushnik dhe Buqe	Pa realizuar
4.	Ndërtimi i ambulancave në Globocice, meremetimi i QMF-se në Dragash dhe QMF-së në Blaq	Globoqic (Pjesërisht) Te tjerat përfundim e sipër (faza përfundimtare)
5.	Energjia efiçente në institucione publike	Pjesërisht

Transparenca në Komunë

Me qëllim të avancimit të punës së kuvendeve të komunave të regionit të Prizrenit lidhur me transparencën dhe llogaridhënien, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka analizuar angazhimin e kuvendit të komunës së Dragashit në përdorimin e mekanizmave për transparencë dhe llogaridhënie institucionale.

KDI i ka rekomanduar përfaqësuesve të dalë nga zgjedhjet lokale 2013, në komunën e Dragashit që të rrisin angazhimin në: përdorimin e ueb faqes zyrtare të Komunës për publikimin e çdo vendimi dhe dokumenti strategjik të nivelit lokal, po ashtu të rekrutojnë Zyrtarin për Informim Komuna e Dragashit dhe të funksionalizohet dhe fuqizohet zyra për marrëdhënie me publikun në komunën e Dragashit, të hartohen Planet vjetore për transparencë komunale, në transmetimin e punimeve të seancave nga mediat lokale në komunat të cilat nuk kanë praktikë deri më tani një gjë të tillë, në ri draftimin e Rregulloreve për transparencë në komunë me qëllim të përfshirjes së publikimit të akteve të Kryetarëve në ueb faqe por edhe hapja e takimeve të kryetarëve me drejtorë të drejtorive komunale për qytetarët dhe Shoqërinë Civile, në përdorimin e një linku në ueb-faqen zyrtare të komunës për qasje në dokumente Publike.

Rekomandimet për Komunë

- Kuvendi i Komunës së Dragashit bashkë me Kryetarin e Komunës, duke u bazuar në neni 61 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, duhet që sa më parë të bëjë zgjedhjen e Nënkrjetarit për Komunitete
- Të rritet angazhimi në përdorimin e ueb faqes zyrtare të Komunës për publikimin e çdo vendimi dhe dokumenti strategjik të nivelit lokal, po ashtu të rekrutojë edhe Zyrtarin për Informim si dhe të funksionalizohet dhe fuqizohet zyra për marrëdhënie me publikun në komunën e Dragashit,
- Të praktikohet publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kuvendit si dhe atyre të Komitetit për Politik dhe Financa në ueb-faqen zyrtare të Komunës
- Përdorimi i një linku të veçantë në ueb faqen zyrtare të komunës për qasje në dokumente Publike.
- Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Dragashit të jenë më sy qelë në trajtimin e dokumenteve dhe respektimin e procedurave ligjore dhe udhëzimeve administrative, në mënyrë që mos të bien ndesh dhe të merren vendime të kundërligjshme, të cilat do ta dëmtonin imazhin e Kuvendit.

PËRFUNDIMET

Çdo vit i ri i qeverisjes është një mundësi e re për udhëheqësit komunal për të përmirësuar vetë-qeverisjen lokale. Është një mundësi e re për të rregulluar më mirë shërbimet publike që i ofron komuna, një mundësi e re për të shpenzuar më përgjegjshëm paratë publike, një mundësi e re për të instaluar një kulturë më transparente të qeverisjes, dhe një mundësi për të qenë më afër qytetarëve në konsultime për punët e komunës dhe për të zgjidhur hallet e komuniteteve të tyre. Përpos vullnetit të mirë për të shfrytëzuar këtë mundësi, duhet edhe reflektim për zhvillimet e viteve paraprake. Ky raport, njëjtë si ai i para një viti, synon të ofrojë një vlerësim të arritjeve, por edhe mangësive dhe pengesave që janë paraqit gjatë vitit 2014.

Nga të zgjedhurit lokal pritet që të ofrojnë zgjidhje për problemet publike të banorëve dhe pritet që të jenë bashkëpunues me të tjerët për zgjidhjen e këtyre problemeve të përbashkëta, duke përfshirë këtu shoqërinë civile dhe partitë opozitare. Pritet që Kryetarët e komunave të jenë më të gatshëm për të dhënë më shumë llogari tek Kuvendet Komunale. Ndërsa nga anëtarët e Kuvendeve Komunale pritet që të jenë më aktiv dhe më konstruktiv në zhvillimet e kuvendit. Përkundër kapaciteteve të vogla organizative, nga Kuvendet Komunale pritet që të organizojnë më shumë diskutime publike për rregullore të rëndësishme dhe jo vetëm të presin atë çfarë servohet nga Zyra e Kryetarit.

Shërbimet publike më cilësore dhe realizimi i premtimeve më së miri bëhen kur ka bashkëpunim konstruktiv edhe me shoqërinë civile dhe grupet profesionale. Këtë vit, udhëheqësit e komunave u shfaqën më bashkëpunuese me organizatat jo-qeveritare se në vitin 2013 kur ne raportuam, pasi që gjysma komunave vetëm i kanë vënë në praktikë kërkesat nga fushatat e avokimit që organizatat tona partnere i kanë ndërmarrë. Këtu mund të përmendim disa nga to si avokimi për sigurimin e analizave të ujit të pijshëm dhe menaxhimi i mbeturinave në Viti, sjellja e kanalizimit në lagjen 2 Korriku në Kaçanik, ndriçimi publik në Klinë. Mirëpo, ka ende mjaft hapësirë për t'i dhënë shoqërisë civile dhe qytetarëve për të ofruar zgjidhje dhe alternative, si në politika lokale ashtu edhe në projekte që kanë kosto financiare.

Përpos shërbimeve publike dhe realizimin e premtimeve zgjedhore, institucionet komunale duhet të bëjnë çmos që banorët e këtyre komunave të ndiejnë institucionin komunal si të tyre. Kjo mund të arrihet kur udhëheqësit komunal bëhen plotësisht transparent për vendimet që marrin, planifikimet që bëjnë dhe shpenzimet e parasë publike. Duke i ofruar këto informata në mënyrë sa më të qasshme dhe online, dhe duke i konsultuar për vendime dhe projekte të rëndësishme, qeveritë lokale mund të ngrisin besimin tek qytetarët e këtyre komunave.

Institucionet e Kosovës kanë nevojë për besim më të madh nga qytetarët e këtij vendi. Udhëheqësit lokal mund të ngrisin besimin në institucionet lokale duke iu ofruar shërbime cilësore, infrastrukturë bazike por edhe duke i takuar për hallet e tyre dhe konsultuar për çështjet e komunitetit dhe lagjeve të tyre.

Aneks: Premtimet e Gjitha Komunave

Premtimet Deçan

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Penda në Hulaj dhe “Grykë të Deçanit	Pa-realizuar
2	Shëtitoren përgjatë lumit “Lumëbardhi”	Pa-realizuar
3	Rruga Deçan-Plavë	Kanë filluar punimet
4.	Asfaltimin e gjitha rrugëve lokale	Pjesërisht
5.	Bursa për studentët	Planifikuar
6.	Uji të pijes për gjitha fshatrat	Pjesërisht
7.	Investime të shumta në bujqësi	Planifikuar me buxhet pamjaftueshëm
8.	Transparencë më të madhe	Pjesërisht

Gjakovë

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Projekte Kapitale: “Zgjerimi i rrugës në dalje të Prizrenit dhe Pejës”.	Pa-realizuar
2	Përfshirje të qytetarit në të gjitha proceset e planifikimit dhe marrjes së vendimeve në lidhje me të ardhmen e Komunës”.	Realizuar
3	“Ndërtimi i Gjakovës së Re dhe Qendra e Kongreseve”	Pa-realizuar
4.	Ndërtimi i Pikave Grumbulluese të qumështit me brend “Gjakova Quality”.	Pa-realizuar
5.	Zhvillimi i programeve për ndërmarrësi dhe inovacion në Universitetin e Gjakovës	Planifikuar me buxhet pamjaftueshëm
6.	Sigurimi i pjesëmarrjes së klubeve sportive nëpër ligat elite të vendit dhe liga ndërkombëtare	Planifikuar me buxhet pamjaftueshëm
7.	Reduktimi i 12 Drejtorive në 9 Drejtori	Pa-realizuar
8.	Fondi për Ndërmarrje Publike të Vogla dhe Mesme	Pa-realizuar
9.	Fondi për Bujqësi	Pa-realizuar

Kaçanik

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Pajisja e shkollave me mjete konkretizuese	E perealizuar
2	Themelimi edhe i dy drejtorive komunal	E perealizuar
3	Asfaltimi i rrugës së fshatit Sllatinë	I realizuar
4.	Instalimi i sistemit të kamerave në shkolla	Pjesërisht i realizuar
5.	Ndërprerja e ndotësve të mëdhenj të ambientit	E perealizuar
6.	Ndërtimi i shkollës në Kaçanik të Vjetër	Planifikuar, por me buxhet të pamjaftueshëm
7.	Ndërtimi dhe revitalizimi i monumenteve historike	Pjesërisht i realizuar dhe i planifikuar me buxhet

Klinë

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Ndërtimi i tri shkollave në fshatrat, Këpuz, Perqevë dhe Jashanicë	Pjesërisht (Në Këpuz nuk ka filluar)
2	Ndërtimin e Çerdhes për fëmijë	Planifikuar
3	Vazhdimi i ndërtimit të objektit për kategoritë e luftës	Realizuar (Duke u punuar)
4.	Rregullimi i Sheshit “Ndue Përlleshi”	Planifikuar (vendimi për rrenim ndërtesash është marrë në Kuvend)
5.	Staza këmbësore deri tek Ujëvarat e Mirushës	Pa-realizuar
6.	Ndihmë në projektin e Mozaikut të Dresnikut	Planifikuar me buxhet (10,000 euro)
7.	Kanalizime dhe ujësjellës në të gjitha fshatrat	Pjesërisht (mbetet numër i madh fshatrash pa kanalizim dhe ujësjellës)
8	Salla e Sporteve	Pjesërisht (nisur në 2005, ende duke u punuar)
9	Ngritje e serave, makina për mjelje lopësh	Planifikuar me buxhet
10	Penda për ujtitje në Kryshëvë të madhe	Duke u realizuar
11	Funksionalizimin e të gjitha sporteve në Klinë	Pa-realizuar
12	Administratë efikase, qeverisje transparente, komunikim me qytetarë	Pjesërisht

Skenderaj

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Hartimi i guidave specifike për promovim biznesi	Pa-realizuar
2	Ri-funksionalizimi i repartit të Stomatologjisë	Realizuar
3	Ndërtimi i ujësjellësve në fshatrat ku ka burim uji	Pa-realizuar
4.	Ndërtimi i Objektit të QKMF-së	Pjesërisht
5.	Ndërtimi i Parkut të Biznesit	Pa-realizuar

Shtime

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Formimin e Drejtorisë për Rini, Kulturë dhe Sport	Realizuar
2	Vazhdimi i qeverisjes së hapur ndaj qytetarëve sikur edhe deri më tani	Realizuar
3	Ndërtimi rrugës transit	Realizuar
4.	Teren Sportiv (Studion Futbollit)	Planifikuar me buxhet (vetëm me PIP)
5.	Përfundimi i Infrastrukturës gjatë 2014 (rrugët, kanalizimi, ujësjellësi,)	Pjesërisht
6.	Zhvillimi i Bujqësisë intensive – (planifikuar në disa segmente të saj por vetëm me PIP)	Pa-realizuar – planifikuar me buxhet pamjaftueshëm
7.	Krijimi i katër zonave të Biznesit	Pa-realizuar – planifikuar me buxhet pamjaftueshëm
8.	Zhvendosja e Gurëthyesve në 2014 – në vendin e përcaktuar sipas Planit Strategjik që i plotëson standardet	Pa-realizuar
9.	Zgjidhja e shpejtë e kontestit në mes Ministrisë dhe Operatorit për Palestrën Sportive	Pa-realizuar

Viti

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Zbatim të ligjit dhe rregulloreve për raportim në Kuvendin Komunal dhe para qytetarëve	Realizuar
2	Organizimi i takimeve me shoqërinë civile dhe me qytetarë nëpër lokalitetet e komunës	Realizuar
3	Pavarësimi i shkollës së mesme në Pozheran	Realizuar
4.	Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore	Realizuar

5.	Zgjerimi i hapësirave të gjelbëruara në Viti	Realizuar
6.	Ndërtimi i fushave të vogla sportive në shumicën e fshatrave	Realizuar
7.	Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në fshatin Beguncë	Planifikuar me buxhet
8.	Rregullimi i sistemit të ujësjellësit në Viti	Planifikuar me buxhet
9.	Rregullimi i shtratit të lumit Morava	Pjesërisht
10.	Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Pozheran	Realizuar
11.	Ndërtimi i palestrës sportive në Viti	Planifikuar me buxhet pamjaftueshëm
12.	Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në fshatin Pozheran	Planifikuar me buxhet pamjaftueshëm
13.	Zhvillimi ekonomik dhe zbutja e papunësisë	Pa u realizuar
14.	Hapja e zyrës për diasporë dhe tërheqje të investimeve	Pa u realizuar

Malishevë

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Realizimi i projekteve për shtrimin e rrugëve në disa fshatra si: Balincë, Astrazup, Lumnishtë, Turjakë, Tërpezë, Fshati i Ri, Bellanicë, Bardhë,	Pjesërisht (në të gjitha fshatrat e cekur janë shtruar disa rrugë)
2	Projekti i ujësjellësit për fshatin Drenoc,	Pjesërisht - faza (I)
3	Akumulacioni i ujërave të shpella e Panorcit (2015-2016)	Pjesërisht Fillimi i realizimit të projektit nëntor 2014
4.	Ndërtimi i shkollës fillore Bubavec	Fillimi i realizimit të projektit
5.	Ndërtimi i shkollës fillore Gollubovc	Pjesërisht
6.	Ndërtimi i shkollës fillore Carralluk	Pjesërisht - Fillimi i ndërtimit
7.	Ndërtimi i shkollës fillore Gurisht	Pjesërisht

Juniku

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Fabrika për grumbullimin dhe përpunimin e frutave të malit	Realizuar
2	Stacioni i autobusëve	Realizuar
3	Përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	Pjesërisht
4.	Ndërtimi i kompleksit turistik "Moronica",	Pjesërisht
5.	Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm	Pjesërisht
6.	Tregu i gjelbër	Pa realizuar

Mamushë

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Shtimi i numrit të serave	Pa-Realizuar
2	Rregullimi i sistemit të ujit për tokat bujqësore	Pa-Realizuar
3	Themelimi i një universiteti në Mamushë	Pa-Realizuar
4.	Përmirësimi i performancës në arsim , shëndetësi dhe kulturë	Pjesërisht
5.	Ngritja e kualiteti të jetës	Pjesërisht

Graçanicë

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Ndërtimi i qendrës së shkollës së mesme	Nuk është realizuar
2	Aftësimi i sistemit për sjellje të ujit nga liqeni i Gazivodës në atë të Badovcit	Është realizuar
3	Sistemi alternativ i ujësjellësit	Është realizuar
4.	Ndërtimi i azilit për kafshë	Ka filluar
5.	Avancimi i sistemit shëndetësor – sigurimi i pajisjeve mjekësore për institucionet shëndetësore	Ka filluar

Prizren

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Shtimi i kapaciteteve të ujit të pijes	Pjesërisht
2	Ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujerave të zeza	Pa realizuar
3	Ndërtimi i tregjeve dhe parkingjeve me partneritet PP	Pa realizuar
4.	Trafiku urban me Partneritet PP	Pa realizuar
5.	Ndërtimi i sheshit të lidhjes së Prizrenit	Në ndërtim e sipër(faza përfundimtare)
6.	Kompletimi i planit për menaxhim të mbeturinave	Realizuar
7.	Ndërtimi i objektit të bibliotekës	Fillimi i realizimit të projektit

Suharekë

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Punësimi i te rinjve përmes biznesit me ane te subvencioneve	Pa realizuar (Parashikimi-180 mijë euro janë paraparë për realizimin e këtij premtimi për 2015-2017)
2	Përkrahje OJQ-ve ne Suhareke përmes projekteve, ne vlere prej 300 mijë euro	Pjesërisht
3	Hulumtimi dhe hartimi i projektit detal te ujërave te zeza ne Suhareke	Pa realizuar (Premtimi përgjatë mandatit katër vjeçar)
4.	Ndërtimi i shkollave Nishor, Leshan, dhe ndërtimi i 3 çerdheve për fëmijë	Pa realizuar (Premtimi 2015)
5.	Ndërtimi i terreneve sportive ne disa vendbanime vlere prej 900.000 euro	Realizuar (Pjesërisht)
4.	Ujësjiellësi (Investime në ato banime që nuk kanë ujësjiellës fare apo e kanë te rrjetin e dobët ne vlere prej 736900 euro)	Pjesërisht
5.	Ndërtimi i shkollës në Duhel dhe Sllapuzhan	Pjesërisht

Rahovec

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Plani rregullativ për qytetin e Rahovecit	Pa realizuar
2	Përmirësimi me ujë te pijshëm për Rahovec	Pjesërisht
3	Ndërtimi i objektit banimi për familjet e dëshmoreve	Pa realizuar
4.	Krijimi i një trupe amatore, skulptore si dhe përkrahje ansambleve te komunës se Rahovecit	Pa realizuar
5.	Ndërtimi i stacionit te pompave te ujit ne Bërnjak me rezervuar	Pa realizuar
6.	Plani regullativ për qytetin e Rahovecit	Pa realizuar
7.	Përmirësimi me ujë te pijshëm për Rahovec	Pjesërisht

Dragash

	Premtimi Zgjedhor	Statusi
1	Planet zhvillimore dhe urbane	Pa realizuar
2	Investime ne rrjetin e rrugëve Ndërtimi i rrugës qe lidh Dragashin me Republikën e Maqedonisë dhe ndërtimi dhe meremetimi i rrugës Dragash-Zhur	Meremetimi - pjesërisht, rruga Dragash-Maqedoni Pa realizuar
3	Ndërtimi i shkollave ne Lapushnik dhe Buqe	Pa realizuar
4.	Ndërtimi i ambulancave ne Globocice, meremetimi i QMF-se ne Dragash dhe QMF-së në Blaq	Globoqic (Pjesërisht) Te tjerat përfundim e sipër (faza përfundimtare)
5.	Energjia efiqente në institucione publike	Pjesërisht

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

352 (496.51)(047)

Pasqyra e komunës një vit pas zgjedhjeve lokale : a është
bërë gjithçka e mundur? / Instituti Demokratik i Kosovës. –
Prishtinë : Instituti Demokratik i Kosovës, 2014. – 185 f. :
ilustr. ; 28 cm.

ISBN 978-9951-8901-2-0

